FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 71

Tiranë – E premte, 13 maj 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 29.4.2022	Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative	8739

UDHËZIM
Nr. 6, datë 29.4.2022

PËR PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË SË UNIFIKUAR PËR HARTIMIN E AKTEVE NORMATIVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 5, dhe 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, duke pasur në konsideratë që ministri i Drejtësisë ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi, bashkërendimin e punës me institucionet e tjera, në funksion të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, si dhe përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të sigurojë që gjatë procesit të hartimit të akteve normative nga çdo autoritet publik të garantohet qartësia, kuptueshmëria dhe qëndrueshmëria e rregullimeve normative, si dhe të rritet cilësia e procesit legjislativ në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen nga autoritetet publike dhe nga personat që marrin pjesë në procesin e hartimit, konsultimit, shqyrtimit dhe miratimit të akteve normative.

Neni 4
Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Akte normative" nënkupton ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, aktet normative të ministrave dhe organeve drejtuese të autoriteteve të tjera, të cilat kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre, si dhe aktet normative që nxirren nga organet e pushtetit vendor, që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe;

b) "Akte ligjore parësore" nënkupton aktet ligjore të cilat rregullojnë një tematikë të veçantë, komplekse dhe që prodhojnë pasoja juridike, si rregull, për një kohë të pakufizuar;

c) "Akte nënligjore parësore" nënkupton aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjeve;

ç) "Akte ligjore ndryshuese" nënkupton aktet që ndryshojnë, zëvendësojnë, shtojnë ose shfuqizojnë aktet ligjore parësore apo dispozita të caktuara të tyre;

d) "Akte nënligjore ndryshuese" nënkupton aktet që ndryshojnë, zëvendësojnë, shtojnë ose shfuqizojnë aktet nënligjore parësore ose dispozita të caktuara të tyre;

dh) "Përafrimi" nënkupton procesin e përqasjes së ligjeve, rregullave dhe procedurave të brendshme të një shteti me të drejtën e Bashkimit Evropian, në funksion të përmbushjes së detyrimeve që burojnë për shtetet që aspirojnë të anëtarësohen në të;

e) "Manual për Hartimin e Legjislacionit" nënkupton rregullat e detajuara për hartimin e legjislacionit, të cilat garantojnë aftësimin e hartuesve me cilësitë e nevojshme profesionale për të hartuar rregullime normative cilësore dhe të qëndrueshme, bashkëlidhur si shtojcë e këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij.

KREU II
RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR HARTIMIN E AKTEVE NORMATIVE

Neni 5
Rregullat kryesore për hartimin e akteve normative

Autoritetet publike dhe personat që marrin pjesë në procesin e hartimit, konsultimit, shqyrtimit dhe miratimit të akteve normative sigurojnë, që akti:

a) të jetë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi;

b) të jetë në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë;

c) kur është rasti, të jetë në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit të Bashkimit Evropian;

ç) të jetë gjithëpërfshirës dhe të mos përmbajë elemente diskriminuese;

d) të mos përmbajë karakteristika të veçanta apo mangësi të karakteristikave të veçanta që krijojnë hapësira për korrupsion gjatë zbatimit, sipas përcaktimeve në Manualin për Hartimin e Legjislacionit;

dh) të hartohet në përputhje me rregullat e hartimit të akteve të përcaktuara në këtë udhëzim dhe në Manualin për Hartimin e Legjislacionit.

Neni 6
Rregullimi normativ

Gjatë procesit të vlerësimit të nevojës për ndërmarrjen e nismës normative, në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore, hartuesi merr parasysh listën me çështje të përgjithshme që duhet të identifikohen dhe të adresohen, duke shpjeguar, nëse:

a) problemi është identifikuar në mënyrë të saktë;

b) veprimi për ndërmarrjen e nismës është i justifikuar;

c) rregullimi normativ është forma më e mirë e veprimit për trajtimin e problemit;

ç) rregullimi normativ ka bazë ligjore;

d) niveli i qeverisjes i përzgjedhur për rregullimin normativ është i duhuri për arritjen e objektivave të synuar në mënyrë efektive;

dh) përfitimet justifikojnë kostot e rregullimit normativ;

e) shpërndarja e efekteve në shoqëri është transparente;

ë) palët e interesuara kanë pasur mundësi për të parashtruar pikëpamjet e tyre;

f) masat që do të ndërmerren sigurojnë zbatimin e rregullimit normativ.

Neni 7
Hartimi i akteve normative

1. Autoritetet publike dhe personat që marrin pjesë në procesin e hartimit, konsultimit, shqyrtimit dhe miratimit të akteve normative veprojnë me profesionalizëm në çdo fazë të hartimit të akteve normative, për të siguruar që:

a) teksti i aktit të jetë i thjeshtë, i qartë, duke përdorur gjuhë të saktë dhe të kuptueshme;

b) fjalitë të jenë të shkurtra dhe të strukturuara qartë;

c) forma dhe përmbajtja e aktit të jetë në përputhje me autorizimin ligjor dhe legjislacionin në fuqi;

ç) dispozitat e aktit të jenë në harmoni me njëra-tjetrën, si dhe të përdoret i njëjti term për të shprehur të njëjtin koncept, me qëllim shmangien e pasigurisë, paqartësisë së tekstit dhe mundësinë e keqinterpretimit;

d) të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të cilave u drejtohet akti të jenë të përcaktuara qartë;

dh) akti të jetë i strukturuar, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim;

e) të shmangen dispozitat të cilat nuk kanë karakter normativ, të tilla si: dëshira, synime, përcaktime me karakter deklarativ, deklarata politike ose shprehje të filozofisë mbi të cilën është mbështetur akti;

ë) data e hyrjes në fuqi e aktit normativ, dispozitat me efekt ndryshues mbi aktet e tjera, si dhe dispozitat kalimtare apo të përkohshme të jenë të mirëpërcaktuara apo të përcaktueshme.

2. Rregulla më të detajuara për hartimin e akteve normative parashikohen në Manualin për Hartimin e Legjislacionit.

Neni 8
Vlerësimi i hapësirave korruptive në legjislacion

1. Autoritetet publike dhe personat që marrin pjesë në procesin e hartimit, konsultimit, shqyrtimit dhe miratimit të akteve normative sigurojnë që akti të mos krijojë hapësira korruptive, sipas përcaktimit të këtij udhëzimi dhe Manualit për Hartimin e Legjislacionit.

2. Gjatë procesit të hartimit të aktit, me qëllim shmangien e hapësirave korruptive, mbahen në vëmendje rregullat e mëposhtme:

a) çdo akt ligjor ose nënligjor, gjatë procesit të hartimit të tij, duhet t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit të hapësirave ligjore për korrupsion, sipas rregullave të përcaktuara në Manualin për Hartimin e Legjislacionit; njëkohësisht duhet të sigurohet që relacioni shpjegues i projektaktit të hartohet në mënyrë të saktë dhe të qartë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Manualin për Hartimin e Legjislacionit, pasi luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kuptimit të dispozitave të caktuara;

b) vlerësimi i hapësirave ligjore për korrupsion duhet të kryhet në të gjitha fazat e procesit legjislativ;

c) grupi i punës, gjatë fazës së hartimit të aktit, duhet të zbatojë rregullat e përcaktuara në Manualin për Hartimin e Legjislacionit, me qëllim që të shmangen hapësirat ligjore për korrupsion;

ç) kur vlerësohet ligjshmëria e formës dhe e përmbajtjes së çdo projektakti nga Ministria e Drejtësisë, tregohet kujdes i veçantë në dy kategori të risqeve për korrupsion:

i. "mungesa e qartësisë" në gjuhë apo teknikë legjislative; dhe

ii. "boshllëqet rregullatore", të tilla si mungesa e afateve ose e rregullave procedurale të qarta;

d) ministritë e linjës, gjatë ripunimit të projektaktit, vërejtjet dhe sugjerimet e ministrit të Drejtësisë në drejtim të hapësirave për korrupsion i shqyrtojnë me përparësi;

dh) për çdo projektakt normativ sigurohet konsultimi gjithëpërfshirës me grupet e interesit, profesionistët e fushës dhe palët e tjera të interesuara.

KREU III
STRUKTURA E AKTIT NORMATIV

Neni 9
Struktura e aktit normativ

Struktura e aktit normativ është si vijon:

a) Titulli: Titulli i aktit duhet të jetë në përputhje me autorizimin ligjor. Titulli duhet të jetë i saktë, i shkurtër dhe gjithëpërfshirës. Titulli përmban numrin e aktit dhe datën/vitin e miratimit.

b) Preambula: Preambula përmban informacion lidhur me kontekstin dhe qëllimin e hartimit të aktit normativ. Preambula mund të përdoret, kur, për shkak të rëndësisë apo historisë së hartimit të aktit, është e nevojshme që informacioni lidhur me kontekstin dhe qëllimin të bëhet i ditur.

c) Baza ligjore: Çdo akt normativ duhet të ketë një bazë ligjore. Në rastin e akteve ligjore, baza ligjore përmban informacionin për dispozitat kushtetuese në bazë të të cilave miratohet, propozuesin e projektaktit dhe autoritetin miratues të tij. Në rastin e akteve nënligjore normative përmban informacionin për dispozitat ligjore në bazë dhe për zbatimin e të cilit miratohet, autoritetin propozues të aktit dhe autoritetin miratues. Baza ligjore duhet të ketë një referencë konkrete dhe të evidentohet qartë. Nëse dispozita ligjore autorizuese është e ndarë, i bëhet referencë të gjitha nënndarjeve të cilat mund të përdoren për të përcaktuar bazën ligjore.

ç) Objekti: Akti normativ përmban një dispozitë për objektin e tij, e cila përcakton fushën e të drejtave dhe detyrimeve që rregullon, si dhe të kritereve dhe procedurave që përmban akti.

d) Qëllimi: Dispozita e qëllimit duhet të jetë e shkurtër dhe koncize dhe të sigurojë arsyet kryesore për të kërkuar iniciativën ligjore apo nënligjore dhe parimet kryesore që mbështesin këtë iniciativë.

dh) Fusha e zbatimit: Dispozita e fushës së zbatimit përmban kufijtë e zbatimit të aktit normativ, si dhe fushën e veprimit të autoriteteve të parashikuara nga akti normativ.

e) Përkufizimet: Përkufizimet japin kuptimin e termave kryesorë të përdorur në tekstin e një akti normativ. Përkufizimet renditen sipas rendit alfabetik të gjuhës shqipe. Përkufizimet nuk duhet të përdoren për të shprehur rregullime ligjore. Çdo

përkufizim duhet të përmbajë një koncept ose një fjalë të vetme dhe duhet të ketë të njëjtin kuptim, sipas fjalorit të gjuhës shqipe ose terminologjisë juridike të përdorur. Termat të cilët janë standardë, të njohur ose të pranuar si standardë në gjuhën juridike ose në gjuhën e përgjithshme, nuk duhet të përkufizohen.

ë) Dispozitat për procedurat administrative: Në përgjithësi, kompetencat administrative lidhur me zbatimin e aktit ushtrohen nga autoritetet shtetërore qendrore ose vendore. Këto dispozita përmbajnë parashikime procedurale, që lidhen me kryerjen e detyrave nga strukturat dhe autoritetet përgjegjëse, si dhe me zbatimin e aktit.

f) Dispozitat lëndore/materiale: Dispozitat lëndore paraqesin lëndën e një akti normativ. Këto dispozita përmbajnë kryesisht të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ndryshme të së drejtës, të cilët mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

g) Dispozitat e vlerësimit: Këto dispozita parashikojnë detyrimin për të bërë vlerësime dhe për të nxjerrë raporte për zbatueshmërinë e aktit normativ.

gj) Dispozitat e delegimit: Këto dispozita duhet të hartohen saktë, të përcaktojnë autoritetin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës.

h) Dispozitat e sanksioneve: Dispozitat që përfshijnë përgjegjësinë penale, administrative ose civile hartohen saktë dhe në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.

i) Dispozitat për nxjerrjen e akteve nënligjore: Përveç shtjellimit të dispozitave të veçanta të delegimit për nxjerrjen e akteve nënligjore, të gjitha autorizimet ligjore mblidhen në një nen të veçantë në fund të ligjit, përpara dispozitave kalimtare, duke përcaktuar autoritetet kompetente dhe afatet për miratimin e akteve nënligjore.

j) Dispozitat e shfuqizimeve: Çdo akt normativ duhet të përmbajë referencë të qartë, në dispozitat e fundit, që specifikon se cili akt normativ i mëparshëm ose dispozita të akteve të mëparshme shfuqizohen nga ky akt. Referencat duhet të jenë shumë të sakta. Në dispozitat shfuqizuese nuk duhet përdorur gjuhë e përgjithshme apo e paspecifikuar. Në veçanti, hartuesi duhet të bëjë kujdes që të mos shfuqizojë akte apo dispozita të akteve që janë adaptuar si pasojë e përafrimit të legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përveç kur ka arsye të bazuar dhe specifike për ta bërë këtë.

k) Dispozitat me efekt ndryshues mbi akte të tjera: Në veçanti, aktet normative mund të përmbajnë dispozita për ndryshime në akte të tjera, të cilat njihen edhe si ndryshime horizontale. Sidoqoftë, kur kemi të bëjmë me ndryshime të rëndësishme të akteve të tjera, këto ndryshime vendosen në një akt të veçantë. Duhet të tregohet kujdes i veçantë në ndryshimin e ligjeve që janë miratuar me shumicë të cilësuar, të cilat nuk mund të ndryshohen me akte të tjera ligjore pa pasur përsëri shumicën e cilësuar.

l) Dispozitat kalimtare: Këto dispozita përcaktojnë rregulla për efektin kohor dhe hapësinor të dispozitave që shfuqizohen ose hyjnë në fuqi. Dispozitat kalimtare përcaktojnë procedurën për kalimin nga regjimi i mëparshëm ligjor në regjimin e ri.

ll) Dispozita e hyrjes në fuqi për akte ligjore: Çdo ligj duhet të specifikojë datën në të cilën hyn në fuqi. Nëse hyrja në fuqi nuk specifikohet në mënyrë të qartë, ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare. Hartuesi mund të vendosë që një apo disa nene të veçanta të hyjnë në fuqi në një datë të ndryshme nga hyrja në fuqi e ligjit në tërësi. Dispozita për hyrjen në fuqi vendoset në pjesën e fundit të ligjit për të garantuar që kjo dispozitë i referohet ligjit në tërësi.

m) Dispozita e hyrjes në fuqi për akte nënligjore: Aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare. Për vendimet me karakter normativ të Këshillit të Ministrave mund të caktohet si datë hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit në Fletoren Zyrtare. Aktet nënligjore normative mund të zbatohen për një periudhë kohore të caktuar ose kohëzgjatja e efekteve të tyre të varet nga kushte të caktuara.

Neni 10

Njësitë strukturore të aktit dhe pjesët përbërëse

Struktura sipas ndarjes formale të aktit normativ paraqitet në rend zbritës, si vijon:

a) Pjesët: përdoren në rastet e teksteve të ligjeve që përmbledhin shumë çështje, siç janë kodet. Ato

janë të numërtuara në mënyrë të njëpasnjëshme, me fjalë ose me numra të mëdhenj romakë;

b) Titujt: Pjesët e një ligji ndahen në tituj, ku secili titull përmban disa krerë. Ashtu si edhe pjesët, titujt përdoren kryesisht në kode. Titujt numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme me numra të mëdhenj romakë;

c) Krerët: Në rastet e akteve normative të gjata, me më shumë se 15–20 nene, nenet me objekt të njëjtë bashkohen me krerë. Krerët numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme me numra të mëdhenj romakë;

ç) Seksionet: Nenet e një kreu që kanë objekt të njëjtë, nëse janë të shumtë, grupohen në seksione. Seksionet numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme me numra arabë;

d) Nenet: Njësia themelore strukturore e një teksti normativ janë nenet. Formati i neneve duhet të jetë i tillë që ta bëjë nenin të lexueshëm si një të tërë. Nenet hartohen jo shumë të gjatë dhe numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme me numra arabë. Nenet emërtohen me tituj, njëlloj si në rastin e ndarjeve të aktit. Titulli i nenit duhet të jetë i saktë dhe i kuptueshëm, pasi ndikon në interpretimin e nenit;

dh) Paragrafët: paraqesin ndarjen bazë të një neni. Si rregull, neni nuk duhet të ketë më shumë se tre ose katër paragrafë. Në rast se është e nevojshme që neni të ketë më shumë paragrafë, hartuesi merr në konsideratë mundësinë e ndarjes së tekstit në nene të ndryshme. Paragrafët e një neni numërtohen me numra rendorë arabë dhe ndiqen nga një pikë;

e) Nënparagrafët: paraqesin ndarjen bazë të një paragrafi. Në rast se paragrafët e një neni rregullojnë çështje komplekse ose voluminoze, ata ndahen në nënparagrafë. Nënparagrafët numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme, me shkronja të vogla të alfabetit shqip dhe me një kllapë të vetme. Nënparagrafët përdoren zakonisht për të qartësuar tekstin e një paragrafi të gjatë, sidomos kur përmban disa çështje të ndryshme;

ë) Nënnënparagrafët: paraqesin ndarjen bazë të një nënparagrafi. Në raste të veçanta, nënparagrafi ndahet në nënnënparagrafë. Nënnënparagrafët shënohen me numra romakë të vegjël dhe me një kllapë të vetme.

Neni 11
Shtojcat e akteve normative

1. Listat, tabelat, tarifat, diagramet, fotografitë, formulat dhe të tjera të ngjashme vendosen si shtojca të akteve normative, përveç rasteve kur është e domosdoshme të vendosen në nënndarjet e akteve dhe janë pjesë përbërëse e tyre.

2. Për hartimin e tabelave zbatohen rregullat e parashikuara në pikën 2, të nenit 13, të këtij udhëzimi.

3. Shtojca duhet të ketë një titull. Në rastet kur ka më shumë se një shtojcë, ato marrin numrat në bazë të radhitjes që i përputhet radhitjes së dispozitave me të cilat janë të ndërlidhura.

Neni 12
Shkrimet fundore

1. Shkrimet fundore duhet të shmangen gjatë hartimit të akteve normative.

2. Përjashtimisht, shkrimet fundore përdoren:

a) për numrat *CELEX*, të cilat nuk janë pjesë e tekstit dhe përdoren për të përcaktuar akte të *acquis* të Bashkimit Evropian që përafrohen nga projektakti normativ përkatës;

b) për akte normative shumë teknike që u referohen parimeve komplekse ose kur është e nevojshme që të jepen udhëzime dhe sqarime, për aq kohë sa bëhet e qartë se ato kanë rol informues dhe si të tilla nuk janë pjesë e tekstit të aktit normativ.

3. Duhet të shmanget theksimi i fjalëve ose i frazave në shkrimet fundore.

KREU IV
ORGANIZIMI DHE PËRMBAJTJA E AKTIT NORMATIV

Neni 13
Formatimi i tekstit normativ

1. Teksti bazë i aktit normativ shkruhet sipas rregullave të mëposhtme:

a) teksti i aktit normativ hartohet në llojin e shkronjave *(font-in)* "*Times New Roman*" të madhësisë 12;

b) hapësira ndërmjet rreshtave është e rregullt, 1.15;

c) vendosja e tekstit në faqe është e baraslarguar nga anët *(justified);*

ç) fillimi i paragrafit zhvendoset 0.5" (gjysmë inç) nga vendi ku fillon normalisht teksti;

d) gjerësia e faqes nuk kalon kufijtë *(margins)* e mëposhtëm: në krye *(top)* 1"; në fund *(bottom)* 1"; majtas *(inside)* 1"; djathtas *(outside)* 1".

2. Në rastin e tabelave, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) lloji i shkronjave të tabelës është "*Times New Roman*";

b) emri i tabelës vendoset sipër tabelës me *"Bold";*

c) teksti i tabelës dhe titujt e kolonave hartohen në "*Times New Roman*", madhësia e shkronjave 12;

ç) teksti i *"font*-it" është "*bold*" për titujt e kolonave dhe i rregullt (*regular*) "*Times New Roman*", madhësia e shkronjave 12, për të gjitha qelizat e tjera të tabelës;

d) gjerësia maksimale e tabelës është "6.25";

dh) burimet e tabelës citohen poshtë tabelës, pa hapësirë rreshtash, në "*Times New Roman*", madhësia e shkronjave 10.

3. Shtojcat vendosen në pjesën e fundit të aktit normativ.

4. Çdo faqe e aktit normativ duhet të ketë numra duke filluar nga numri 1 (një).

Neni 14
Organizimi i fjalive

1. Fjalitë duhet të jenë të shkurtra dhe të qarta.

2. Duhen shmangur fjalitë pa kuptim normativ, si rekomandimet, deklaratat, motivacionet ose parashikimet.

Neni 15
Përzgjedhja e fjalëve

1. Fjalët e përdorura në tekstin normativ duhet të jenë në gjuhën shqipe, bashkëkohore dhe të përdoren në kuptimin e tyre të zakonshëm dhe kryesor.

2. Duhet të shmangen fjalët apo shprehjet joformale.

3. Duhet të shmanget përdorimi i fjalëve arkaike, të cilat nuk përdoren shpesh apo nuk kuptohen, si dhe i neologjizmave të cilat nuk janë bërë ende pjesë e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe.

Neni 16
Fjalët e huaja

1. Fjalët me origjinë të huaj duhet të shmangen nëse është e përshtatshme një shprehje përgjithësisht e njohur në gjuhën shqipe.

2. Fjalët dhe shprehjet e huaja përdoren vetëm nëse ato janë pranuar në përdorimin e përditshëm të gjuhës shqipe dhe për to nuk ka fjalë tjetër në gjuhën shqipe.

3. Për arsye ligjore, në hartimin e akteve normative mund të përdoren fjalë apo shprehje të huaja për të siguruar përshtatje me dispozitat e akteve ndërkombëtare apo me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

4. Kur përdoren fjalë ose shprehje të huaja, ato shkruhen me shkronja kursive.

Neni 17
Shprehjet teknike

1. Shprehjet teknike që janë krijuar dhe përdoren në fusha të kufizuara duhet të shmangen.

2. Shprehjet teknike mund të përdoren në rastet kur bëjnë pjesë në fjalorin e zakonshëm profesional të personave të cilëve u drejtohet akti normativ. Shprehje të tilla duhet të përkufizohen nëse përdoren në një akt normativ me përdorim të gjerë.

Neni 18
Termat ligjorë

1. Termat ligjorë përdoren në kuptimin e tyre të zakonshëm ligjor, siç përcaktohet në legjislacionin ekzistues, në vendimet gjyqësore dhe në doktrinën mbizotëruese.

2. Kur është e nevojshme, si edhe në rastin e termave të huaj, hartuesi i aktit normativ jep një përkufizim për termin përkatës të përdorur.

Neni 19
Shkurtesat

1. Kur në të njëjtin tekst të aktit normativ është e nevojshme të përsëritet një shprehje e caktuar, zëvendësimi i saj me një shkurtim është i mundur, me kusht që shkurtimi të shpjegohet kur përdoret për herë të parë.

2. Shkurtesat shkruhen me shkronja të mëdha dhe nuk duhet të kenë pika ndërmjet ose në fund të tyre.

Neni 20
Numrat

Në tekstin e aktit normativ, numrat, si rregull, shënohen me numër arab të shoqëruar me përshkrimin me shkronja në kllapa, me përjashtim të rasteve kur përdoren në tabela apo formula matematikore.

Neni 21
Datat

1. Datat shkruhen me numra arabë dyshifrorë.
2. Muajt shkruhen me shkronja. Shkronjat e para të muajve të vitit shkruhen me shkronja të vogla.
3. Viti shkruhet në formën e plotë katërshifrore.

Neni 22
Njëjësi dhe shumësi

1. Gjatë hartimit të aktit normativ përdoret njëjësi, me qëllim që të shmanget dykuptimësia.
2. Në aktin normativ, njëjësi nënkupton edhe shumësin.

Neni 23
Gjuha politikisht asnjanëse

Aktet normative hartohen me një gjuhë politikisht asnjanëse.

Neni 24
Gjuha asnjanëse përkundrejt gjinisë

1. Aktet normative hartohen në trajtën mashkullore përgjithësuese, duke nënkuptuar të dyja gjinitë.
2. Kur është e mundur, teksti i aktit normativ hartohet me terminologji që është asnjanëse për sa i përket gjinisë, duke përdorur terma me gjini asnjanëse.

Neni 25
Kohët e foljeve

1. Aktet normative hartohen në kohën e tashme.
2. Nëse është e nevojshme që të shprehet lidhja kohore e fakteve, faktet që ndodhin njëkohësisht me veprimin e aktit normativ jepen në kohën e tashme dhe faktet që paraprijnë veprimin e aktit normativ në kohën e shkuar.
3. Nëse është e nevojshme që të citohen ngjarje të së shkuarës dhe të së ardhmes, referohet në kohën kur miratohet ose kur hyn në fuqi akti normativ, duke përmendur faktet e njëkohshme me veprimin e aktit normativ në kohën e tashme.

Neni 26
Mënyrat

Aktet normative hartohen në mënyrën dëftore.

Neni 27
Trajtat

1. Aktet normative hartohen në trajtën veprore.
2. Trajta pësore duhet të shmanget kur është e mundur.

Neni 28
Lidhëzat

1. Lidhëza "dhe" përdoret për të bashkërenduar dy pjesë të një fjalie.
2. Lidhëza "ose" përdoret për të veçuar ose për të treguar alternativat.
3. Duhet shmangur përdorimi i lidhëzës së përbërë "dhe/ose", sepse krijon dyshime nëse kushtet duhen plotësuar në mënyrë alternative apo në mënyrë kumulative.
4. Në vend të lidhëzave, mund të përdoren formulat hyrëse për të treguar raportin mes fjalëve, shprehjeve ose nënparagrafëve.

Neni 29
Emrat e prejardhur nga foljet

Përdorimi i emrave të prejardhur nga foljet shmanget kur mund të përdoren foljet.

Neni 30
Foljet modale

Gjatë hartimit të aktit normativ duhet krijuar praktikë e qëndrueshme për përdorimin e foljeve modale, në varësi të faktit nëse tregojnë një kërkesë taksative ose një të drejtë diskrecionale. Përdorimi i tyre i gabuar nga pikëpamja gramatikore apo jo në mënyrë të njëllojtë shkakton paqartësi në lidhje me karakterin lejues ose detyrues të dispozitës.

Neni 31
Shenjat e pikësimit

1. Për të përforcuar kuptimin e tekstit të aktit normativ, përdoren shenjat e pikësimit.

2. Gjatë pikësimit duhet pasur parasysh gjatësia dhe struktura e fjalisë, rendi i fjalëve dhe të përdoren ato elemente që e transmetojnë kuptimin në mënyrë më të qartë.

3. Pikësimi dhe shenjat sintaksore përdoren si vijon:

a) pika: përdoret në kuptimin e saj të zakonshëm sintaksor dhe, veçanërisht, në fund të neneve dhe paragrafëve;

b) presja: përdoret në kuptimin e saj të zakonshëm sintaksor;

c) dy pikat: përdoren në kuptimin e tyre të zakonshëm sintaksor dhe, veçanërisht, pas pjesës hyrëse të paragrafit;

ç) pikëpresja: përdoret në kuptimin e saj të zakonshëm sintaksor dhe, veçanërisht, për ndarjen e nënparagrafëve ose nënnënparagrafëve;

d) thonjëzat: përdoren në kuptimin e tyre të zakonshëm sintaksor dhe, veçanërisht, për terma të përkufizuar dhe përfshirjen e një teksti të ri nëpërmjet akteve ndryshuese;

dh) viza lidhëse: përdoret veçanërisht për të lidhur fjalët e përbëra;

e) kllapat rrethore dhe kllapat katrore: si rregull shmangen; kllapat përdoren për shkurtesa dhe numra;

ë) shenja e përqindjes: përdoret kur është e nevojshme, veçanërisht në tabela, ndërsa në tekst përdoret fjala "për qind" me shkronja;

f) pikëpyetja dhe pikëçuditësja: nuk duhen përdorur;

g) shenja e paragrafit "§": nuk duhet përdorur.

Neni 32
Referencat

1. Referencat përdoren në rastet kur teksti i aktit normativ i referohet një parashikimi në të njëjtin akt ose një parashikimi në një akt tjetër.

2. Referenca e brendshme përcakton nenin e saktë, paragrafin ose nënparagrafin tek i cili bëhet referenca, duke filluar nga pjesa më e vogël përbërëse e dispozitës që referohet.

3. Referenca e jashtme identifikon qartë aktin normativ të referuar, duke cituar titullin e plotë, përfshirë numrin dhe datën e miratimit.

4. Në rast se akti i referuar është ndryshuar, referenca e jashtme nuk citon vetë aktin ndryshues, por tregon se është bërë referencë tek akti parësor "i ndryshuar".

5. Duhet të shmanget përdorimi i referencave rrethore dhe zinxhir.

KREU V
AKTET NDRYSHUESE

Neni 33
Ndryshimi, plotësimi ose shfuqizimi i akteve normative

1. Një akt normativ i nivelit më të lartë apo i nivelit të njëjtë mund të shfuqizojë një apo disa akte normative të nivelit të njëjtë apo të nivelit më të ulët.

2. Çdo akt ndryshues shkruhet në atë mënyrë që teksti i ri normativ të respektojë rregullat e gramatikës, drejtshkrimit dhe pikësimit.

3. Ndryshimi, plotësimi ose shfuqizimi i një neni ose i nënndarjeve të tij bëhet përmes një paragrafi të veçantë për çdo nen dhe identifikohet duke përdorur thonjëza.

4. Kur teksti vendoset brenda një njësie strukturore, citohet pjesa pas së cilës vendoset teksti i ri. Në këtë rast, citohet vetëm aq tekst sa është e nevojshme për të identifikuar saktësisht tekstin përtej çdo dyshimi. Togfjalëshi i cili shërben si pikë referimi vendoset në thonjëza. Gjithashtu, teksti që vendoset, identifikohet duke përdorur thonjëza.

5. Kur bëhen ndryshime në një fjali e cila ka lëvizur automatikisht më lart ose më poshtë për sa i përket numërtimit, referenca tek ajo bëhet nëpërmjet përdorimit të emërtimit të ri numerik.

6. Gjatë ndryshimit dhe plotësimit të akteve normative, nenet e reja renditen në vendin e tyre sistematik, duke i dhënë numrin e nenit paraardhës në tekstin e ndryshuar, i pasuar nga një vijë e pjerrët dhe një numër rendor arab.

7. Për të vendosur një ose disa nene pasuese në një vend të caktuar midis neneve, titujt e të cilave përmbajnë vija të pjerrëta për shkak të ndryshimeve të mëparshme, nenit të ri i jepet numri i nenit paraardhës në tekstin e ndryshuar të pasuar nga një shkronjë në rendin alfabetik të shqipes.

8. Kur një njësi strukturore e një niveli më të lartë vendoset pa ndërprerë rendin ekzistues të neneve, vendoset njësia e re strukturore (numri fillestar i njësisë i ndjekur nga një vijë e pjerrët dhe një numër rendor arab) dhe titulli i njësisë strukturore të nivelit më të lartë. Vendi ku kjo ndërhyrje bëhet, duhet të tregohet qartë.

9. Kur një fjalë, togfjalësh ose një numër përdoret disa herë në njësinë strukturore që ndryshohet dhe zëvendësohet në secilin rast, kjo tregohet duke shtuar "në secilin rast".

Neni 34
Titulli i akteve ndryshuese

1. Titulli i akteve ndryshuese duhet të tregojë faktin e ndryshimeve, duke përdorur formulime të përshtatshme, si fjalët: "shtesa", "ndryshime" ose "shtesa dhe ndryshime". Kjo rregull zbatohet në rastin kur akti normativ ndryshon, si dhe kur shfuqizon aktet ekzistuese. Në rastet kur akti normativ vetëm shfuqizon një akt normativ, në titull përdoret fjala "shfuqizim".

2. Për hartimin e titullit të një ligji ndryshues, duhet të përcaktohet ligji i ndryshuar me numrin, datën dhe titullin e tij, pa shtuar asgjë që lidhet me përmbajtjen e vetë ligjit ndryshues.

Neni 35
Baza ligjore e akteve ndryshuese

1. Aktet ndryshuese kanë nevojë për një bazë ligjore.

2. Parashikimet në lidhje me bazën ligjore në aktet parësore zbatohen edhe për bazën ligjore të akteve ndryshuese.

Neni 36
Dispozitat hyrëse në aktet ndryshuese

Çdo ndryshim i një akti parësor paraprihet nga një fjali hyrëse, e cila specifikon aktin që do të ndryshohet, duke përdorur citimin e plotë të tij. Citimi i plotë pasohet nga shprehja standarde "... ndryshohet si më poshtë:".

Neni 37
Formulat ndryshuese

1. Renditja e ndryshimeve bazohet në strukturën e aktit parësor që ndryshohet.

2. Çdo ndryshim hartohet në mënyrë që të jetë i qartë se cili do të jetë formulimi i ardhshëm i aktit normativ.

3. Formula ndryshuese tregon saktësisht se ku ndryshohet teksti dhe çfarë ndryshimi bëhet.

4. Formulat konkrete ndryshuese paraqiten, si vijon:

a) nëse teksti aktual pushon së zbatuari dhe nuk zëvendësohet me tekst të ri: "... shfuqizohet/n";

b) nëse teksti i ri do t'i shtohet tekstit aktual: "... shtohet/n ... përpara ... / ...pas...";

c) nëse teksti i mëparshëm ndryshohet me tekstin e ri: "... ndryshohet(n) si më poshtë ... / ... zëvendësohet/n nga ...".

5. Një fragment teksti i përzier, që për shembull, përmban një numër dhe më shumë se një fjalë të shkruar, referohet si "togfjalësh".

Neni 38
Ndryshimi i titullit

Ndryshimi i titullit shmanget nëse është e mundur.

Neni 39
Ndryshimet gjuhësore të sjella nga propozimi për ndryshime legjislative

1. Ndryshimet e nevojshme gjuhësore, që vijnë nga propozimi për ndryshime legjislative bëhen në dispozita konkrete të aktit normativ.

2. Për hartimin e ndryshimeve gjuhësore mund të përdoren formulat ndryshuese të përbashkëta.

Neni 40
Ndryshimi i shtojcave

1. Ndryshimi i shtojcave të një teksti normativ bëhet në të njëjtën mënyrë si njësitë e tjera strukturore të tekstit normativ.

2. Në rastet kur ndryshimi u referohet vetëm shtojcave të aktit normativ, dispozita hyrëse dhe referimi në ndryshimin e fundit formulohen në të njëjtën mënyrë si bërja e një ndryshimi në një dispozitë të vetme.

3. Nëse bëhen edhe ndryshime të tjera në aktin parësor, formula ndryshuese në lidhje me shtojcën renditet e fundit.

4. Kur shtojcat ndryshohen, zëvendësohen ose shtohen, formula ndryshuese duhet japë drejtpërdrejt formulimin e saj.

5. Nëse teksti në një tabelë ose grafik ndryshon plotësisht, titujt ekzistues mbi kolonën apo grafikun konkret vendosen në formulën ndryshuese së bashku me fushën përkatëse në tabelë apo grafik.

Neni 41
Ndryshimet me pasojë mbi aktet e tjera

1. Ndryshimet që prekin aktet e tjera normative grupohen së bashku në një nen.

2. Në rastet kur ndryshimet përmbajnë edhe shfuqizime të akteve të tjera, duhet të bëhet ndarja midis dispozitave të shfuqizimeve dhe dispozitave të ndryshimeve në akte të tjera, duke i grupuar në dispozita të veçanta, titulli i të cilave të tregojë qartë ndryshimin ose shfuqizimin e akteve të tjera.

3. Neni që përmban ndryshimet që prekin aktet e tjera ndahet në paragrafë.

4. Për secilin ligj apo akt nënligjor që ndryshohet apo shfuqizohet krijohet një paragraf i veçantë në dispozitën përkatëse. Secili paragraf fillon me një fjali hyrëse për ligjin ose aktin nënligjor përkatës.

Neni 42
Akti gjithëpërfshirës

1. Një akt gjithëpërfshirës ("*omnibus*") është mjeti me të cilin akte ligjore të ndryshme ndryshohen ose shfuqizohen me një akt ligjor të vetëm.

2. Akti gjithëpërfshirës përdoret në mënyrë të veçantë, në rastet kur disa akte ligjore parësore preken nga ndryshime kryesore, të cilat janë të lidhura ngushtë sa i takon përmbajtjes.

3. Rregullat për hartimin e akteve parësore zbatohen kryesisht edhe për aktet gjithëpërfshirëse.

KREU VI
RREGULLA TË VEÇANTA PËR AKTET NËNLIGJORE NORMATIVE

Neni 43
Titulli

1. Titulli i një akti parësor nënligjor shkruhet në përputhje me rregullat e përcaktuara dhe të zbatueshme për aktet parësore ligjore.

2. Titulli i aktit parësor nënligjor tregon nivelin e instrumentit legjislativ, duke përfshirë, sipas rastit, fjalën "Vendim", "Rregullore", "Urdhër" ose "Udhëzim".

3. Titujt e akteve nënligjore duhet të ndërtohen në një mënyrë që i bën ato të dallohen lehtësisht nga njëri-tjetri.

Neni 44
Dispozita e bazës ligjore

1. Dispozita e bazës ligjore duhet të përmbushë kërkesën për citim sipas nenit 118 të Kushtetutës.

2. Nëse dispozita e bazës ligjore është e ndarë, duhet t'u bëhet referencë të gjitha nënndarjeve, të cilat mund të përdoren për të përcaktuar bazën ligjore të projektaktit, në mënyrë të saktë (neni, pika, shkronja).

3. Akti parësor ligjor, si bazë ligjore, referohet duke përdorur titullin e plotë dhe datën e miratimit. Nëse akti parësor si bazë ligjore është ndryshuar, kjo duhet të përcaktohet qartë në citimin e aktit si bazë ligjore të aktit nënligjor. Akti ndryshues i aktit parësor që nuk e prek dispozitën e bazës ligjore referohet në bazën ligjore të projektaktit, vetëm nëse ndikon drejtpërdrejt në autorizim.

Neni 45
Struktura e akteve nënligjore

1. Në rastet kur akti nënligjor normativ përmban më pak se 20 (njëzet) paragrafë të

veçantë, struktura e aktit organizohet, sipas rastit, në:

a) paragrafë (të numërtuar përmes numrave rendorë arabë); dhe

b) nënparagrafë (të numërtuar me shkronja të rendit alfabetik të gjuhës shqipe).

2. Në rastet kur akti nënligjor normativ përmban më shumë se 20 (njëzet) paragrafë të veçantë, përdoret teknika legjislative për hartimin dhe strukturimin e akteve ligjore (strukturimi në krerë, nene, paragrafë, nënparagrafë, sipas rastit).

KREU VII
PËRAFRIMI DHE PËRPUTHSHMËRIA E AKTIT NORMATIV ME LEGJISLACIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN

Neni 46
Referencat dhe procesi i përafrimit të legjislacionit

1. Referenca, si rregull, nuk bëhet në tekstin e një akti normativ që nuk është pjesë e rendit juridik shqiptar.

2. Në referencat e drejtpërdrejta te Rregulloret e Bashkimit Evropian bëhet cilësimi, si vijon:

a) Në momentin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, referenca e drejtpërdrejtë në dispozitat konkrete të Rregullores së Bashkimit Evropian bëhet për shkak të zbatueshmërisë së tyre të drejtpërdrejtë;

b) Përpara anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, referenca e drejtpërdrejtë mund të bëhet te legjislacioni vendës, që mbulon lëndën e Rregullores, dhe sigurohet që në momentin e anëtarësimit, legjislacioni vendës automatikisht të shfuqizohet dhe të bëhet referencë e drejtpërdrejtë në Rregulloren e Bashkimit Evropian.

3. Kur referimi bëhet në një akt legjislativ të Komuniteteve Evropiane ose të Bashkimit Evropian, përdoret emërtimi i plotë.

Neni 47
Citimi i së drejtës së Bashkimit Evropian

1. Kur referimi bëhet në një Rregullore të Bashkimit Evropian, në gjuhën shqipe ndiqet renditja, si vijon:

a) emërtimi "Rregullore";

b) emërtimi i shkurtuar i komunitetit miratues në kllapa (KE, KEE, BE);

c) numri rendor zyrtar, që përmban shkurtimin "Nr.", numrin rendor, vijë tërthore dhe vitin e miratimit;

ç) institucioni miratues;

d) data e miratimit;

dh) përcaktimi i përmbajtjes së Rregullores; dhe

e) referenca në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

2. Kur referimi bëhet në një direktivë të Bashkimit Evropian, në gjuhën shqipe ndiqet renditja, si vijon:

a) emërtimi "Direktivë";

b) numri rendor zyrtar, që përfshin vitin e miratimit, numrin rendor dhe emërtimin e shkurtuar të komunitetit miratues (KE, KEE, BE);

c) institucioni miratues;

ç) data e miratimit;

d) përcaktimi i përmbajtjes së direktivës; dhe

dh) referenca në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

3. Kur referimi bëhet në një vendim kuadër ose vendim të Bashkimit Evropian, në gjuhën shqipe ndiqet renditja, si vijon:

a) emërtimi "Vendim Kuadër" or "Vendim";

b) numri rendor zyrtar, që përfshin vitin e miratimit, numrin rendor dhe emërtimin e shkurtuar të institucionit miratues;

c) institucioni miratues;

ç) data e miratimit;

d) përcaktimi i përmbajtjes së vendimit kuadër ose vendimit; dhe

dh) referenca në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

4. Referenca te një korrigjim citon numrin e botimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe numrin e faqes.

5. Kur citohet e drejta e Bashkimit Evropian në shqip, citimi i plotë i një akti legjislativ të Bashkimit Evropian përfshin një referencë te çdo ndryshim të bërë në tekst. Kur një akt legjislativ është ndryshuar disa herë, referenca bëhet vetëm për ndryshimin e fundit. Referenca për një amendament përcakton aktin legjislativ ndryshues, numrin e tij rendor dhe referencën në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

6. Për citimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, shënohet gjithnjë titulli i marrëveshjes

ndërkombëtare dhe data e miratimit të tij. Akti normativ me të cilin marrëveshja ndërkombëtare është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm evidentohet në përmbajtjen e relacionit shpjegues përkatës.

Neni 48
Tabela e përputhshmërisë

1. Gjatë procesit të hartimit të akteve normative, autoriteti propozues përgatit tabelat e përputhshmërisë, të cilat pasqyrojnë shkallën e përputhshmërisë së këtyre akteve normative me *acquis* e Bashkimit Evropian.

2. Modeli i tabelës së përputhshmërisë është sipas shtojcës bashkëlidhur vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave", të ndryshuar.

3. Modeli i tabelës së përputhshmërisë sipas kërkesave të Komisionit Evropian, që shërben për të paraqitur nivelin e përgatitjes për vendet kandidate në Bashkimin Evropian dhe përshtatjen sipas *acquis* së Bashkimit Evropian, gjatë procesit të negociatave për Kapitujt e *acquis* së Bashkimit Evropian, është sipas shtojcës K të Manualit për Hartimin e Legjislacionit.

KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 49
Interpretimi i dispozitave të udhëzimit

Në rast të paqartësive, struktura kompetente për interpretimin e dispozitave të këtij udhëzimi është Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 50
Shtojca e udhëzimit

Manuali për Hartimin e Legjislacionit, botimi i tretë, i bashkëlidhet këtij udhëzimi si shtojcë, pjesë përbërëse e tij.

Neni 51
Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MANUAL

PËR HARTIMIN E LEGJISLACIONIT

Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

EURALIUS Consolidation of the Justice System in Albania

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

Projekt i zbatuar nga:

MANUAL

PËR HARTIMIN E LEGJISLACIONIT

Botimi i 3-të

Metodologjia e unifikuar shqiptare për procesin ligjvënës,
hartimin e akteve normative dhe terminologjinë juridike
sipas neneve 5(1) dhe 6(5) të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001
"Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë"

Tiranë 2021

Botim i Ministrisë së Drejtësisë,
me ndihmën teknike të projektit EURALIUS V
(Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri)

Redaktimi: Tedi Dobi

Design & Layout: Adelajda Alla

Shtypur në shtypshkronjën MORAVA

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Ky botim u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e Manualit për Hartimin e Legjislacionit është përgjegjësi vetëm e Ministrisë së Drejtësisë dhe e EURALIUS si dhe nuk pasqyron domosdoshmërish pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Pjesët e Manualit lidhur me metodologjinë për vlerësimin e hapësirave korruptive në hartimin e legjislacionit në Republikën e Shqipërisë janë përgatitur me asistencën e Presencës së OSBE-së në Shqipëri, dhe pikëpamjet e shprehura në të janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht pozicionin zyrtar të OSBE.

EURALIUS
Ministria e Drejtësisë
Blvd Zogu I-rë
Tiranë
E-mail: info@euralius.eu
Web: www.euralius.eu

TABELA E PËRMBAJTJES

1 Përdorimi i Manualit
1.1 Struktura
1.2 Lista e Shkurtimeve
1.3 Përkufizime

PJESA A
PARIME TË PËRGJITHSHME TË LEGJISLACIONIT .

1 Kuadri kushtetues
1.1 Hierarkia e legjislacionit
1.2 Statusi i akteve ligjore
1.3 Statusi i akteve nënligjore përkundrejt akteve të tjera administrative .

2 Statusi i së drejtës ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm.
2.1 Natyra juridike detyruese e marrëveshjeve ndërkombëtare
2.2 Përgatitja e marrëveshjeve ndërkombëtare.
2.3 Lidhja dhe ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

3 Statusi i së drejtës së BE-së në rendin juridik të brendshëm
4 Statusi i vlerësimit të hapësirave për korrupsion në legjislacion
5 Kodifikimi i legjislacionit.
6 Alternativat ndaj legjislacionit
7 Implikimet për hartuesin

PJESA B
VLERËSIMI I LEGJISLACIONIT

1 Termat e referencës

2 Objekti i vlerësimit

3 Rishikimi i kushtetutshmërisë

4 Rishikimi i përputhshmërisë me të drejtën ndërkombëtare

5 Rishikimi i përafrimit me acquis e BE-së

6 Procedura për kryerjen e vlerësimit

7 Vlerësimi i hapësirave për korrupsion në legjislacion
7.1 Identifikimi i risqeve gjuhësore për hapësira korruptive
7.1.1 Dykuptueshmëria
7.1.2 Stili gjuhësor
7.1.3 Harmonizimi
7.2 Identifikimi i risqeve substantive për hapësira korruptive
7.2.1 Objektivat e ligjit apo të aktit nënligjor
7.2.2 Procedurat
7.2.3 Organi zbatues i ligjit apo i aktit nënligjor
7.2.4 Mungesa e mbikëqyrjes
7.2.5 Mungesa e sanksioneve ose sanksionet e papërcaktuara qartë
7.2.6 Kontrolli gjyqësor
7.3 Procedura e vlerësimit të hapësirave për korrupsion
7.3.1 Procedura e përgjithshme
7.3.2 Procedura e vlerësimit
8 Mjete ndihmëse për përgatitjen e projektakteve dhe kryerjen e vlerësimit
8.1 Fletorja Zyrtare
8.2 Bazat e të dhënave
8.3 Mjete të tjera

PJESA C
REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR HARTIMIN E LEGJISLACIONIT

1 Procesi i hartimit të legjislacionit
1.1 Hapat paraprakë për hartimin e legjislacionit
1.2 Hartimi i legjislacionit brenda administratës ose nga grupet e punës me ekspertë
1.3 Konsultimi
2 Përdorimi i gjuhës
2.1 Qartësia dhe fjalori juridik.
2.2 Kuptueshmëria
2.3 Gjatësia dhe struktura e fjalisë
2.4 Stili rrëfyes
2.5 Zgjedhja e fjaleve dhe njëtrajtshmëria
2.6 Fjalët dhe shprehjet e huaja
2.7 Shprehjet latine
2.8 Shprehjet teknike
2.9 Përsëritjet
2.10 Numrat

2.11 Datat
2.12 Gjuha asnjanëse përkundrejt gjinisë
2.13 Gjuha politikisht asnjanëse
2.14 Njëjësi dhe shumësi
2.15 Kohët e foljes.
2.16 Mënyrat e foljes
2.17 Lidhëzat
2.18 Emrat e prejardhur nga foljet
2.19 Foljet modale
2.20 Shenjat e pikësimit
2.21 Shkrimet fundore
2.22 Shkurtimet

3 Referencat
3.1 Referencat e brendshme
3.2 Referencat e jashtme

4 Citimi i legjislacionit
4.1 Citimi i plotë
4.2 Titulli i citimit
4.3 Citimi i elementeve të legjislacionit .

PJESA D
AKTET PARËSORE

1 Vërejtje të Përgjithshme.

2 Titulli
2.1 Rëndësia dhe pjesët përbërëse
2.2 Titulli i plotë
2.3 Numri i aktit
2.4 Data e miratimit
2.5 Shkurtimi i titullit

3 Baza ligjore
3.1 Rëndësia dhe statusi
3.2 Forma të ndryshme

4 Organizimi
4.1 Struktura
4.2 Preambula
4.3 Dispozita e objektit të ligjit
4.4 Dispozita e qëllimit të ligjit
4.5 Dispozita e fushës së zbatimit

4.6 Përkufizime
4.7 Dispozitat për procedurat administrative
4.8 Dispozitat lëndore
4.9 Dispozitat e vlerësimit
4.10 Dispozitat për nxjerrjen e akteve nënligjore
4.11 Dispozitat e sanksioneve
4.12 Dispozitat e shfuqizimeve
4.13 Dispozitat me efekt ndryshues mbi akte të tjera

5 Njësitë strukturore të aktit dhe emërtimi i tyre

6 Ndarja dhe emërtimi i neneve
6.1 Nenet dhe pjesët e tyre përbërëse
6.2 Paragrafët dhe pjesët e tyre përbërëse
6.3 Lidhja ndërmjet paragrafëve
6.4 Lidhja ndërmjet nënparagrafëve

7 Akti gjithëpërfshirës

8 Dispozitat kalimtare

9 Dispozitat për hyrjen në fuqi
9.1 Përkufizimi i saktë
9.2 Hyrja në fuqi me kusht
9.3 Hyrja në fuqi në periudha të ndryshme kohore
9.4 Kufizimet kohore dhe pushimi i fuqisë së legjislacionit

10 Formula përmbyllëse

PJESA E
AKTET NDRYSHUESE

1 Vërejtje të përgjithshme për legjislacionin ndryshues

2 Aktet zëvendësuese

3 Aktet individuale ndryshuese
3.1 Tiparet karakteristike
3.2 Titulli i aktit ndryshues
3.3 Dispozita e bazës ligjore
3.4 Dispozita hyrëse
3.5 Formulat ndryshuese

4 Struktura
4.1 Numërtimi i neneve të akteve ndryshuese
4.2 Veprimi ndryshues “shtohet”

4.3 Veprimi ndryshues "ndryshohet si më poshtë"
4.4 Veprimi ndryshues "zëvendësohet"
4.5 Veprimi ndryshues "shfuqizohet"

5 Lloje të tjera të ndryshimeve
5.1 Ndryshimi i titullit
5.2 Ndryshimet gjuhësore të passjella nga propozimi për ndryshime ligjore
5.3 Ndryshimi i shtojcave

6 Ndryshimet me pasojë mbi akte të tjera

7 Dispozita kalimtare

8 Hyrja në fuqi

9 Akti gjithëpërfshirës ndryshues

10 Konsolidimi i akteve
10.1 Statusi ligjor
10.2 Objektivat e konsolidimit
10.3 Rregullat formale të konsolidimit

PJESA F
AKTET E PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EVROPIAN

1 Konsiderata të përgjithshme mbi traktatet dhe institucionet e BE-së

2 Burimet e së drejtës së BE-së
2.1 E drejta parësore
2.2 E drejta dytësore

3 Aksesi në të drejtën e BE-së
3.1 Numri CELEX

4 Parime dhe procedura për përafrimin e legjislacionit
4.1 Hapat përgatitorë për përafrimin e së drejtës së brendshme me legjislacionin e BE-së
4.2 Planifikimi i përafrimit
4.2.1 Identifikimi dhe zgjedhja e akteve ligjore të BE-së për t'u përafruar
4.2.2 Planifikimi dhe priorizimi i akteve ligjore të BE-së për t'u përafruar
4.2.3 Përkthimi
4.3 Monitorimi dhe raportimi mbi përafrimin
4.3.1 Tabela e Përputhshmërisë (TeP)
4.3.2 Analiza e Hapësirave Ligjore (LGA).
4.3.3 Vlerësimi i Hapësirave Institucionale dhe Administrative (IAGA)

5 Harmonizimi i së drejtës së brendshme me të drejtën parësore

6 Harmonizimi i së drejtës së brendshme me Rregulloret e BE-së
6.1 Zbatueshmëria e Rregulloreve të BE-së në momentin e aderimit në BE
6.2 Zbatueshmëria e Rregulloreve të BE-së para momentit të aderimit

7 Transpozimi i Direktivave të BE-së
7.1 Pasojat e mos-transpozimit ose transpozimit të papërshtatshëm të një Direktive

8 Harmonizimi i së drejtës së brendshme me Vendimet e BE-së

9 Rishikimi i legjislacionit vendas në varësi të ndryshimit të rrethanave
9.1 Rishikimi i legjislacionit vendas në varësi të statusit të anëtarësimit të Shqipërisë
9.2 Rishikimi i legjislacionit vendas në varësi të ndryshimit të legjislacionit të BE-së

10 Kërkesat për citim sipas së drejtës së Bashkimit Evropian
10.1 Citimi i së drejtës së Bashkimit Evropian
10.2 Kërkesat për citim gjatë transpozimit të Direktivave të BE-së
10.3 Referencë për përputhshmërinë me procedurën në pajtim me Direktivën (BE) 2015/1535 (Direktiva e Njoftimit)

PJESA G
AKTET NËNLIGJORE

1 Vërejtje të Përgjithshme

2 Autorizimi për nxjerrjen e akteve nënligjore

3 Aktet nënligjore parësore
3.1 Titulli
3.2 Dispozita miratuese
3.3 Organi që nxjerr aktin nënligjor
3.4 Kërkesa të posaçme
3.5 Struktura e akteve nënligjore
3.5.1 Praktika e deritanishme
3.5.2 Perspektiva krahasuese dhe rekomandime

3.6 Nëndelegimi i akteve nënligjore
3.7 Hyrja në fuqi
3.8 Formula përmbyllëse

4 Ndryshimi i akteve nënligjore

4.1 Titulli
4.2 Dispozita miratuese
4.3 Struktura
4.4 Hyrja në fuqi
4.5 Formula përmbyllëse

PJESA H
ASISTENCA HARTUESE GJATË PROCESIT LEGJISLATIV PARLAMENTAR

1 Procedura Legjislative
1.1 Paraqitja e projektligjeve në Kuvend
1.2 Shqyrtimi nga Komisionet e Kuvendit
1.3 Shqyrtimi në Seancën Plenare të Kuvendit
1.4 Shqyrtimi në parim
1.5 Shqyrtimi nen për nen dhe miratimi

2 Procedura legjislative për aktet specifike
2.1 Shqyrtimi i projektligjeve në lidhje me financat dhe buxhetin
2.2 Shqyrtimi i nismës legjislative për rishikimin e Kushtetutës dhe zbatimin e vendimeve të GjK-së

3 Asistenca hartuese gjatë procesit legjislativ parlamentar

PJESA I
INTERPRETIMI I LEGJISLACIONIT

1 Vërejtje të Përgjithshme

2 Rregullat e interpretimit
2.1 Interpretimi tekstual
2.2 Interpretimi me analogji
2.3 Interpretimi a *contrario*
2.4 Interpretimi teleologjik
2.5 Specifikat e interpretimit të së drejtës së BE-së

3 Implikimet për hartuesin

SHTOJCAT

A Lista e akteve të nxjerra nga organet administrative në përputhje me praktikën e deritanishme kundrejt terminologjisë së Kushtetutës

B Udhërrëfyes për procesin ligjbërës

C Shembuj të akteve ligjore standarde

D Shembuj të akteve nënligjore standarde

E	Formular për relacionin shoqërues
F	Formular i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit
G	Listë kontrolli për kushtetutshmërinë e projektaktit
H	Listë kontrolli për përgatitjen ose shqyrtimin e projektaktit
I	Listë kontrolli për vlerësimin e hapësirave për korrupsion
J	Përmbledhje e rregullave për teknikën legjislative
K	Listë kontrolli për përafrimin në të drejtën e BE-së dhe formulari i Tabelës së Përputhshmërisë
L	Listë kontrolli për përgatitjen e analizës së hapësirave ligjore dhe modeli i LGA
M	Listë kontrolli për përgatitjen e vlerësimin e hapësirave institucionale dhe administrative dhe modeli i IAGA

PARATHËNIE PËR BOTIMIN E TRETË

Siguria juridike është një nga elementët thelbësorë të shtetit të së drejtës. Për të respektuar parimin e sigurisë juridike, rregullimet ligjore duhet të reflektojnë qartësi, kuptueshmëri dhe qëndrueshmëri. Instrumenti kryesor që përdoret për të garantuar qartësinë dhe kuptueshmërinë e rregullimeve ligjore, por në raste të caktuara edhe qëndrueshmërinë e tyre, janë rregullat e hartimit të legjislacionit.

Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e projekteve Euralius, ka përgatitur manualet për hartimin e legjislacionit, të cilat, kanë ndihmuar hartuesit dhe ligjvënësit, për të ndjekur praktikat më të mira gjatë hartimit të rregullimeve ligjore. Botimi i 2-të, i këtij Manuali, është publikuar në vitin 2010. Megjithatë, nga ky vit, institucionet shqiptare të përfshira në procesin legjislativ, kanë krijuar një eksperiencë dhe praktika legjislative të pasura, të cilat, do të duhet të gjenin reflektim në manualin e hartimit të legjislacionit. Nga ana tjetër, ka lindur edhe nevoja për t'iu përgjigjur sfidave të reja me të cilave po përballet procesi i hartimit të legjislacionit, veçanërisht përafrimin me të drejtën e BE apo edhe nevojën për të siguruar rregulla të unifikuara për vlerësimin e hapësirave për korrupsion në legjislacion.

Botimi i tretë i Manualit për Hartimin e Legjislacionit, është një punë e gjatë e kryer bashkërisht nga Ministria e Drejtësisë dhe Euralius V, dhe reflekton jo vetëm eksperiencën e fituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit gjatë hartimit dhe vlerësimit të legjislacionit përgjatë gjithë këtyre viteve, por njëkohësisht, edhe praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian gjatë hartimit të ligjeve.

Ndjekja e metodave dhe teknikave të duhura për hartimin e legjislacionit ka një peshë të jashtëzakonshme në sigurimin e suksesit të reformave ligjore që ndërmerren në fusha të caktuara dhe në forcimin e procesit legjislativ. Qëllimi

i këtij Manuali është të ndihmojë të gjithë hartuesit e legjislacionit, nëpërmjet paraqitjes së standardeve dhe teknikave bashkëkohore për hartimin e legjislacionit, të pasqyruar me shembuj dhe udhëzimet përkatëse, në prodhimin e legjislacionit me cilësi të lartë i cili ofron siguri, qartësi dhe vazhdimësi për shoqërinë. Duke trajtuar gjerësisht përgatitjen dhe vlerësimin e legjislacionit nga të gjithë personat që janë të përfshirë në procesin legjislativ, ky Manual mund të jetë i dobishëm edhe për zbatuesit e ligjit, duke përfshirë këtu edhe gjykatat, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit dhe interpretimin e tij, sipas rastit.

Hartimi i rregullimeve ligjore që garantojnë qartësi dhe kuptueshmëri dhe që në fund, garantojnë respektimin e parimit të sigurisë juridike, bëhet më i lehtë nëpërmjet këtij Manuali. Prandaj, unë e çmoj si një nga instrumentet praktikë më të rëndësishëm që garanton aftësimin e hartuesve me cilësitë e nevojshme profesionale për të hartuar rregullime ligjore cilësore dhe të qëndrueshme. Ministria e Drejtësisë, përgjatë procesit të vlerësimit të legjislacionit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit, do të sigurojë zbatimin e rregullave të përcaktuara në këtë Manual. Megjithatë, është detyrë e çdo hartuesi për t'u kujdesur në hartimin e rregullimeve ligjore që, jo vetëm të zbatohen, por njëkohësisht të garantojnë zbërthimin më të mirë të politikave në akte ligjore dhe nënligjore. Nëpërmjet zbatimit të rregullave të këtij Manuali, çdo akt i hartuar është i qartë dhe i kuptueshëm për qytetarët, dhe në këtë mënyrë, ne sigurojmë që qytetarët të përfitojnë të drejtat dhe të kujdesen për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga rregullimet ligjore të shtetit të së drejtës.

Ulsi Manja, *Ministër i Drejtësisë*

PARATHËNIE PËR BOTIMIN E TRETË

Projektet EURALIUS kanë asistuar Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë që nga viti 2005 në forcimin e pavarësisë, transparencës, efektshmërisë, përgjegjshmërisë dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në përputhje me praktikat më të mira dhe *acquis* të BE-së.

Që në 2007 me ndihmën e EURALIUS I & II janë përgatitur botimi i parë i përditësuar dhe përsëri në 2010 botimi i dytë i Manualit për Hartimin e Legjislacionit. Botimi aktual i Manualit, fryt i bashkëpunimit midis MD dhe EURALIUS V, ngrihet mbi praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane, përvojat e mëparshme si dhe mësimet e nxjerra gjatë miratimit dhe zbatimit të paketës legjislative të Reformës në Drejtësi.

Për përgatitjen e Manualit është kryer një analizë e plotë krahasuese dhe për këtë arsye janë marrë parasysh praktikat më të mira nga udhërrëfyesit përkatës nga vende të tjera si Gjermania, Holanda dhe Italia, si dhe Manuali i Përbashkët i BE-së për prezantimin dhe hartimin e akteve që i nënshtrohen procedurës së zakonshme legjislative. Për më tepër, Manuali merr parasysh procedurat vendase dhe risitë në lidhje me përgatitjen e projektakteve, të tilla si specifikat e përgatitjes së Raportit të Vlerësimit të Ndikimit (RVN) për projektaktet.

Një risi e këtij botimi të 3-të të Manualit është një qasje e orientuar ndaj praktikuesve duke ofruar udhëzime në praktikën e përditshme të atyre që përfshihen në hartimin dhe shqyrtimin e legjislacionit. Një risi tjetër është diferencimi midis akteve nënligjore normative dhe akteve të tjera administrative, si dhe përfshirja e një pjese specifike me udhëzime për përgatitjen e akteve nënligjore. Më tej, ky Manual përfshin përditësimin e udhëzimeve mbi mënyrën e hartimit të legjislacionit vendas në harmoni me *acquis* të BE-së dhe metodologjinë e përafrimit të ligjit vendas me të drejtën direkt të zbatueshme të BE-së. Përveç kësaj, Manuali përshkruan qasjet kryesore në interpretimin e

legjislacionit dhe ndikimin e tyre mbi hartimin e legjislacionit me qëllim që të garantohet siguria juridike, qartësia dhe transparenca.

EURALIUS është krenar për bashkëpunimin e gjatë me MD përgjatë procesit të përgatitjes dhe miratimit të legjislacionit lidhur me fushën e drejtësisë dhe në finalizimin e këtij Manuali. Vlerësojmë gjithashtu bashkëpunimin produktiv me aktorët e tjerë vendas dhe ndërkombëtarë që kanë kontribuar në drejtim të përgatitjes së këtij Manuali vërtet gjithëpërfshirës.

Shpresoj se të gjithë ata që janë të përfshirë në hartimin e legjislacionit, transpozimin e *acquis* të BE-së si dhe shqyrtimin e legjislacionit të shfrytëzojnë këtë Manual në punën e tyre të përditshme si një burim praktik që kontribuon në përgatitjen e legjislacionit të kuptueshëm dhe të qëndrueshëm.

Dr. Agnes Bernhard, *Drejtuese e ekipit,* EURALIUS V

SHËNIM I AUTORËVE

Botimi i parë i Manualit për Hartimin e Legjislacionit u përgatit gjatë viteve 2002 – 2003 nga Ministria e Drejtësisë me mbështetjen teknike të ofruar në kuadër të Programit të Përbashkët midis Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian për Shqipërinë. Botimi i parë u përditësua më tej gjatë viteve 2006 - 2007 me ndihmën e projektit EURALIUS I.[1] Një botim i dytë pasoi gjatë viteve 2008 - 2009 dhe u botua në vitin 2010 me ndihmën teknike të projektit EURALIUS II dhe ndihmën e mëtejshme të projektit SMEI[2] në lidhje me aspektet e përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si pjesë e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian.

Që nga koha e publikimit të botimit të fundit të këtij Manuali në vitin 2010, kanë lindur një sërë arsyesh që kanë nxjerrë në pah nevojën për përditësimin e tij. Arsyeja kryesore është realizimi duke filluar nga viti 2016 i një procesi gjithëpërfshirës të Reformës në Drejtësi, i cili ka përfshirë miratimin e ndryshimeve rrënjësore në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe miratimin e një numri gjithëpërfshirës të ligjeve, ndër të tjerash:

- 7 ligje të nivelit kushtetues;
- ndryshime në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Procedurës Civile, ligjin për gjykatat administrative;
- miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur; dhe
- 30 ligje të tjera që synojnë forcimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë, efikasitetit dhe profesionalizmit në sistemin e drejtësisë.

Kjo reformë e thellë në sistemin e drejtësisë shqiptare ka patur një ndikim të konsiderueshëm në mënyrën e dimensionimit të legjislacionit dhe vlen të përmendet që shumë 'mësime të nxjerra' janë bërë pjesë të mënyrës së hartimit dhe rishikimit të legjislacionit në një mënyrë sistematike dhe organike.

1 Projekti i financuar nga BE "Misioni Europian i Asistencës për Sistemin e Drejtësisë Shqiptare".
2 Projekti i financuar nga BE "Fuqizimi i Ministrisë së Integrimit Europian".

Për më tepër, ky Manual merr në konsideratë risitë në procedurat që ndjek Këshilli i Ministrave në lidhje me përgatitjen e projektakteve, siç janë kërkesat dhe specifikat e përgatitjes së Raportit të Vlerësimit të Ndikimit për secilin projektakt të përgatitur. Për më tepër, janë bërë të disponueshme ndihma dhe burime informacioni të reja, të cilat mund të përdoren si mbështetje gjatë hartimit të legjislacionit.

Në Mars të vitit 2020, Këshilli Evropian vendosi të hapë negociatat për aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për rrjedhojë, harmonizimi dhe përafrimi i legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian është bërë edhe më i rëndësishëm. Si i tillë, ky botim i Manualit siguron burime shtesë në mënyrë që hartuesit e legjislacionit shqiptar të fitojnë disa njohuri themelore në lidhje me funksionimin e Bashkimit Evropian dhe sistemin juridik të tij, si dhe të familjarizohen me teknikat përkatëse të përafrimit të legjislacionit. Përditësimi i seksioneve lidhur me përafrimin me *acquis* të BE është përgatitur me asistencën teknike të projektit EURALIUS V[3] dhe të projektit SEI.[4]

Përvoja e fituar gjatë vlerësimit së legjislacionit, veçanërisht të problematikave të hasura në lidhje me përputhshmërinë juridike, ka shërbyer si bazë për formulimin dhe dhënien e saktë të disa rekomandimeve dhe për thjeshtëzimin e rekomandimeve ekzistuese. Disa nga specifikimet formale të mëparshme janë ndryshuar. Kërkesat ligjore dhe formale për hartimin e legjislacionit janë ilustruar me shembuj përkatës. Kur këta të fundit janë marrë nga tekste të cilat në versionin origjinal nuk përputhen me specifikimet e reja ose më të përditësuara, janë përshtatur në këtë botim të Manualit.

Shqipëria është ende në fazën fillestare të krijimit të një mekanizmi të harmonizuar për vlerësimin e hapësirave korruptive, sidomos në legjislacion. Megjithatë, përgjatë këtyre viteve është vënë re forcimi i rolit të institucioneve të administratës publike në identifikimin e rreziqeve korruptive gjatë hartimit të legjislacionit, me qëllim reduktimin dhe shmangien e këtyre hapësirave korruptive. Për këtë arsye, në Manual janë parashikuar parimet dhe procedurat për kryerjen e këtij vlerësimi, bazuar në Metodologjinë për Vlerësimin e Hapësirave Korruptive në Hartimin e Legjislacionit në Republikën e Shqipërisë, të përgatitur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në kuadër të projektit "Mbështetje për masat antikorrupsion në Shqipëri – 2018".

Ky botim i tretë i Manualit të Hartimit të Legjislacionit është rezultat i

3 Projekti i financuar nga BE "Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri".
4 Projekti i financuar nga BE "Mbështetja e Procesit të Integrimit në BE të Shqipërisë".

bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit dhe strukturave të tjera përgjegjëse, të specializuara për çështje të rëndësishme lidhur me vlerësimin e legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë, me ndihmën teknike të projektit EURALIUS V. Për këtë qëllim, dua të falënderoj të gjithë kolegët në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit, ministritë e linjës si dhe institucionet e tjera që kanë punuar për hartimin e tij ose kanë kontribuar me komente gjatë fazës së konsultimit të këtij Manuali. Në mënyrë të veçantë dëshiroj të shpreh mirënjohjen për punën dhe angazhimin për zj. Elsa Gjini, nga Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit, zj. Monika Meça, nga Njësia e Legjislacionit dhe Akteve Rregullatore, në Kryeministri si dhe z. Viktor Gumi, ekspert, që ka punuar për përgatitjen e seksioneve për vlerësimin e hapësirave për korrupsion në legjislacion.

Falënderime të thella shkojnë gjithashtu për Dr. Agnes Bernhard, drejtuese e ekipit të projektit EURALIUS V, Amantina Dobi, Idlir Peçi dhe Tedi Dobi, ekspertë të projektit EURALIUS V për bashkëpunimin dhe sugjerimet e tyre të vazhdueshme, si dhe për të gjithë kolegët e tjerë që kanë gjetur kohën për ngritjen e çështjeve dhe problematikave të ndryshme lidhur me përputhshmërinë juridike, duke kontribuar në këtë mënyrë në zhvillimin e vazhdueshëm të rekomandimeve të përfshira në këtë Manual.

Çdo koment dhe sugjerim për përmirësimin e mëtejshëm të Manualit është mëse i mirëpritur. Komentet dhe sugjerimet e mundshme i drejtohen Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit dhe dorëzohen me shkrim në zyrën e protokollit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë,

Besmir Beja, *Drejtor i Përgjithshëm*

1 Përdorimi i Manualit

1.1 Struktura

1 Ministria e Drejtësisë luan një rol të rëndësishëm në qartësinë, kuptueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit normativ në Republikën e Shqipërisë. Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të metodologjisë së unifikuar shqiptare për procesin ligjvënës, hartimin e akteve normative dhe terminologjinë juridike.[5] Në përputhje me nenin 24(2) të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" si dhe paragrafit 22 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.08.2003 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave", të ndryshuar, Ministria e Drejtësisë shprehet për ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes, për çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legjislative dhe për terminologjinë juridike të projektaktit duke parashtruar, kur është rasti, edhe formulimet përkatëse. Instrumenti kryesor që përdoret për të garantuar qartësinë dhe kuptueshmërinë e legjislacionit në Republikën e Shqipërisë është ky Manual, zbatueshmëria e të cilit sigurohet gjatë procesit të vlerësimit të legjislacionit që kryhet nga Ministria e Drejtësisë.

2 Manuali është konceptuar si një mjet praktik që realizon një përmbledhje të veprimtarisë legjislative dhe që mundëson transmetimin e përvojës kolektive dhe praktikës më të mirë tek të gjithë ata individë dhe institucione të përfshira në hartimin ose në vlerësimin e legjislacionit. Versioni elektronik i Manualit mund të gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë (www.drejtesia.gov.al), të Qendrës së Botimeve Zyrtare (www.qbz.gov.al) dhe të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (www.parlament.al). Po ashtu, versioni elektronik në gjuhën angleze të Manualit mund të gjendet në faqen zyrtare të projektit EURALIUS (www.euralius.eu).

3 Manuali është hartuar duke u mbështetur në kornizën kushtetuese dhe ligjore që rregullon procesin legjislativ në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, për hartimin e këtij Manuali janë marrë në konsideratë

5 Neni 6(5) i ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar.

botimet akademike në fushën e teknikës legjislative, manualet e ngjashme të teknikës legjislative që përdoren në vendet e Bashkimit Evropian, si dhe përvoja e fituar në punën e përditshme në Ministrinë e Drejtësisë, ministritë e linjës dhe në komisionet parlamentare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë gjatë hartimit dhe vlerësimit të legjislacionit.

4 Manuali ndjek një metodologji të qartë duke i prezantuar lexuesit një përmbledhje të kornizës kushtetuese dhe të parimeve që rregullojnë legjislacionin, metodat dhe mjetet ndihmëse për kryerjen e vlerësimit të legjislacionit, udhëzime për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe rekomandime në lidhje me emërtimet, citimet dhe referencat e kryqëzuara. Gjithashtu, Manuali trajton llojet e ndryshme të akteve ligjore dhe strukturën tipike të tyre, duke përcaktuar rregullat formale për strukturimin dhe numërtimin e dispozitave të ndryshme, si dhe teknikën për hartimin e llojeve të ndryshme të dispozitave të ndryshme.

5 Një risi e këtij Manuali është prezantimi i një pjese të posaçme me udhëzime për hartimin e akteve nënligjore dhe përditësimi i rregullave mbi mënyrën e hartimit të legjislacionit të brendshëm në përputhje me standardet e *acquis* së Bashkimit Evropian. Për më tepër, Manuali përshkruan qasjet kryesore në interpretimin e legjislacionit dhe ndikimin e tyre në hartimin e legjislacionit për të garantuar siguri, qartësi dhe qëndrueshmëri të legjislacionit.

6 Botimi i 3-të i Manualit është i strukturuar në nëntë Pjesë:

7 Pjesa A **"Parime të përgjithshme të legjislacionit"** përmban seksione mbi kornizën kushtetuese, përfshirë hierarkinë e legjislacionit, statusin e akteve ligjore dhe akteve nënligjore, statusin e së drejtës ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm, e cila përfshin natyrën juridike detyruese të marrëveshjeve ndërkombëtare, përfundimin dhe ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe një seksion të posaçëm mbi statusin e *acquis-së* së BE-së në rendin e brendshëm juridik. Vend të veçantë zë edhe statusi ligjor i vlerësimit të hapësirave për korrupsion në legjislacion si dhe parimet për vlerësimin efektiv të hapësirave për korrupsion në legjislacion. Pjesa A përmbyllet me seksione mbi kodifikimin e legjislacionit, alternativat ndaj legjislacionit dhe pasojat e tyre për hartuesin gjatë përgatitjes së legjislacionit.

8 Pjesa B **"Vlerësimi i legjislacionit"** përmban seksione mbi përgjegjësinë

e Ministrisë së Drejtësisë për të vlerësuar legjislacionin, rregullat dhe teknikat për kontrollin e kushtetutshmërisë, pajtueshmërinë me të drejtën ndërkombëtare dhe përafrimin e legjislacionit të cilit i është bërë vlerësimi me *acquis* e BE-së si dhe procedurën për kryerjen e vlerësimit, mjetet ndihmëse në përgatitjen e projekteve ligjore dhe zhvillimin e vlerësimit të legjislacionit, siç është Fletorja Zyrtare, bazat e të dhënave dhe mjetet e tjera. Vend të veçantë zë procedura e vlerësimit të hapësirave për korrupsion duke u përqendruar në identifikimin e risqeve për hapësira korruptive.

9 Pjesa C **"Rekomandime të përgjithshme për hartimin e legjislacionit"** fillon me seksione mbi procesin e hartimit të legjislacionit, përfshirë hapat paraprakë dhe rregullimet organizative për hartimin e legjislacionit dhe procesin e konsultimit të projektligjeve. Më tej, kjo pjesë jep rekomandime përgjithësisht të zbatueshme për hartimin e legjislacionit në mënyrë të qartë dhe koncize, siç është përdorimi i gjuhës, përfshirë përdorimin e fjalorit juridik, kuptueshmërinë, gjatësinë dhe strukturën e fjalisë, stilin e tregimit, zgjedhjen e fjalëve, fjalët dhe shprehjet e huaja, shprehjet në latinisht, shprehjet teknike, përsëritjet, numrat, datat, gjinia dhe gjuha politikisht asnjanëse, si dhe përdorimi i njëjësit dhe shumësit, kohët e foljeve, mënyrat, lidhëza, kthimi në trajtë emërore, foljet ndihmëse, shenjat e pikësimit, shkrimet fundore dhe shkurtimet. Për më tepër, Pjesa C përmban seksione në lidhje me rregullat për përdorimin e referencave dhe citimin e legjislacionit.

10 Pjesa D "**Aktet parësore"** trajton teknikat e hartimit të legjislacionit, përfshirë strukturën e teksteve ligjore, sistemin dhe rendin e dispozitave ligjore, si dhe stilin e hartimit. Pjesa D fillon me vërejtje të përgjithshme dhe përmban seksione mbi ndërtimin e titullit të aktit, duke përfshirë rëndësinë dhe pjesët përbërëse të titullit, titullin e gjatë dhe titullin e shkurtër, numrin e aktit, datën e miratimit dhe rregullat formale për shkurtimin e titullit. Më tej, në këtë pjesë trajtohen dispozita e bazës ligjore duke shpjeguar rëndësinë dhe statusin e saj dhe format e ndryshme të dispozitave që tregojnë bazën ligjore. Kjo pjesë përfshin edhe seksionin për organizimin e aktit, e cila trajton thellësisht dispozitat thelbësore, siç janë preambula, dispozita e qëllimit, dispozita e fushëveprimit, përkufizimet, dispozitat rregullatore, dispozitat vlerësuese, dispozitat autorizuese, dispozitat sanksionuese, dispozitat shfuqizuese, dispozitat shfuqizuese me efekt mbi akte të tjera. Në vijim, janë trajtuar njësitë strukturore sipërore të aktit dhe

emërtimi i tyre, si dhe dispozitat individuale të aktit dhe emërtimi i tyre, siç janë nenet dhe pjesët përbërëse të tyre, paragrafët dhe pjesët përbërëse të tyre dhe mënyra për tregimin e marrëdhënies midis paragrafëve dhe ndërmjet nënparagrafëve si dhe dispozitave kalimtare të aktit. Pjesa D përmbyllet me trajtimin e dispozitave për hyrjen në fuqi, hyrjen e kushtëzuar në fuqi, hyrjen në fuqi në momente të ndryshme kohore dhe afatet kohore dhe përfundimin e afatit të vlefshmërisë së legjislacionit.

11 Pjesa E "**Aktet ndryshuese"** fillon me vërejtje të përgjithshme për ndryshimin e legjislacionit dhe dallimin midis akteve zëvendësuese dhe akteve ndryshuese individuale, duke shpjeguar tiparet e tyre karakteristike, rregullat për përpilimin e titullit të aktit ndryshues, fjalinë hyrëse dhe formulën ndryshuese. Gjithashtu, kjo pjesë trajton strukturën e akteve ndryshuese, përfshirë numërtimin e neneve të aktit ndryshues, veprimet ndryshuese "shtohet", "ndryshohet", "zëvendësohet" dhe "shfuqizohet", si dhe llojet e tjera të ndryshimeve, të tilla si ndryshimi i titullit, ndryshimet gjuhësore të shoqëruara nga një propozim për ndryshime legjislative dhe shtesa për ndryshimin e shtojcave. Kjo pjesë përmban edhe seksione mbi ndryshimet mbi akte të tjera, dispozitat kalimtare, hyrjen në fuqi dhe prezanton parimin e akteve ndryshuese gjithëpërfshirëse. Pjesa E përmbyllet me seksione mbi konsolidimin e akteve, siç janë statusi juridik, objektivat dhe rregullat formale të konsolidimit.

12 Pjesa F **"Aktet e përafrimit me *acquis* e Bashkimit Evropian"** paraqet vërejtje të përgjithshme mbi traktatet dhe institucionet e BE-së, si dhe mbi burimet e së drejtës së BE-së, konkretisht e drejta primare dhe e drejta sekondare, si dhe mjetet për akses në të drejtën e BE-së dhe për të kuptuar numrin CELEX. Më tej, Pjesa F prezanton parimet e përgjithshme të përafrimit të legjislacionit dhe shtjellon hapat për përafrimin e ligjit vendas me legjislacionin e BE-së, duke vijuar me trajtimin e rregullave për harmonizimin e legjislacionit vendas me të drejtën primare dhe harmonizimin e legjislacionit vendas me Rregulloret e BE-së. Në këtë seksion është treguar kujdes i posaçëm në trajtimin e dallimit ndërmjet zbatueshmërisë së Rregulloreve të BE-së në datën e aderimit në BE kundrejt zbatueshmërisë së Rregulloreve përpara momentit të aderimit. Po kështu, një rëndësi e posaçme i është kushtuar transpozimit të Direktivave të BE-së dhe pasojave të mos transpozimit ose transpozimit të paplotë të një Direktive, si dhe harmonizimit të ligjit kombëtar me Vendimet e BE-së. Pjesa F përmbyllet me kërkesat e citimit të së drejtës së BE-së, si dhe kërkesat e citimit kur zbatohen Direktivat e BE-së.

13 Pjesa G "**Aktet nënligjore"** fillon me vërejtje të përgjithshme dhe kuadrin e autorizimit ligjor për nxjerrjen e akteve nënligjore, duke vijuar me karakteristikat e akteve parësore nënligjore, përfshirë titullin, dispozitën e miratimit, caktimin e organit që nxjerr aktin nënligjor dhe kërkesat e veçanta, rekomandime për strukturën e akteve nënligjore, rregullat në lidhje me nëndelegimin e akteve nënligjore, hyrjen në fuqi dhe formulën përmbyllëse të akteve nënligjore. Pjesa G përqendrohet gjithashtu në ndryshimin e akteve nënligjore dhe karakteristikat e tyre, të tilla si titulli, dispozita e miratimit, struktura, hyrja në fuqi dhe formula e mbylljes.

14 Pjesa H "**Asistenca hartuese gjatë procesit legjislativ parlamentar"** përcakton procedurën legjislative të Kuvendit, që përfshin paraqitjen e projektligjeve në Kuvend, shqyrtimin nga komisionet e Kuvendit, shqyrtimin në seancën plenare të Kuvendit, diskutimin në parim dhe diskutimi nen për nen dhe miratim në tërësi të projektaktit. Gjithashtu, pjesa H trajton në mënyrë të detajuar rregullat e veçanta të procedurës legjislative për akte specifike, siç është shqyrtimi i projektligjeve që lidhen me financat dhe buxhetin si dhe rishikimin e Kushtetutës. Po kështu, një rëndësi e veçantë i kushtohet zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo pjesë përmbyllet me një seksion mbi ndihmën e dhënë nga ekzekutivi në hartimin e legjislacionit gjatë procesit legjislativ parlamentar.

15 Pjesa I "**Interpretimit i legjislacionit"** fillon me disa vërejtje të përgjithshme mbi rregullat e interpretimit, duke përpunuar më tej rregullat e interpretimit me analogji, interpretimit *a contrario* dhe atë teleologjik, specifikat e interpretimit të *acquis* së BE-së, si dhe ndikimin e rregullave të interpretimit në hartimin e legjislacionit.

1.2 Lista e Shkurtimeve

BE	Bashkimi Evropian
FZBE	Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian
FZ	Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë
GJK	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
GJDBE	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
IAGA	Vlerësimi i Hapësirave Institucionale dhe Administrative (Institutional and Administrative Gap Assessment)
KPA	Kodi i Procedurave Administrative
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
LKM	Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"
LMN	Ligji nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë"
LGJA	Ligji nr.49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar
LQBZ	Ligji nr.78/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare"
LGA	Analiza e Hapësirave Ligjore (Legal Gaps Analysis)
LNJKP	Ligji nr.146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik"
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve anëtare të tyre
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
RKM	Rregullorja e Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr. 584, datë 28.8.2003
RK	Rregullorja e Kuvendit
RVN	Raporti i Vlerësimit të Ndikimit
TP	Tabela e Përputhshmërisë
TBE	Traktati i Bashkimit Evropian
TFBE	Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian

1.3 Përkufizime

16 Me qëllim që të lehtësohet kuptimi dhe përdorimi i këtij Manuali, është i nevojshëm përkufizimi i termave kryesorë të përdorur në të. Kështu, në këtë Manual, termi *legjislacion* përdoret për të nënkuptuar të gjithë llojet e akteve me karakter normativ që vendosin norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike dhe që i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektesh. Në këtë Manual, termi *legjislacion* përfshin *aktet ligjore* si dhe *aktet nënligjore* normative.

17 *Aktet ligjore* nënkuptojnë aktet normative, që pas procesit legjislativ miratohen nga shumica e Kuvendit[6] dhe shpallen me dekret të Presidentit të Republikës[7] dhe që konkretisht përfshijnë (a) Kushtetutën, (b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, (c) ligjet, si dhe (d) aktet normative të Këshillit të Ministrave me fuqinë e ligjit.

18 *Aktet nënligjore* nënkuptojnë aktet e nxjerra në bazë dhe për zbatimin e ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë, të cilat marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në FZ[8] dhe janë të zbatueshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.[9] Aktet nënligjore përfshijnë vendimet dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave, si dhe aktet normative të ministrit dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore.

19 *Aktet ligjore parësore* nënkuptojnë aktet ligjore të reja të cilat rregullojnë një tematikë të veçantë, pak a shumë komplekse, ndërsa *aktet parësore nënligjore* përfshijnë akte nënligjore të reja të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjeve. Rregullimet ligjore grupohen së bashku nën një titull dhe hyjnë në fuqi si një akt ligjor "i ri" ose akt nënligjor "i ri", gjithmonë për një kohë të pakufizuar.

20 *Aktet ligjore ndryshuese* nënkuptojnë aktet që ndryshojnë aktet ligjore ekzistuese, ndërsa *aktet nënligjore ndryshuese* nënkuptojnë aktet që përmbajnë ndryshime në aktet nënligjore ekzistuese. Aktet ndryshuese, si rregull, nuk kanë periudhë vlefshmërie: Pas hyrjes në fuqi të tyre, ato ndryshojnë, shtojnë ose shfuqizojnë dispozita të caktuara të aktit.

6 Neni 78(1) dhe 81(2) i Kushtetutës.
7 Neni 84 i Kushtetutës.
8 Neni 117(1) i Kushtetutës.
9 Neni 116(3) dhe 118(1) i Kushtetutës.

21 Së fundi, *përafrimi* nënkupton procesin e përqasjes së ligjeve, rregullave dhe procedurave të brendshme të një shteti në mënyrë që t'i japë efekt të gjithë trupës së *acquis* së BE-së, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që burojnë për shtetet që aspirojnë të anëtarësohen në të. Përafrimi arrihet përmes disa mjeteve, duke përfshirë: a) harmonizimin, përmes të cilit legjislacioni kombëtar zëvendësohet nga legjislacioni i BE-së në një fushë të caktuar ku BE-ja ka kompetencë të plotë dhe shtetet anëtare nuk i rregullojnë vetë ato çështje; b) transpozimin, përmes të cilit legjislacioni vendas përputhet me objektivat e parashikuar në aktet e BE-së, por shtetet anëtare vendosin se si do të rregullojnë teknikisht çështjet brenda kornizës së parashikuar nga aktet e BE-së; c) koordinimin, nëpërmjet së cilit synohet koordinimi i aktiviteteve ndërmjet shteteve anëtare, kur parashikohet nga legjislacioni i BE-së.

Pjesa A
Parime të përgjithshme të legjislacionit

1. Kuadri kushtetues

1.1 Hierarkia e legjislacionit

22 Neni 116 i Kushtetutës parashikon kornizën e akteve normative që janë në fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat janë si më poshtë:[10]

- Kushtetuta;
- marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- ligjet;
- aktet normative të Këshillit të Ministrave.

23 Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përftuar kështu edhe fuqinë e caktuar juridike.

24 Piramida e akteve normative e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre.[11] Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike.[12]

25 Marrëveshjet ndërkombëtare vendosen nën Kushtetutë në renditjen e akteve normative dhe kështu ato kanë një vend të rëndësishëm në rendin juridik shqiptar. Neni 122 i Kushtetutës nënvizon pozicionin e tyre hierarkik në raport me të drejtën e brendshme, duke parashikuar se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi ligjet e brendshme që nuk përputhen me to.

10 Neni 116(2) rregullon aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe, të cilat nuk janë nën fokusin e këtij Manuali.
11 Shih vendimet nr. 3, datë 20.2.2006; nr. 2, datë 3.2.2010; nr. 5, datë 5.2.2014, paragrafi 42, të GJK-së.
12 Neni 4(2) i Kushtetutës.

26 Shqipëria është një vend kandidat për anëtarësim në BE dhe si i tillë ka nënshkruar MSA-në më datë 12 qershor 2006[13], e cila hyri në fuqi më datë 1 Prill 2009.[14]

27 Sa i përket raportit hierarkik midis ligjeve organike ose të miratuara me shumicë të cilësuar të Kuvendit dhe ligjeve të zakonshme ose të miratuara sipas rregullit të përgjithshëm, GJK-ja, në jurisprudencën e saj, ka përcaktuar qartësisht se ligjet e miratuara me shumicë të cilësuar renditen pas Kushtetutës dhe qëndrojnë më lart se ligjet e miratuara me shumicë të thjeshtë.[15] Për pasojë, duhet të theksohet se ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ato të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve organike, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenin 81(2)(a) të Kushtetutës.[16]

28 Paralelisht, aktet nënligjore të nxjerra nga institucionet shtetërore të autorizuara me ligj duhet të jenë në përputhje me aktet më të larta juridike, si në kuptimin formal ashtu edhe në atë material.[17]

13 Marrëveshja e Stabilizim Asociimit midis Komuniteteve Europiane dhe Shteteve Anëtare të tyre, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, u miratua me Ligjin Nr. 9590, datë 27.07.2006 "Marrëveshja e Stabilizim Asociimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe Shteteve Anëtare të tyre", botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 87, datë 14 gusht 2006.

14 MSA-ja e botuar në FZBE L 107/166, më 28 Prill 2009.

15 Shih vendimet nr. 19, datë 3.05.2007; nr. 9, datë 23.03.2010; nr. 23, datë 08.06.2011; nr. 5, datë 5.02.2014 të GJK-së.

16 Për më tepër shih vendimin nr. 5, datë 5.02.2014, paragrafët 54-57, të GJK-së.

17 Shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2011 të GJK-së.

fig. 1. Hierarkia e legjislacionit

1.2 Statusi i akteve ligjore

29 Ligji është instrumenti themeltar i parashikuar në Kushtetutë.[18] Sipas nenit 78 të Kushtetutës, si rregull i përgjithshëm, Kuvendi miraton ligje me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.

30 Në rrethana të veçnta, të lidhura përgjithësisht me çështje ushtarake, Kushtetuta kërkon që aktet ligjore të miratohen nga Kuvendi me një shumicë absolute të të gjithë anëtarëve të tij, siç janë:

- ligjet në lidhje me vendosjen e forcave ushtarake të huaja, ose kalimin e tyre në territorin shqiptar, si dhe ligjet për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit;[19]
- vendimi për Dekretin e Presidentit të Republikës për vendosjen e gjendjes së luftës në përgjigje të një agresioni të armatosur kundër Republikës së Shqipërisë.[20]

31 Për ligjet me rëndësi të veçantë për funksionimin e shtetit dhe me ndikim në të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, neni 81(2) i Kushtetutës parashikon miratimin e tyre nga një shumicë e cilësuar prej tre të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, të cilat renditen më poshtë:

- kodet;
- ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara në Kushtetutë;
- ligji për shtetësinë;
- ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale;
- ligji për referendumet;
- ligji për gjendjen e jashtëzakonshme;
- ligji për statusin e funksionarëve publikë;
- ligji për amnistinë;
- ligji për ndarjen administrative të Republikës.

18 Termi "ligj" i përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, ka raste që nënkupton një interpretim të gjerë duke përfshirë dhe aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e termit "ligj" në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës dhe jo të aktit të organit ligjvënës. Për të përcaktuar nëse ndodhemi para njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës (shih vendimet nr. 20, datë 11.07.2006; nr. 7, datë 27.02.2013 të GJK-së).

19 Neni 12(3) i Kushtetutës.

20 Neni 172(2) i Kushtetutës.

32 Aktet normative me fuqinë e ligjit në kuptim të nenit 101 të Kushtetutës nxirren nga Këshilli i Ministrave, për marrjen e masave të përkohshme në situata të nevojës dhe urgjencës.[21] Aktet normative të Këshillit të Ministrave miratohen më pas nga Kuvendi i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte normative humbasin fuqinë që nga fillimi në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

33 Për shkak të natyrës dhe rëndësisë së veçantë që paraqesin këto akte normative në korpusin e brendshëm legjislativ, më poshtë jemi ndalur më gjerë në përdorimin e këtij instrumenti ligjvënës nga Këshilli i Ministrave.

34 Në analizë të nenit 101 të Kushtetutës, elementët që sanksionohen në përmbajtje të kësaj dispozite janë: (a) nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit, (b) përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit, (c) fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre, (ç) miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

35 Kuptimi i "nevojës dhe urgjencës" është interpretuar në mënyrë të vazhdueshme nga GJK-ja, e cila ka konstatuar se "nevoja" dhe "urgjenca" janë parakushte të domosdoshme që varen nga njëra-tjetra në mënyrë të ndërsjellë dhe që lidhen me situata konkrete, me pasoja për vlefshmërinë e aktit normativ, dhe se qeveria është e detyruar të reflektojë ekzistencën e tyre "në përmbajtjen e çdo akti normativ me fuqinë e ligjit që ajo nxjerr, së paku në preambulën e saj".[22]

36 Mungesa e "nevojës" dhe "urgjencës", të cilat duhen vërtetuar se ekzistojnë përpara momentit të marrjes të iniciativës nga qeveria, sjell si pasojë pavlefshmërinë e aktit normativ me fuqinë e ligjit. Në këto kushte, qeveria shqiptare nuk mund të ndërmarrë një nismë për nxjerrjen e një akti normativ me fuqinë e ligjit, pa vlerësuar më parë rrethanat e krijuara që kanë shkaktuar nevojë dhe urgjencë. Natyra e vlerësimit që bën ky organ është faktik dhe juridik.[23]

37 Nevoja dhe urgjenca janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ato mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm jetësorë, natyrorë

21 Aktet normative të Këshillit të Ministrave me fuqinë e ligjit në kuptim të nenit 101 të Kushtetutës janë të barasvlershme me "dekret ligjet" që mund të nxirreshin nga qeveria shqiptare përpara Kushtetutës aktuale dhe ndjekin nga afër modelin italian të "*decreti di valore di legge ordinaria*" të parashikuar në nenin 77 të Kushtetutës Italiane.

22 Shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të GJK-së.

23 Shih vendimet nr.24, datë 10.11.2006; nr.1, datë 10.11.2006; nr. 5, datë 5.2.2014 të GJK-së.

e shoqërorë, si fatkeqësitë natyrore, boshllëku legjislativ i shkaktuar nga shfuqizimi i akteve, nevoja për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike, parandalimi i menjëhershëm i spekulimeve. Ajo që i bashkon të gjitha këto situata është fakti se përfaqësojnë një gjendje jo të zakonshme në jetën e vendit, ku evidentohet dukshëm rreziku i ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat publike ose për të drejtat themelore të shtetasve. Ky rrezik dikton nevojën e masave të menjëhershme, por që legjislacioni ekzistues nuk i mundëson dot.[24] Elementi urgjencë nuk mund të ekzistojë në vetvete pa nevojën, sepse urgjenca tregon vetëm një situatë që nuk mund të presë, ndërsa nevoja tregon substancën e saj, përcakton situatën që kërkon zgjidhje, tregon marrëdhënien shoqërore që kërkon rregullim ligjor. Kuptimin e tyre të vërtetë termat nevojë dhe urgjencë e manifestojnë në kuadër të situatës së rastit konkret, duke i vlerësuar në kohën kur është vërtetuar prania e tyre.

38 Sikurse GJK-ja ka vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme, qeveria shqiptare është e detyruar të shpjegojë dhe argumentojë nevojën dhe urgjencën konkrete që e kanë detyruar të nxjerrë aktin normativ me fuqinë e ligjit. Ky detyrim ka karakter formal dhe substancial.[25] Respektimi i këtij detyrimi duhet të garantohet fillimisht nga organi propozues i nismës për nxjerrjen e aktit normativ përkatës, duke siguruar në çdo rast shpjegimin e ekzistencës së kritereve kushtetuese në përmbajtje të aktit normativ me fuqinë e ligjit, si dhe në relacionin shpjegues që i bashkëngjitet aktit normativ, i cili duhet të jetë i mirë argumentuar mbi praninë dhe respektimin e kritereve dhe kushteve formale dhe materiale për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit në kuptim të nenit 101 të Kushtetutës.

39 Përkohshmëria e masave lidhet me kushtin e shqyrtimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Nëse akti nuk miratohet nga Kuvendi apo nuk merret në shqyrtim prej tij, me kalimin e periudhës 45 ditore, ai jo vetëm nuk prodhon më efekte për të ardhmen por, njëkohësisht, humbet fuqinë që nga fillimi. Në rast se akti normativ miratohet me ligj dhe hyn në fuqi, ai bëhet pjesë konstante e korpusit të legjislacionit, me përjashtim të rasteve kur vetë Kuvendi i cakton një afat kohor fuqisë së tij.[26]

40 Ligji që miraton Kuvendi, duke vlerësuar, formalisht dhe substancialisht,

24 Po aty.
25 Shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të GJK-së.
26 Po aty.

aktin normativ me fuqinë e ligjit, është instrumenti konvertues i të parit si ligj material në një ligj formal dhe, ky i fundit, nuk mund të jetë veçse ligj i thjeshtë.[27] Bazuar në këtë karakteristikë të ligjit miratues të aktit normativ me fuqinë e ligjit, vlen të theksohet detyrimi kushtetues i Kuvendit për përmbushjen e kërkesave procedurale dhe lëndore për miratimin e ligjeve të cilësuara sipas nenit 81(2) dhe 83 të Kushtetutës, në raport me nenet 1, 2, 4, 7 dhe 116 të Kushtetutës, duke mos deleguar në këtë kuptim pushtetin e tij ligjbërës. Këshilli i Ministrave nuk mundet të ndërhyjë me akte normative me fuqinë e ligjit në ato fusha, rregullimi i të cilave, *expressis verbis*, përbën kompetencë ekskluzive të Kuvendit.[28]

41 Shprehja "masa të përkohshme" në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese, dhe sipas kësaj të fundit, duhet kuptuar e lidhur vetëm me fuqinë e përkohshme, maksimumi 45 ditëshe, të aktit normativ me fuqinë e ligjit që i përmban ato masa dhe jo me fuqinë juridike të ligjit që e ka miratuar.[29]

42 Elementi tjetër që del nga kuptimi dhe përmbajtja e nenit 101 të Kushtetutës lidhet me fuqinë juridike të aktit dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre. Akti normativ me fuqinë e ligjit është ligj në kuptimin material të termit, por jo në kuptimin formal të tij. Në thelb, ai rregullon marrëdhënie shoqërore të rëndësishme që meritojnë trajtim me ligj nga Kuvendi, por kur vërtetohet prania e nevojës dhe urgjencës, Kushtetuta lejon që iniciativën ligjvënëse, në këtë rast, ta kryejë Këshilli i Ministrave.

43 GJK-ja ka çmuar se fuqia juridike e aktit normativ me fuqinë e ligjit është e barabartë me fuqinë e ligjit që nga momenti i nxjerrjes së tij, sepse kjo vlerë e normës përcaktohet nga natyra e marrëdhënies juridike që gjen rregullim në të dhe jo nga organi që e ka miratuar.[30]

44 GJK-ja ka interpretuar qartë dallimin ndërmjet hyrjes në fuqi të aktit normativ me fuqinë e ligjit (ligj në kuptimin material) dhe hyrjes në fuqi të ligjit formal,[31]duke mbajtur në konsideratë specifikat dhe përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës. Elementë të tillë, si nevoja dhe urgjenca, tregojnë se aktet në fjalë duhet të hyjnë në fuqi menjëherë. Këta elementë, që qëndrojnë në bazë të transferimit kushtetues të së drejtës së nxjerrjes së

27 Shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014 të GJK-së.
28 Po aty.
29 Shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të GJK-së.
30 Po aty.
31 Shih vendimin nr. 47, datë 07.07.1999 të GJK-së.

aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi drejt Këshillit të Ministrave, do të zhvleftësoheshin nëse për hyrjen në fuqi të tyre do të duhet të respektohen, detyrimisht, të gjitha afatet dhe procedurat e parashikuara nga neni 117 i Kushtetutës. Nga ana tjetër, përmbajtja e pjesës së dytë të nenit 101 të Kushtetutës, tregon qartë se ato hyjnë në fuqi menjëherë.[32] Pavarësisht hyrjes në fuqi menjëherë të akteve normative me fuqinë e ligjit, këto akte normative botohen në edhe në FZ.[33]

45 Rëndësi të veçantë i është kushtuar edhe detyrimit kushtetues për njoftimin publik të aktit normativ nga organi që e nxjerr atë. Sipas interpretimit të GJK-së, bërja publike e këtyre akteve nuk ka si domosdoshmëri botimin në FZ. Këshilli i Ministrave, për këtë qëllim mund të përdorë, në funksion të kohës që ka në dispozicion, krahas botimit në FZ dhe komunikimin zyrtar me mjete të tjera të përshtatshme, njoftimin me anë të mediave apo me mjete të tjera si këto. Pavarësisht nga forma e përzgjedhur për komunikimin publik, njoftimi duhet të mbërrijë detyrimisht në adresë të subjekteve, të cilëve u përkasin të drejtat e detyrimet që krijon akti normativ me fuqinë e ligjit, me qëllim që këta të mos cenohen.[34]

46 Së fundmi, kompetenca e Kuvendit për miratimin e aktit normativ konsiston në vlerësimin në formë dhe përmbajtje të normës dhe elementeve përbërëse të saj, si dhe në shprehjen e mendimit përfundimtar lidhur me aktin normativ. Natyra e këtij vlerësimi është politike, por dhe juridike. Ai shqyrton praninë e të gjitha elementeve të përcaktuara shprehimisht për aktin normativ me fuqinë e ligjit në Kushtetutë, si dhe pajtueshmërinë e përmbajtjes së tij me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi. Kuvendi i Shqipërisë është organi që bën vlerësimin dhe kontrollin e nevojës dhe urgjencës, sepse Kushtetuta e ka ngarkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për këtë qëllim. Kuvendi, gjatë miratimit të aktit normativ, ka diskrecion të zgjedhë një nga tri alternativat e mëposhtme: (a) të marrë në shqyrtim dhe ta miratojë aktin e nxjerrë nga Këshilli i Ministrave, (b) ta marrë në shqyrtim dhe të mos e miratojë atë, (c) të heshtë derisa të plotësohet afati 45 ditor që dispozita kushtetuese i ka lënë në dispozicion për tu shprehur lidhur me aktin. Alternativa e zgjedhur nga Kuvendi lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me perspektivën e mëtejshme të normës. Vlerësimi dhe miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit, të nxjerrë nga qeveria, dhe dhënia fuqi të mëtejshme atij nuk mund të bëhet ndryshe veçse me anë

32 Shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të GJK-së.
33 Neni 29(1) i LKM-së.
34 Po aty.

të një norme që ka të njëjtat vlera, pra me ligj.[35]

47 Çdo lloj ndërhyrje nga ana e Kuvendit pas kalimit të afatit kushtetues 45 ditor është e pavlefshme, pasi praktikisht nuk ekziston më objekti ndaj të cilit mund të bëhet vlerësim. Në mënyrë të qartë, Kushtetuta e ka përcaktuar afatin 45 ditor si një afat prekluziv që nuk mund të zgjatet për asnjë lloj arsyeje dhe nga asnjë autoritet. Përfundimi i këtij afati sjell pasoja të menjëhershme për aktin normativ me fuqinë e ligjit, duke e lënë atë pa fuqi që nga fillimi.

1.3 Statusi i akteve nënligjore përkundrejt akteve të tjera administrative

48 Kushtetuta parashikon kategori të ndryshme të akteve të nxjerra nga organet administrative, të cilat bazohen në ligj dhe synojnë zbatimin e ligjit, d.m.th., aktet nënligjore (neni 118 i Kushtetutës) dhe aktet e brendshme administrative (neni 119 i Kushtetutës). Këto akte duhet të dallohen nga aktet individuale administrative, të cilat organet administrative i nxjerrin bazuar në Kodin e Procedurave Administrative.[36]

49 Aktet nënligjore janë akte normative në kuptimin e Kreut I, Pjesa e Shtatë e Kushtetutës.[37] Sipas nenit 118 të Kushtetutës, aktet nënligjore nxirren në bazë të ligjit. Kështu, aktet nënligjore duhet të jenë në përputhje me aktet më të larta në hierariknë e akteve juridike, si në kuptimin formal ashtu edhe material.[38]

50 Aktet nënligjore duhet të nxirren nga organet e parashikuara në Kushtetutë. Në këtë kuptim, neni 116 i Kushtetutës u referohet 'akteve normative' të Këshillit të Ministrave (neni 116(1)(c) i Kushtetutës),[39] organeve të qeverisjes vendore (neni 116(2) i Kushtetutës), si dhe ministrave dhe organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore shtetërore (neni 116 (3) i Kushtetutës).

51 Neni 117 i Kushtetutës parashikon që 'aktet normative' të Këshillit të

35 Po aty.
36 Lista e akteve të nxjerra nga organet administrative siç referohet në praktikën aktuale përkundrejt terminologjisë së Kushtetutës bashkëlidhur si Shtojca A e këtij Manuali.
37 Pjesa e Shtatë, Kreu I, që përfshin nenet 116 deri 120 të Kushtetutës, titullohet: "Aktet Normative".
38 Shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2011 të GJK-së.
39 Duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJK-së, kompetenca e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte nënligjore bazohet në konceptin e rezervës ligjore, (*Gesetzesvorbehalt*), sipas të cilit ligjvënësi vendos të delegojë një çështje specifike për rregullime të mëtejshme tek një organ specifik përmes akteve nënligjore.

Ministrave, ministrave dhe institucioneve të tjera shtetërore qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në FZ. Aktet nënligjore të këtyre organeve administrative duhet të botohen në FZ.

52 Po ashtu, neni 118(2) i Kushtetutës parashikon se *"një ligj duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte."*. Kompetenca për të nxjerrë akte nënligjore nuk mund t'u delegohet organeve të tjera.[40] Këto kërkesa janë një shprehje e tre parimeve themelore kushtetuese: demokracia, ndarja e pushteteve dhe sundimi i ligjit. Një akt nënligjor është përjashtim nga rregulli që normat me efekte të përgjithshme detyruese duhet të miratohen nga pushteti legjislativ. Prandaj, një akt nënligjor, i cili ka efekt të përgjithshëm detyrues - sipas Kushtetutës - i delegohet pushtetit ekzekutiv brenda kufijve rigorozë të një autorizimi të qartë nga ligji, si dhe qëllimit dhe parimeve sikurse përcaktohen nga ligji. Çdo akt nënligjor i cili nuk bazohet në një autorizim të qartë ose shkon përtej qëllimit dhe parimeve të përcaktuara nga ligji është antikushtetues.

53 Sipas Kushtetutës, karakteristikat kryesore të një akti nënligjor janë si më poshtë:

- Aktet nënligjore janë normative dhe kanë efekt të përgjithshëm detyrues, d.m.th. prodhojnë efekte për një grup subjektesh të përcaktuar nga karakteristikat e përgjithshme (si të gjithë qytetarët; të gjithë pronarët e makinave; të gjithë banorët e një bashkie të caktuar).
- Ata nxirren në bazë të ligjit; d.m.th., të akteve të miratuara nga ligjvënësi.[41] Aktet nënligjore nuk mund t'ia delegojnë nxjerrjen e një akti nënligjor një organi tjetër.
- Ata nxirren nga Këshilli i Ministrave, ministrat, organet drejtuese të institucioneve të tjera qendrore të shtetit ose organet e qeverisjes vendore; d.m.th nga një organ administrativ.

40 Neni 118(3) i Kushtetutës.

41 Sipas nenit 101 të Kushtetutës, akteve normative të Këshillit të Ministrave të miratuara bazuar në këtë nen u jepet 'fuqia e ligjit'. Kështu, akte të tilla mund të shërbejnë edhe si bazë për akte nënligjore, si p.sh., akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 1, datë 31.1.2020 "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike", miratuar me ligjin nr. 18/2020, të ndryshuar, në nenet 30(4) dhe 37(5) autorizon Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore, përkatësisht, për përcaktimin e trajtimit financiar të punonjësve të OFL-së dhe Drejtorisë së Antiterrorit, si dhe për miratimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave mbi informacionin kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe terrorizmit me bazat e tjera të të dhënave, si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara në këtë bazë të dhënash.

- Aktet nënligjore të organeve administrative me juridiksion në të gjithë territorin e Shqipërisë botohen në FZ; d.m.th. aktet nënligjore të Ministrit, Këshillit të Ministrave dhe organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore.
- Aktet nënligjore autorizohen shprehimisht nga ligji, i cili duhet të përcaktojë organin kompetent, objektin, pra çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren aktet nënligjore.

54 Nëse një akt nënligjor nuk plotëson njërën nga këto kritere kushtetuese, ai nuk është në përputhje me nenet 116–118 të Kushtetutës dhe si i tillë është antikushtetues. Nëse mangësia që paraqitet lidhet vetëm me disa parashikime të një akti nënligjor, atëherë vetëm këto parashikime preken nga pasoja e antikushtetutshmërisë.

55 Neni 119 i Kushtetutës parashikon aktet e brendshme administrative të organeve administrative: rregulloret e Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve të tjera shtetërore qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve shtetërore qendrore, të cilët kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshëm vetëm për subjektet administrative që janë në varësi të këtyre organeve.[42] Këto akte nuk mund të shërbejnë si bazë për marrjen e vendimeve që lidhen me individë dhe subjekte të tjera,[43] përkundrazi, nxirren për organizimin e brendshëm të tyre (rregullat e sjelljes, orarin e ofrimit të shërbimeve, ditët e pushimit apo organizimin e pushimeve vjetore, etj.).[44]

56 Ndryshe nga aktet nënligjore, aktet e brendshme administrative nuk kanë nevojë për bazën ligjore autorizuese për nxjerrjen e tyre. Aktet nënligjore janë një përjashtim nga prerogativa legjislative dhe shprehje e delegimit të pushtetit legjislativ[45] brenda kufijve të rreptë për pushtetin ekzekutiv, ndërsa aktet e brendshme administrative janë detyrues vetëm për vetë organin administrativ që i ka nxjerrë ose për njësitë administrative që varen prej tij. Për rrjedhojë, këto akte nuk kanë efekt të përgjithshëm detyrues, d.m.th., efekte përtej organit administrativ, funksionarëve dhe organeve

42 Neni 119(1) i Kushtetutës.

43 Neni 119(2) i Kushtetutës.

44 Ka shumë debate në lidhje me konceptin e karakterit të brendshëm. Një qasje që gjen mbështetje nga bota akademike është interpretimi i karakterit të brendshëm të formulimit si akte administrative të brendshme dhe, për këtë arsye, nuk përbëjnë akte nënligjore në kuptimin e nenit 118 të Kushtetutës, ndërsa një qasje tjetër është bërja e dallimit ndërmjet "karakterit të brendshëm" të një akti nga një akt i "brendshëm", pasi urdhrat dhe rregulloret janë të detyrueshme vetëm për subjektet administrative që varen prej tyre, përcaktojnë rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk janë shteruese në zbatimin e tyre, prandaj ato mund të kenë një ndikim në të drejtat dhe detyrimet e palëve të treta.

45 Pushteti legjislativ karakterizohet nga tagri për të miratuar norma me efekt të përgjithshëm detyrues.

të tij. Si të tillë, nuk do të konsiderohen "akte normative në kuptimin e ngushtë". Një dispozitë brenda një akti të brendshëm administrativ, e cila vendos një rregull me efekt për një palë të tretë do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën.

57 Sidoqoftë, ashtu si aktet nënligjore, aktet e brendshme administrative nxirren në bazë të ligjit[46] dhe për zbatimin e akteve që kanë fuqi të përgjithshme juridike.[47] Prandaj, këto akte nuk duhet të bien ndesh me ligjin, si në kuptimin formal ashtu edhe në atë material.

58 Aktet e brendshme administrative të organeve administrative, 'vetëdetyruese' apo drejtuar edhe njësive administrative që varen prej tyre, nuk mund të shërbejnë si bazë për marrjen e vendimeve lidhur me individë dhe subjekte të tjerë. Gjithashtu, nuk mund të referohen drejtpërdrejt në gjykatë. Sidoqoftë, këto akte mund të kenë një efekt të tërthortë mbi individët, kur përdoren nga administrata publike për të interpretuar ligje ose akte nënligjore të caktuara (p.sh. në fushën e taksave dhe sigurimeve shoqërore)dhe në këtë mënyrë mund të kundërshtohen indirekt në gjykatë.[48]

59 Në dallim nga aktet normative, nuk është e domosdoshme botimi i akteve të brendshme administrative në FZ. Në praktikë, aktet e brendshme administrative janë botuar gjerësisht në FZ dhe në faqen e internetit të organeve administrative që kanë miratuar aktet.

60 Në nenet 100(5) dhe 102(4), Kushtetuta u referohet udhëzimeve, ndonëse nuk parashikon ndonjë përkufizim për udhëzimet e Këshillit të Ministrave ose të ministrave, të cilat përkundrazi përcaktohen në nenin 28(ç) të LKM-së, si akte nënligjore të Këshillit të Ministrave, ministrave ose drejtuesve të institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, me karakter shpjegues, që shtjellojnë me hollësi të gjitha urdhërimet e ligjit ose vendimit të Këshillit të Ministrave. Kështu, udhëzimet e nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit shtjellojnë rregullat e përgjithshme të sjelljes të përcaktuara me ligj. Në interpretim të këtij përkufizimi ligjor, udhëzimi synon të sugjerojë dhe të shpjegojë se si të zbatohet ligji, në rastet kur është e nevojshme ose kur ligji prezanton situata të reja ose komplekse ligjore ose shoqërore, të cilat mund të ndikojnë në zbatimin uniform të ligjit.

46 Nenet 119(2) i Kushtetutës dhe Neni 119(2) i Kushtetutës.
47 Neni 119(3) i Kushtetutës.
48 Shih edhe Opinionin e Komisionit të Venecias, CDL-AD(2019)025, paragrafi 31.

61 Megjithatë, karakteri sqarues i udhëzimit në kuptim të nenit 28(ç) të LKM-së nuk duhet marrë dhe as interpretuar në kuptimin e ngushtë të emërtimit të tij, sikur ai nuk mund të sjellë efekte detyruese për subjektet e së drejtës. Organet përkatëse të administratës publike, si dhe personat të cilëve iu drejtohet udhëzimi, janë të detyruar të zbatojnë me përpikmëri rregullat që ai vendos për marrëdhënien juridike në përputhje me autorizimin ligjor për nxjerrjen e tij. Sigurisht që efektet detyruese të normave të udhëzimit nuk janë të të njëjtit nivel me normat juridike të vendimeve. Megjithatë, normat juridike që parashikon udhëzimi janë norma të një akti juridik dhe, si të tilla, mbeten të detyrueshme për t'u zbatuar.[49]

62 Aktet e brendshme administrative kanë këto karakteristika kryesore:

- Këto akte, ashtu si aktet nënligjore, nxirren nga organet administrative.
- Aktet e brendshme administrative nxirren në zbatim të akteve që kanë efekt të përgjithshëm detyrues, si aktet ligjore dhe nënligjore normative.
- Ndryshe nga aktet nënligjore, ato kanë karakter të brendshëm dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve të treta; d.m.th., nuk kanë efekt të përgjithshëm detyrues.
- Aktet e brendshme administrative nuk e kanë shprehimisht të nevojshme autorizimin për nxjerrjen e tyre.
- Aktet e brendshme administrative nuk e kanë të detyrueshëm botimin në FZ.

63 Aktet nënligjore normative dhe aktet e brendshme administrative dallojnë nga aktet administrative individuale. Nga dispozitat e mësipërme kushtetuese kuptohet që aktet normative – ligje dhe akte nënligjore normative – janë detyruese dhe kanë efekt të përgjithshëm detyrues, d.m.th. i drejtohen një rrethi subjektesh të papërcaktuar të së drejtës ose të përcaktuar nga karakteristikat e përgjithshme (p.sh. të gjithë qytetarët, të gjithë pronarët e makinave, të gjithë banorët e një bashkie të caktuar). Aktet administrative me karakter individual (në krahasim me normat juridike me efekt të përgjithshëm) nxirren në bazë të një norme juridike me efekt të përgjithshëm dhe kanë për qëllim rregullimin e një çështjeje specifike për një ose më shumë individë të caktuar.[50]

49 Sadushi, S. "E drejta administrative 2". Tiranë: 2008, f. 76-77.
50 Sadushi, S. "E drejta administrative procedurale". Tiranë: 2017, f.15-16.

64 KPA-ja dhe LGJA-ja[51] përkufizojnë aktin nënligjor normativ si shprehje të vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, i cili rregullon një ose disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes, dhe i cili nuk është shterues në zbatimin e tij. Ndryshe nga aktet nënligjore normative, neni 3(1)(a)(b) i KPA-së dhe neni 2(2) i LGJA-së parashikojnë:

- *akti administrativ individual*, i cili është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektesh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;
- *akti administrativ kolektiv*, i cili është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektesh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.

65 Në analizë të përkufizimeve ligjore të mësipërme, GJK-ja ka theksuar se një akt me karakter normativ duhet të vendosë norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektesh.[52]Akti normativ është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje, dhe që nuk është shterues në zbatimin e tij, kuptim i dhënë edhe nga LGJA-ja.[53]

66 Ndërsa, akti administrativ individual është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Ai i referohet një fakti konkret, jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike, dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete me natyrë teknike dhe jo normative.[54]

67 Doktrina juridike, legjislacioni, por edhe jurisprudenca e GJK-së kanë identifikuar kriteret që përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në individual

51 Neni 3(2) i KPA-së dhe neni 2(3) i LGJA-së.
52 Shih vendimin nr.185, datë 26.11.2001 të GJK-së.
53 Shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2016 të GJK-së.
54 Shih vendimet nr.35, datë 07.03.2013; nr.14, datë 21.03.2014; nr.59, datë 23.12.2014; nr. 86, datë 30.12.2016 të GJK-së.

ose normativ, të cilat janë:[55]

- Subjektet të cilëve u drejtohet akti - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktueshëm në bazë të karakteristikave të përgjithshme ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës;
- Objekti - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete të së drejtës administrative ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes, me karakter abstrakt;
- Karakteri shterues/joshterues - efekteti shtrihen teksubjektetë përcaktuara dhe në mënyrë të njëhershme ose tek subjekte të papërcaktuara të së drejtës, në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme.

68 Gjithashtu, duhet treguar kujdes në diferencimin e aktit nënligjor normativ nga akti administrativ kolektiv, i cili i drejtohet një grupi subjektesh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, si dhe krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.

69 Zbërthimi i kritereve të mësipërme nxjerr në pah edhe dallimin ndërmjet aktit administrativ kolektiv nga akti administrativ individual, për shkak të papërcaktueshmërisë së numrit të personave që i përkasin grupit. Kriteret e tjera që lidhen me objektin e rregullimit dhe karakterin shterues plotësohen edhe nga akti administrativ kolektiv.

70 Nisur edhe nga terminologjia jo shumë e qëndrueshme që përdor Kushtetuta në emërtimin e akteve administrative të përmendur më sipër, në praktikë termat e përdorur për aktet nënligjore në kuptim të nenit 118 të Kushtetutës janë pjesërisht të njëjta me termat e përdorur për aktet e brendshme administrative në kuptim të nenit 119 të Kushtetutës, si dhe për aktet administrative individuale. Përdorimi i termave të njëjtë është problematike për shkak të natyrës juridike thelbësisht të ndryshme të këtyre akteve (shih më lart karakteristikat e akteve dhe kërkesat ligjore për miratimin e tyre). Kjo situatë kërkon që, fillimisht, organi administrativ që nxjerr aktin dhe më pas subjektet të cilëve u drejtohet akti, të vlerësojnë për çdo akt natyrën juridike, me qëllim identifikimin e llojit të aktit (akt nënligjor normativ, akt administrativ i brendshëm, akt administrativ individual).[56]

55 Shih vendimet nr. 185, datë 26.11.2001; nr. 35, datë 17.07.2013; nr. 14, datë 21.03.2014; nr.59, datë 23.12.2014; nr. 86, datë 30.12.2016 të GJK-së.

56 Kjo çështje mund të kishte nevojë dhe për ndërhyrje nga ligjvënësi.

71 Për shembull, Këshilli i Ministrave, në pajtim me nenin 100(5) të Kushtetutës, nxjerr vendime dhe udhëzime. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave nxjerr akte normative me efekt detyrues të përgjithshëm sipas nenit 116 (1)(ç) të Kushtetutës.[57] Këshilli i Ministrave përdor termin 'vendim' dhe 'udhëzim' për nxjerrjen e akteve nënligjore në kuptim të nenit 118(1) të Kushtetutës. Aktet nënligjore normative kanë nevojë për një autorizim të qartë nga ligji, d.m.th. një dispozitë ligjore që autorizon shprehimisht Këshillin e Ministrave të nxjerrë aktin në përputhje me ligjin (neni 118(2) i Kushtetutës). Në këto raste, vendimi ose udhëzimi botohet në FZ në mënyrë që të ketë efekte juridike, përndryshe janë të pavlefshme (neni 117(1) i Kushtetutës).

Shembull për një akt nënligjor normativ të titulluar 'vendim':
Vendimi nr. 110, datë 6.3.2019, i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre"

Shembull për një akt nënligjor normativ të titulluar 'udhëzim':
Udhëzimi nr.1, datë 13.04.2016, i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e kritereve e të procedurave për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe akteve noteriale të lidhura për zhvillimin, në cilësinë e investitorit e të pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njësive individuale, të objektit në fazën e karabinasë dhe të objektit të përfunduar"

72 Në të njëjtën kohë, Këshilli i Ministrave përdor termin *vendim* për akte që u drejtohen individëve të caktuar ose një grupi individësh, të cilët bazohen në KPA. Akte të tilla janë akte individuale administrative.[58]

Shembull për një akt administrativ individual të titulluar 'vendim':
Vendimi nr. 677, datë 28.9.2016 i Këshillit të Ministrave "Për lirimin dhe emërimin nga/në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave"

57 Neni 116 (1)(ç) i Kushtetutës u referohet 'akteve normative të Këshillit të Ministrave'. Nuk sqaron qartë nëse këto akte duhen kuptuar vetëm si akte normative në kuptimin e nenit 101 të Kushtetutës apo nëse kjo përfshin aktet nënligjore në kuptim të nenit 118 të Kushtetutës. Në praktikë, kjo dispozitë përdoret si bazë ligjore për të dy llojet e akteve.

58 Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë edhe akte administrative individuale, të cilat nuk janë në vëmendje të trajtimit në këtë pjesë. Në çdo rast, këto akte nuk duhet të bien ndesh me aktet normative të niveleve më të larta.

73 Në përputhje me nenin 102(4) të Kushtetutës, ministri, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij/saj nxjerr urdhra dhe udhëzime. Sipas nenit 116(3) të Kushtetutës, ministrat mund të miratojnë akte normative të cilat botohen në FZ dhe që konsiderohen akte nënligjore në kuptim të nenit 118 të Kushtetutës. Ndërkohë, neni 119(1) i Kushtetutës u referohet urdhrave të ministrave dhe rregulloreve të ministrive, si akte që kanë karakter të brendshëm, të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që janë në varësi të këtyre organeve. Neni 28 (d) i LKM-së i përkufizon urdhrat si akte nënligjore me karakter të brendshëm, që mund të vendosin rregulla sjelljeje, ose mund të rregullojnë një marrëdhënie konkrete.

74 Në praktikë, termi *urdhër* i ministrit, përdoret për aktet nënligjore, aktet e brendshme administrative si dhe aktet administrative individuale. Për shembull, urdhri i Ministrit të Shëndetësisë për kufizimet në lidhje me parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 është akt nënligjor me efekt detyrues të përgjithshëm në të gjithë territorin, i nxjerrë në bazë të një akti normativ të Këshillit të Ministrave në kuptimin e nenit 101 të Kushtetutës.[59] Nga ana tjetër, urdhri i të njëjtit ministër për emërimin e drejtorit të Klinikës Universitare të Tiranës është një akt administrativ individual dhe jo një akt nënligjor, në kuptimin e neneve 116 – 118 të Kushtetutës dhe as një akt i brendshëm administrativ.

Shembull i një akti nënligjor normativ të ministrit të titulluar 'urdhër':
Urdhri nr. 267, datë 03.08.2020, i Ministrit të Drejtësisë "Për rregullat dhe procedurat për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në një vend të huaj"

Shembull i një akti të brendshëm administrativ të ministrit të titulluar 'urdhër':
Urdhri nr. 181, datë 15.06.2020, i Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e programit vjetor të inspektimit të noterëve për vitin 2020"

Shembull për një akt administrativ individual të titulluar 'urdhër':
Urdhri nr. 64, datë 23.5.2016, i Ministrit të Financave "Për delegim kompetencash"

59 Duke iu referuar nenit 119(2)(3), Kushtetuta parashikon qartë se urdhrat dhe rregulloret nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për marrjen e vendimeve në lidhje me individët dhe subjektet e tjera. Këto akte nxirren në bazë dhe për zbatim të akteve që kanë fuqi juridike të përgjithshme. Prandaj, përdorimi i termit 'urdhër' për një 'akt nënligjor' nuk do të ishte i rekomandueshëm.

75 Për më tepër, në praktikë, ndonjëherë, urdhrat bazohen në vendimet e Këshillit të Ministrave. Për shembull, ligji nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit" autorizon Këshillin e Ministrave të rregullojë çështjet që lidhen me miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit. Këshilli i Ministrave me vendim rregulloi këto çështje dhe në pikën 7 të këtij vendimi autorizoi Drejtorin e Policisë së Shtetit për të miratuar specifikimet dhe kushtet teknike të zbatimit të objekteve të uniformës, shenjave dhe elementeve të tjera të Policisë së Shtetit, si dhe zëvendësimin e materialeve të objekteve të uniformës, brenda vlerës së normës dhe funksionet, që, për arsye pune dhe shërbimi, gjatë orarit zyrtar mbajnë veshje civile. Kështu, urdhri bazohet drejtpërdrejt në një akt nënligjor normativ dhe indirekt në një ligj. Në këtë rast, kemi të bëjmë me një **nëndelegim**, dhe si i tillë është në kundërshtim me nenin 118(3) të Kushtetutës, prandaj kjo qasje nuk duhet të ndiqet.

76 Përveç kësaj, termi *rregullore* përdoret për t'iu referuar një akti nënligjor në kuptim të nenit 118 të Kushtetutës si dhe një akti të brendshëm administrativ të ministrit në kuptimin e nenit 119 të Kushtetutës. Asnjë shembull nuk është identifikuar për një akt administrativ individual të referuar si *rregullore*.

Shembull i një akti nënligjor normativ të ministrit të titulluar 'rregullore'
Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë në institucionet e administratës shtetërore gjatë periudhës së epidemisë COVID-19 (miratuar me urdhrin nr. 38 datë 12.5.2020)[60]

Shembull për një akt të brendshëm administrativ të titulluar 'rregullore':
Rregullore e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" (miratuar me urdhrin nr. 5745, datë 13.8.2008, të ndryshuar)

77 Si të tilla, kategoritë e ndryshme të akteve të lartpërmendura duhet të dallohen sipas kritereve të mëposhtme:

60 Sipas pikës 1 të urdhrit nr. 38, datë 13.5.2020, Rregullorja që i është bashkangjitur atij, është pjesë përbërëse e urdhrit dhe si e tillë mund të klasifikohet më mirë si "urdhër" sesa si "rregullore" në kuptimin e nenit 119 të Kushtetutës.

- Autoriteti që ka kompetencën për miratimin e tyre:
  - aktet normative të ligjvënësit janë ligjet;
  - aktet normative të autoriteteve administrative janë aktet nënligjore;
- Efekti juridik që prodhojnë:
  - aktet normative të ligjvënësit dhe të organeve administrative me efekte detyruese të përgjithshme janë përkatësisht ligje ose akte nënligjore normative;
  - aktet e organeve administrative me efekte individuale janë vendime administrative;
  - aktet e organeve administrative me karakter të brendshëm janë rregullore dhe urdhra.

2. Statusi i së drejtës ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm

2.1 Natyra juridike detyruese e marrëveshjeve ndërkombëtare

78 Republika e Shqipërisë, në përputhje me nenin 5 të Kushtetutës, zbaton të drejtën ndërkombëtare që është e detyrueshme për të (*pacta sunt servanda*). Në kuptim të këtij neni, i cili sanksionohet në pjesën e parimeve të përgjithshme të Kushtetutës, e drejta ndërkombëtare (*ius gentium*), në kuptimin e saj më të gjerë, nënkupton sistemin e ligjeve që rregullon ndërvarësinë e shteteve sovrane dhe të drejtat dhe detyrat e tyre ndërmjet tyre.

79 Burimet themelore të së drejtës ndërkombëtare janë (a) traktatet, (b) konventat, (c) e drejta ndërkombëtare zakonore, për aq sa kjo është dëshmi e një praktike të përgjithshme të sjelljes të pranuar si juridikisht detyruese, (ç) parimet e përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e civilizuara. Traktatet dhe konventat, të cilat sipas terminologjisë së legjislacionit shqiptar njihen si "**marrëveshje ndërkombëtare**", përbëjnë burimin kryesor të së drejtës ndërkombëtare publike.

80 Neni 122 i Kushtetutës parashikon se, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Normat e marrëveshjeve ndërkombëtare janë të vetëzbatueshme dhe mund të zbatohen drejtpërdrejt nga autoritetet shtetërore dhe gjykatat, nëse është mjaft e qartë dhe e saktë për të siguruar bazën për një vendim në një rast të

veçantë. Nëse norma ndërkombëtare ka natyrë deklarative, pra ajo nuk e ka qartësinë dhe saktësinë e nevojshme mbi të cilën mund të bazohet një vendim, për pasojë, nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj duhet rregulluar me ligj vendas. Marrëveshja ndërkombëtare interpretohet në mirëbesim, në përputhje me kuptimin e termave të marrëveshjes në kontekstin e tyre, nën dritën e objektit dhe qëllimit të marrëveshjes.[61]

81 Neni 116 i Kushtetutës i vendos marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara menjëherë pas Kushtetutës dhe mbi ligjet e brendshme. Kështu, në rast konflikti midis një ligji të brendshëm dhe një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar, kjo e fundit ka epërsi në zbatim në çdo rast.[62] Çdo përplasje dhe papajtueshmëri midis marrëveshjeve ndërkombëtare dhe Kushtetutës mund të shmanget nëpërmjet kompetencës që i është dhënë Gjykatës Kushtetuese në nenin 131(1)(b) të Kushtetutës për të shqyrtuar pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre.

82 Koncepti monist ndaj marrëdhënieve midis së drejtës së brendshme dhe ndërkombëtare të ndjekur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë lejon unifikimin e të gjitha normave juridike, ndërkombëtare dhe të brendshme. Prandaj, ratifikimi i një marrëveshje ndërkombëtare nga Shqipëria e bën atë automatikisht pjesë integrale të rendit juridik shqiptar, që nga momenti i hyrjes në fuqi të aktit që ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare.[63]

83 Republika e Shqipërisë gjithashtu ka ratifikuar Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve,[64] e cila në nenin 27 parashikon se shtetet palë në Konventë nuk mund të përdorin dispozitat e së drejtës së brendshme si justifikim për pamundësinë e tyre për të zbatuar një marrëveshje ndërkombëtare. Ndaj, për shkak të këtij parimi të përgjithshëm të epërsisë të së drejtës ndërkombëtare, dispozita deklarative në ligjet individuale të brendshme që përcaktojnë përparësinë e së drejtës ndërkombëtare duhet të shmangen. Meqenëse parimi i përgjithshëm i epërsisë të së drejtës ndërkombëtare ka autoritetin kushtetues, dispozita të tilla legjislative do ishin të tepërta.

61 Shih nenin 36(1) të LMN-së.

62 Neni 122 (2) i Kushtetutës parashikon se: "Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.".

63 Kini parasysh që një marrëveshje ndërkombëtare hyn në fuqi sipas mënyrës së parashikuar nga vetë marrëveshja dhe sipas dispozitave të LMN-së (neni 16).

64 Ligji nr.8696, datë 23.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Vjenës "Për të Drejtën e Traktateve""

84 Një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare që meriton vëmendje të veçantë është KEDNJ-ja[65]. Ky akt ndërkombëtar gëzon një status të veçantë në rendin tonë juridik në krahasim me aktet e tjera ndërkombëtare. Neni 17(2) i Kushtetutës përbën një standard minimum dhe një prag, poshtë të cilit nuk mund të kalohet. Neni 17(2) i Kushtetutës parashikon se kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Kushtetuta në asnjë rast nuk duhet të tejkalojnë kufizimet e KEDNJ-së. Në sajë të kësaj dispozite kushtetuese, KEDNJ-ja ka një status kushtetues vetëm përsa i takon kufizimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Niveli i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në KEDNJ përbën njëkohësisht edhe një nivel kushtetues. Ligjvënësi është i lirë të garantojë një nivel mbrojtjeje më të lartë, por kurrsesi më të ulët se sa ai i Konventës. Asnjë palë shtetërore në KEDNJ nuk mund të kufizojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut më shumë sesa vetë Konventa.[66]

2.2 Përgatitja e marrëveshjeve ndërkombëtare

85 Projektet e marrëveshjeve ndërkombëtare përgatiten nga ministritë, institucionet qendrore e vendore, si dhe entet publike, në përputhje me Kushtetutën, të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë dhe legjislacionin shqiptar në fuqi, ku përfshihen:

- Ligji për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë;
- Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve;
- Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve midis Shteteve dhe Organizatave Ndërkombëtare ose midis Organizatave Ndërkombëtare.[67]

86 Përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë, të autorizuar për negocimin dhe parafimin e marrëveshjeve ndërkombëtare pajisen me plotfuqi, e cila lëshohet nga ministri i Punëve të Jashtme, pas autorizimit të dhënë nga Presidenti i Republikës, kur marrëveshja ndërkombëtare që negociohet është në emër të Republikës së Shqipërisë, ose Kryeministri, kur marrëveshja ndërkombëtare që negociohet është në emër të Këshillit të Ministrave.[68] Përjashtohen nga pajisja me plotfuqi për nënshkrimin

65 Ligji nr.8137, datë 31.07.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore"

66 Shih vendimet nr.24, datë 13.06.2007; nr. 12, datë 14.04.2010; nr. 20, datë 01.06.2011; nr. 4, datë 15.02.2021 të GJK-së.

67 Ligj nr. 18/2014 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Vjenës "Për të Drejtën e Traktateve midis Shteteve dhe Organizatave Ndërkombëtare ose midis Organizatave Ndërkombëtare", 1986".

68 Neni 6(1)–(3) i LMN-së.

e marrëveshjeve ndërkombëtare ambasadori i misionit diplomatik me shtetin ose organizatën ndërkombëtare ku është akredituar.[69]

87 Iniciativa për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare mund të merret nga institucionet e Republikës së Shqipërisë ose të një shteti tjetër apo nga një organizatë ndërkombëtare. Kur palët kanë rënë dakord për nevojën e lidhjes së një marrëveshjeje ndërkombëtare, ministria kompetente[70] për zbatimin e marrëveshjes përgatit projektin që do t'i propozohet palës tjetër.[71]

88 Për hartimin e projektmarrëveshjes, ministria kompetente merr mendimet e ministrive dhe institucioneve të interesuara, si dhe në çdo rast mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, kur marrëveshja ka efekt financiar, si dhe Ministrisë përgjegjëse për çështjet e integrimit evropian, kur marrëveshja ka lidhje me *acquis* të BE. Pas marrjes së mendimeve për projektmarrëveshjen, ministria kompetente bashkërendon e reflekton në tekst propozimet dhe komentet e institucioneve të lartpërmendura, të cilat ia dërgon Ministrisë së Punëve të Jashtme për t'ia përcjellë në rrugë diplomatike palës tjetër.[72]

89 Negociatat për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare bëhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet përfaqësuesve të palëve ose në distancë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme. Para zhvillimit të negociatave të drejtpërdrejta, ministria kompetente përcakton përbërjen dhe kreun e delegacionit, kohën dhe vendin e zhvillimit të negociatave. Në përfundim të negociatave, nëse palët bien dakord, kryetarët e delegacioneve mund të parafojnë tekstin e projektmarrëveshjes në dy ose më shumë kopje, në varësi të palëve negociuese. Për këtë qëllim, kryetarët e delegacioneve vendosin në çdo fletë të projektmarrëveshjes inicialet e tyre.[73]

90 Pas përfundimit të procesit të negocimit, projektmarrëveshja ndërkombëtare miratohet, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me propozimin ose bashkëpropozimin e ministrisë/ve kompetente. Nëse zbatimi i marrëveshjes lidhet me miratimin e akteve normative ose ndryshimeve të ligjeve ekzistuese, në relacion duhet të evidentohen masat

69 Neni 6(5) i LMN-së.
70 Në rastet kur projektmarrëveshja trajton çështje në kompetencë të dy ose më shumë ministrive, faza përgatitore e saj drejtohet nga ministria, çështjet e së cilës përbëjnë pjesën kryesore të projektmarrëveshjes.
71 Neni 8(1)–(2) i LMN-së.
72 Neni 8(3) dhe (5) i LMN-së.
73 Neni 9 i LMN-së.

ligjore që duhen ndërmarrë, rëndësia e tyre dhe autoriteti përgjegjës për përgatitjen e tyre.[74] Marrëveshja ndërkombëtare nënshkruhet nga autoritetet përkatëse, në kohën dhe në vendin e caktuar nga palët.[75]

2.3 Lidhja dhe ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

91 Marrëveshjet ndërkombëtare mund të lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose në emër të Këshillit të Ministrave. Marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë ('marrëveshjet ndërkombëtare shtetërore') mund të nënshkruhen nga Presidenti i Republikës ose nga një zyrtar i lartë me autorizim nga Presidenti i Republikës. Marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Këshillit të Ministrave ('marrëveshjet ndërkombëtare qeveritare') mund të nënshkruhen nga Kryeministri ose nga një zyrtar i lartë i pajisur me autorizim nga Kryeministri.

92 Është vështirë të bëhet një ndarje e prerë se në cilat marrëveshje del si palë Republika e Shqipërisë apo Këshilli i Ministrave. Sidoqoftë, praktika e deritanishme e lidhjes së marrëveshjeve ka evidentuar se marrëveshjet shumëpalëshe, marrëveshjet e rëndësishme politike, dhe, në përgjithësi, të gjitha marrëveshjet që parashikohen në nenin 121(1) (a)-(ç) të Kushtetutës, lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë.

93 Ndërkohë, në marrëveshjet ndërkombëtare, zbatimi të cilave prek një numër më të kufizuar institucionesh, shfaqet si subjekt Këshilli i Ministrave. Gjithashtu, në përcaktimin e subjekteve të një traktati një element i rëndësishëm që duhet mbajtur parasysh është dhe reciprociteti i palëve. Kështu, nuk është e përshtatshme dhe reciproke që njëra palë e marrëveshjes të jetë qeveria e një shteti dhe pala tjetër të jetë vetë shteti.[76]

94 Ndonëse, Kushtetuta i referohet vetëm procedurës së ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtar,[77] neni 11 i Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve parashikon se pëlqimi i një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat mund të shprehet me anë të nënshkrimit, shkëmbimit të instrumenteve që ligjërojnë një traktat, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit ose nga ndonjë mjet tjetër, në qoftë se bihet dakord për këtë.

74 Neni 10 i LMN-së.
75 Neni 15 i LMN-së.
76 A. Skapi, "E drejta e traktateve dhe zbatimi i saj në Shqipëri" (2017) "Albanian Law Journal" nr. 4, fq. 7.
77 Nenet 116, 117, 121, 122, 123, 131 të Kushtetutës.

95 **Ratifikimi** është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj.[78] Procedura e "ratifikimit" është e lidhur ngushtësisht me procedurën e nënshkrimit të marrëveshjes ndërkombëtare nga shteti palë. Procedurës së ratifikimit mund t'i nënshtrohen si marrëveshjet dypalëshe ashtu dhe ato shumëpalëshe.[79]

96 Marrëveshjet shumëpalëshe parashikojnë dispozita të ndryshme përsa i përket procedurave të nënshkrimit. Përshembull, Konventat e Këshillit të Evropës duhet të nënshkruhen nga shtetet që duan të bëhen palë dhe më pas të ratifikohen[80] ndërsa, në përgjithësi, Konventat e Kombeve të Bashkuara parashikojnë një afat të caktuar kohor për nënshkrim pas mbarimit të të cilit ato janë të hapura për aderim.[81]

97 LMN-ja parashikon instrumente të tjerë përveç ratifikimit, shprehimisht aderimi, pranimi dhe miratimi.[82] **Aderimi** është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare, e cila nuk është nënshkruar më parë prej saj, sipas parashikimeve të vetë marrëveshjes.[83]

98 **Pranimi** apo **miratimi** janë procedura që aplikohen më rrallë se dy procedurat e mësipërme, por që gjithsesi janë të pranishme në praktikën e lidhjes së marrëveshjeve shumëpalëshe. Kjo procedurë aplikohet në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare që nuk janë të hapura për nënshkrim, por që adoptohen nga konferenca e shteteve palë me votim.[84]

99 Ratifikimi, aderimi, pranimi apo miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë bëhet nga Kuvendi[85] me ligj të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.[86] Ligji ratifikues duhet të përmbajë gjithashtu çdo rezervë që Shteti ka bërë në lidhje me dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare.[87] Gjithashtu, marrëveshjet ndërkombëtare

78 Neni 17(1) i LMN-së.
79 A. Skapi, "E drejta e traktateve dhe zbatimi i saj në Shqipëri" (2017) "Albanian Law Journal" nr. 4, f. 11.
80 Neni 59(1) i KEDNJ-së parashikon se "Kjo Konventë është e hapur për nënshkrimin e anëtarëve të Këshillit të Evropës. Ajo duhet të ratifikohet.".
81 Neni 21 i Traktatit të Kombeve të Bashkuara për Tregtinë e Armëve, 2013, parashikon se: "...Ky traktat i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga secili shtet nënshkrues. Pas hyrjes në fuqi, ky traktat është i hapur për aderimin e çdo shteti që nuk e ka nënshkruar traktatin.".
82 Neni 18 i LMN-së.
83 Po aty.
84 A. Skapi, "E drejta e traktateve dhe zbatimi i saj në Shqipëri" (2017) "Albanian Law Journal" nr. 4, f. 11.
85 Neni 18(3) i LMN-së.
86 Neni 121(1) i Kushtetutës.
87 Neni 26(2) i LMN-së.

parashikojnë përgatitjen e rregullave dhe procedurave suplementare në legjislacionin e brendshëm në përputhje me parashikimet e marrëveshjes. Nëse në dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare përcaktohet detyrimi i shtetit për identifikimin e një autoriteti vendas ose për nxjerrjen e akteve rregullatore në zbatim të marrëveshjes, sipas rastit, ligji ratifikues përmban dispozita mbi përcaktimin e autoritetit vendas apo të institucionit të ngarkuar dhe afatet për miratimin e këtyre rregullave suplementare.[88]

100 Në aspektin juridik, marrëveshjet ndërkombëtare shtetërore i detyrimisht i nënshtrohen ratifikimit, ndërsa marrëveshjet ndërkombëtare qeveritare mund të hyjnë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi, miratimit nga Këshilli i Ministrave pas nënshkrimit ose me nënshkrimin e tyre, nëse kjo parashikohet shprehimisht në tekstin e marrëveshjes. Sidoqoftë, Kryeministri ngarkohet të njoftojë Kuvendin sa herë që Këshilli i Ministrave nënshkruan një marrëveshje ndërkombëtare që nuk ratifikohet me ligj.

101 Konkretisht, LMN-ja parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare, që pas nënshkrimit nuk ratifikohen, miratohen nga Këshilli i Ministrave sipas procedurave të parashikuara në ligj,[89] ndërsa marrëveshjet ndërkombëtare, që nuk i nënshtrohen ratifikimit/ aderimit/ pranimit/ miratimit nga Kuvendi ose miratimit nga Këshilli i Ministrave, hyjnë në fuqi me nënshkrim.[90]

102 Në çdo rast, Këshilli i Ministrave i përcjell menjëherë Ministrisë së Punëve të Jashtme dekretin e Presidentit të Republikës për miratimin e çdo ligji për ratifikimin/ aderimin/ pranimin/ miratimin/ denoncimin/ pezullimin e marrëveshjeve ndërkombëtare shtetërore, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin pas nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare qeveritare.[91]

103 Ligji i ratifikimit/ aderimit/ pranimit/ miratimit/ denoncimit ose vendimi i miratimit pas nënshkrimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, së bashku me tekstin e marrëveshjes në gjuhën shqipe dhe në gjuhën tjetër të huaj të nënshkruar, botohen në FZ.[92] Ministria e Punëve të Jashtme, pas botimit në FZ të këtyre akteve, bën çdo njoftim, sipas parashikimit të marrëveshjes për hyrjen në fuqi, pezullimin, denoncimin dhe shfuqizimin

88 Shembull i një ligji standard për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është bashkëlidhur si Shtojca C e këtij Manuali.
89 Neni 19 i LMN-së.
90 Neni 20 i LMN-së.
91 Neni 31(1) i LMN-së.
92 Neni 33(1) i LMN-së.

e marrëveshjes. Në rastin e marrëveshjeve të lidhura me institucionet financiare ndërkombëtare, njoftimet bëhen nga Ministri i Financave.[93]

104 LMN-ja, përveç marrëveshjeve ndërkombëtare shtetërore dhe qeveritare, u ka krijuar hapësirën e nevojshme institucioneve të ndryshme qendrore dhe vendore për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare ndërinstitucionale bashkëpunimi me institucionet homologe të shteteve të tjera apo me organizata ndërkombëtare.

105 Marrëveshjet ndërinstitucionale kanë karakter tërësisht teknik, zbatimi i të cilave lidhet ekskluzivisht vetëm me kompetencën e institucioneve që i lidhin ato.[94] Të tilla mund të konsiderohen p.sh. memorandumet e mirëkuptimit ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit, institucioneve arsimore, kulturore, etj.

106 Pavarësisht karakterit të tyre teknik dhe objektit të kufizuar, këto marrëveshje janë konkretizim i politikës së jashtme të shtetit shqiptar në raport me një palë tjetër ndërkombëtare dhe, si të tilla, institucionet kompetente që janë palë të tyre duhet të konsultohen nga pikëpamja politike dhe juridike me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Marrëveshjet ndërkombëtare ndërinstitucionale nuk nevojitet të miratohen në parim me vendim të Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje nënshkruhen nga kreu i institucionit apo entit publik ose çdo zyrtar i autorizuar prej tyre.

107 Paralelisht në sferën ndërkombëtare ekzistojnë instrumente të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar, siç janë "Deklaratat e Përbashkëta të Qëllimit", "Rekomandimet" dhe "Kodet e Sjelljes". Zakonisht, këto janë marrëveshje politike pa fuqi juridike detyruese, dhe ndaj shpesh karakterizohen si *soft law* ("ligj i butë"). Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës janë një shembull i *soft law*.

108 Sidoqoftë, duhet të theksohet se, përmes pranimit dhe njohjes së tyre të përgjithshme, instrumentet e *soft law* mund të përfshihen me kalimin e kohës në fushën e të drejtës ndërkombëtare zakonore dhe të bëhen ligjërisht detyruese. Në çdo rast, hartuesi nuk duhet të hartojë në kundërshtim me instrumente të tilla të *soft law* pa një shkak të fortë, edhe nëse aktualisht ato përfaqësojnë thjesht një angazhim publik të ndërmarrë nga shteti.

93 Neni 31(2)–(3) i LMN-së.
94 Neni 13(1) i LMN-së.

3. Statusi i *acquis-së* së BE-së në rendin juridik të brendshëm

109 Shqipëria është një vend kandidat për aderim si shtet anëtar në Bashkimin Europian, dhe si i tillë ka nënshkruar MSA-në, të ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006 "Marrëveshja e Stabilizim Asociimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve të tyre Anëtare", dhe si e tillë detyrimet që dalin nga MSA-ja përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik.

110 Më 25 Mars 2020, Këshilli Evropian vendosi të hapë negociatat e pranimit me Shqipërinë. Sapo Shqipëria të aderojë në BE me anë të Traktatit të Aderimit, i cili duhet të ratifikohet nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe Shqipëria si vend aderues, acquis-ja e BE-së do të bëhet pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe do të zbatohet drejtpërdrejt (për shembull Rregulloret), përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon miratimin e një ligji (për shembull Direktivat). Për më tepër, *acquis* e BE-së do të ketë epërsi ndaj ligjeve të brendshme që nuk janë në përputhje me të.

111 Koncepti i **përafrimit** të së drejtës nënkupton procesin e harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me të drejtën e BE-së. Procesi i përafrimit përfshin metoda dhe teknika për transpozimin e legjislacionit të BE-së në ligjin kombëtar, përfshirjen e tij në sistemet juridike kombëtare dhe procesin e zbatimit, i cili manifestohet individualisht përmes realizimit të të drejtave individuale ose marrjes përsipër të detyrimeve konkrete.

112 Rrjedhimisht, vendet që aspirojnë të anëtarësohen në BE duhet të përshtatin ligjet, rregulloret dhe procedurat e tyre të brendshme, në mënyrë që t'i japin fuqi të gjithë korpusit të së drejtës të BE-së, të përfshirë në *acquis-në* e BE-së (shiko për më shumë hollësi Pjesa F, Seksioni 1.3).

4. Statusi i vlerësimit të hapësirave për korrupsion në legjislacion

113 Korrupsioni,[95] ndërmjet faktorëve të tjerë, favorizohet edhe nga legjislacioni

95 Në Shqipëri, ka disa përkufizime ligjore të termit "korrupsion". Ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", në nenin 3, pika 6, e përkufizon korrupsionin si çdo veprim ose mosveprim të kundërligjshëm, sipas legjislacionit penal në fuqi, në lidhje me çdo formë të korrupsionit aktiv, korrupsionit pasiv, shpërdorimit të detyrës ose kompetencave, ushtrimit të ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave ose marrjen e vendimeve, shpërdorimit të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, përfitimit të paligjshëm të interesave, si dhe çdo akt tjetër të ngjashëm me to. Ndërlidhur me sa më sipër, Kodi Penal e përkufizon korrupsionin në dy forma:

(i) "korrupsioni aktiv" është premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, një nëpunësi/zyrtari për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij; dhe

i paplotë. Vlerësimi i hapësirave për korrupsion të legjislacionit është një rishikim i formës dhe përmbajtjes së rregullave ligjore, të hartuara ose të miratuara, në mënyrë që të zbulohet dhe minimizohet rreziku i korrupsionit në të ardhmen që mund të lehtësohet për t'u kryer prej këtyre rregullave.

114 Ekzistojnë dy metoda për të parandaluar rreziqet e korrupsionit në legjislacion. Metoda e parë është që hartuesit të dinë rreziqet e korrupsionit dhe t'i shmangin ato gjatë punës për hartimin e aktit. Metoda e dytë është që ekspertë të specializuar të shqyrtojnë aktin e draftuar për rreziqet e korrupsionit pas përfundimit të tij, por ende të pamiratuar nga organi kompetent, dhe të kenë mundësi për përmirësime përfundimtare. Metoda e dytë është më komplekse dhe nënkupton punën jo vetëm në tekstin e draftit, por edhe në relacionin shpjegues dhe dokumente të tjera shoqëruese të tij. Kjo metodë ndonjëherë, kërkon informacione dhe kërkime shtesë. Ky manual përqendrohet në metodën e parë duke dhënë këshilla për zbatimin nga hartuesit e akteve.

115 Vlerësimi i hapësirave për korrupsion ka si qëllim kryesor shmangjen e hapësirave për korrupsion që mund të ekzistojnë në përmbajtjen e projektaktit ose të legjislacionit të miratuar. Potenciali kryesor i këtij vlerësimi është parandalimi i korrupsionit në të ardhmen, i lehtësuar përmes legjislacionit të hartuar keq. Ky vlerësim ka gjithashtu potencialin për të përmirësuar cilësinë e vetë shkrimit të akteve normative. Kjo metodikë ka impakt të drejtpërdrejtë mbi teknikën legjislative dhe cilësinë e legjislacionit, pasi shumë nga mjetet e përdorura për të minimizuar rreziqet e korrupsionit çojnë pashmangshmërisht në formulime më të thjeshta dhe më konsistente të akteve, duke i bërë ato më të arsyetuara, më koherente dhe të mirëmenduara.

116 Vlerësimi i hapësirave për korrupsion pasuron më tej debatin publik rreth projektaktit. Procesi i vlerësimit ofron një perspektivë të pazakontë mbi projektaktet. Normalisht fokusi në debatet parlamentare është tek grupet e ndryshme të interesit të prekura nga një ligj; ndërkohë vlerësimi i hapësirave për korrupsion e ndryshon këtë pikëpamje në dobi të

(ii) "korrupsioni pasiv" është kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga një nëpunës/zyrtar që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij.
Kodi Penal përfshin dhe vepra të tjera penale në konceptin e përgjithshëm "krimet e korrupsionit", siç janë ushtrimi i ndikimit të paligjshëm, shkelja e barazisë në tendera, shpërdorimi i detyrës, në sektorin publik si dhe sektorin privat. Nga ana tjetër, duhen përmendur edhe shkeljet që lidhen me konfliktin e interesave, përdorimin abuziv të fondeve shtetërore dhe financimin e parregullt të partive politike.

publikut të gjerë duke e minimizuar ndodhjen e tij dhe për pasojë duke rritur ndërgjegjësimin dhe debatin publik mbi korrupsionin. Në mënyrë ideale, ky vlerësim do të mobilizonte publikun, kur për shembull disa rreziqe korrupsioni të projektaktit ose të aktit ligjor apo nënligjor bëhen publike. Në këtë drejtim, jo vetëm suksesi i vlerësimit të hapësirave për korrupsion, domethënë një ndryshim në një projektakt apo në një akt ligjor ose nënligjor të miratuar, por edhe vetë procesi i debatit siguron vlerë të shtuar. Disponueshmëria publike e një metodike të shëndoshë të vlerësimit të hapësirave për korrupsion sigurisht lehtëson procese të tilla.

117 Vlerësimi i hapësirave për korrupsion funksionon *ex ante,* pra para se të jetë shfaqur korrupsioni në praktikë, ndikon në formën dhe thelbin e akteve ligjore ose nënligjore, rrit pjesëmarrësit në procesin e hartimit të aktit dhe mund të çojë në zhvillimin e një ekspertize e cila do t'i bëjë strategjitë ekzistuese antikorrupsion akoma më të fuqishme. Në fund të fundit, parandalimi është më mirë sesa kurimi.

5. Kodifikimi i legjislacionit

118 Koncepti tradicional bazë i kodifikimit është ai i *konsolidimit* (shih për më shumë detaje Pjesa E Seksioni 10), që synon grumbullimin e të gjitha dispozitave ekzistuese ligjore në një fushë të caktuar, por pa ndryshuar thelbin e dispozitave ligjore. Kodifikimi gjithashtu mund të mos ndryshojë mënyrën e hartimit të tyre, duke siguruar vetëm se ato janë koherente, si një tekst i mbledhur i cili pasqyron hierarkinë ekzistuese të normave ligjore. Sidoqoftë, kur ka një mospajtim thelbësor në hierarki, mund të kërkohet ndryshimi formal i tekstit të dispozitës, përpara se ajo të bëhet pjesë e kodit.

119 Kodet nuk kanë të njëjtat objektiva dhe nuk i nënshtrohen të njëjtave dinamika, si ligjet e zakonshme. Ligjet vendosin norma për rregullimin e një lënde të veçantë, ndërsa Kodet përmbledhin normat në një fushë të caktuar të jurisprudencës dhe synojnë të kenë një shkallë qëndrueshmërie, të jenë koherentë dhe të qartë. Kushtetuta shqiptare njeh rëndësinë dhe natyrën e veçantë të Kodeve duke kërkuar një shumicë të cilësuar të votave për miratimin e tyre në Kuvend, si dhe duke i vendosur në një shkallë më lart në hierarkinë e normave juridike (shih nënseksionin 1.1). Për këtë arsye, ligjvënësi duhet të jetë i kujdesshëm për të siguruar që Kodet t'i shërbejnë qëllimit të tyre si një shprehje e qëndrueshme dhe e saktë e së drejtës bashkëkohore ose një mjet për zhvillimin e sistemit

juridik përmes rishikimit periodik dhe të nevojshëm të Kodeve.

120 Legjislacioni i shteteve moderne karakterizohet në përgjithësi nga disa të meta. Së pari, ka një rritje të madhe të numrit të ligjeve. Në përgjithësi nuk dihet, ose nganjëherë madje as afërsisht, se sa tekste ligjesh ekzistojnë në një vend të caktuar. Këto tekste përfshijnë shumë forma të legjislacionit: *acquis* e BE-së, marrëveshje të tjera ndërkombëtare, si dhe legjislacionin vendas, normat ligjore të autoriteteve vendore, urdhrat ose vendimet e ministrave, e kështu me radhë.

121 Së dyti, ekziston akumulimi i tepërt i teksteve ligjore. Kur miratohen ligjet e reja shpesh harrohet të bëhet inventari i teksteve të mëparshme ligjore dhe të shfuqizohen tekste ligjore kontradiktore apo të pavlefshme. Kjo sigurisht do të kërkonte një përpjekje tjetër shtesë, domethënë një analizë të hollësishme ligjore për të kontrolluar përputhshmërinë e teksteve të vjetra, si dhe me Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare apo legjislacionin evropian. Nganjëherë transformimet e vogla të koncepteve në ligje të ndryshme, mund ta bëjnë zëvendësimin e vështirë. Kjo mund të vihet re për shembull në rastet e shpërndarjes së kompetencave e përgjegjësive, apo gjatë përgatitjes së një baze të dhënash. Kështu numri i ligjeve vazhdon të rritet. Përdoruesi humbet në këtë labirint ligjesh, administrata nuk e di më si të zbatojë legjislacionin dhe rritet numri i mosmarrëveshjeve.

122 Së treti, ligjet janë të paqëndrueshme. Ka raste, kur ligjet ose nene të tyre, ndryshohen disa herë vetëm gjatë një viti. Përveç mangësisë së përhershme të sigurisë ligjore që vjen si pasojë e ndryshimeve të shpeshta, ekzistojnë edhe probleme të tjera. Për shembull, ndryshimi i një ligji shqiptar që përafron disa aspekte të acquis-së mund të rezultojë në shkelje të detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të integrimit në BE nëse kërkesat e acquis-së nuk janë marrë në konsideratë në mënyrën e duhur.

123 Këto tri mangësi kryesore të ligjeve - zgjerimi, akumulimi dhe paqëndrueshmëria –dëmtojnë efektivitetin dhe koherencën e legjislacionit në përgjithësi. Ndërkohë, në një shtet demokratik dhe të së drejtës, ligjet duhet të përdoren me lehtësi dhe të jenë menjëherë të disponueshëm për përdoruesit, në përputhje me detyrimin kushtetues të qartësisë, parashikueshmërisë dhe kuptueshmërisë për publikun.[96] Kodifikimi synon të jetë një zgjidhje për këto probleme.

96 Shih vendimin nr. 3, datë 8.6.2011 të GJK-së.

124 Kodifikimi mund të ketë dy qëllime të ndryshme, të cilat arrihen me procedura të veçanta.

125 Qëllimi i parë mund të jetë reformimi i legjislacionit, si dhe organizimi i tij në mënyrë sistematike. Reforma në legjislacion konsiston në rihartimin dhe riformulimin e një fushe të së drejtës, duke integruar koncepte të reja dhe duke krijuar norma të reja. Kodifikimi ambicioz kërkon shumë kohë dhe këmbëngulje dhe nuk është gjithmonë i suksesshëm.

126 Qëllimi i dytë mund të jetë kodifikimi i normave ekzistuese, i cili vetëm konsolidon tekstet. Ky është më modest në qëllimet e veta dhe konsiston në përmbledhjen dhe strukturimin e ligjeve në fuqi ashtu siç janë dhe jo ashtu siç duhet të jenë. Ai nuk përfshin krijimin e rregullave të reja, por vetëm një inventarizim që hap rrugën për çdo reformë të nevojshme. Ky lloj kodifikimi ka avantazhin e lehtësimit të përdorimit të legjislacionit.

127 Në të dy rastet, kodifikimi është sistematik. Kodifikimi i një fushe të së drejtës duhet të bëhet në përputhje me programin e hartuar paraprakisht. Programimi lejon klasifikimin e ligjeve sipas përmbajtjes së tyre dhe mundëson përfshirjen e tyre në kode të ndryshme.

Shembull
Kodi i Familjes konsolidon të gjitha dispozitat përkatëse të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit për birësimin duke rregulluar kështu të gjithë sistemin e së drejtës familjare.

128 Kodifikimi është tematik, në kuptimin që ai synon ndërtimin e një sistemi të ligjeve, domethënë një përmbledhje të bashkërenduar të ligjeve dhe rregullave që i përkasin të njëjtit korpus. Në çdo sistem ndërvarësia e elementeve synon të arrijë një qëllim të përbashkët. Prandaj është e domosdoshme që për çdo kod të përftohet një përmbledhje e njëtrajtshme dhe koherente pa mbivendosje.

Shembull
Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur konsolidon të gjitha dispozitat përkatëse në lidhje me drejtësinë për të mitur, në vetvete një pjesë e sistemit të së drejtës penale.

129 Një kod mbledh dhe inkorporon të gjitha dispozitat ligjore vendase në fushën e caktuar. Në disa raste, dispozitat e tij mund të pasqyrojnë edhe detyrime ndërkombëtare ose evropiane. Kjo e lejon kodin që të jetë homogjen dhe i qartë.

Shembull
Kodi i Procedurës Penale ka përfshirë dispozitat që reflektojnë detyrimet ndërkombëtare, siç janë juridiksioni i GJEDNJ-së dhe Direktivat përkatëse të BE-së për përafrimin e rendit juridik të brendshëm me atë të BE-së.

130 Në thelb të tij, kodifikimi përfshin ligjet që janë në fuqi dhe që janë të zbatueshme, ligjin bashkëkohor në fuqi, domethënë ligjin e zbatueshëm. Për të arritur këtë, ligjet që janë shfuqizuar (në mënyrë eksplicite ose implicite) dhe dispozitat kalimtare apo të përkohshme që nuk janë më në fuqi duhen identifikuar, në mënyrë që të mos përfshihen; po kështu normat që janë të pavlefshme, që nuk janë përdorur ose që janë vjetruar.

6. Alternativat ndaj legjislacionit

131 Ndërhyrja legjislative mund të justifikohet ose të jetë e dobishme për t'u mundësuar subjekteve të ndryshme të realizojnë më mirë të drejtat dhe detyrimet e tyre. Legjislacioni i ri gjithashtu mund të rezultojë në thjeshtësimin e punës së administratës si dhe të gjykatave.

132 Një dispozitë ligjore e cila është shumë e detajuar mund ta bëjë atë më pak të qartë dhe mund të ulë fleksibilitetin e zbatimit të saj. Për këtë arsye, kur nevoja për ndërhyrje legjislative është në diskutim e sipër, duhet të shtrohet pyetja nëse ndryshimi duhet të bëhet me ligj, me forma të tjera rregulluese duke miratuar akte të tjera ligjore apo nënligjore apo duhet të pritet derisa gjykata të përcaktojë çështjen nëpërmjet interpretimit të ligjeve ekzistuese. Në sistemin tonë ligjor, kjo zgjidhje e fundit nuk do të ishte e dobishme, për arsye se nuk mund të pritet që Gjykata e Lartë të bëjë interpretimin përfundimtar të çdo situate ligjore të paqartë me vendime për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

133 Alternativat mund të jenë veçanërisht të rëndësishme në rregullimin e çështjeve të biznesit dhe të industrisë. Nxjerrja e ligjeve të reja mund të mos kërkohet pasi çështja mund të vetë rregullohet, ose mund të ekzistojnë ligje të tjera që e rregullojnë çështjen. Rezultatet mund të arrihen me mënyra të tjera jo formale, për shembull me kodet e praktikave të mira. Këto kode praktikash mund të kenë ose jo bazë ligjore.

134 Sidoqoftë, edhe kur ka legjislacion ekzistues, mund të merret vendimi politik për të nxjerrë ligjin lidhur me një çështje të veçantë, nëse kjo përbën një shqetësim të madh publik. Për më tepër, mund të ketë ndonjë

standard të jashtëm kundrejt të cilit duhet të zgjidhet çështja nëse duhet nxjerrë një ligj apo jo. Legjislacioni vendas mund të parashikojë detyrime ligjore që lindin nga termat e një traktati ndërkombëtar ose nga përafrimi i tij me legjislacionin e BE-së.

135 Duhet theksuar, që masa alternative të ndryshme në vend të ligjit mund të ndërmerren pa ndonjë autoritet ligjor specifik, si për shembull:

- Vetërregullimi mund të jetë një avantazh si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin e biznesit. Sektori publik nuk do të kishte nevojë të përdorte burime të mëdha për ushtrimin e kontrollit, dhe bizneset do të çliroheshin nga kostot administrative në lidhje me kontrollin publik.
- Marrëveshjet vullnetare midis shtetit dhe grupeve përkatëse (për shembull shoqërive private, pushteteve vendore, sindikatave) duke ua lënë vetë grupeve që të zgjedhin mjetet e parapëlqyera. Marrëveshje të tilla do t'i detyronin bizneset që të kuptonin objektivat për të cilat është rënë dakord, duke qenë të lirë të zgjedhin mënyrat që do të zbatohen për arritjen e këtyre objektivave. Një masë e tillë lejon fleksibilitet në planifikimin e punës së shoqërisë, duke zvogëluar kështu kostot ekonomike për bizneset.
- Fushatat e informimit të publikut për të bindur njerëzit që të ndryshojnë qëndrimin e tyre në aspekte të caktuara. Kjo metodë përdoret më gjerësisht në fusha të tilla si shëndetësia, energjia dhe rregullat e trafikut.

136 Disa çështje mund të rregullohen më mirë nëpërmjet stimujve ekonomikë, si vendosja e taksave dhe subvencioneve për të motivuar qytetarët dhe bizneset që të veprojnë në mënyrën e duhur. Në këtë rast tregu përdoret vetë si rregullator, duke i nxitur qytetarët dhe bizneset drejt një qëndrimi të caktuar me përdorimin e stimujve ekonomikë.

137 Prandaj, para se të vendoset nëse do të bëhet rregullimi me ligj në një fushë të caktuar, duhet të tregohet kujdes për të vlerësuar nëse ekzistojnë rregulla ose struktura të vetërregullimit dhe, në rast se ekzistojnë, duhet vlerësuar nëse ato janë efektivë në rregullimin e kësaj fushe. Nëse nuk ekzistojnë struktura të vetërregullimit, atëherë duhet të vlerësohet mundësia e përfshirjes së tyre në vend të rregullimit me ligj.[97] Instrumenti i duhur për të bërë vlerësimin e alternativave të mundshme përpara vendimmarjes për inciativa ligjore është Raporti i Vlerësimit të Ndikimit (për më tepër shih Pjesën C nënseksioni 1.1 të këtij Manuali).

97 Shih për më tepër Ellickson, R. "Order without Law: How Neighbors Settle Disputes", Cambridge: 1991.

7. Implikimet për hartuesin

138 Hartuesi i ligjeve duhet të sigurojë që projektligjet dhe projektaktet nënligjore të respektojnë hierarkinë, statusin dhe efektin e normave ligjore të parashikuara në Kushtetutë. Prandaj, dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara ose me acquis-në e BE-së. Po kështu, aktet nënligjore nuk duhet të shkojnë përtej kompetencave të ligjeve në bazë të të cilave ato dalin, dhe dispozitat e akteve nënligjore nuk duhet të bien ndesh me dispozitat e vetë ligjeve, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara ose acquis-në e zbatueshëm për rastin konkret.

139 Fakti që të gjitha ligjet kanë hierarki dhe status hierarkik, shkakton përgjegjësi të veçantë për hartuesit dhe për procesin legjislativ. Përgjegjësitë dhe ndërlikimet më tipike parashikohen si më poshtë:

- Për të mbrojtur rëndësinë e tyre sipas Kushtetutës, ligjet për të cilat kërkohet një shumicë e cilësuar, duhet të ndryshohen vetëm me ligje të cilat miratohen me të njëjtën procedurë dhe jo me shumicë të thjeshtë siç parashikohet në nenin 78 të Kushtetutës.98
- Çështje që janë të ngjashme duhet të rregullohen me një ligj të vetëm, në vend që të shpërndahen në ligje të ndryshme. Legjislacioni duhet të shihet si një program veprimi ku pyetjet dhe përgjigjet, faktet dhe rrjedhojat ligjore përcaktohen sa më ngushtë të jetë e mundur në lidhje me njëra tjetrën. Prandaj, nuk duhet që të miratohen disa ligje që lidhen me të njëjtën fushë rregullimi, ose të plotësohet një ligj i përgjithshëm me disa ligje të tjera të veçanta.

140 Hartuesi duhet të sigurojë që një projektligj të jetë në përputhje me rendin ligjor ekzistues dhe të sigurojë, nëpërmjet ndryshimeve ose shfuqizimeve, koherencën e legjislacionit, duke eliminuar konfliktet midis dispozitave të ndryshme ligjore, në përputhje me detyrimin kushtetues të qartësisë, parashikueshmërisë dhe kuptueshmërisë për publikun.[99]

98 Shih vendimin nr. 19, datë 03.05.2007 të GJK-së.
99 Shih vendimin nr. 23, datë 8.06.2011 të GJK-së.

Pjesa B
Vlerësimi i legjislacionit

1. Termat e referencës

141 Përgjegjësia e Ministrisë së Drejtësisë për vlerësimin e legjislacionit përcaktohet në nenin 24(2) të LKM-së, në pikën 22 të RKM-së, si dhe në nenin 6(3) të LMD-së. Po kështu, në pikën 31 të RKM-së përcaktohet detyrimi për ministrin propozues për të reflektuar në ripunimin e projektaktit mendimin juridik të Ministrit të Drejtësisë, në lidhje me ligjshmërinë e formës dhe përmbajtjes së projektaktit, duke kryer për këtë qëllim, nëse çmohet e nevojshme, konsultime të përbashkëta ose ridërgimin e projektaktit për një mendim përfundimtar.

142 Veprimtaria e vlerësimit të legjislacionit që realizohet nga Ministria e Drejtësisë mbështet veprimtaritë legjislative të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore. Ajo shqyrton:

- projektligjet të hartuara nga ministritë përkatëse përpara se ato të paraqiten në Këshillin e Ministrave për shqyrtim dhe miratim;
- projektaktet nënligjore të hartuara nga ministritë përkatëse përpara se ato të paraqiten në Këshillin e Ministrave për shqyrtim dhe miratim;
- projektaktet nënligjore të hartuara nga ministritë përkatëse përpara se ato të nxirren (me përjashtim të akteve nënligjore me karakter individual), dhe
- projektaktet nënligjore të hartuara nga drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore të autorizuar për ta bërë këtë në bazë të delegimit ligjor përpara se ato të nxirren (me përjashtim të akteve nënligjore me karakter individual).

143 Ministri i Drejtësisë ka një rol të rëndësishëm për shqyrtimin e projektakteve gjatë procesit parlamentar, veçanërisht për çështjet në fushën e përgjegjësisë së tij. Sipas parashikimit në nenin 47 të RK-së,[100]

100 Miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, të ndryshuar.

anëtarët e Këshillit të Ministrave kanë të drejtë, dhe kur u kërkohet e kanë për detyrë, të marrin pjesë në seancë plenare ose në mbledhjet e komisioneve dhe nënkomisioneve. Atyre u jepet fjala sa herë që e kërkojnë. Për më tepër, strukturat e specializuara të Ministrisë së Drejtësisë mund të bashkëpunojnë me shërbimin juridik të Kuvendit gjatë procesit të shqyrtimit të projektakteve në komisionet e Kuvendit.

2. Objekti i vlerësimit

144 Vlerësimi i realizuar nga Ministria e Drejtësisë është një vlerësim ligjor. Ky vlerësim përfshin shqyrtimin e aspekteve sistematike dhe formale të secilit propozim në kontekstin e sistemit ligjor në tërësi. Ai fillon me pyetjen paraprake nëse shtrirja e rregullimit të planifikuar është e nevojshme për të arritur objektivin rregullator të synuar.

145 Vlerësimi sistematik i legjislacionit përqendrohet kryesisht nëse rregullat janë në përputhje me ligjet e nivelit më të lartë ("vlerësim vertikal i legjislacionit") në kontekstin e hierarkisë së normave juridike, kryesisht në lidhje me:

- kushtetutshmërinë (e shtjelluar më tej në seksionin 3),
- objektin e autorizimit në rastin e akteve nënligjore (e shtjelluar më tej në Pjesën D nënseksioni 4.10)
- përputhshmërinë me të drejtën ndërkombëtare (e shtjelluar më tej në seksionin 2), dhe përputhshmërinë dhe nivelin e përafrimit me *acquis* e BE-së (e shtjelluar më tej në seksionin 5).

Për më tepër, **vlerësimi sistematik** i legjislacionit përfshin një verifikim nëse rregullimet e planifikuara përshtaten në mënyrë të përsosur në sistemin juridik ekzistues ("vlerësim horizontal i legjislacionit"), duke bërë pyetjet e mëposhtme, për shembull:

- Cili është raporti i legjislacionit të ri me legjislacionin ekzistues?
- A është strukturuar si duhet projekti sipas parimeve të organizimit?
- A është e përshtatshme marrëdhënia midis rregullit dhe përjashtimit?
- A janë shmangur rregullimet e dyfishta dhe kontradiktore?
- A është shprehur si duhet ajo që duhet të thuhet?
- A janë të qarta referencat tek dispozitat e tjera (p.sh.. referencat statike ose dinamike)?
- A mund të shfuqizohen dispozitat e tepërta në këtë fushë të posaçme juridike?

- A është përmbajtja normative e qartë në secilin rast?
- A janë dispozitat të lehta për t'u zbatuar?
- A mund të trajtohen çështjet përmes mekanizmit të vetërregullimit dhe a ka shembuj efektivë të vetërregullimit në atë fushë?

146 Në të njëjtën kohë, duhet të përmbushen kërkesat përkatëse për formën dhe stilin (vlerësimi formal), për shembull, në lidhje me titujt, dispozitat urdhëruese, citimet, formulën ndryshuese dhe dispozitat për hyrjen në fuqi. Parashikimet ligjore dhe nënligjore verifikohen gjithashtu për të parë nëse ato janë të sakta dhe të kuptueshme nga ana gjuhësore.

3. Rishikimi i kushtetutshmërisë

147 Rishikimi i kushtetutshmërisë është një aspekt thelbësor në vlerësimin e legjislacionit.[101] Kur lindin paqartësi ose dyshime, është e rëndësishme që ministria përkatëse të përfshihet në kohën e duhur në mënyrë që të realizohet zbatueshmëria e Kushtetutës në çdo rast.

148 Kontrolli që ushtrohet nga organi propozues/rishikues ndryshon nga kontrolli i bërë nga GJK-ja ose gjykatat e zakonshme në drejtimet e mëposhtme:

- Ushtrohet gjatë hartimit/ rishikimit të projektaktit;
- Efekti i aktit duhet të parashikohet dhe të llogaritet pa sjellë pasoja;
- Përfshin një numër të ndryshëm të personave ose institucioneve të interesuar në procesin e rishikimit, gjë që ndikon në rezultatin e rishikimit;
- Faktori kohë është një element i rëndësishëm: propozimet e shpejta mbartin rrezik në dëm të cilësisë;
- Mundësitë për ndërhyrje në projektakt janë të pakufizuara.

149 Në lidhje me kufizimin e autoritetit legjislativ dhe delegimin e tij, duhet të tregohet kujdes gjatë hartimit / rishikimit, me qëllim që vendimmarrja të ushtrohet vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (kushtetutshmëria funksionale)[102] dhe autorizimi i organeve të tjera prej ligjvënësit për të rregulluar një fushë të caktuar duhet të shprehet në ligj.[103] Në lidhje me aktet nënligjore duhet t'i kushtohet kujdes jo vetëm objektit të autorizimit nga ligji, por gjithashtu dallimeve ndërmjet akteve nënligjore, akteve administrative individuale dhe akteve administrative

101 Listë kontrolli për kushtetutshmërinë e projektaktit, bashkangjitur si Shtojca G e këtij Manuali.
102 Shih vendimet nr. 1, datë 12.01.2011; nr. 60, datë 16.09.2016 të GJK-së.
103 Shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2016 të GJK-së.

të brendshme (shih për më tepër Pjesa A nënseksioni 1.3).

150 Çdo ndërhyrje apo kufizim në të drejtat dhe liritë themelore në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës duhet të jetë në përputhje me kriteret kushtetuese:

- Ndërhyrja/kufizimi të vendoset vetëm me ligj;
- Ndërhyrja/kufizimi të vendoset për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve;
- Ndërhyrja/kufizimi të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë;
- Ndërhyrja/kufizimi të mos cenojë thelbin e lirive dhe të të drejtave;
- Ndërhyrja/kufizimi të mos tejkalojnë në asnjë rast kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

151 Siguria juridike është një nga elementët kryesorë të shtetit të së drejtës.[104] Siguria juridike ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Prandaj, legjislacioni duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të përcaktojë:[105]

- instrumentet për të realizuar ndërhyrjen ligjore;
- subjektet të cilave u drejtohet;
- raporte të caktuara të sjelljes;
- mënyrën e zbatimit të tij;
- rezultatin/ete pritshëm;
- pasojat e parashikueshme për subjektet të cilëve u drejtohet ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij.

152 Për të vlerësuar strategjinë e ndërhyrjes së ligjvënësit dhe respektimin e kriterit të baraspeshës së interesave, duhet të bëhet testi i proporcionalitetit. Jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar qartësisht kriteret që duhet të vlerësohen për të arritur në konkluzionin nëse ndërhyrja e kryer nga ligjvënësi respekton ose jo parimin e proporcionalitetit. Konkretisht, vlerësimi përqendrohet në kriteret e mëposhtme:

- nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës;
- nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta, ose të bazuara

104 Shih vendimin nr. 26, datë 02.11.2005 të GJK-së.
105 Shih vendimin nr. 34, datë 20.12.2005 të GJK-së.

mbi vlerësime alogjike;

- nëse mjetet e përdorura nuk janë të justifikueshme për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.[106]

153 Proporcionaliteti i ndërhyrjes së ligjvënësit vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh se aspektet e mësipërme nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që si rezultat i tij i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit.[107]

154 Pra, në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre.[108]

4. Rishikimi i përputhshmërisë me të drejtën ndërkombëtare

155 Relacionet shpjeguese të projektligjeve të paraqitura nga Këshilli i Ministrave në Kuvend duhet të përmbajnë një analizë të përputhshmërisë së projektligjit me detyrimet e Shqipërisë sipas së drejtës ndërkombëtare.[109]

156 Kur një projektligj shtron pyetje në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare, projekti dhe relacioni shpjegues i tij duhet të përmbajnë udhëzime të arsyeshme për detyrimet përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë informacionin për rëndësinë e tyre, për veprimet e ndërmarra nga autoritetet kombëtare dhe për vendimet e gjykatave. Po ashtu, struktura që kryen shqyrtimin e projektit duhet të kujdeset që projektligji të mos jetë në kundërshtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

157 Dispozitat e KEDNJ-së kanë ndikim më të fortë, ndër të tjera për shkak të praktikës gjyqësore gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të GJEDNJ-së, e cila ofron interpretime përfundimtare të dispozitave konventore. Në këtë drejtim është e rëndësishme të theksohet mishërimi i KEDNJ-së në rendin e brendshëm juridik nëpërmjet nenit 17(2) të Kushtetutës.

106 Shih vendimet nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 86, datë 30.12.2016 të GK-së.
107 Shih vendimet nr.16, datë 25.07.2008; nr.52, datë 05.12.2012; nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 86, datë 30.12.2016 të GJK-së.
108 Shih vendimet nr.12, datë 14.04.2010; nr.52, datë 05.12.2012; nr.1 datë 06.02.2013; nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 86, datë 30.12.2016 të GJK-së.
109 Neni 25(2) i LKM-së; neni 19(ç) i RKM-së.

5. Rishikimi i përafrimit me *acquis* e BE-së

158 Përafrimi, që është procesi i bërjes së dispozitave përkatëse të sistemeve ligjore të ndryshme koherente me njëri-tjetrin, bazohet në një koncept që është i lehtë për t'u kuptuar. Ai duhet të realizohet në mënyrë që një komunitet siç është BE-ja, anëtarët e të cilit kanë sisteme të ndryshme ligjore, të funksionojnë në mënyrë efektive dhe efikase.

159 Detyrimi specifik për të përafruar legjislacionin shqiptar me atë të BE-së rrjedh nga MSA-ja.[110] Gjatë fazës së parë të zbatimit të MSA-së, domethënë pesë vitet e para pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, miratimi dhe zbatimi i *acquis* së BE-së është përqendruar në elementët kryesorë të tregut të brendshëm: konkurrencën, të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, prokurimin publik, standardizimin dhe certifikimin, shërbimet financiare, transportin tokësor dhe detar, të drejtën e shoqërive, kontabilitetin, mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e të dhënave, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë, drejtësinë dhe punët e brendshme, bujqësinë dhe peshkimin dhe mjedisin.[111]

160 Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së është sfidues dhe kompleks. Ky proces kërkon jo vetëm që Shqipëria të krijojë një kuadër rregullator në përputhje me kërkesat e *acquis* së BE-së, por edhe që të sigurohen strukturat administrative dhe kushtet e tjera të nevojshme për zbatimin e *acquis*-së. Kështu që, procesi i përafrimit tej kalon detyrat e hartimit të legjislacionit dhe, më e rëndësishmja, kërkon vëmendje të veçantë në fazën e zhvillimit të politikave dhe analizën e kostos në mënyrë që të merren vendime të informuara dhe të mund të prodhohen akte juridike cilësore.

161 Në përgjithësi, përgjegjësia për hartimin e politikave dhe për kryerjen e detyrave të transpozimit i përket fillimisht ministrisë ose ministrive propozuese në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë. Ministria propozuese duhet të analizojë aktin dhe të bëjë vlerësimin e vet të përputhshmërisë në relacionin shpjegues që shoqëron projektaktin (shih modelin në Shtojcën E të këtij Manuali).

110 MSA ka hyrë në fuqi në datën 1 Prill 2009.

111 Shih nenin 6(3) të MSA-së: "Në fushën e përafrimit ligjor dhe zbatimit të ligjeve, synimi është që Shqipëria të përqendrohet gjatë fazës së parë në elementët themelorë të acquis-së, me tregues specifikë, ashtu siç përshkruhet në Titullin VI të kësaj Marrëveshjeje.". Shih gjithashtu nenin 70(2) të MSA-së: "Ky përafrim fillon në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementët e acquis-së të Komunitetit të përmendura në këtë Marrëveshje brenda periudhës tranzitore të përcaktuar në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje.".

162 Kuadri institucional për përafrimin tashmë rregullohet me urdhrin e Kryeministrit nr. 93, datë 20.5.2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës", përmes të cilit ngrihet Komiteti Teknik i Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian.

163 Komiteti teknik ka si qëllim të drejtojë, vlerësojë, monitorojë dhe koordinojë realizimin e angazhimeve të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian, për çështje teknike specifike, që lindin në kuadër të: (a) negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, (b) zbatimit të MSA-së, (c) harmonizimit të së drejtës së BE-së në kuadrin e të drejtës vendase, (ç) asistencës teknike të ndihmës së Bashkimit Evropian apo donatorëve të tjerë për Shqipërinë, në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE.

164 RKM-ja, përmes ndryshimeve të kryera në vitin 2006, ka parashikuar se ministria përgjegjëse për çështjet e integrimit evropian koordinon dhe siguron përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis-në* e BE-së.[112] Projektaktet me karakter normativ, që synojnë përafrimin me *acquis* të BE-së në legjislacionin vendas dhe projektaktet e nxjerra nga ministri i linjës, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij, kur ato synojnë përafrimin me *acquis* të BE-së, para miratimit të tyre, i dërgohen, për mendim ministrit përgjegjës për çështjet e integrimit evropian. Këto projektakte shoqërohen me relacionin dhe me tabelën e përputhshmërisë për verifikimin dhe konfirmimin e shkallës së përputhshmërisë së tyre me acquis të BE-së.[113] Mendimi që jepet në këtë rast duhet të reflektohet në projektaktin e ripunuar nga ministri propozues.[114] Nëse është e nevojshme, mund të zhvillohen konsultime të përbashkëta për këtë qëllim.

165 Në këtë kuadër, Ministria përgjegjëse për çështjet e integrimit evropian luan disa role të rëndësishme në procesin e përafrimit të legjislacionit:

- Harton dhe përditëson metodologjinë mbi të cilën kryhet përafrimi (PKIE).
- Ndihmon ministritë e linjës, në fazën paraprake të hartimit, të identifikojnë ato akte të *acquis* së BE-së që do të transpozohen në një

112 Shih vendimin nr. 201, datë 29.3.2006, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003" Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave".
113 Sipas pikës 31(3) të RKM-së, shtojca "Modeli i relacionit dhe tabelës së përputhshmërisë së projektaktit normativ me acquis të Bashkimit Evropian".
114 Pika 31(2) e RKM-së.

fushë të veçantë.

- Pasi të jetë hartuar projektakti, verifikon nivelin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së.

166 Niveli i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së verifikohet dhe kontrollohet nga ministri përgjegjës për çështjet e integrimit evropian në përputhje instrumentet e përafrimit, pra relacionin dhe tabelën e përputhshmërisë së projektaktit normativ me *acquis* të BE-së. Në rast se projektaktet nuk shoqërohen me relacionin dhe tabelën e përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, i kthehen nga ministri përgjegjës për çështjet e integrimit evropian institucionit propozues për plotësime të mëtejshme, përpara shqyrtimit nga Këshilli i Ministrave.[115] Mendimi që jep ministri përgjegjës për çështjet e integrimit evropian është i domosdoshëm në çdo rast. Nëse institucioni propozues nuk kërkon mendimin e ministrit përgjegjës për çështjet e integrimit evropian për projektakte që synojnë përafrimin me *acquis* të BE-së, ato nuk merren në shqyrtim nga Këshilli i Ministrave.[116]

167 Kontrolli i përputhshmërisë me *acquis* e BE-së nuk mbaron në nivelin qeveritar në rastet kur Këshilli i Ministrave miraton një projektakt dhe e dërgon atë në Kuvend (për më shumë informacion shihni Pjesën H).

6. Procedura për kryerjen e vlerësimit

168 Vlerësimi i legjislacionit kryhet kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë, e cila është e specializuar dhe ka përvojë në hartimin dhe vlerësimin e legjislacionit për çështjet nën juridiksionin e Ministrisë, si dhe në dhënien e mendimit të specializuar për projektet e akteve ligjore dhe të akteve nënligjore normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore. Njësi të tjera të specializuara në Ministri përfshihen në procesin e vlerësimit të legjislacionit kur duhet të adresohen çështje gjithëpërfshirëse (p.sh. bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet civile dhe penale, sistemi penitenciar, ndihma juridike e garantuar nga shteti, çështjet e mbikëqyrjes dhe kontrollit të profesioneve të lira etj.).

169 Në përputhje me pikën 18 të RKM-së, teksti i projektaktit të dërguar për mendim duhet të shoqërohet me raportin e vlerësimit të ndikimit

115 Pika 25(3) e RKM-së.
116 Pika 25(4) e RKM-së.

të plotësuar, relacionin shpjegues me të gjitha elementet e tij, si dhe çdo dokument tjetër, sipas përcaktimeve të RKM-së (p.sh. tabelat e përputhshmërisë ose të dhënat mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, sipas rastit). Projektakti do i nënshtrohet vlerësimit formal si dhe vlerësimit ligjor, ndërsa relacioni shpjegues do i nënshtrohet vlerësimit për përmbushjen e elementëve që duhet të përmbajë sipas pikës 19 të RKM-së.[117]

170 Projektligjet dhe projektaktet nënligjore i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë pasi të jetë përfunduar puna përgatitore, shoqëruar me kërkesën specifike për dhënie mendimi. Ministri i Drejtësisë jep mendim jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e marrjes të projektaktit dhe të kërkesës për mendim që e shoqëron atë.[118] Për projektakte të një rëndësie të veçantë, strukturat juridike në ministritë e linjës mund të përfshijnë Ministrinë e Drejtësisë gjatë përgatitjes së projektit[119] përpara përmbushjes së detyrimit ligjor për konsultim.[120]

171 Kur është e nevojshme, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit mund të përfshijë njësi të tjera të specializuara të Ministrisë së Drejtësisë dhe të hartojë mendimin e saj si një përmbledhje të të gjithë sugjerimeve dhe komenteve të dhëna.

172 Vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga Ministri i Drejtësisë shihen me përparësi gjatë ripunimit të projektaktit.[121] Mendimi juridik i Ministrit të Drejtësisë, lidhur me ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së projektaktit, reflektohet në ripunimin e projektaktit nga ministri propozues. Për këtë qëllim, nëse çmohet e nevojshme, mund të zhvillohen konsultime të përbashkëta ose projektakti ridërgohet për mendim përfundimtar.[122]

7. Vlerësimi i hapësirave për korrupsion në legjislacion

7.1 Identifikimi i risqeve gjuhësore për hapësira korruptive

173 *Vlerësimi i hapësirave korruptive në legjislacion* është teknika që duhet përdorur në mënyrë të organizuar dhe sistematike nga hartuesit në institucionet publike shqiptare, gjatë procesit të hartimit të ligjeve dhe

117 Model i një relacioni shpjegues mund të gjendet si Shtojca E e këtij Manuali.
118 Pika 28 e RKM-së.
119 Pika 15 e RKM-së.
120 Pika 22 e RKM-së
121 Pika 30 e RKM-së.
122 Pika 31 e RKM-së.

akteve nënligjore, për të vlerësuar dhe konkluduar nëse rregullat e hartuara përmbajnë karakteristika të veçanta apo mangësi të karakteristikave të veçanta që krijojnë hapësira për korrupsion gjatë zbatimit të tyre, pavarësisht faktit se qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë për të kontribuuar për korrupsionin.

7.1.1 Dykuptueshmëria

174 Dykuptueshmëria përfshin rastin kur një rregull ligjor mund të kuptohet nga lexuesi në më shumë se një kuptim. Dykuptueshmëria e rregullit ligjor mbart rrezikun e zbatimit jouniform të tij në praktikë, duke lënë hapësirë për zbatuesin e ligjit të favorizojë padrejtësisht dikë dhe të përfitojë në mënyrë të parregullt për vete. Gjithashtu, legjislacioni i paqartë lë vend edhe për abuzim dhe korrupsion në sistemin e drejtësisë sepse i jep hapësirë gjyqtarëve dhe prokurorëve ta zbatojnë në mënyrë të ndryshme, ndonëse situatat mund të jenë të ngjashme.

175 Një rregull ligjor ka kuptim të dyfishtë për shkak të cilësisë së gjuhës që është përdorur për formulimin e tij ose për shkak të gabimeve në teknikën legjislative të hartimit të legjislacionit.

176 Rreziqet më të përhapura që i japin shkak dykuptueshmërisë në legjislacion lidhen me:

- stilin gjuhësor; dhe
- harmonizimin.

7.1.2 Stili gjuhësor

177 Gjuha e paqartë apo e ndërlikuar në hartimin e një ligji apo akti nënligjor normativ lidhet me pasaktësitë e fjalëve të përdorura apo me parregullsinë e frazës dhe të ndërtimit të fjalisë (sintaksa). Një ligj apo akt nënligjor duhet hartuar në mënyrë të thjeshtë, të qartë dhe konçize, me qëllim që çdo person i prekur nga zbatimi i tij të mund ta ndjekë, ta lexojë lehtësisht dhe ta kuptojë atë.

178 **Përzgjedhja e fjalës**. Fjala duhet të përzgjidhet e tillë që të përkojë me kuptimin e parë të saj dhe të njohur nga përdoruesit e ligjit apo të aktit nënligjor. **Çdo fjalë duhet të ketë kuptimin e duhur dhe të saktë** (shih për më shumë Pjesën C seksioni 2.5).

179 Mund të ndodhë që ligji apo akti nënligjor të rregullojë një marrëdhënie

juridike relativisht të re dhe shumë të specializuar, për të cilën nevojiten **fjalë të reja teknike**, ku sugjerohet që fjalët e reja të përdorura të përkufizohen (shih për më shumë Pjesën C seksioni 2.8).

Shembull

Fjala e re: Në nenin 42, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se "2. Sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg i kërkohet njëra, disa apo të gjitha prej masave të mëposhtme, në mënyrë të veçantë: d) të ofrojë akses të hapur në **ndërfaqet** teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual".

Problemi: Fjala "ndërfaqe" është një fjalë e re, që nuk ka përdorim të shpeshtë në gjuhën e përditshme, që e bën të paqartë llojin e masës që i kërkohet sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në tregun e komunikimeve elektronike

Zgjidhja: Në nenin 3, pika 16, jepet përkufizimi "**Ndërfaqe**" është tërësia e karakteristikave që përshkruajnë pikën e lidhjes ndërmjet dy njësive të komunikimeve elektronike, si p.sh. ndërmjet dy rrjeteve të komunikimeve ose ndërmjet një rrjeti të komunikimeve dhe pajisjes së përdoruesit. Ndërfaqja mund të jetë pajisje (hardware) ose program (software).

180 Me kalimin e kohës, **gjuha ndryshon**. Rrjedhimisht, për të shmangur rrezikun e dykuptueshmërisë duhen shmangur fjalët arkaike, fjalët e huaja, neologjizmat apo edhe shkurtimet e fjalëve (shih për më shumë Pjesën C seksioni 2.5).

Shembull

Fjalë e huaj: Neni 21, pika 2, e ligjit nr.53/2012, "Për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale me Task Forcën Hetimore Speciale të Eulex-it" parashikon "Dispozitat e parashikuara në këtë nen nuk cenojnë **prerogativat** e parashikuar në nenin 15 të këtij ligji".

Problemi: Vendosja e kësaj fjale vë në diskutim nëse rregullat e nenit 15 i japin përfituesit të drejta apo privilegje.

Zgjidhja: Dispozitat e parashikuara në këtë nen nuk cenojnë **privilegjet** e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

181 **Fjalitë të ndërtohen të shkurtra**, që nënkupton një fjali të përmbajë një mendim (shih për më shumë Pjesën C seksioni 2.3).

Shembull

Fjalia e gjatë: Neni 63, pika 2, e ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, parashikon "Relatori caktohet me short, duke marrë parasysh ngarkesën dhe aftësitë e secilit anëtar **sipas procedurës dhe rregullave më të hollësishme të miratuara nga Këshilli**.

Problemi: Cili është objekti i procedurës dhe rregullave të hollësishme të miratuara nga Këshilli? Shorti për caktimin e relatorit? Apo llogaritja e ngarkesës dhe e aftësive të secilit anëtar? Cili është lloji i aktit nënligjor normativ që nxjerr Këshilli?

Zgjidhja: Relatori caktohet me short, duke marrë parasysh ngarkesën dhe aftësitë e secilit anëtar. Këshilli me vendim miraton procedurën e shortit dhe përcakton rregulla më të hollësishme për përllogaritjen e ngarkesës dhe aftësive të secilit anëtar.

182 Në ndërtimin e fjalisë të përdoret rendi **kryefjalë – kallëzues – kundrinor** (shih për më shumë Pjesën C seksioni 2.4).

Shembull

Rendi i fjalëve: Neni 9 i ligjit nr.60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar, parashikon "Në zbatim të parimit të ruajtjes së konfidencialitetit, sekretit shtetëror dhe mbrojtjes së të dhënave personale, njësitë përgjegjëse bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me ILDKPKI-në për shkëmbim të dhënash, të plota dhe pa asnjë rezervë, me qëllim shqyrtimin dhe zgjidhjen e një rasti të sinjalizuar

kur, pavarësisht nga organizata e sinjalizuesit, të sinjalizuarit i përkasin organizatave të ndryshme".

Problemi: Formulimi paraqet tri probleme: gjatësinë e fjalisë, rendin e fjalëve dhe përdorim të fjalisë bashkërenditëse. Teksti lë vend për keqkuptime sepse ndonëse përmendet zbatimi i parimeve të konfidencialitetit, sekretit shtetëror dhe mbrojtja e të dhënave personale, vijohet me detyrimin për shkëmbimin e të dhënave të plota pa asnjë rezervë. Është e paqartë se cila është ideja themelore e rregullit: detyrimi për shkëmbim të plotë dhe pa rezerva të informacionit apo detyrimi për ruajtjen e rregullave në shkëmbimin e informacionit. Po ashtu, është e paqartë përse theksohet organizata e sinjalizuesit, kur ajo nuk ka rëndësi. Mungon në tekstin e rregullit kushti që kjo dispozitë zbatohet atëherë kur rasti lidhet me më shumë se një të sinjalizuar.

Zgjidhja: Njësitë përgjegjëse bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me ILDKPKI-në për shqyrtimin dhe zgjidhjen e një rasti të sinjalizuar kur ai lidhet me më shumë se një të sinjalizuar, të cilët i përkasin organizatave të ndryshme. Bashkëpunimi realizohet nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave, të plota dhe pa asnjë rezervë. Njësitë përgjegjëse dhe ILDKPKI-ja në procesin e bashkëpunimit zbatojnë rregullat e ruajtjes së konfidencialitetit, sekretit shtetëror dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

183 Nëse është e mundur të përdoren **sa më pak fjalitë bashkërenditëse dhe fjalitë me shumë gjymtyrë**. Rrethanori dhe përcaktori duhet të vendosen pranë fjalës apo shprehjes, që ato shoqërojnë (shih për më shumë Pjesën C seksioni 2.3).

Shembull Rrethanori: Neni 15 pika 2 e ligjit nr. 16/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar, parashikon "ILDKPKI-ja ose njësia përgjegjëse duhet të ruajnë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin

e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar te persona të tretë brenda ose jashtë organizatës ose ILDKPKI-së, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor".

Problemi: Përdorimi i shumë gjymtyrëve në këtë fjali bën të paqartë nëse sinjalizuesi e jep pëlqimin me shkrim vetëm për përdorimin e informacionit për qëllime të tjera apo edhe për përhapjen e informacionit edhe tek persona të tretë. E njëjta paqartësi ekziston edhe për përmbushjen e detyrimit ligjor. Paqartësi krijon edhe rrethanori "te persona të tretë brenda ose jashtë organizatës ose ILDKPKI-së" jo vetëm që rrethanorët janë disa të listuar, por edhe vetë fjalia fillon me ILDKPKI-në.

Zgjidhja: ILDKPKI-ja ose njësia përgjegjëse duhet të ruajnë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin. Informacioni nuk përdoret për qëllime të tjera, nuk përhapet dhe as nuk transmetohet tek persona të tretë, që nuk merren me shqyrtimin dhe vlerësimin e rastit. Detyrimi i konfidencialitetit nuk zbatohet në rastet kur: a) sinjalizuesi jep pëlqimin me shkrim; ose b) duhet përmbushur një detyrim ligjor.

184 Fjalitë të ndërtohen në kohën e tashme (shih për më shumë Pjesën C seksioni 2.15).

Shembull
Koha
e ardhme: Neni 399/2 pika e 1 e Kodit të Procedurës Civile parashikon "Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, **do të konsiderohen**..."

Problemi: Përdorimi i kohës së ardhme krijon paqartësi mbi kohën se kur do të bëhet konsiderimi i afatit të arsyeshëm sipas këtij neni.

Zgjidhja: Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, **konsiderohen**...

185 Fjalitë duhet të formulohen në **numrin njëjës.** Përdorimi i numrit shumës lejon abuzuesin me ligjin të vendosë kritere shtesë për zbatimin e procedurës apo të rregullit, duke i mohuar të drejtat përfituesve të ligjit apo duke bërë presion të papërshtatshëm korruptiv.

Shembull Fjali në shumës: Neni 2 pika 2 e Kodit të Procedurës Civile parashikon se "Palët janë të lira që në çdo kohë të tërheqin padinë, por gjithnjë përpara shuarjes së saj për efekt gjykimi ose në bazë të ligjit".

Problemi: Në mënyrën e formuluar, rregulli tregon se në gjykim ka gjithnjë më shumë se një palë. Po ashtu, tregon se padia tërhiqet nga të gjitha palët në proces, kur në fakt kjo e drejtë i takon vetëm njërës palë, asaj paditëse, që ka vënë në lëvizje gjykatën.

Zgjidhja: Pala paditëse është e lirë që në çdo kohë të tërheqë padinë, por gjithnjë para shuarjse së saj për efekt gjykimi ose në bazë të ligjit.

186 Përdorimi i **sinonimeve** duhet të shmanget.

187 Në rastet, kur rregulli ligjor përmban një listë cilësish, kriteresh apo kushtesh, është shumë e rëndësishme që **lidhëzat të përdoren në mënyrë të saktë** (shih për më shumë Pjesën C seksioni 2.17).

Shembull Mungesë lidhëze: Neni 45 pika 3 e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, parashikon "Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur: a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga komisioni i votimit; b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor

të kandidatëve; c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët; ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët; d) nuk është e qartë se për për cilin kandidat është votuar; dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit"

Problemi: Mungesa e lidhëzës është një rrezik që dikush t'i zbatojë këto kritere të pavlefshmërisë së votës në mënyrë kumulative. Vër re që kjo dispozitë është e njëjtë në përmbajtje me nenin 117 pika 3 të Kodit Zgjedhor, por aty gjendet lidhëza "ose".

Zgjidhja: Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur: a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga komisioni i votimit; b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve; c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët; ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët; d) nuk është e qartë se për për cilin kandidat është votuar; **ose** dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.

Gjithashtu, paqartësi krijon edhe teknika e fundit legjislative që po përdoret në Shqipëri me lidhëzën e përbërë "dhe/ose", e cila krijon dyshime tek përdoruesi nëse kushtet duhen plotësuar në mënyrë alternative apo në mënyrë kumulative.

Shembull Lidhëza dhe/ose: Neni 21 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon "Veprimtaria administrative i nënshtrohet: a) kontrollit administrativ, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi mbi mjetet ligjore administrative dhe legjislacionit në fuqi; b) kontrollit të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi; **dhe/ose** c) çdo kontrolli tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi".

Problemi: Është e paqartë nëse veprimtaria administrative i nënshtrohet detyrimisht tre lloj kontrolleve apo nëse mund t'i nënshtrohet qoftë edhe vetëm një prej llojeve të kontrolleve.

Zgjidhja: Veprimtaria administrative i nënshtrohet: a) kontrollit administrativ, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi mbi mjetet ligjore administrative dhe legjislacionit në fuqi; b) kontrollit të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi; **ose** c) çdo kontrolli tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi

7.1.3 Harmonizimi

188 Kur hartohet një ligj apo një akt nënligjor, hartuesi duhet t'i kushtojë rëndësi harmonizimit, që nënkupton të identifikojë se sa koherent është akti i ri ligjor apo nënligjor brenda tekstit të tij, por edhe në raport me legjislacionin aktual. Koherenca ligjore i referohet marrëdhënies logjike dhe sistematike të rregullave të ndryshme në të njëjtin ligj apo të ligjeve të ndryshme me njëri-tjetrin. Aty ku kjo marrëdhënie nuk është e qartë, kjo dykuptueshmëri formon një rrezik korruptiv.

189 **Dispozitat kontradiktore** zënë vend kur përmbajtja e dy rregullave ligjore apo nënligjore krijojnë konflikt me njëra-tjetrën. Konflikti mund të shfaqet nëpërmjet mungesës së koherencës së brendshme në tekstin e ligjit ose të aktit nënligjor. Një rast tipik është kur e njëjta situatë përcaktohet nga dy rregulla të ndryshme, me përmbajtje të ndryshme. Në këtë rast, duhet vëmendje e shtuar për të analizuar objektin e ligjit apo të aktit nënligjor, për të identifikuar se cila prej dispozitave bie ndesh me të.

Shembull Dispozita kontradiktore: Neni 17 pika 5 e ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike" thotë:

"Në rast të dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore konstatohet një konflikt interesi, **ky shërbim ndërpritet menjëherë**. Në rastin kur ndihma juridike parësore jepet nga një qendër shërbimi për ndihmë juridike parësore, çështja trajtohet në përputhje me parashikimet e Kodit

të Procedurave Administrative, për shmangien e konfliktit të interesit. Në rastin kur ndihma juridike parësore jepet nga një organizatë jofitimprurëse e autorizuar, kjo e fundit merr masa për shmangien e konfliktit të interesit, sipas dispozitave ligjore në fuqi, **duke siguruar dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kërkuesin**".

Problemi: Nëse një OJF e autorizuar konstaton konflikt interesi, ajo ndërpret dhënien e shërbimit të ndihmës juridike parësore sipas fjalisë së parë apo shmang konfliktin, duke siguruar shërbimin e ndihmës juridike sipas fjalisë së tretë.

Zgjidhja: "Në rast se gjatë dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore konstatohet një konflikt interesi, **ky shërbim ndërpritet menjëherë**. Në rastin kur ndihma juridike parësore jepet nga një qendër shërbimi për ndihmë juridike parësore, çështja trajtohet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, për shmangien e konfliktit të interesit. Në rastin kur ndihma juridike parësore jepet nga një organizatë jofitimprurëse e autorizuar, kjo e fundit merr masa për shmangien e konfliktit të interesit, sipas dispozitave ligjore në fuqi. **Qendra e shërbimit ose organizata jofitimprurëse e autorizuar, pas shmangies së konfliktit të interesit, i siguron kërkuesit dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore**".

190 Dispozitat kontradiktore zënë vend edhe nëpërmjet mungesës së koherencës së jashtme, që ligji apo akti nënligjor ka në raport me ligje apo akte të tjera nënligjore. Në këtë rast, duhet kushtuar kujdes për të identifikuar vendin që zë ligji apo akti nënligjor në kuadrin ligjor të përgjithshëm në drejtim të hierarkisë së tij dhe më pas, vendin që ai zë në sektorin që rregullon.

Shembull Dispozita kontradiktore: Neni 152 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve

dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" parashikonte pezullimin mbi bazë diskrecioni, duke i njohur Këshillit autoritetin për të pezulluar magjistratin nëse: a) ndaj magjistratit ka filluar hetimi penal; b) kur ndaj tij është caktuar masa e arrestit për një vepër penale të kryer nga pakujdesia; c) kur ndaj tij kanë filluar hetimet ose procedimet disiplinore për shkelje disiplinore. Kjo dispozitë vijon nenin 151 të ligjit, që përcakton si raste pezullimi: a) ndaj magjistratit caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale; ose b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje.

Problemi: Ashtu siç vuri në dukje Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 34/2017, neni 152 ka parashikuar raste të tjera pezullimi për magjistratin, në mungesë të delegimit të shprehur të nenit 140 të Kushtetutës, duke cenuar kështu nenin 116 të Kushtetutës. Neni 140 i Kushtetutës parashikon si raste pezullimi: a) kur ndaj magjistratit caktohet masa e sigurimit "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale; ose b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; ose c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Zgjidhja: Neni 152 duhet të riformulohet për të treguar pezullimin e magjistratit nga detyra kur ndaj tij fillon procedimi disiplinor dhe duke shpjeguar se cili quhet momenti i fillimit të procedimit disiplinor.

191 **Terminologjia.** Rëndësi e veçantë i duhet kushtuar **saktësisë në terminologji**. Termat zgjidhen sipas kuptimit që ato kanë në sektorin, të cilin pritet të rregullojë ligji apo akti nënligjor që po hartohet (shih për më shumë Pjesën C seksioni 2.1).

Shembull Terma të ndryshëm: Neni 92 pika 1 shkronja "f" e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë",

i ndryshuar, përdor termin "norma e evadimit të çështjeve", ndërsa ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" përdor termin "rendimenti i përfundimit të çështjeve", të cilin madje e përkufizon në nenin 2 shkronja "l".

Problemi: Përdorimi i dy termave të ndryshëm mund të shkaktojë situatën që Këshilli të miratojë dy standarde të ndryshme pune, të cilat prekin përformancën e gjykatës në tërësi, por edhe vlerësimin individual profesional të magjistratit.

Zgjidhja: Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, duhet të përdorë të njëjtin term "rendimenti i përfundimit të çështjeve".

192 **Referencat** duhet të formulohen me kujdes të veçantë (shih për më shumë Pjesën C seksioni 3).

193 **Vakuumi ligjor** ndodh në rastin kur një situate të caktuar faktike, ligji apo akti nënligjor nuk i jep zgjidhje në mënyrë të qartë. Vakuumi ligjor përbën rrezik korruptiv sepse i lejon zbatuesit të zgjidhë një çështje me diskrecionin e tij, duke nxjerrë përfitime të parregullta korruptive. Vakuumi ligjor është pasojë e dispozitave kontradiktore, por edhe në rastin kur ligji apo akti nënligjor hesht.

7.2 Identifikimi i risqeve substanciale për hapësira korruptive

194 Në këtë seksion bëhet fjalë kur ligji apo akti nënligjor ka boshllëqe në rregullimin e mekanizmave parandalues të korrupsionit. Këto lloj rreziqesh korruptive janë substanciale sepse lidhen me lëndën, që është objekt rregullimi nga ligji apo akti nënligjor. Mungesa e mekanizmave parandalues përbën rrezik korruptiv sepse e lejon zbatuesin e ligjit të mos mbajë përgjegjësi për veprimet që kryen. Gjithashtu, mungesa e mekanizmave parandalues krijon hapësira edhe për qytetarin të nxjerrë përfitime të parregullta nga zbatimi i ligjit.

195 Duhet evidentuar se rreziqet substanciale janë të ndryshme nga ato të dykuptueshmërisë. Një ligj apo akt nënligjor mund të jetë shumë i qartë dhe i kuptueshëm, por ai nuk përmban mekanizmat parandalues. Megjithatë,

nuk përjashtohet mundësia që rreziqet substanciale të bashkëekzistojnë me rreziqet e dykuptueshmërisë.

Shembull Mungesa e përgjegjësisë:	Neni 9 i ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, parashikonte[123] se "Në mbledhjen e tij më të afërt, Këshilli i Lartë i Drejtësisë zgjedh një komision të përbërë nga tre anëtarë të dalë prej tij, për të verifikuar zgjedhshmërinë, pajtueshmërinë dhe **ushtrimin në përputhje me ligjin të detyrës së anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë**".
Problemi:	Ligji nuk përmbante asnjë dispozitë që të tregonte llojet e shkeljeve disiplinore në ushtrimin e detyrës së anëtarit të KLD-së dhe as procedurën e hetimit të shkeljeve të tij.
Zgjidhja:	Nenet 5 dhe 6 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, përcaktojnë shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe procedurën disiplinore.

196 Për të bërë vlerësimin e rreziqeve substanciale është e rëndësishme, që hartuesi të mbajë në konsideratë strukturën e ndërtimit të ligjit apo të aktit nënligjor:

- dispozitat e përgjithshme mbi objektin dhe qëllimin dhe;
- procedurat;
- organin zbatues;
- mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit; dhe
- sanksionet.

7.2.1 Objektivat e ligjit apo të aktit nënligjor

197 Hartuesi duhet të analizojë me kujdes **objektivat**, që synohen të arrihen nëpërmjet ligjit apo aktit nënligjor. Në këtë analizë merr vlerë të posaçme

123 Ky ligj është shfuqizuar me ligjet nr.115/2016 dhe nr. 96/2016 të Reformës në Drejtësi të vitit 2016.

Vlerësimi paraprak i projektligjit apo i projektaktit nënligjor normativ (shih për më shumë Pjesën C). Në përputhje me këtë vlerësim paraprak, formulohen objektivat e ligjit dhe fusha e zbatimit të tij. Ky proces analizues materializohet më pas në relacionin shpjegues, që shoqëron projektligjin apo aktin nënligjor.

198 Gjithashtu, eliminimi i këtij rreziku substancial kërkon që hartuesi të analizojë edhe **koherencën e objektivave** të ligjit apo aktit nënligjor me rregullat konkrete që ai përmban në brendësinë e tij. Dështimi i kësaj analize sjell në vijim formulime të paqarta substanciale të ligjit apo të aktit nënligjor në drejtim të procedurave, organit zbatues, mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit dhe sanksioneve. Objektivat e gabuar të ligjit apo kur ato krijojnë konflikte me legjislacionin në fuqi janë një zile alarmi për korrupsion sistemik. Ato shkaktojnë edhe trajtim preferencial të grupeve të interesit në kundërshtim me interesin publik.

7.2.2 Procedurat

199 Ka disa rreziqe korruptive që lidhen me procedurat, ku më të rëndësishmet janë masa e diskrecionit të organit publik, procedura e paqartë, afatet e paqarta, mbingarkesa e procedurës me formalitete, mungesa e rregullave të konkurrencës dhe përsëritja/mbivendosja e procedurave/kontrolleve.

200 **Diskrecioni i gjerë.** Rregullat që disiplinojnë diskrecionin e organit publik në një ligj apo akt nënligjor përbëjnë rrezik korruptiv kur ato ofrojnë një hapësirë të tejskajshme diskrecioni apo hapësirë arbitrariteti të organit publik. Ky rrezik korruptiv është i pranishëm edhe kur diskrecioni i atribuohet një organi publik në nivel më të gjerë sesa është i duhur për të ushtruar përgjegjësinë e tij. Rrjedhimisht, zyrtari duke përdorur diskrecionin ka hapësirë korruptive për të nxjerrë përfitime të parregullta. Modeli më i zakonshëm është përdorimi i fjalës "mund". Si rregull, ligji hartohet në mënyrë urdhërore.

201 Ndonjëherë diskrecioni i gjerë shfaqet edhe me togfjalëshin se zyrtari publik "ka të drejtë të" kryejë apo mos kryejë një veprim, që nënkupton dhënien e mundësisë diskrecionare.

Shembull
Diskrecioni: Neni 31 pika 1 e ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor" parashikonte[124]

124 Kjo dispozitë është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor

"Të drejtën për nisjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë e ka Ministri i Drejtësisë".

Problemi: Formulimi tregon se fillimi i procedimit disiplinor është në diskrecionin e Ministrit të Drejtësisë dhe nuk është detyrim i tij, sa herë që konstaton shkelje disiplinore të gjyqtarit.

Zgjidhja: Neni 138 pika 1 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon "Nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore".

202 **Diskrecioni pa kritere.** Gjithashtu, rreziku korruptiv mbi diskrecionin del në pah edhe kur ligji i jep organit publik hapësirë për të zgjedhur një mundësi pa caktuar kritere, mbi të cilat duhet të bazohet për zbatimin e asaj mundësie.

Shembull Diskrecioni: Neni 31 pika 6 e ligjit nr. 8811/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" parashikonte[125] "Ministri i Drejtësisë vë në dijeni Këshillin e Lartë të Drejtësisë për rastet dhe për motivet e mosfillimit të procedimit disiplinor të gjyqtarit në kushtet e shkronjës "a" pika 1 e nenit 16 të këtij ligji". Bëhej fjalë për rastet kur procedimi disiplinor sugjerohej nga një verifikim apo inspektim disiplinor kryer nga KLD nëpërmjet Inspektoratit të tij.

Problemi: Ligji nuk parashikonte motivet për të cilat Ministri i Drejtësisë vendoste mosfillimin e procedimit disiplinor të gjyqtarit.

Zgjidhja: Neni 134 pika 1 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

---

në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

125 Ky ligj është shfuqizuar me ligjet nr.115/2016 dhe nr. 96/2016 të Reformës në Drejtësi të vitit 2016.

Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon "Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore; b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor; c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve; ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat "b" deri në "ç", të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji; d) magjistrati ka vdekur".

203 Duhet vënë re se rreziku mbi diskrecionin pa kritere verifikohet edhe në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për të vendosur mbi një çështje, duke përdorur më shumë se një mundësi, por pa caktuar kritere të veçanta për secilën mundësi. Ky lloj diskrecioni bëhet edhe konflikt në gjykatë.

204 Neni 37 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", adreson problematikën e diskrecionit pa kritere duke parashikuar se "Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative në nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton **edhe** nëse: a) zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit; b) zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit; c) zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë".

205 **Diskrecioni për përjashtimin nga rregulli.** Rrezik korruptiv përbën edhe dhënia e diskrecionit për të zbatuar përjashtimin nga rregulli. Diskrecioni për të zbatuar përjashtimin nga rregulli mund të jepet nëpërmjet rregullave që nuk përmbajnë kritere përjashtimore ose nëpërmjet rregullave që janë të përgjithshme dhe të paqarta.

Shembull Diskrecioni Neni 29 pika 3 fjalia 2 e ligjit nr. 9643/2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikonte[126] "Procedura me negociim përdoret vetëm në rrethana të veçanta, siç përcaktohet në nenet 32 e 33 të këtij ligji dhe në rregullat e prokurimit publik". Mirëpo lista e rasteve të parashikuara në nenet 32 dhe 33 jo vetëm që është e zgjeruar, por edhe ndryshon herë pas here me ligj, që shkakton humbjen e tiparit "vetëm rrethana të veçanta".

Problemi: Agjencia e Prokurimit Publik në raportin e saj vjetor për vitin 2017 deklaron se problematikë gjatë vitit 2017 ka vazhduar të mbetet numri i lartë procedurave me negociim pa shpallje paraprake, të cilat përbëjnë 31.8% të totalit të të gjitha procedurave të prokurimit, të zhvilluara gjatë vitit 2017.

Zgjidhja: Kur formulohet një përjashtim nga rregulli, atëherë kriteret janë të tilla që të kufizojnë në një numër shumë të ulët rastesh zbatimin e përjashtimit.

206 **Mungesa e procedurës.** Identifikimi i këtij rreziku korruptiv dhe eliminimi i tij garanton që procedura administrative të jetë e aksesueshme dhe e hapur; të jetë e parashikueshme; si dhe të mos ketë konflikt interesi.

207 Ky lloj rreziku korruptiv verifikohet në ato raste, kur ligji apo akti nënligjor nuk tregon hapat proceduralë që duhen ndjekur për përfitimin e një të drejte apo përmbushjen e një detyrimi.

Shembull Mungesa e procedurës Neni 61 i ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" parashikon "Ministri i Drejtësisë mund të urdhërojë që zyra e noterit të administrohet nga zëvendësnoteri ose nga një noter tjetër gjatë kohëzgjatjes së pezullimit. Personi që kryen administrimin e zyrës merr të gjitha të drejtat dhe detyrat profesionale të noterit të pezulluar, sa i përket arkivit dhe çeljes së dëshmisë së trashëgimisë testamentare"

126 Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Problemi: Formulimi i këtij neni nuk përmban ndonjë parashikim të shprehur që t'i japë të drejtë Ministrit të Drejtësisë që në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë të nxjerrin aktet nënligjore me qëllim parashikimin e gjithë procedurës së hollësishme për realizimin e administrimit të zyrës së noterit nga zëvendësnoteri ose një noter tjetër. Pra, krijohet rreziku që një administrim i tillë nga një noter tjetër që është në kushte konkurrence të krijojë ndërhyrje në aktivitetin e noterit të pezulluar, por edhe tek konfidencialiteti i raportit mes klientit dhe noterit.

Zgjidhja: Ministri i Drejtësisë urdhëron që zyra e noterit të administrohet nga zëvendësnoteri ose nga një noter tjetër gjatë kohëzgjatjes së pezullimit. Personi që kryen administrimin e zyrës merr të gjitha të drejtat dhe detyrat profesionale të noterit të pezulluar, sa i përket arkivit dhe çeljes së dëshmisë së trashëgimisë testamentare. **Ministri i Drejtësisë, pasi merr mendimin e Dhomës Kombëtare të Noterisë, me udhëzim përcakton rregulla të detajuara për procedurën e zëvendësimit gjatë pezullimit, bazuar në parimin e konkurrencës së lirë dhe të ndershme**.

208 **Procedura administrative e paqartë.** Ky rrezik korruptiv lidhet me formulimin e rregullit ligjor në mënyrë të tillë që procedura që zbaton organi publik është e paqartë. Përdoruesi i ligjit apo i aktit nënligjor e ka të vështirë të kuptojë hapat proceduralë që duhen ndjekur deri në marrjen e një vendimi. Rrjedhimisht, zyrtari mund ta përdorë këtë rrezik korruptiv në mënyrë abuzive për të nxjerrë përfitime të parregullta.

Shembull: Procedura e paqartë: Neni 84 pikat 1 dhe 2 e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikojnë "1. Vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar bëhet ndaj të miturit, interesat e të cilit kërkojnë një vëmendje dhe mbikëqyrje të posaçme dhe që për rrethanat konkrete nuk mund të realizohet nga ana e prindit

ose personave të afërm. 2. Shërbimi i specializuar mundësohet **nga institucionet ose persona juridikë të licencuar edhe për këtë qëllim dhe në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës**.

Problemi: Ligji nr.18/2017 "Për të drejtat e fëmijëve" përdor kritere të tjera procedurale për masat që merren ndaj të miturit, siç është "përkujdesja alternative" në nenin 57. Nga ana tjetër, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur i referohet institucioneve "të licencuara edhe për këtë qëllim", ndërsa Ligji "Për të drejtat e fëmijëve" nuk ka procedurë licencimi për institucionet që ofrojnë shërbime.

Zgjidhja: Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Ligji për të Drejtat e Fëmijëve duhet të harmonizohen duke saktësuar rregullat e vendosjes së të miturit në konflikt me ligjin në shërbimin e specializuar, si dhe të saktësojnë procedurën dhe kriteret e identifikimit dhe licencimit të organit që ofron këtë shërbim.

209 **Procedura e ndërlikuar.** Ky rrezik shfaqet kur rregulli ligjor apo nënligjor formulohet në mënyrë të tillë që krijon vështirësi për qytetarët për të ushtruar të drejtat e tyre apo kritere të shumta për qytetarët për të përfituar një të drejtë. Rrjedhimisht, për zyrtarin bëhet e thjeshtë të abuzojë dhe të nxjerrë përfitime të parregullta nga qytetarët, që duan të shmangin vonesat dhe lodhjen. Një formë tjetër e shfaqjes së këtij rreziku është edhe rasti kur procedura e prezantuar nga ligji apo akti nënligjor është e papërshtatshme, që në praktikë e shndërron atë në një procedurë të pazbatueshme.

210 **Aksesi i kufizuar në informacion.** Ky lloj rreziku korruptiv zë vend kur ligji apo akti nënligjor ndalon apo kufizon marrjen e informacionit nga personi që preket nga zbatimi i ligjit. Në këtë mënyrë, zyrtari publik ka mundësinë të abuzojë me pushtetin e tij gjatë zbatimit të ligjit.

Shembull

Aksesi i kufizuar Neni 141 pika 1 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën

e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikonte[127] "Gjatë procedimit disiplinor, magjistratit ose përfaqësuesit të tij u sigurohet aksesi në dosje në masën që nuk cenon: a) interesat ligjorë të palëve ose personave të tretë; b) funksionet e organit vendimmarrës; c) qëllimin e procedimit".

Problemi: Gjykata Kushtetuese e analizoi këtë dispozitë dhe arsyetoi se "nisur nga rëndësia që paraqet respektimi gjatë procedimit disiplinor i parimeve të përcaktuara në nenin 100 të ligjit, vlerëson se shprehja e përdorur nga ligjvënësi në pikën 1 të nenit 141 të ligjit "në masën që nuk cenon a) interesat ligjorë të palëve ose personave të tretë; b) funksionet e organit vendimmarrës; c) qëllimin e procedimit" nuk siguron garancinë kushtetuese që buron nga e drejta për një proces të rregullt ligjor për mbrojtje efektive dhe barazi të armëve gjatë procedimit disiplinor të gjyqtarëve".

Zgjidhja: Gjatë procedimit disiplinor, magjistratit ose përfaqësuesit të tij u sigurohet aksesi në dosje, përveçse kur ekziston ndonjë nga rastet e kufizimit të informacionit sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

211 **Afatet e papërcaktuara ose të papërcaktueshme.** Që një procedurë të jetë efektive dhe pa hapësira korruptive, është e nevojshme që të përcaktohen afate në hapat proceduralë të saj. Mungesa e afateve apo afatet e papërcaktuara krijojnë rrezik korruptiv sepse organi publik ose privat ka mundësinë e abuzimit, duke nxjerrë përfitime të parregullta nga kryerja e veprimeve sipas afateve që i vlerëson ai vetë.

212 **Mungesa e konkurrencës.** Mungesa e rregullave të konkurrencës është një rrezik tjetër korruptiv. Ky rrezik i jep mundësi të hapur organit publik për të abuzuar. Ky lloj rreziku mund të zërë vend edhe kur rregullat e konkurrencës janë tepër të përgjithshme apo kur delegohen për t'u rregulluar nga një organ ekzekutiv me akt nënligjor.

127 Kjo dispozitë është shfuqizuar pjesërisht nga Gjykata Kushtetutese me vendimin nr. 34/2016.

Shembull Mungesa e konkurrencës: Neni 18 i ligjit nr. 10018, datë 31.11.2008, "Për Avokaturën Shtetit", i ndryshuar, parashikon "Në çështje të rëndësishme për interesat e shtetit, ose kur natyra e çështjes kërkon juristë ose ekspertë të specializuar në fusha të veçanta, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit kontrakton, sipas një procedure konkurruese dhe transparente përzgjedhjeje, avokatë, studio avokatie ose ekspertë, vendas apo të huaj, si dhe shërbime të tjera ndihmëse. 2. Procedura e kontraktimit nuk i nënshtrohet rregullave për prokurimin publik. Procedurat dhe kriteret për kontraktimin e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse, si dhe mënyra e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Problemi: Kjo dispozitë në mënyrë të shprehur shmang rregullat e prokurimit publik. Arsyet e kontraktimit të shërbimit janë shumë të përgjithshme "rëndësia e interesave të shtetit" ose "natyra e çështjes". Kriteret dhe procedura janë deleguar të rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Zgjidhja: Ligji duhet të detajojë kriteret bazë të konkurrencës në këtë proces, ndërsa akti nënligjor i Këshillit të Ministrave duhet t'i nënshtrohet vlerësimit të hapësirave korruptive.

213 **Procedura e paqartë e vendimmarrjes.** Ky lloj rreziku korruptiv del në pah kur ligji apo akti nënligjor nuk cakton kritere dhe procedurë të qartë për marrjen e vendimit nga organi publik.

Shembull Kriteret e paqarta: Neni 44 i ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, "Për regjistrimin pasurive të paluajtshme" parashikonte[128]

128 Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, i cili më pas është shfuqizuar me ligjin nr. 111/2018 "Për kadastrën".

"Për parandalimin e ndonjë mashtrimi, **veprimi** të padrejtë ose **të pamjaftueshëm**, regjistruesi lëshon urdhër për regjistrimin e kufizimit në seksionin përkatës të kartelës, me ose pa kërkesën e personit të interesuar për pasurinë e paluajtshme, kontratën e qirasë ose hipotekën me të gjitha ndryshimet pasi të ketë udhëzuar që të dëgjohen ata persona që ai i mendon të përshtatshëm.".

Problemi: Kriteret e kufizimit janë me fraza të përgjithshme, sidomos kriteri "parandalim i një veprimi të pamjaftueshëm" që krijojnë pasiguri për të drejtën e pronësisë së qytetarit, duke lënë hapësirë korruptive për regjistruesin në lëshimin e urdhrit për kufizimin e pronës. Regjistruesi nuk ka detyrimin që vendimin e tij ta bazojë në prova dhe as detyrimin që aktin e tij ta arsyetojë.

Zgjidhja: Kufizimi kryhet nga regjistruesi për parandalimin e mashtrimit apo veprimeve të padrejta mbi të drejtat e pronësisë të regjistruara, kur nga faktet ose dokumentacioni i paraqitur/administruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme konstatohet se drejta e pronarit për të vepruar mbi pasurinë e paluajtshme është e kufizuar. Akti i kufizimit lëshohet në formën e urdhrit, i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe duhet të përmbajë mjetet mbrojtëse të palëve që u drejtohet.[129]

7.2.3 Organi zbatues i ligjit apo i aktit nënligjor

214 Në hartimin e rregullave për organin zbatues të ligjit bëhen prezent disa rreziqe korruptive, siç janë ato rreziqe që lidhen me mos/përcaktimin e kompetencave të organit publik dhe konfliktin e interesave.

215 **Organi i papërcaktuar.** Ky lloj rreziku verifikohet kur ligji përmban rregulla mbi një situatë të caktuar, por nuk cakton një organ kompetent për

129 Kjo është përmbajtja e nenit 59 të ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar

zbatimin e tyre. Në format më të zakonshme, ky lloj rreziku është i lidhur me dykuptueshmërinë, në formën e mungesës së koherencës së ligjit apo të boshllëkut ligjor.

Shembull

Organi i papërcaktuar: Kodi Penal në formën e tij fillestare të vitit 1995 parashikonte në nenet 58-64 të tij alternativat e dënimit me burgim. Kodi i Procedurës Penale nuk përmbante asnjë rregull për zbatimin e tyre, por e delegonte ekzekutimin e vendimeve penale tek ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar. Ky ligj i fundit nuk caktonte asnjë organ kompetent për ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e alternativave të dënimit me burgim.

Problemi: Ndonëse hartuesit e Kodit Penal shprehën vullnetin për alternativat e dënimit me burgim, përbën problem mospërcaktimi i një organi kompetent për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave alternative të dënimit.

Zgjidhja: Në vitin 2008, Kuvendi miratoi dy ligjet nr. 10023/2008 dhe nr. 10024/2008, që sollën ndryshime në Kodin Penal dhe në ligjin nr. 8331/1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ku u përcaktua si organ kompetent për mbikëqyrjen e alternativave të dënimit me burgim Shërbimi i Provës.

216 **Kompetencat e paqarta.** Ky rrezik shfaqet në disa forma. Eleminimi i këtij rreziku kërkon që ligji apo akti nënligjor të përkufizojë kompetencën e organit publik në mënyrë të tillë, që ajo të përfshijë të gjitha aspektet e ligjit apo të aktit nënligjor.

217 Një formë e këtij rreziku përfshin rastin kur ligji apo akti nënligjor nuk përcakton në mënyrë të qartë përgjegjësitë e organit publik. Një rast tjetër është ai kur kompetencat nuk janë të plota për të ushtruar funksionin. Gjithashtu, ky rrezik mund të shfaqet edhe në formën kur kompetencat e dy ose shumë organeve publike mbivendosen. Në rastin e mbivendosjes, abuzimi lidhet me kryerjen e funksionit nga dy organe njëherazi ose me

moskryerjen e funksionit fare, pasi secili institucion ia lë kryerjen e tij institucionit tjetër.

218 **Caktimi i vonuar i organit kompetent.** Në këtë rast bëhet fjalë kur ligji parashikon ngritjen e një organi publik për zbatimin e ligjit, por e delegon procedurën e organizimit dhe të funksionimit të tij me akt nënligjor, pa caktuar afate konkrete. Rreziku në këtë rast qëndron në faktin që ngritja e organit kompetent për zbatimin e ligjit të vonohet ose të mos ndodhë kurrë.

Shembull
Ngritja e vonuar e organit: Neni 282/2 i ligjit nr. 8901, datë 23.05.2002 "Për falimentimin", i ndryshuar, parashikonte[130] ngritjen e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit. Pika 3 e kësaj dispozite parashikonte "Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave". Ligji nuk caktonte afatin, brenda të cilit Këshilli i Ministrave të nxirrte vendimin.

Problemi: Ligji delegonte procedurën e organizimin dhe funksionimit të Agjencisë tek Këshilli i Ministrave, pa caktuar afat kohor. Si rezultat, ngritja e kësaj Agjencie u vonua. Këshilli i Ministrave nxori vendimin nr. 852, datë. 21.10.2010 "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit". Agjencia u bë funksionale në vitin 2012.

Zgjidhja: Ligji duhet të parashikonte një afat të caktuar brenda të të cilit Këshilli i Ministrave të nxirrte vendimin për ngritjen e Agjencisë.

219 **Kompetencat e fragmentarizuara.** Ky rrezik është i pranishëm kur ligji krijon një skemë të komplikuar institucionesh për zbatimin e tij, ku secili nga institucionet përmbush një pjesë të kompetencës në procesin vendimmarrës. Në këtë rast, ka gjasa që ligji të mos zbatohet, pasi çdo institucion ia kalon përgjegjësinë tjetrit.

130 Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 111/2016 "Për falimentimin".

Shembull

Fragmentarizimi: Neni 5/1(3) i Ligjit nr.10 385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" parashikon "Në përfundim të trajnimit fillestar, zhvillohet provimi kualifikues për ndërmjetës. Provimi i kualifikimit organizohet të paktën një herë në vit nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit.".

Problemi: Ligji parashikon provimi kualifikues për ndërmjetës organizohet bashkërisht nga Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, por pa e përcaktuar qartë kompetencën e secilit institucion në procesin e organizimit dhe vlerësimit të provimit, çka ka qenë një nga arsyet e mosorganizimit të këtij provimi në 3 vitet e fundit.

Zgjidhja: Ligji duhet të parashikonte qartësisht rolin e secilit institucion në organizimin dhe vlerësimin e provimit kualifikues për ndërmjetës, ose duhet ta delegonte këtë çështje për rregullim nga një akt nënligjor normativ.

220 **Konflikti i interesave.** Konflikti i interesave dhe parandalimi i tij rregullohet me ligj të veçantë – ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar. Neni 3 pika 1 e këtij ligji e përkufizon konfliktin e interesave si gjendjen e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

221 për qëllime të vlerësimit të hapësirave korruptive, hartuesi i ligjit apo i aktit nënligjor duhet të bëjë kujdes që gjatë formulimit të rregullave të reja, ato të përmbushin standardet e parandalimit dhe të shmangies së konfliktit të interesave.

7.2.4 Mungesa e mbikëqyrjes

222 Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit lidhet me përgjegjshmërinë e zbatuesit të ligjit. Nëse zbatuesi i ligjit nuk mbikëqyret apo kontrollohet gjatë

zbatimit të ligjit, atëherë ai nuk ka përgjegjësi për abuzimin me detyrën. Rrjedhimisht, mungesa e mekanizmit mbikëqyrës përbën rrezik korruptiv.

Shembull Mungesa e mbikëqyrjes:	Ligji nr. 8901, datë 23.05. 2002 "Për falimentimin", i ndryshuar, në formën e vet fillestare parashikonte[131] rregullat për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi, ku figurë kryesore ishtë administratori. Ligji nuk parashikonte një mekanizëm mbikëqyrës të procedurës së falimentimit dhe as mbikëqyrje për administratorët.
Problemi:	Mungesa e mekanizmit mbikëqyrës krijonte probleme abuzimi nga administratorët përgjatë procedurave të falimentimit, që shkaktonin humbje të mëtejshme për debitorët dhe përfitime të parregullta për administratorët.
Zgjidhja:	Ligji u ndryshua me ligjin nr. 9919, 19.05.2008, i cili ngriti si organ mbikëqyrës Agjencinë e Mbikëqyrjes së Falimentimit. Sipas nenit 282/3 të ndryshuar, Agjencia kishte si përgjegjësi mbikëqyrjen e veprimtarisë së administratorëve, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të procedurave të falimentimit.

223 Lidhur me mbikëqyrjen është shumë e rëndësishme edhe **niveli i transparencës** së procedurës administrative që siguron ligji apo akti nënligjor. Nëpërmjet transparencës garantohet që zbatimi i ligjit të mbikëqyret edhe nga publiku dhe shoqëria civile, të cilat ushtrojnë presion pozitiv për eleminimin e korrupsionit.

7.2.5 Mungesa e sanksioneve ose sanksionet e papërcaktuara qartë

224 Edhe sanksionet janë të lidhura me përgjegjshmërinë në zbatimin e ligjit. Sanksionet caktohen për të adresuar situatën kur verifikohet një shkelje e ligjit. Rregullat mbi sanksionet mund të përbëjnë rrezik korruptiv atëherë kur sanksionet mungojnë fare ose kur ato janë disproporcionale. Disproporcionaliteti mund të shfaqet edhe në formën e diferencës së

131 Ky ligj është shfuqizuar tashmë me ligjin nr. 111/2016 "Për falimentimin"

thellë midis nivelit minimal dhe maksimal të sanksionit. Në këto lloj rastesh, zyrtarëve që caktojnë sanksionet iu lind mundësia të abuzojnë me detyrën, duke mos i ndjekur shkeljet e ligjit dhe duke bërë presion për përfitime të parregullta nga kundravajtësit e ligjit.

Shembull
Gjobat
disproporcionale: Nenet 5, 14, 15, 16, 17, pikat 1 dhe 2, 18 dhe 20 të ligjit nr.99/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar" rritën masën e gjobave në 500 mijë lekë dhe 10 milionë lekë për tatimpaguesit. Ky ndryshim ligjor u frymëzua nga nevoja për të luftuar informalitetin.

Problemi: Këto dispozita ligjore mbi sanksionet u shfuqizuan nga Gjykata Kushtetuese[132] me arsyetimin se ashpërsia e gjobave në rastin konkret është e tillë sa ato në thelb shndërrohen në dënime penale. Bazuar në karakteristikat dhe qëllimet e ndryshme midis dënimeve administrative me gjobë të vendosura për një shkelje me natyrë administrative dhe atyre të parashikuara për të njëjtën shkelje kur ajo kualifikohet si vepër penale, Gjykata çmon se kjo masë e ligjvënësit e ka kapërcyer logjikën normale të synimit dhe qëllimit të një mase administrative në fushën e taksave dhe të tatimeve. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se masat e gjobave janë dukshëm të ekzagjeruara dhe jo të përshtatshme për të justifikuar arritjen e qëllimit dhe objektivit për të cilin ato janë parashikuar.

Zgjidhja: Ligji duhet të caktojë gjoba proporcionale që i përgjigjen natyrës së shkeljes dhe që arrijnë qëllimin, për të cilin ato janë parashikuar.

7.2.6 Kontrolli gjyqësor

225 Mungesa e kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative përbën një rrezik të dukshëm korruptiv.

132 Shih vendimin nr. 33, datë 08.06.2016 të GJK-së.

Shembull Mungesa e ankimit:	Ligji nr. 7703, datë 1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 39/1 "Ankimi në Komisionin Epror', pika 3 parashikon "Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë".
Problemi:	Mungesa e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të dhënë nga Komisioni Epror Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (Komisioni Epror) krijon probleme abuzimi. Pavarësisht se rikompozimi i kësaj strukture duke përfshirë edhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë (anëtari i pestë) me kriterin që të ketë përvojë profesionale prej jo më pak se 10 vjet punë është bërë në adresim të vendimit të GJEDNJ-së, cështja "Dauti kundër Shqipërisë", 3 shkurt 2009, nuk e përcakton këtë strukturë si "*gjykatë e pavarur dhe të paanshme*". Kolegji Administrativ me vendimin njësues nr. 00-2021-1317 (113) ka konkluduar se neni 39/1, pika 3 i ligjit nr. 7703/1993, në pjesën ku parashikon se *"...Vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë*", vjen në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*". Si rrjedhojë, kjo dispozitë mbetet e pazbatueshme, për aq sa rregullimi ligjor për KMCAP nuk arrin të plotësojë kushtet e një organi *quazi* gjyqësor. Në rastet ku kundërshtohet një vendim i KMCAP Epror, sipas këtij ligji, do të zbatohet drejtpërdrejtë ky vendim i GJEDNJ-së, dhe dispozitat kushtetuese dhe ligjore të përgjithshme që garantojnë kontrollin gjyqësor mbi aktin administrativ.[133]
Zgjidhja:	Ligji duhet të parashikojë të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit Epror në gjykatën administrative.

226 Një formë tjetër e shfaqjes së këtij rreziku është edhe formulimi i përgjithshëm "ankim në gjykatë" pa treguar gjykatën kompetente ku

133 Shih paragrafin 159 të vendimit njësues të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

paraqitet ankimi, duke e treguar atë me frazën e përgjithshme "në gjykatën kompetente" apo duke treguar një gjykatë të gabuar nga pikëpamja e kompetencës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në Shqipëri, në kushtet kur sistemi gjyqësor është i organizuar në gjykata të juridiksionit të përgjithshëm dhe në gjykata administrative.

Shembull Fraza e Përgjithshme: Në ligjin nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", i ndryshuar, në nenin 34 "Afati i përfundimit të procesit", pika 2 parashikohet se "Nëse ATP-ja nuk përmbush detyrimin për të trajtuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, brenda afatit 3-vjeçar, atëherë subjektet mund t'i drejtohen gjykatës së shkallës së parë për të trajtuar kërkesën e tyre, sipas përcaktimeve të këtij ligji.".

Problemi: Mungesa e përcaktimit të qartë të gjykatës nga pikëpamja lëndore krijon probleme abuzimi dhe qartësie për qytetarët që janë përfituesit e këtyre vendimeve se pranë kujt gjykate të shkallës së parë duhet të drejtohen për të trajtuar kërkesën e tyre.

Zgjidhja: Ligji duhet të parashikojë gjykatën kompetente nga pikëpamja lëndore për trajtimin e kërkesave që lidhen me shqyrtimin e dosjeve që janë aplikuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që janë në proces shqyrtimi pranë Agjencisë.

7.3 Procedura e vlerësimit të hapësirave për korrupsion

227 Në këtë seksion jepen shpjegime mbi bazën rregullatore, institucionin përgjegjës, aktorët e tjerë që bashkëpunojnë në proces, transparencën e procesit, afatet dhe listën e kontrollit. Gjithashtu, shpjegohet edhe procedura nga pikëpamja e hartimit të projektaktit.

7.3.1 Procedura e përgjithshme

228 Siç është evidentuar në Pjesën A seksioni 4 "Statusi ligjor i vlerësimit të hapësirave për korrupsion në legjislacion", **<u>në Shqipëri nuk ka patur një</u>**

bazë ligjore të detyrueshme për vlerësimin e hapësirave për korrupsion. I vetmi dokument ligjor që përmend vlerësimin e hapësirave korruptive në legjislacion është Strategjia Kombëtare kundër Korrupsionit, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo strategji ka marrë angazhimin që vlerësimi i hapësirave korruptive të përdoret sistematikisht nga të gjitha institucionet publike që hartojnë ligje dhe akte nënligjore. Rrjedhimisht, mbetet sfidë për të ardhmen miratimi i një baze solide ligjore që të përcaktojë detyrimin për vlerësimin e hapësirave korruptive.

229 Strategjia flet për vlerësimin e hapësirave korruptive **vetëm në procesin e hartimit të ligjeve dhe të akteve nënligjore**. Ajo nuk e parashikon këtë proces për ligjet dhe aktet nënligjore tashmë të miratuara. Zgjerimi i fushës së zbatimit të vlerësimit të hapësirave korruptive, për të përfshirë edhe ligjet dhe aktet nënligjore të miratuara, mbetet sfidë për të ardhmen. Për të lehtësuar një qasje të tillë, duhet siguruar baza ligjore e përshtatshme[134] që lejon përdorimin e metodologjisë e shoqëruar me një analizë funksionale të kapaciteteve të administratës publike për të përballuar një proces të tillë, së bashku me teknikat e prioritizimit të ligjeve dhe akteve nënligjore për t'u vlerësuar.

230 Sa i takon **lëndës rregullatore** të ligjit apo akteve nënligjore, sugjerohet që ato që lidhen me të drejtën publike të jenë në fokusin e vlerësimit të hapësirave korruptive. Megjithatë, edhe ligje të të drejtës private nuk janë të përjashtuara apriori. Mund të ndodhë që këto ligje të rregullojnë liri dhe të drejta të qytetarëve apo praktika tregtare, të cilat të lënë hapësira korruptive. Prioritizimi i kuadrit ligjor që i nënshtrohet vlerësimit të hapësirave korruptive duhet bërë nga Koordinatori Kombëtar Antikorrupsion (Ministri i Drejtësisë), që duhet të bashkëpunojë me ministrinë përgjegjëse, por duke treguar kujdes edhe për çështjet e ngritura dhe shqetësuese në publik.

231 Në kushtet e mungesës së një baze solide ligjore, duket që institucioni përgjegjës më i përshtatshëm për të kryer vlerësimin e hapësirave për korrupsion është Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.[135] Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave që

134 Mënyra më e saktë për të arritur këtë qëllim është hartimi dhe miratimi i një ligji të posaçëm me këtë lëndë, megjithatë nuk përjashtohet edhe mënyra e hartimit të akteve nënligjore të ekzekutivit, që urdhërojnë apo udhëzojnë administratën publike të veprojë sipas përgjegjësive sektoriale.

135 Ky rol i Ministrisë së Drejtësisë është përcaktuar fillimisht me vendimin nr. 506, datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë" dhe më pas me vendimin nr. 606, datë 20.10.2021 "të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë"

ka përcaktuar fushën e përgjegjësisë së Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, konstatohet se ai ka të drejtën e bashkërendimit të punës për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Megjithatë duhet bërë kujdes. Vlerësimi i hapësirave korruptive ka një fushë zbatimi më të gjerë: ajo nuk zbatohet vetëm mbi ligjet që në mënyrë specifike luftojnë korrupsionin, por mbi ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë kryesisht çështje të administrimit të pushtetit në raport me qytetarët.

232 Me qëllim forcimin e kapaciteteve është e rëndësishme që përgjegjësia për zbatimin e kësaj metodologjie të mos ndryshojë shpesh në të ardhmen sepse vetëm në këtë mënyrë krijohet traditë, uniformitet dhe përvoja e duhur. Është e kështillueshme që Ministria e Drejtësisë në strukturën e drejtorisë së kodifikimit të dedikojë një njësi përgjegjëse me ekspertë që përdorin këtë metodologji. Duke iu referuar studimit krahasues të vitit 2014, konstatohet se shumica e 13 vendeve të analizuara që përdorin metodologji të tilla, kanë siguruar mbështetje në nivel ligjor[136], duke garantuar në këtë mënyrë edhe qëndrueshmërinë e strukturës shtetërore përgjegjëse për përdorimin e këtij Manuali.

233 Një çështje shumë e rëndësishme është **konsultimi publik dhe roli që mund të luajë shoqëria civile** në vlerësimin e hapësirave korruptive. (shih Pjesa C seksioni 1.3 të këtij Manuali). Kuadri ligjor për konsultimin publik vendos rregulla të detyrueshme për publikimin online të projektakteve ligjore dhe nënligjore normative.

234 Sa i takon **fazave të procesit** ku duhet përdorur vlerësimi i hapësirave korruptive, rekomandohet që çdo institucion publik që harton ligje apo akte nënligjore normative, duhet ta përdorë vlerësimin e hapësirave korruptive që në fillim të procesit. Pas hartimit të versionit fillestar të projektaktin, Ministria përgjegjëse zhvillon procesin e bashkërendimit me ministritë dhe institucionet e tjera të interesuara sipas lëndës (neni 24 i ligjit nr. 9000/2003) dhe duke ia nënshtruar projektligjin procedurës së konsultimit publik (neni 6 i ligjit 146/2014). Ministritë, institucionet e interesuara dhe publiku i paraqet mendimet me shkrim, të cilat analizohen nga hartuesit e projektaktit dhe reflektohen në projektakt. Nëse hartuesit vlerësojnë se një sugjerim nuk mund të reflektohet, ata duhet

136 Vlerësim I Ligjeve Anti-korrupsion (Vlerësim i hapësirave korruptuese), Studim Krahasues dhe Metodologji, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Tilman Hoppe, Nëntor 2014, faqe 82, https://www.rcc.int/pubs/28/anti-corruption-assessment-of-laws-in-south-east-europe-corruption-proofing, vizituar për herë të fundit më 20.01.2019

të formulojnë edhe arsyen e mosreflektimit, që shënohet në relacionin shpjegues të projektaktit.

235 Sigurisht që një çështje e ndjeshme mbetet **koha/afati** që i jepet në dispozicion aktorëve të konsultuar për të dhënë mendim mbi projektligjin apo projektaktin nënligjor. Vlerësimi i hapësirave ligjore për korrupsion duhet të kryhet në të gjitha fazat e procesit legjislativ. Koha duhet të jetë e mjaftueshme për të realizuar një vlerësim serioz dhe efektiv. Në kontekstin aktual, ku vlerësimi i hapësirave korruptive ende nuk është i rregulluar në legjislacion, afati i zbatueshëm është ai 10 ditor i përcaktuar nga VKM-ja nr. 584/2003, i ndryshuar. Nga ana tjetër, në rastin e nismave që i nënshtrohen konsultimit publik mund të përdoren edhe afate më të gjata. Kështu, neni 15 i ligjit nr. 146/2015 "Për konsultimin publik" parashikon disa afate të tilla, që duken efektive: 20 ditë pune, ndërsa për akte veçanërisht komplekse afati për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve mund të zgjatet gjer në 40 ditë.[137]

236 Së fundmi, për të arritur qëllimin që synon përdorimi i metodologjisë së vlerësimit të hapësirave korruptive, sugjerohet që Ministria e Drejtësisë të marrë edhe funksionin e monitorimit të përmbushjes së rekomandimeve të raporteve të vlerësimit. Madje një qasje pozitive do të ishte edhe publikimi online i raporteve të vlerësimit të hapësirave korruptive, duke shfrytëzuar dispozitat e ligjit për konsultimin publik. Këto çështje mbeten në nivel sugjerues përderisa në Shqipëri nuk ka një bazë solide ligjore që detyron vlerësimin e hapësirave korruptive.

7.3.2 Procedura e vlerësimit

237 Duke bërë një lidhje me rreziqet për korrupsion që synohet të identifikohen, specialisti e kryen procesin në dy faza:

i) Në **fazën e parë**, hartuesi siguron mbledhjen e të dhënave të përgjithshme që lidhen kryesisht me rreziqet substanciale. Në këtë fazë, hartuesi i jep përgjigje çështjeve të mëposhtme:

- Cili është objekti i ligjit dhe fusha e zbatimit të tij në drejtim të marrëdhënieve që ai rregullon?
- A bie ligji ndesh me parimet e vlerësimit efektiv të hapësirave korruptive?

137 Për të lehtësuar vlerësimin e hapësirave korruptive nga hartuesit e ligjit, në Aneksin i të këtij Manuali është përfshirë Lista e Kontrollit të Rreziqeve Korruptive.

- A ka praktika ekzistuese korruptive që lidhen me fushën e zbatimit të ligjit?
- Nëse po, cila është skema e praktikës korruptive?
- Cilat janë momentet që shfaqet korrupsioni tek autoritetet publike që veprojnë sipas objektit dhe zbatimit të ligjit?

238 Në këtë fazë identifikohen edhe mangësitë rregullatore që lidhen me kompetencat kontradiktore, mbivendosjen e autoritetit për të zhvilluar rregullat apo për të mbikëqyrur zbatimin e tyre, mangësitë për të identifikuar një autoritet publik përgjegjës, mungesa e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes dhe mungesa e mekanizmave për t'iu drejtuar gjykatës, përcaktimi i paqartë i rolit, detyrave dhe të drejtave të zyrtarit publik; boshllëqet në ligj; rregullime konfliktuale me njëra-tjetrën; delegim i panevojshëm i autoritetit publik rregullator tek një organ tjetër dhe mungesa e transparencës së përshtatshme.

239 Për të lehtësuar këtë fazë të parë është e nevojshme të konsultohen si dokumente:

- Rezolutat e Kuvendit që lidhen me veprimtarinë e organeve të pavarura ILDKPKI, KLSH, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës. Në të ardhmen duhet të konsultohen edhe rezolutat mbi raportimin e KLGj dhe të KLP;
- Rekomandimet e nënkomiteteve BE-Shqipëri për aq sa mund te aplikohen;
- Raportet vjetore të Koordinatorit Antikorrupsion dhe planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit;
- Raportet e organizatave ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit si GRECO apo UNODC;
- Rekomandimet Vjetore drejtuar prokurorisë për luftën kundër kriminalitetit;
- Analizat e riskut të përgatitura nga institucionet publike apo organizata të tjera;
- Vendime eventuale të Gjykatës Kushtetuese, nëse lidhen me objektin dhe fushën e zbatimit të ligjit;
- Vendime eventuale të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë si dhe vendimet e Gjykatës së Lartë për unifikimin/njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore;
- Raporte të ndryshme monitorimi të kryera nga organizata të shoqërisë civile;

- Vjetarët statistikorë;
- Informacion i transmetuar nga media;
- Informacion mbi masat anti-korrupsion që shtete të tjera kanë ndërmarrë në këtë fushë në kohën e hartimit të ligjeve të ngjashme;
- Çdo informacion tjetër i nevojshëm sipas objektit dhe fushës së zbatimit të ligjit.

ii) Në **fazën e dytë**, kryhet vlerësimi përfundimtar, i cili i jep përgjigje diskrecionit të gjerë, përcaktimit të kompetencave të paqarta duke përdorur, mungesës apo rregullimit të papërshtatshëm të procedurës administrative, si dhe stilit gjuhësor.

240 Raporti përfundimtar i vlerësimit sugjerohet të ndahet në katër pjesë:

1. Analiza e formës së projektligjit apo e projekaktit nënligjor normativ;
2. Analiza e përmbajtjes së tij;
3. Të dhëna mbi riskun e korrupsionit që kanë rezultuar nga shqyrtimi i praktikave të mëparshme të vlerësimit të korrupsionit për projektakte të ngjashme;
4. Rekomandime për eleminimin apo reduktimin e rreziqeve korruptive.

241 Është e kështillueshme që rekomandimet të jenë konkrete dhe aty ku është e mundur, ato të shoqërohen edhe me shembuj ilustrues mbi rreziqet e korrupsionit, si dhe të shoqërohen me formulime konkrete për riformulimin e tekstit që kritikohet. Në këtë mënyrë, rekomandimet jo vetëm që bëhen të qarta, por edhe bëhen të pranueshme nga autori i tekstit ligjor.

Shembull

Rekomandim i përgjithshëm: "Të forcohet përgjegjshmëria e organit publik që është përgjegjës për zbatimin e këtij ligji".

Problemi: Gjuha është shumë e përgjithshme.

Zgjidhja: Të parashikohen shkeljet disiplinore të zyrtarit publik, procedura disiplinore, si dhe masat disiplinore që merren ndaj tij

8. Mjete ndihmëse për përgatitjen e projektakteve dhe kryerjen e vlerësimit

8.1 Fletorja Zyrtare

242 Krijimi i mundësisë së aksesit te tekstet autentike, zyrtare të legjislacionit në fuqi, është me rëndësi vendimtare gjatë përgatitjes së ligjeve të reja dhe kryerjes së vlerësimit të akteve ligjore. **Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë** është botimi i vetëm zyrtar në Republikën e Shqipërisë, ku botohen aktet juridike të institucioneve të Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta, LQBZ-ja,[138] si dhe ligje të veçanta përcaktojnë se cilat akte ligjore dhe akte nënligjore duhet të botohen në FZ.

243 Qendra e Botimeve Zyrtare është përgjegjëse për publikimin e versionit përfundimtar të akteve[139], pasi ato të dorëzohen zyrtarisht nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit përgjegjës për dorëzim,[140] megjithatë duhet të theksohet se kreu i institucionit përgjegjës është përfundimisht përgjegjës për dorëzimin e versionit përfundimtar të aktit për botim.[141] Qendra e Botimeve Zyrtare është në varësi të Ministrisë së Drejtësisë,[142] e cila drejton veprimtarinë e Qendrës.[143]

244 FZ-ja shtypet nga Qendra e Botimeve Zyrtare dhe është e ndaluar shtypja nga subjektet e tjera.[144] Qendra e Botimeve Zyrtare, përveç botimit të FZ-së, vë në dispozicion një version elektronik të FZ-së në faqen e saj zyrtare.[145] Për më tepër, çdo vit Qendra e Botimeve Zyrtare boton **Indeksin e Fletores Zyrtare**, i cili përfshin renditjen kronologjike të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të botuara në seritë e ndryshme të FZ-së gjatë një viti.

245 **Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian** është fletorja e botimit zyrtar të BE-së. Ajo përfshin dy seri të lidhura, Seritë L dhe Seritë C, si dhe një Seri S shtesë. FZBE-ja botohet çdo ditë në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së. Seria L përmban të gjitha rregulloret dhe direktivat e BE-së dhe akte të tjera legjislative. Seria C përmban informacione dhe njoftime. Seria C gjithashtu përfshin atë pjesë të Fletores Zyrtare, Seritë CE, e cila botohet vetëm në formë elektronike dhe përmban akte ligjore përgatitore. Ftesat publike

138 Neni 6 i LQBZ-së.
139 Neni 8(1) i LQBZ-së.
140 Neni 9(1) i LQBZ-së.
141 Neni 9(4) i LQBZ-së.
142 Neni 4(1) i LQBZ-së.
143 Neni 6(14) i LMD-së.
144 Neni 6(4) i LQBZ-së.
145 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.qbz.gov.al/eli/fz

për tender publikohen në Serinë S. Një përmbledhje gjashtë mujore, me dy vëllime të së drejtës në fuqi të Komunitetit shoqëron Fletoren Zyrtare. Vëllimi i parë përmban një indeks sistematik, ndërsa vëllimi i dytë një regjistër kronologjik dhe alfabetik. Të gjitha botimet e FZBE-së janë aksesueshme në faqen e internetit,[146] si dhe Përmbledhja e Legjislacionit në Fuqi e Bashkimit Europian.

8.2 Bazat e të dhënave

246 Është e pamundur në ditët e sotme përgatitja dhe vlerësimi i akteve legjislative pa u mbështetur në mjetet elektronike ndihmëse. Çdo akt legjislativ - akt ligjor ose nënligjor - duhet të përshtatet plotësisht në sistemin ligjor ekzistues. Strukturat që merren me hartimin dhe vlerësimin e legjislacionit duhet të jenë në gjendje të zbulojnë informacione mbi legjislacionin kombëtar në fuqi. Vetëm kështu do të jetë e mundur shmangia e rregullimeve të padëshirueshme, të përsëritura, të paqarta dhe përdorimit gjuhësor jo të qëndrueshëm. Dhe, jo më pak e rëndësishmja, mjetet elektronike ndihmëse mund të përdoren si bazë për formulimin e formulave ndryshuese të sakta.

247 Mjeti më i rëndësishëm gjatë hartimit të legjislacionit është **Arkivi Elektronik i Akteve**, i cili administrohet nga Qendra e Botimeve Zyrtare dhe mund të aksesohet përmes shiritit të kërkimit në faqen zyrtare të internetit të Qendrës së Botimeve Zyrtare.[147]

248 Arkivi Elektronik i Akteve është baza elektronike e të dhënave ku ngarkohen për t'u pasqyruar online FZ-ja, në version elektronik, aktet e botueshme, aktet e përditësuara, përmbledhëset e legjislacionit.[148] Në Arkivin Elektronik të Akteve botohen të gjitha aktet e botueshme, së bashku me të gjitha ndryshimet e pësuara pas miratimit të tyre. Kur akti i botuar pëson ndryshime pas miratimit, Qendra e Botimeve Zyrtare, gjatë botimit të aktit ndryshues në Arkivin Elektronik të Akteve përditëson aktin bazë me këto ndryshime. Në Arkivin Elektronik të Akteve botohet, në çdo rast, akti i përditësuar.[149]

249 Për më tepër, Kuvendi mban **Librarinë e Akteve** që mund të aksesohet përmes faqes së saj zyrtare[150] dhe që përfshin të gjitha ligjet, vendimet,

146 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.eur-lex.europa.eu
147 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.qbz.gov.al
148 Neni 3(2) i LQBZ-së.
149 Neni 14(4) i LQBZ-së.
150 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.parlament.al/librariaakteve

rezolutat dhe deklaratat që janë miratuar nga seanca plenare e Kuvendit. Për më tepër, përmes faqes zyrtare të Kuvendit, mund të aksesohet **Indeksi i Projektligjeve**[151], përfshirë informacionin për projektligjet që janë miratuar ose që aktualisht janë në procedurë, siç janë statusi i miratimit, teksti i projektligjit të depozituar, relacioni shpjegues, raportet e komisioneve parlamentare të ngarkuara për dhënie mendimi dhe i Komisionit përgjegjës, procesverbalet e mbledhjeve, votimi i deputetëve, teksti i aktit ligjor ekzistues që ndryshohet, teksti i aktit ligjor të miratuar, sipas rastit. Ky burim është i paçmueshëm për hartuesit për të kuptuar sfondin se si projektaktet kanë ndryshuar gjatë diskutimeve në Kuvend, si dhe qëllimin e ligjvënësit për çështjet konkrete.

250 Bazat e të dhënave krijojnë shumë mundësi që janë domethënëse në shumë aspekte kur bëhet fjalë për hartimin e akteve juridike. Ato e bëjnë më të lehtë qasjen e shpejtë në informacion se si të citohet saktë një ligj ose një akt nënligjor. Kur planifikohen ndryshimet, është e mundur të kontrollohet nëse formula ndryshuese i referohet vendit të duhur në tekstin e dispozitës që duhet të ndryshohet. Është e mundur të bëhet një hulumtim i gjerë për të konstatuar dispozitat e rëndësishme në lidhje me çështje të caktuara. Në këtë rast, mund të shihen edhe aspekte të tjera, të tilla si data e miratimit ose e hyrjes në fuqi. Një kërkim i bazuar në termat përkatës siç janë, për shembull, "kërkues", "konsumator" dhe "ndërmarrje" është gjithashtu i mundur, duke bërë të mundur që këto terma të përdoren në mënyrë uniformë.

251 Bazat e të dhënave mund të përdoren gjithashtu për të përcaktuar se cilat dispozita ligjore përmbajnë një autorizim për nxjerrjen e akteve nënligjore ose cilat akte nënligjore bazohen në dispozitat ligjore autorizuese përkatëse.

252 Baza e të dhënave e **Librarisë Ligjore**,[152] e cila është botuar nga INTECH +, është një tjetër burim i vlefshëm pasi ka një koleksion gjithëpërfshirës të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ofron mundësi të thelluara të kërkimit, lidhur me formulimet aktuale të pothuajse të të gjithë ligjeve dhe akteve nënligjore falas si dhe të statusit të tyre.

253 Informacione të mëtejshme të rëndësishme për hartuesit, veçanërisht duke pasur parasysh procesin e përafrimit të legjislacionit të brendshëm

151 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.parlament.al/projektligje/indexlist
152 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.ligjet.org

me *acquis-në* e BE-së, janë në dispozicion përmes **EUR-Lex**, një shërbim i ofruar nga Zyra Evropiane e Publikimeve.[153] EUR-Lex përmban ndër të tjera, të drejtën e BE-së, referencat e botimit të dispozitave zbatuese në legjislacionin e brendshëm të Shteteve Anëtare, dokumente mbi punën legjislative përgatitore, pyetjet parlamentare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe Gjykatës Evropiane të Shkallës së parë. Po kështu, është e mundur të kryhet një kërkim paralel duke kaluar midis versioneve të gjuhës që janë të disponueshme. EUR-Lex gjithashtu ofron qasje në FZBE-së, Seritë L dhe C, që nga viti 1998 e në vijim.

254 Vendimet e dhëna nga gjykatat e zakonshme janë gjithashtu të aksesueshme në faqen e internetit[154] për shumë gjykata të shkallës së parë dhe të apelit, vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë mund të aksesohen përmes faqes zyrtare të kësaj Gjykate[155], ndërsa vendimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese publikohen në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të Gjykatës.[156]

8.3 Mjete të tjera

255 Strukturat që merren me shqyrtimin e legjislacionit mund të përdorin mjete të tjera të vlefshme gjatë procesit të përgatitjes së projektakteve dhe kryerjes së vlerësimit të legjislacionit, veçanërisht për qëllime të referencave të kryqëzuara ose analizave se cilat dispozita janë të rëndësishme në lidhje me çështje të caktuara. Këtu mund të përmendim **përmbledhëset e legjislacionit**, të cilat publikohen në mënyrë periodike nga Qendra e Botimeve Zyrtare[157] dhe përmbajnë një përmbledhje të të gjithë ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi që i përkasin një fushë të veçantë të së drejtës (si p.sh. për arsimin, për mjedisin, për koncesionet, për drejtësisë penale, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë etj.) në kohën e publikimit. Për më tepër, përmbledhëset e legjislacionit botohen edhe nga botues privatë si AlbJuris.

256 Përveç kësaj, gjatë hartimit ose vlerësimit të akteve juridike, mund të përdoren edhe botimet akademike në këtë drejtim, ku **revistat juridike** janë veçanërisht të dobishme për të kuptuar debatet dhe qasjet aktuale për çështje juridike konkrete. Burime të tilla mund të përmendim, ndër të

153 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.eur-lex.europa.eu
154 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.gjykata.gov.al
155 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.gjykataelarte.gov.al
156 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php
157 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: https://qbz.gov.al/publications/summaries

tjera, revistën juridike të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës ose Universitetit Luarasi, revistën "Jus&Justicia" të Universitetit Evropian të Tiranës. Revista të tjera të rëndësishme janë "Revista Avokatia",[158] një botim periodik prej nëntë vjetësh i Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë dhe "Revista Jeta Juridike"[159], një botim tremujor i Shkollës së Magjistraturës, të cilat synojnë nxitjen e diskutimit ligjor në baza praktike dhe teorike, si dhe sigurimin e informacionit për risitë në legjislacion dhe analiza nga një këndvështrim krahasues.

257 Përdorimi i terminologjisë së duhur dhe të qëndrueshme është thelbësor në lidhje me transparencën, sigurinë juridike dhe qartësinë, dhe si i tillë kujdes i duhur duhet të tregohet edhe gjatë procesit të harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis* e BE-së. Për këtë qëllim, një mjet i dobishëm mund të jetë **Manuali për Përkthimin e Legjislacionit Shqiptar në Anglisht**,[160] botuar në vitin 2011 nga Ministria e Integrimit Europian me mbështetjen teknike të projektit SMEI, për të ndihmuar të gjithë ata persona që merren me përkthimin e normave juridike nga gjuha shqipe në anglisht si dhe anasjelltas.

258 **Libraria e Legjislacionit Shqiptar**, e administruar nga projekti EURALIUS,[161] është një burim i vlefshëm për gjetjen e përkthimeve jozyrtare në anglisht të shumë ligjeve dhe akteve nënligjore shqiptare kryesisht në fushën e drejtësisë dhe pronës. Sidoqoftë, duhet të theksohet se këto materiale përbëjnë përkthime jozyrtare ose konsolidime që ofrohen vetëm për qëllime informacioni. Teksti jozyrtar nuk ofron të drejta dhe nuk imponon detyrime përveç atyre të dhëna ose të vendosura nga legjislacioni i miratuar dhe botuar zyrtarisht në gjuhën shqipe. Në rast se është e nevojshme të konsultohet përkthimi zyrtar i legjislacionit, duhet të kërkohen përkthimet zyrtare të përgatitura nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë.

158 Versioni i fundit mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.avokatia.al
159 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: www.magjistratura.edu.al/84-numrat-e-revistes-ne-vite.html
160 Versioni elektronik mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/8-Manual-p%C3%ABr-perkthimin-e-legjislacionit-shqiptar-ne-anglisht.pdf
161 Mund të vizitohet në faqen zyrtare si vijon: https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation

Pjesa C

Rekomandime të përgjithshme për hartimin e legjislacionit

1. Procesi i hartimit të legjislacionit

1.1 Hapat paraprakë për hartimin e legjislacionit

259 Nevoja për ndërhyrje legjislative mund të lindë për shumë arsye të ndryshme. Nevoja për të ndryshuar legjislacionin ekzistues mund të bëhet e dukshme përgjatë zbatimit të tij ose në rastet kur debati publik midis grupeve të interesit dhe institucioneve politike mund të çojë në një vendim për të bërë ndërhyrjen.[162]

260 Para fillimit të procesit të hartimit të projektaktit, strukturat teknike në bashkërendim me strukturën juridike, bëjnë **vlerësimin paraprak** të nismës për propozimin e projektaktit ku përfshihen, ndërmjet të tjerave, shpjegime lidhur me:[163]

- qëllimin e projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen;
- përputhshmërinë me programin politik dhe me programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, si dhe me strategjitë e programet e miratuara mbi drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore;
- pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi;
- parashikimet dhe masat, që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e projektaktit;
- shpenzimet buxhetore dhe efektet financiare të pritshme;
- ndikimet ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore të pritshme.

261 Për më tepër, gjatë procesit të vlerësimit të nevojës për ndërhyrje legjislative, strukturat teknike mund të konsiderojnë të dobishme marrjen

162 Udhërrëfyesi i procesit të hartimit të legjislacionit gjendet bashkangjitur si Shtojca B e këtij Manuali.
163 Paragrafi 12 i RKM-së.

në konsideratë të listës së mëposhtme të çështjeve të përgjithshme që duhet të identifikohen dhe të adresohen:[164]

- A është përcaktuar saktë problemi?
- A është i justifikuar veprimi i qeverisë?
- A është rregullimi forma më e mirë e veprimit të qeverisë?
- A ekziston një bazë ligjore për rregullim?
- Cili është niveli (ose nivelet) i duhur i qeverisë për këtë veprim?
- A i justifikojnë kostot përfitimet e rregullimit?
- A është transparente shpërndarja e efekteve në të gjithë shoqërinë?
- A kanë pasur mundësi të paraqesin pikëpamjet e tyre të gjitha palët e interesuara?
- Si do të arrihet pajtueshmëria?

262 Në praktikë, ky lloj vlerësimi paraprak, si dhe adresimi i çështjeve të mësipërme, materializohet në relacionin shpjegues të projektaktit, që hartohet nga struktura përgjegjëse e projektaktit, si dhe në RVN.

263 Që nga viti 2018,[165] procesi i vlerësimit paraprak të nevojës, alternativave dhe mënyrës së ndërhyrjes legjislative bëhet edhe nëpërmjet përgatitjes së RVN-së[166] gjatë procesit të vlerësimit së ndërhyrjes. RVN-ja është një metodë analitike e zhvilluar vitet e fundit në shumë vende të tjera në Evropë, SHBA dhe Kanada. Kjo metodë përdoret për përmirësimin e cilësisë së legjislacionit, në drejtim të efikasitetit, efektivitetit dhe ndikimit në shoqëri pas miratimit të tij.

264 RVN-ja përbën një pjesë integrale të procesit legjislativ. Nëse një problematikë e caktuar nuk analizohet në të gjithë përbërësit e tij, analizë e cila sigurohet nga kjo metodë, qartësia e dispozitave që eventualisht mund të rregullojnë atë problem mund të kompromotohet, duke ndikuar në zbatimin e tyre.

265 Vlerësimi i Ndikimit është një mjet i njohur ndërkombëtarisht dhe shumë i rëndësishëm që kontribuon jo vetëm në procesin e hartimit por edhe në atë të zbatimit dhe monitorimit të legjislacionit të miratuar. Vlerësimi paraprak lehtëson në mënyrë të ndjeshme vlerësimin e mëpasshëm. Sa

164 Pyetjet bazohen në Rekomandimin e vitit 1995 të Këshillit të OECD-së për Përmirësimin e Cilësisë së Qeverisjes siç është riformuluar dhe përditësuar në Udhëzimet e OECD-së për Cilësinë dhe Performancën Rregullatore të vitit 2005, të cilat hartuesi mund t'i konsultojë në faqen e internetit të OECD-së: www.oecd.org

165 Pika 16 e RKM-së.

166 Modeli i një Raporti të Vlerësimit të Ndikimit mund të gjendet si Shtojca F e këtij Manuali.

më i qartë dhe i diferencuar të jetë vlerësimi paraprak, aq më e lehtë do të jetë që të ndërmerret një analizë e besueshme pas miratimit dhe zbatimit të ligjit. Nga ana tjetër, vlerësimi i mirë i mëpasshëm ndihmon për krijimin e një baze më të qëndrueshme për vlerësimin paraprak të ligjeve që mund të miratohen në të njëjtën fushë, pasi ofron të dhëna të dobishme në këtë drejtim për krahasime ose analogji si dhe për të kuptuar në thelb nevojën për ndërhyrje apo identifikuar zgjidhje të përshtatshme, duke mundësuar që efektet e legjislacionit të ardhshëm të përcaktohen më mirë. Për këtë arsye, autoritetet publike duhet t'i kushtojnë të njëjtën vëmendje të dy llojeve të vlerësimit.

266 Vlerësimi i ndikimit shqyrton çështjet e politikës/legjislacionit të propozuar si dhe zgjidhjet e problematikave të ndryshme, të cilat trajtojnë pyetjet në vijim:

- Cila është politika apo problemi që po shqyrtohet?
- Cilat grupe ndikohen nga politika apo problemi?
- Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?
- Çfarë opsionesh po shqyrtohen?
- Cilat janë përfitimet, kostot dhe risqet e pritshme të secilit opsion?
- Cili është opsioni i preferuar dhe pse – cilat rrethana e mbështesin atë?
- Si do të zbatohet opsioni i preferuar?
- Si do të monitorohen dhe do të vlerësohen efektet e ndryshimeve të politikave pas zbatimit?[167]

267 Për më tepër, duhet të tregohet kujdes për të shqyrtuar përvojat e krahasueshme në vendet e tjera kur vendoset për një nismë të re legjislative. Sidoqoftë, përvoja e vendeve të tjera mund të mos merret si e dhënë dhe legjislacioni i vendeve të ndryshme duhet të analizohet dhe të krahasohet me njëri-tjetrin, duke marrë parasysh kontekstin shoqëror ku vepron legjislacioni i huaj dhe shkaqet që sollën atë pjesë të legjislacionit në vendin e huaj në raport me kushtet dhe rrethanat specifike të realitetit shqiptar. Aplikimi i një modeli të huaj ose i një metode ligjore të rregullimit të huaj pa marrë parasysh rrethanat vendase mund të çojë në një zgjidhje juridike të gabuar. Edhe pse modelet e huazuara nga vendet e tjera kanë rëndësinë e tyre, implementimi i ligjeve të huaja apo krijimi i organeve të ngjashme duhet të bëhet gjithmonë në përputhje me rendin

167 Për më shumë shih Metodologjinë e Vlerësimit të Ndikimit, të përgatitur nga Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore në Kryeministri, me mbështetjen e projektit SIGMA, prill 2018.

tonë juridik dhe kushtetues.[168]

268 RVN-ja hartohet nga strukturat përgjegjëse në bashkërendim me strukturën juridike të institucionit përkatës dhe u dërgohet për mendim institucioneve të interesuara si pjesë e dokumentacionit shoqërues të projektaktit.[169] Forma dhe përmbajtja e RVN-së është e përcaktuar në RKM, si shtojcë e kësaj të fundit, dhe duhet respektuar nga institucioni propozues i nismës, në të kundërt Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave vendos kthimin e projektaktit ministrit propozues.[170]

269 Vlerësimi i ndikimit duhet të fillojë në fazën më të hershme të mundshme të procesit të zhvillimit të politikave/legjislacionit, pasi ai është i projektuar për të ndihmuar vendimmarrësit të vendosin nëse duhet ndërmarrë një politikë/projektakt/rregullim i caktuar apo jo. Kjo duhet të përfshijë të gjitha propozimet e politikave dhe idetë fillestare në lidhje me ndërhyrjen e qeverisë që është vlerësuar për t'u kryer në strategjitë e ndryshme sektoriale, dokumentet apo në programet e politikave.[171]

270 Mbështetur në vlerësimin paraprak të projektaktit, ministri cakton me urdhër të veçantë çështjet që duhen rregulluar, format e pjesëmarrjes dhe hapat kryesorë të realizimit dhe bashkërendimit të procesit legjislativ, afatet përkatëse për realizimin e tyre, strukturat përgjegjëse, si dhe burimet njerëzore dhe materiale që ngarkohen të bashkëpunojnë me strukturën juridike për hartimin e çdo projektakti.[172]

1.2 Hartimi i legjislacionit brenda administratës ose nga grupet e punës me ekspertë

271 Administrata shtetërore, përgjithësisht, e kryen vetë hartimin paraprak të projektaktit pa pjesëmarrjen e ekspertëve të jashtëm në rastet kur ajo ka burimet e nevojshme njerëzore dhe kur çështja që do të rregullojë projektligji nuk kërkon përdorimin e burimeve apo njohurive nga jashtë.

272 Në përputhje me këtë, projektligjet që, nga pikëpamja faktike dhe politike, konsiderohen të thjeshta, përgatiten vetëm në ministrinë ose ministritë përgjegjëse. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe kur rrethanat e kërkojnë

168 Shih vendimin nr. 43, datë 26.6.2015 të GJK-së.
169 Pika 18 e RKM-së.
170 Pika 47(b) e RKM-së.
171 Për më shumë shih Metodologjinë e Vlerësimit të Ndikimit, të përgatitur nga Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore në Kryeministri, me mbështetjen e SIGMA-s, prill 2018.
172 Pika 13 e RKM-së.

këtë gjë, për shembull kur legjislacioni është urgjent.

273 Nga pikëpamja praktike, projektaktet hartohen nën përgjegjësinë e strukturës juridike të ministrisë përgjegjëse. Struktura juridike, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse dhe ato të fushave përkatëse të ministrisë, mund të organizojë këshillime me drejtues a specialistë të drejtorive, sektorëve a enteve, si dhe me struktura të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave lidhet me objektin, qëllimin dhe zbatimin e projektaktit.[173]

274 Për përgatitjen e projektakteve, struktura juridike mund të kërkojë mendimin e ekspertëve të tjerë, brenda ose jashtë ministrisë.[174] Për më tepër, grupet e punës të ekspertëve, të cilat mund të përfshijnë persona nga jashtë administratës, ngrihen kur fusha që mbulon legjislacioni i propozuar është e gjerë ose kur legjislacioni synon të vendosë ose të ndryshojë parime themelore.

275 **Grupi i punës** ngrihet me urdhër të Kryeministrit ose të ministrit përgjegjës. Akti që krijon grupin e punës duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- Detyrat e grupit të punës dhe periudhën brenda së cilës ato do të kryhen;
- Anëtarët e grupit të punës, duke identifikuar në mënyrë specifike kryetarin dhe nënkryetarin e grupit;
- Detyrimet dhe procedurat e raportimit për informimin e publikut të gjerë;
- Çështje në lidhje me të drejtën e autorit të materialeve të përgatitura nga grupi i punës;
- Kërkesat e sekretit profesional;
- Marrëdhëniet midis grupit të punës dhe organizatave të tjera;
- Caktimin e sekretariatit;
- Buxhetin, veçanërisht, për detyra specifike dhe zëra të tjerë të rëndësishëm të shpenzimeve;
- Detyrat e administratës për të siguruar informacion për grupin e punës.

276 Përveç përfaqësuesve të ministrive të tjera dhe autoriteteve të tjera me interes të drejtpërdrejtë, në grupin e punës mund të përfshihen si anëtarë (ose, kur lejohet, si të ftuar) politikanë dhe ekspertë, duke përfshirë ekspertë të huaj të çështjes në fjalë. Ekspertët mund të vijnë nga struktura të tjera si: universitetet, gjyqësori, si dhe nga organizatat private.

173 Pika 14 e RKM-së.
174 Pika 15 e RKM-së.

277 Anëtarët e grupit të punës duhet të zgjidhen në bazë të njohurive për çështjen, prirjes për të punuar në ekip dhe gatishmërisë. Grupi i punës duhet të sigurojë në masën e mundshme përfaqësim të barabartë të gjinive, krahinave, grupmoshave, komunitetit shkencor dhe personave aktivë në fushën në fjalë. Grupi i punës mund të ketë në përbërje edhe anëtarë që përfaqësojnë disiplinat kryesore të lidhura me aktivitetet e parashikuara në projektligj, me qëllim që të inkurajohet një qasje ndërdisiplinore.

278 Grupi i punës mund të përdorë mënyra alternative për të angazhuar ata që kanë njohuri të posaçme të çështjes ose që kanë të ngjarë të preken nga legjislacioni i propozuar. Kështu, grupi i punës mund të takohet me ekspertë, për shembull për të diskutuar çështje të veçanta në hollësi. Komentet e ekspertëve mund të kërkohen kur grupi i punës ka hartuar propozimet e tij. Në mënyrë të ngjashme, mund të konsultohen përfaqësues të institucioneve të tjera në baza *ad hoc*, të cilët nuk janë anëtarë të grupit.

279 Sekretariati i një grupi pune duhet të sigurohet nga ministria përgjegjëse për projektin legjislativ. Këto funksione normalisht drejtohen nga personi përgjegjës për projektin. Funksionet e sekretariatit përfshijnë:

- mbajtjen e një liste të anëtarëve të grupit të punës (emri, detyra, autoriteti/organizata, profesioni, të dhënat e kontaktit);
- hartimin dhe mbajtjen e procesverbaleve të takimeve dhe vendimeve të grupit të punës;
- hartimin e dokumenteve të punës që paraqesin, ndër të tjera, gjendjen fillestare, përparësitë dhe disavantazhet e alternativave të ndryshme dhe hartimin e dokumenteve të tjera që mundësojnë punimet e grupit të punës;
- kryerjen e detyrave të tjera që kërkohen nga grupi i punës.

280 Grupi i punës raporton tek autoriteti që e ka ngritur atë, zakonisht pranë ministrit përgjegjës. Megjithatë, mund të parashikohet një shkallë pavarësie nga ministri duke detyruar grupin e punës të raportojë drejtpërdrejt në kabinetin e Kryeministrit.

281 Në bazë të raportit, institucioni përgjegjës vendos për procedurat vijuese në lidhje me projektin legjislativ, si dhe nëse raporti i grupit të punës duhet publikuar ose jo.

1.3 Konsultimi

282 Ministria që merr iniciativën për propozimin e një akti ligjor duhet të dërgojë projektaktin së bashku me relacionin shpjegues për objektin, qëllimin dhe përmbajtjen e projektaktit te ministritë dhe institucionet e tjera të interesuara.[175]

283 Ministria përgjegjëse është e detyruar të paraqesë projektaktin te Ministria e Drejtësisë për të marrë mendim mbi ligjshmërinë e formës dhe përmbajtjes së ligjit, me përjashtim të akteve me karakter individual.[176]

284 Projektaktet me implikime ekonomike apo financiare duhet të dërgohen edhe në ministritë përgjegjëse për financat dhe ekonominë.[177] Projektaktet duhen dërguar edhe në ministrinë përgjegjëse për integrimin Evropian, e cila ka detyrimin që të vlerësojë përputhshmërinë e tyre me *acquis* e BE-së.[178]

285 Për të promovuar një vendimmarrje të hapur, transparente dhe demokratike, është e rëndësishme që projektaktet të konsultohen me grupet e interesit, subjektet e përfshira drejtpërdrejt apo indirekt në fushën e zbatimit të tyre, ekspertë apo profesionistë të fushës së rregullimit të projektaktit. [179]

286 Me qëllim garantimin e transparencës dhe një qasje të gjerë të publikut mbi legjislacionin, në kuadër të zbatimit të LNJKP-së, nga ana e autoriteteve publike synohet të garantohet pjesëmarrja e publikut në procesin e hartimit dhe miratimit të legjislacionit.[180]

287 Konsultimi i jashtëm luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e cilësisë teknike të legjislacionit. Për shkak të diversitetit në rritje të proceseve shoqërore dhe ekonomike, kuadri ligjor rregullator përkatës po bëhet vazhdimisht më kompleks. Legjislatori përballet me rreziqe gjithnjë e më

175 Neni 24(1) i LKM-së.
176 Neni 24(2) i LKM-së.
177 Pika 23 e RKM-së.
178 Pika 25 e RKM-së.
179 Në këtë drejtim, Rekomandimi i Këshillit të Europës Nr. R (2002) 2 për qasjen në dokumente zyrtare nënvizon se *"Autoritetet publike duhet të angazhohen për zhvillimin e një politike aktive të komunikimit, me qëllim të vënies në dispozicion të publikut të çdo informacioni që konsiderohet i dobishëm në një shoqëri demokratike transparente." Parimi XI i Rekomandimit përcakton, veçanërisht, se "një autoritet publik, me iniciativën e tij dhe kur është e përshtatshme, duhet të marrë masat e nevojshme për të bërë publike informacione të cilat i posedon kur dhënia e një informacioni të tillë është në interes të promovimit të transparencës së administratës publike dhe efikasitetit brenda administratës ose inkurajon pjesëmarrjen e informuar të publikut në çështje me interes publik.".*
180 Neni 8 i LNJKP-së.

të mëdha të gabimeve ose llogarive të gabuara në hartimin e normave ligjore. Konsultimi me palët e interesuara gjatë procesit legjislativ është një mënyrë e dukshme për përballimin e këtij problemi.

288 Palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik janë:[181]

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
- personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Personat e tjerë të huaj mund të marrin pjesë në procesin e konsultimit, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ose me kërkesë të drejtpërdrejtë të organeve publike, kur e çmojnë të nevojshme.

289 Njoftimi për projektaktet që do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet përmes regjistrit elektronik, i cili është i aksesueshëm tek www.konsultimipublik.gov.al.[182] Organi publik, në raste të veçanta, mund të mbledhë informacione ose opinione paraprake nga grupet e interesit përpara se të nisë procesin e hartimit të aktit përkatës.[183] Në të kundërt, konsultimi publik mund të ndërmerret pas përfundimit të projektaktit nga strukturat përkatëse dhe para dërgimit në Këshillin e Ministrave.

290 Palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë organit publik vendimmarrës komentet dhe rekomandimet e tyre:[184]

- brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak;
- brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik;
- deri në 40 ditë pune nga data e njoftimit për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme.

291 Komentet e parashtruara si rezultat i konsultimit duhet të analizohen në mënyrë të kujdesshme. Komentet e bëra mund të jenë tepër të vlefshme për përmirësimin e një projektakti, veçanërisht kur ato lidhen me përmbajtjen e një teksti ligjor të propozuar.

181 Neni 8 i LNJKP-së.
182 Neni 11(1) i LNJKP-së.
183 Neni 12(1) i LNJKP-së.
184 Neni 15 i LNJKP-së.

292 Në vlerësimin e komenteve është e nevojshme të merret në konsideratë fizibiliteti objektiv i propozimeve të bëra; si qëndrojnë këto propozime në lidhje me propozimet e tjera të parashtruara dhe sa e lehtë do të ishte përfshirja e tyre në strukturën e propozuar të projektligjit. Mund të jetë gjithashtu me vend që të mbahen parasysh kualifikimet dhe eksperienca, statusi i përfaqësimit dhe ndonjë motivim tjetër i dukshëm i autorit të komenteve.

293 Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve kryhet nga organi publik përgjegjës për hartimin e projektaktit, i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara të konsultuara.[185] Projektaktet shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuara, sipas dispozitave të këtij ligji. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë organi publik paraqet një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre në një nga format e njoftimit, që parashikon LNJKP-ja.[186]

2. Përdorimi i gjuhës

2.1 Qartësia dhe fjalori juridik

294 Disiplina akademike e gjuhësisë vlerëson kuptueshmërinë e një teksti duke përdorur dimensionet e thjeshtësisë, shkurtësisë, koncizitetit, strukturës dhe organizimit. Këto dimensione mund të zbatohen edhe në gjuhën e legjislacionit. Tri aspekte janë të rëndësishme kur bëhet fjalë për të shkruar tekste të kuptueshme ose për t'i përmirësuar ato nga ana stilistikore, përkatësisht zgjedhja e fjalëve, struktura e fjalive dhe struktura e tekstit.

295 Gjuha e përdorur në tekstet rregullatore duhet të jetë e saktë dhe, për aq sa është e mundur, e kuptueshme për të gjithë. Atyre, që u është besuar detyra e hartimit të akteve juridike, duhet të gjejnë ekuilibrin e duhur midis përdorimit të gjuhës, e cila duhet të jetë sa më precize të jetë e mundur, duke pasur parasysh lëndën që do të rregullohet dhe qëllimin e legjislacionit. Të gjithë ata që preken nga një rregullim i posaçëm duhet të jenë në gjendje të kuptojnë se cila është situata juridike pa pasur nevojë të kërkojnë këshilla juridike dhe më pas të veprojnë në përputhje me rrethanat.

185 Neni 19(2) i LNJKP-së.
186 Neni 19(3) i LNJKP-së.

296 Ajo që nënkuptohet me "të gjithë" varet nga grupi i njerëzve të cilëve legjislacioni u imponon detyrime ose u jep të drejta. Legjislacioni i cili adreson një grup të gjerë të synuar dhe në këtë mënyrë, në fakt, "të gjithë", siç është Kodi Penal, duhet të jetë i kuptueshëm për këdo me inteligjencë mesatare.

297 Në rastin e legjislacionit që adreson një grup të kufizuar të synuar, "të gjithë" do t'i referohet kryesisht atyre që punojnë në një fushë ligjore specifike (p.sh. tregtarëve në rastin e Kodit Civil ose gjyqtarëve në rastin e ligjit për pushtetin gjyqësor). Në raste të tilla, organi ligjvënës mund të supozojë se subjektet, të cilave u drejtohet legjislacioni, kanë ekspertizën e nevojshme. Njerëzit e zakonshëm duhet të paktën të jenë në gjendje të kuptojnë thelbin e përgjithshëm të qëllimit të legjislacionit në fjalë.

298 Një karakteristikë specifike e fjalorit ligjor është se përdor terma që, formalisht, janë identikë me ato të përdorur në gjuhën e përditshme, por që kanë një kuptim të ndryshëm në një kontekst juridik. Fjalë të tilla si "kryesisht" dhe "posedojnë", për shembull, përdoren ndryshe në një kontekst juridik sesa në përdorimin e përditshëm, domethënë ato janë terma juridikë të specializuar.

299 Kur rregullohen çështje në një fushë të caktuar të specializuar, duhet të tregohet kujdes kur përdoret terminologjia e posaçme e disponueshme në atë fushë. Terminologjia e specializuar duhet të përdoret vetëm kur nuk ka perifrazime të përgjithshme ose kur perifrazime të tilla do të rrisnin në mënyrë disproporcionale gjatësinë e një dispozite të veçantë. Për shembull, rregullimet në lidhje me përbërësit e ushqimit ose procedurat e prodhimit mund të përdorin terminologjinë e prodhuesve të ushqimit të cilët duhet t'u përmbahen atyre rregullimeve.

300 Për të siguruar që publiku i gjerë nuk arrin të kuptojë si duhet ose mund të keqkuptojë një tekst ligjor, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë terminologjisë së përdorur gjatë shkrimit të ligjeve dhe akteve nënligjore. Përkufizimet mund të përdoren kur termat kanë një kuptim të ndryshëm nga përdorimi në gjuhën e përditshme ose kur kuptimi fillestar i termave jepet nga ligjvënësi. Në të kundërt, përkufizimi nuk duhet të përfshihet kur përdoret një term i cili tashmë është krijuar (dhe përdoret në ligje të tjera). Kjo shmang përsëritjet e tepërta dhe konfuze.

Shembull
Neni 3 (a) i ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti

"Ndihmë juridike" është shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara në këtë ligj, për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat garantohen dhe financohen nga shteti.

Ky përkufizim vlen për të gjithë sistemin ligjor, përveç nëse organi ligjvënës shprehimisht përcakton një përkufizim tjetër në një ligj tjetër.

301 Ndonjëherë, fjalët kanë kuptime të ndryshme në varësi të kontekstit rregullator. Si të tillë, termat duhet të kontrollohen me kujdes për të parë nëse ato kanë kuptime të ndryshme dhe nëse janë përdorur siç duhet. Përdorimi i termit në disa kuptime krijon vështirësi në kuptimin e tekstit pavarësisht se vetë termi është lehtësisht i kuptueshëm. Termi, i cili tashmë është përdorur më parë në një kontekst juridik, nuk duhet t'i atribuohet një kuptimi tjetër, nëse nuk ka asnjë arsye për ta bërë këtë. Në këtë rast, krijimi i një termi të ri do të ishte zgjidhja më e mirë.

302 Përdorimi i terminologjisë së specializuar duhet të planifikohet me kujdes: së pari, duhet sqaruar se cilat terma të specializuar janë aktualisht në përdorim në tekste të tjera ligjore ose nëse termat e rinj janë të nevojshëm të krijohen dhe çfarë ato duhet të referojnë. Lidhja midis këtyre termave duhet të qartësohet - ndoshta me ndihmën e një skice të thjeshtë që përcakton marrëdhëniet midis tyre. Kjo mund të përdoret si bazë për të vendosur se cilët terma duhet të përdoren. Termat nuk duhet të jenë të paqartë dhe të përdoren në mënyrë të njëtrajtshme.

2.2 Kuptueshmëria

303 Saktësia dhe qartësia janë veçanërisht të rëndësishme në tekstet ligjore. Shprehja e normave juridike në mënyrë të saktë dhe të qartë, në mënyrë që ato të kuptohen nga publiku i gjerë, kërkon një punë të madhe përgatitore - e cila kërkon kohë dhe përpjekje.

Duhet të gjenden:

- fjalët e duhura,
- fjalitë e duhura, dhe
- ekuilibri i duhur midis saktësisë dhe kuptueshmërisë.

304 Rregullat e mëposhtme përgjithësisht të zbatueshme do të ndihmojnë në

shkrimin e teksteve të cilat lexuesit e kanë të lehtë për t'i kuptuar:

- Çfarë doni të thoni?
- Mbështetini idetë në fjalët kyçe
  - Shkruani fjalë kyçe ose paraqisni një strukturë për të ilustruar se cilat marrëdhënie duhet të sqarohen dhe cilat shkaqe apo rrethana sjellin pasoja juridike.

Pastaj përgatisni projektin tuaj të parë dhe më pas lexojeni përsëri me sy kritik:

- A ka ndonjë mënyrë më të mirë për të thënë diçka?

Kontrolloni zgjedhjen tuaj të fjalëve dhe strukturën e fjalive

- Përdorni fjali të shkurtra. Një ide = një fjali.
- Vendoseni rregullin kryesor në fjalinë kryesore.
- Nëse është e mundur, përdorni vetëm një fjali kryesore dhe jo më shumë se një fjali të varur.
- Vendosni rregullin kryesor në fillim të fjalisë.
- Përdorni më shumë shprehje foljore sesa shprehje emërore.
- Shmangni përcaktorët e gjatë, veçanërisht strukturat e gjata me pjesore. Në vend të kësaj, përdorni fjali lidhore.
- Shmangni diatezën pësore; në vend të kësaj përdorni diatezën veprore.

Bjerini shkurt

- Shmangni përdorimin e fjalëve të pakuptimta ose që nuk përdoren në kuptimin e duhur.
- Përdorni fjalë të shkurtra.

305 Kujdes i veçantë duhet të tregohet gjatë hartimit të akteve juridike të reja. Dispozitat ekzistuese duhet të rishikohen nëse ato janë të paqarta dhe shfaqin vështirësi në zbatimin e tyre. Sidoqoftë, me të gjitha përpjekjet për të siguruar që rregullimet të shkruhen në mënyrë që ato të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe të sakta, kuptueshmëria nuk duhet të arrihet në dëm të saktësisë së përmbajtjes ligjore.

306 Nëse një tekst ligjor është i vështirë për t'u kuptuar, kjo ndonjëherë mund të kompensohet nga materiali shoqërues, për shembull relacioni shpjegues, shënimet sqaruese në faqen e internetit të një ministrie ose broshurat që

përmbajnë shpjegime dhe shembuj praktikë. Në raste të tilla, përparësi duhet t'i jepet kuptueshmërisë së përgjithshme përkundrejt saktësisë.

2.3 Gjatësia dhe struktura e fjalisë

307 Fjalitë e shkurtra janë më të lehta për t'u kuptuar sesa fjalitë e gjata. Kujtesa afatshkurtër e një personi mesatar nuk mund të përpunojë fjali që përmbajnë më shumë se shtatë kundrinorë ose 22 fjalë. Nëse duhet të shkruani fjali më të gjata, kini kujdes t'i strukturoni ato qartë.

308 Propozimet e rëndësishme duhet të vendosen në vendin gramatikisht më të rëndësishëm në një fjali (p.sh. kryefjalë ose kundrinor). Kjo shpesh mund të nënkuptojë vendosjen e kallëzuesit sa më parë në fjali. Fjalitë e varura, kur është e mundur, duhet të vendosen pas kallëzuesit në fjalinë kryesore.

309 Një fjali, kur është e mundur, duhet të përmbajë vetëm një veprim. Fjalitë e gjata dhe të ndërlikuara që përmbajnë një fjali kryesore dhe disa fjali të varura duhet të ndahen në disa fjali kryesore ose fjali më të shkurtra.

Shembull
Mos shkruani: "Pagesa kalimtare paguhet për periudhën në të cilën nëpunësit civilë kanë qenë në detyrën nga e cila janë larguar, të paktën për kohëzgjatjen e gjashtë muajve dhe jo më shumë se tre vjet.".

Por shkruani: "Pagesa kalimtare paguhet pas largimit nga detyra për periudhën në të cilën nëpunësi civil ishte në detyrën e tij të fundit. Kjo periudhë është jo më pak se gjashtë muaj dhe jo më shumë se tre vjet."

310 Fjalitë nuk duhet të mbingarkohen me shumë fjalë. Fjalitë që përmbajnë shumë parafjalë të rasës gjinore ose emërore duhen riformuluar.

Shembull
Mos shkruani: "... që mundësia e shfaqjes së një ngjarje të siguruar është e përjashtuar."

Por shkruani: "... që ngjarja e siguruar nuk mund të ndodhë më."

311 Është e mundur të shmanget përsëritja e emrave, për shembull duke përdorur përemra si "ky", "ai/ajo" dhe "që", nëse këta përcaktohen qartë.

Shembull
Neni 3 (3) i ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare

Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

312 Elementet shpjeguese të paraqitura nga "për shembull", "në veçanti" dhe "mbi të gjitha" duhet të vendosen në një fjali të veçantë, pasi në të kundërt do ta bënin fjalinë shumë të gjatë.

Shembull
Mos shkruani: "Fondet e sigurimeve të kujdesit afatgjatë informojnë dhe këshillojnë personat e siguruar dhe të afërmit e tyre në lidhje me çështjet që lidhen me nevojën e kujdesit afatgjatë, veçanërisht në lidhje me shërbimet e ofruara nga fondet e sigurimeve të kujdesit afatgjatë dhe shërbimet dhe ndihma e dhënë nga organizata të tjera."

Por shkruani: "Fondet e sigurimeve të kujdesit afatgjatë informojnë dhe këshillojnë personat e siguruar dhe të afërmit e tyre për çështje që lidhen me nevojën e tyre për kujdes afatgjatë. Këto, në veçanti, përfshijnë pyetje në lidhje me shërbimet e ofruara nga fondet e sigurimeve të kujdesit afatgjatë, si dhe shërbime dhe ndihmë të ofruar nga organizata të tjera."

313 Në varësi të faktit nëse kallëzuesi është shprehur në diatezën veprore apo pësore, theksi do të vendoset tek ata që kryejnë veprimin ose tek "objekti i veprimit".

Prandaj, diatezat veprore duhet të përdoren aty ku është e nevojshme, për arsye të sigurisë juridike, për të përcaktuar qartë se kush ka vepruar ose kush kërkohet të veprojë. Diateza veprore duhet të përdoret edhe për shkak se në rast të kundërt referenca tek personi që vepron do të duhej të shtohej duke përdorur "nga", duke krijuar struktura të ndërlikuara të fjalive.

Shembull
Mos shkruani: "Auditi i lartë i çdo departamenti emërohet nga Komisioneri."

Por shkruani: "Komisioneri emëron auditin e lartë të çdo departamenti."

Shmangni, si rregull, diatezën pësore sa herë që të jetë e mundur. Sidoqoftë, strukturat pësore janë shpesh më të shkurtra, pasi ato nuk përmbajnë asnjë referencë tek personi që kryen veprimin.

2.4 Stili rrëfyes

314 Stili rrëfyes është një teknikë e dobishme (sidomos brenda për brenda nenit) për të krijuar një rend logjik, duke shmangur referencat e brendshme dhe përsëritjet, për efekt të thjeshtësisë së gjuhës dhe si rrjedhim për të hartuar një tekst që është më i lehtë për t'u kuptuar nga lexuesi. Një shembull i përdorueshmërisë së stilit rrëfyes është si më poshtë vijon:

Stili referues:

"1. Personi mund të bëjë kërkesë në Ministri për licencë.

2. Kërkesa sipas pikës 1 bëhet në tri kopje.

3. Nëse personi që bën kërkesën sipas pikës 1 është nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, kërkesa bëhet në katër kopje."

Stili rrëfyes:

"1. Personi mund të bëjë kërkesë në Ministri për licencë.

2. Kërkesa bëhet në tri kopje.

3. Nëse personi është nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, kërkesa bëhet në katër kopje".

2.5 Zgjedhja e fjalëve dhe njëtrajtshmëria

315 Zgjidhni fjalët bashkëkohore dhe i përdorni ato në kuptimin e tyre të zakonshëm dhe kryesor. Megjithatë nuk duhen përdorur fjalë apo shprehje informale. Gjuha ligjore kërkon një shkallë të caktuar formaliteti. Duhet të shmanget përdorimi i fjalëve arkaike të cilat nuk përdoren shpesh apo nuk kuptohen apo i neologjizmave të cilat nuk janë bërë ende pjesë e përdorimit të përditshëm të gjuhës shqipe. Kur ka një shkak të veçantë për moszbatimin e këtyre rregullave, atëherë fjalët duhet të përkufizohen (shiko Pjesën D nënseksionin 4.6).

316 Në tekstin ligjor, i njëjti koncept duhet të shprehet kudo me të njëjtat fjalë të cilat nuk duhen përdorur për dy ose më shumë koncepte të ndryshme.

Fjalët duhet të përdoren me atë kuptim që përkon me përdorimin e tyre në pjesë të tjera të ligjit. Kjo praktikë bën që të shmangen pasiguria ligjore, paqartësitë e tekstit dhe mundësitë e keqinterpretimit. Hartuesi duhet të shikojë të gjithë legjislacionin ekzistues të fushës përkatëse para se të fillojë punën hartuese në mënyrë që të sigurojë përdorimin konsistent të terminologjisë.

2.6 Fjalët dhe shprehjet e huaja

317 Fjalët dhe shprehjet me origjinë të huaj duhet të shmangen nëse në gjuhën shqipe ka një shprehje të përshtatshme gjerësisht të përdorur. Fjalët dhe shprehjet e huaja mund të përdoren vetëm nëse ato janë pranuar në përdorimin e përditshëm të gjuhës shqipe dhe për to nuk ka fjalë tjetër në gjuhën shqipe.

318 Për arsye gjuhësore, mund të përdoren fjalë të huaja kur fjalët dhe shprehjet janë të njohura dhe gjerësisht të përdorura nga personat të cilëve u drejtohet ligji edhe pse jo nga publiku i gjerë. I tillë mund të jetë rasti kur përdoren terma teknikë.

319 Fjalët dhe shprehjet e huaja mund të përdoren edhe kur ato përbëjnë një mjet të njohur dhe të përshtatshëm për shprehjen e një koncepti në mënyrë të qartë dhe të shkurtër (për shembull emrat shkencorë në latinisht). Në të gjitha rastet, kur përdoren fjalë ose shprehje të huaja, ato duhet të shkruhen me shkronja kursive.

320 Gjithashtu, mund të përdoren fjalë apo shprehje të huaja (ndoshta të kombinuara me ekuivalenten në shqip) për të siguruar përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare apo me *acquis* e BE-së.

2.7 Shprehjet latine

321 Përdorimi i maksimave dhe shprehjeve latine në tekstet e akteve juridike duhet të shmanget sa më shumë që të jetë e mundur. Në këto raste duhet të përdoret termi ekuivalent i tyre në gjuhën shqipe. Disa nga termat më të zakonshëm dhe ekuivalentët e tyre, janë si më poshtë:

Latinisht	Shqip
mutatis mutandis	me ndryshimet përkatëse
ex lege	për shkak të ligjit
ex officio	kryesisht

a priori	paraprak
a posteriori	pasues
bona fide	mirëbesim
de facto	sipas faktit
de jure	sipas ligjit
ex tunc	që nga fillimi
ex nunc	që nga ky moment
ex aequo et bono	sipas ekitesë[187] dhe së mirës publike
ex proprio motu	me iniciativë vetjake

2.8 Shprehjet teknike

322 Me përjashtim të rasteve kur shprehjet bëjnë pjesë në gjuhën e zakonshme profesionale të personave të cilëve u drejtohet ligji (d.m.th., shprehje të krijuara dhe të përdorura kryesisht në fusha të kufizuara), ato duhet të shmangen sa më shumë të jetë e mundur. Në qoftë se shprehje të tilla përdoren në një akt ligjor me zbatim më të gjerë, ato duhet të përkufizohen qartë.

2.9 Përsëritjet

323 Nenet e tekstit ligjor janë, sigurisht nga pikëpamja gramatikore, në njëfarë mënyre të pavarura. Përemrat dhe mbiemrat duhet të përdoren me kujdes; përemrat që u referohen termave të përdorur më parë në nene të tjera nuk duhen përdorur. Ndonjëherë do të jetë e nevojshme që të përsëriten fjalët e përdorura në nenet e tjera.

324 Megjithatë, brenda një neni të vetëm hartuesi duhet të marrë në konsideratë përdorimin e stilit rrëfyes për të thjeshtuar tekstin dhe për ta bërë atë më të kuptueshëm për përdoruesin, kur kjo mund të bëhet pa krijuar paqartësi (shih nënseksionin 2.1).

2.10 Numrat

325 Numrat duhet të shkruhen edhe me shkronja kur përdoren në tekstin e ligjit, por në tabela, formula matematike ose në kontekste të tjera për të cilat ka praktikë të njohur, duhet të përdoren shifra.

187 Parim i njohur në rendin juridik shqiptar me vendimin nr. 15 datë 15.04.2010 të GJK-së.

2.11 Datat

326 Emri i muajit shkruhet me shkronja dhe elementet e tjera të datës shkruhen me numra arabë. Viti gjithmonë duhet shkruar në formën e plotë katërshifrore. Vini re se sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, shkronjat e para të muajve nuk shkruhen me shkronja të mëdha.

2.12 Gjuha neutrale përkundrejt gjinisë

327 Kur dispozitat ligjore u referohen njerëzve, format gramatikore mashkullore përdoren në mënyrë konvencionale të përgjithësuar (mashkullore përgjithësuese), duke përfshirë të dy gjinitë. Gjithsesi, mbështetur në parimin e barazisë gjinore (siç përcaktohet në nenin 18 të Kushtetutës), dispozitat ligjore duhet si rregull i përgjithshëm t'i referohen të dy gjinive.

328 Një renditje e emrave dhe përemrave që i përkasin gjinisë mashkullore mund të krijojë përshtypjen sikur ato nuk u referohen grave ose thjesht nënkuptohen. Barazia gjinore gjuhësore në legjislacion synon të adresojë drejtpërdrejt gratë, pasi ato ndikohen në mënyrë të barabartë nga legjislacioni. Megjithatë, barazia gjinore gjuhësore duhet të jetë në përpjesëtim me nevojën për të siguruar kuptueshmërinë ose qartësinë e normave ligjore. Nëse është e mundur, teksti i legjislacionit duhet të hartohet me terminologji asnjanëse përsa i përket gjinisë, duke përdorur terma me gjini asnjanëse.

2.13 Gjuha politikisht asnjanëse

329 Legjislacioni duhet të hartohet me një gjuhë politikisht asnjanëse. Aktet ligjore të tilla shkaktojnë më pak kundërshtime politike të panevojshme dhe në disa raste mund të rrisin shkallën e pranimit të legjislacionit nga publiku.

2.14 Njëjësi dhe shumësi

330 Në hartimin e legjislacionit, kudo që të jetë e mundur, rekomandohet të përdoret njëjësi në vend të shumësit me qëllim që të shmanget dykuptimësia e panevojshme.

Shembull
Mos shkruani: "Ministri përcakton procedurat për llojet e ankimeve që parashikohen në këtë dispozitë."

Por shkruani: "Ministri përcakton procedurën për çdo lloj ankimi që parashikohet në këtë dispozitë."

331 Në rastin e parë, forma e shumësit do të linte pa përgjigje pyetjen nëse ministri duhet të përcaktojë një procedurë të ndryshme për secilin ankim, apo duhet të përcaktojë një procedurë të vetme për të gjitha llojet e ankimeve, apo është në dorën e ministrit të përcaktojë një apo disa procedura. Rasti i dytë është shumë i qartë: çdo lloj ankimi duhet të ketë procedurën e vet.

3.15 Kohët e foljes

332 Ligjet duhet të hartohen në kohën e tashme.

Shembull
Mos shkruani: "Çdo anije para hyrjes në port do të paraqesë para drejtuesit të portit këto dokumente...".

Por shkruani: "Çdo anije para hyrjes në port paraqet para drejtuesit të portit këto dokumente...".

333 Nëse është e nevojshme që ligji të shprehë lidhjen kohore të fakteve, faktet që ndodhin njëkohësisht me veprimin e ligjit duhet të shkruhen në kohën e tashme dhe faktet që paraprijnë veprimin e ligjit në kohën e shkuar.

334 Nëse është e nevojshme që të përmenden ngjarje të së shkuarës dhe të së ardhmes, kjo duhet bërë duke iu referuar kohës kur ligji miratohet apo kur hyn në fuqi, dhe duke përdorur kohën e tashme kur u referohemi fakteve që ndodhin njëkohësisht me veprimin e ligjit.

2.16 Mënyrat e foljes

335 Ligjet duhet të hartohen në mënyrën dëftore dhe jo në mënyrën urdhërore ose lidhore. Përdorimi i mënyrës dëftore i shërben qartësisë sepse kjo lloj mënyre është treguese e informacionit.

Shembull
Mos shkruani: "Asnjë person nuk duhet të ketë të drejtë...";

Por shkruani: "Asnjë person nuk ka të drejtë";

Mos shkuani: "Nëse do të përcaktohej se ..."

Por shkruani: "Nëse përcaktohet se ..."

2.17 Lidhëzat

336 Lidhëza "dhe" përdoret për të bashkërenduar dy pjesë të një fjalie.

Shembull
Bulevardet dhe rrugët shënohen me tabela.

337 Lidhëza "ose" përdoret për të veçuar ose për të treguar alternativat.

Shembull
Rrugët mund të tregohen me tabela rrethore **ose** katrore.

338 Një formulë hyrëse mund të përdoret për të treguar raportin mes fjalëve, shprehjeve ose nënparagrafëve. Formula të tilla mund të jenë "një (cilado) prej mënyrave që vijojnë" ose "të gjitha mënyrat e mëposhtme". Megjithatë, ligjet shqiptare përdorin më shpesh lidhëzat ndërmjet dy fjalive të fundit, sikurse u shpjegua më lart, për të treguar marrëdhëniet midis fjalëve, shprehjeve ose nënparagrafëve.

2.18 Emrat e prejardhur nga foljet

339 Përdorimi i emrave që vijnë nga foljet duhet shmangur kur mund të përdoren foljet.

Shembull 1
Mos shkruani: "Personi mund të bëjë kërkesë..".

Por shkruani: " Personi mund të kërkojë...".

Shembull 2
Mos shkruani: "Ministri hyn në konsultim me ...".

Por shkruani: "Ministri konsultohet me..."

2.19 Foljet modale

340 Duhet treguar kujdes që foljet modale të përdoren gjithmonë në mënyrë konsistente në varësi të faktit nëse ato tregojnë një urdhër apo lejojnë diçka. Përkatësisht, përdoret zakonisht folja gjysmëndihmëse me vlerë modale

"duhet" e cila vendoset përpara një foljeje tjetër për të plotësuar kuptimin e kësaj të fundit, ndërsa folja "mund" ka një kuptim më diskrecionar. Përdorimi jo i saktë nga pikëpamja gramatikore apo jo në mënyrë të njëllojtë i këtyre foljeve shkakton paqartësi në lidhje me karakterin lejues apo urdhërues të dispozitës.

341 Folja "duhet" mund t'i japë kuptime të ndryshme foljes që e shoqëron atë në varësi të fjalisë. Ajo mund ta paraqesë atë që shpreh folja si të detyrueshme, si të nevojshme apo si të domosdoshme. Por ajo mund t'i japë foljes që e shoqëron edhe kuptime të tjera si "ka shumë mundësi, ka shumë të ngjarë, mundet". Këto raste nuk tregojnë detyrim për kryerjen e një veprimi. Për të shmangur këtë paqartësi rekomandohet që, kur është e mundur, të shmanget përdorimi i foljes "duhet".

2.20 Shenjat e pikësimit

342 Është praktikë e mirë e hartimit të legjislacionit të mos mbështetesh në shenjat e pikësimit për të shprehur kuptimin e tekstit ligjor. Nëse kuptimi i ligjit mbështetet vetëm tek shenjat e pikësimit, një gabim i këtyre shenjave ose mosvendosja e një shenje të saktë pikësimi mund të krijojë pasoja ligjore të mëdha. Shenjat e pikësimit duhet të përdoren vetëm për ta përforcuar kuptimin. Kur hartuesi është mbështetur tek shenjat e pikësimit për të shprehur kuptimin do t'i duhet të rishqyrtojë gjatësinë dhe strukturën e fjalisë, rendin e fjalëve dhe të përpiqet të ndryshojë këta elementë për të dhënë kuptimin më qartë.

343 Shenjat e pikësimit përdoren në legjislacion si më poshtë:

- pika (".") përdoret në kuptimin e saj të zakonshëm sintaksor dhe veçanërisht në fund të neneve, paragrafëve dhe të nënparagrafit të fundit;
- presja (",") përdoret në kuptimin e saj të zakonshëm sintaksor;
- dy pika (":") përdoret në kuptimin e tyre të zakonshëm sintaksor dhe veçanërisht pas pjesës hyrëse të një paragrafi;
- pikëpresja (";") përdoret në kuptimin e saj të zakonshëm sintaksor dhe veçanërisht për ndarjen e nënparagrafëve;
- nuk duhet të përdoret pikëpyetja ("?") ose pikëçuditësja ("!");
- thonjëzat ("...") përdoren në kuptimin e tyre të zakonshëm sintaksor dhe veçanërisht për termat e përkufizuar dhe futjen e një teksti të ri nëpërmjet akteve ndryshuese;

- vija lidhëse ("-") përdoret veçanërisht për të lidhur fjalët e përbëra, për shembull, "njëri-tjetrin" (hartuesi duhet të ndjekë praktikën gjuhësore të përdorimit të vizës ndarëse në fjalët e përbëra);
- kllapat e rrumbullakëta ose kllapat ("(...)") dhe kllapat katrore ("[...]") duhet të shmangen;
- shenja e përqindjes ("%") mund të përdoret sipas nevojës, veçanërisht në tabela, ndërsa në tekst duhet të përdoret fjala "përqind" me shkronja;
- nuk duhet të përdoret shenja e paragrafit ("§").

2.21 Shkrimet fundore

344 Shkrimet fundore duhet të shmangen si rregull gjatë hartimit të legjislacionit. Sidoqoftë, duhet të theksohet se një përjashtim është shënimi i CELEX-it i cili nuk është pjesë e tekstit dhe që përdoret për të përcaktuar akte të *acquis-së* së BE-së që përafrohen nga projektakti përkatës.

345 Gjithashtu, për akte nënligjore shumë teknike që u referohen parimeve komplekse ose kur është e nevojshme që të jepen udhëzime dhe sqarime, mund të përdoren shkrimet fundore, për aq kohë sa bëhet e qartë se ato kanë rol informues dhe *si të tilla* nuk janë pjesë e tekstit të aktit nënligjor.

2.22 Shkurtimet

346 Shkurtimet nuk duhet të përdoren në tekstin kryesor të dispozitave ligjore. Prandaj, termat si "për shembull" dhe "i ndryshuar" duhet të shkruhen të plota.

347 Vetëm disa përjashtime nga ky rregull janë të lejueshme. Për shembull, shkurtimet e paracaktuara të Fletores Zyrtare ose Buletinit Zyrtar të Njoftimeve përdoren kur citohet referenca e publikimit.

348 Emrat e përveçëm dhe përcaktimet e tjera zyrtare që përfshijnë shkurtime mund të përdoren gjithashtu në një dispozitë. Përdorimi i shkurtimeve në tabela, skica ose formula shpesh e bën prezantimin më të mirë.

349 Kur në tekstin e ligjit është e nevojshme të përsëritet një shprehje e caktuar, shkurtimi mund të përdoret me kusht që të shpjegohet në rastin kur përdoret për herë të parë, duke shtuar një shprehje të përshtatshme si për shembull:

"më poshtë referohet si " (*shkurtimi*) ""

Kjo teknikë mund të përdoret kur koncepti për të cilin do të përdoret shkurtimi shfaqet në fillim të tekstit.

350 Përndryshe, përkufizimi i shkurtimit mund të jetë zgjidhja më e mirë.

Shembull
"ASCAL" nënkupton Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.

Kurdoherë që shkurtimet përdoren, duhet të merren shkurtimet ose simbolet zyrtare të përdorura zakonisht.

351 Kur krijohen shkurtime të reja për përdorim ekskluziv në një dispozitë specifike (aneks, tabelë, formulë), ato duhet të përbëhen nga elementë individualë të trajtës së plotë. Kur shkurtime të tilla mbarojnë me një shkronjë të madhe (siç është përdorimi i "DNJF" për "Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas") ato shkruhen pa pikë në fund.

3. Referencat

352 Referencat përdoren në rastet kur teksti i aktit i referohet:

- një parashikimi në të njëjtin akt (referencë e brendshme) ose
- një parashikimi në një akt tjetër (referencë e jashtme).

Referencat e hapura, si rregull i përgjithshëm, duhet të shmangen sepse vijnë në kundërshtim me parimin kushtetues të sigurisë juridike.[188]

3.1 Referencat e brendshme

353 Referencat e brendshme vendosen kur fjalia e përmendur është në një pjesë tjetër të të njëjtit akt. Hartuesi duhet të vendosë nëse referenca e brendshme lehtëson në fakt kuptimin e dispozitës apo nëse është më mirë të riformulohet dispozita.

354 Referenca e brendshme duhet të përcaktojë nenin e saktë, paragrafin ose nënparagrafin tek i cili bëhet referenca, duke filluar nga pjesa më e

188 Në vende të tjera europiane, përdorimi i referencave të hapura është konstatuar si jokushtetues nga Gjykatat Kushtetuese përkatëse (shih për shembull çështjen gjermane BVerG 21.9,2016, 2 BVL/15 ose çështjen austriake Vfslg 16999/2003, ku Gjykata Kushtetuese Austriake sqaroi se ky parim është i zbatueshëm edhe për referencat ndaj akteve ligjore të BE-së).

vogël përbërëse e dispozitës që referohet. Në raste të rralla mund të jetë e nevojshme që të bëhet referenca tek një kre i tërë ose pjesë tjetër e ligjit. Referenca të tilla janë të përshtatshme vetëm në qoftë se ajo ka të bëjë me të gjitha dispozitat e kreut ose pjesës dhe duhet shmangur kur referohen vetëm disa prej dispozitave të tyre.

355 Gjithashtu duhen shmangur **referencat zinxhir**. Një referencë zinxhir ndodh kur një dispozitë i referohet një dispozite tjetër e cila nuk përmban një normë ligjore, por përkundrazi thjesht i referohet një dispozite tjetër në të njëjtin akt.

Shembull
Një referencë e nenit 3 në nenin 7, i cili përmban referencë të mëtejshme tek neni 10

356 Po kështu, **referencat rrethore** duhet të shmangen. Një referencë rrethore ndodh kur dispozita e parë i referohet një dispozite tjetër që vetë i referohet një dispozite tjetër në të njëjtin akt i cili më pas i referohet dispozitës së parë.

Shembull
Një referencë e nenit 3 në nenin 7, i cili përmban një referencë mbrapsht në nenin 3.

3.2 Referencat e jashtme

357 Legjislativi mund të përdorë tekstet ekzistuese dhe t'u referohet atyre. Referimi i kryqëzuar mund t'u referohet rregullimeve të tjera ose pjesëve të tyre. Referimi i kryqëzuar do të thotë që ato tekste të cilave u bëhet referimi (dispozitat e referuara dhe tekstet e tjera të referuara) bëhen një element i dispozitës që përmban referencën (dispozita kryesore).

358 Referimi i kryqëzuar bëhet përmes përdorimit të referencave të jashtme kur fjalia e referuar është një dispozitë e një akti tjetër të veçantë. Dallimi duhet të bëhet nga referencat me një funksion normativ dhe referencat pa një funksion normativ.[189] Referencat pa një funksion normativ nuk përdoren për integrimin e dispozitave të aktit tjetër në aktin që bën referencën, por përkundrazi për të demonstruar ose kujtuar në lidhje me një çështje që po referohet.[190]

189 Berberi, S. "Legjistika: Parime dhe rregulla për hartimin e akteve normative". Tirana: 20161. f. 132
190 Berberi, S. "Legjistika: Parime dhe rregulla për hartimin e akteve normative". Tirana: 2016. f. 133

359 Referencat me një funksion normativ ndahen në:

- referenca formale, dhe
- referenca materiale.

360 Në rastin e **referencave formale**, dispozita i referohet një akti tjetër me qëllimin që ky referim të bëhet kryesisht në burimin normativ sesa në vetë aktin, kështu që do të përfshijë të gjitha ndryshimet e mëvonshme që mund t'i bëhen aktit të përmendur.

361 Kur bëhet një referencë formale në aktin tjetër, ai akt duhet të identifikohet jo me citimin e plotë të titullit të tij, por nga lënda e titullit.

Shembull
Neni 63(1)(n) i Ligjit për noterinë

Noteri respekton detyrimet që rrjedhin nga Kodi i Punës dhe legjislacioni në fuqi për sigurimet shoqërore...

362 Referenca, kur bëhet për herë të parë te një ligj tjetër, ky i fundit duhet të identifikohet qartë duke cituar titullin e plotë, përfshirë numrin dhe datën e miratimit. Në qoftë se ai ligj është ndryshuar, referencat e jashtme nuk duhet të citojnë ligjet ndryshuese, por thjesht të tregojnë që ai është ndryshuar.

363 Në rastin e **referencave materiale**, dispozita u referohet vetë dispozitave të aktit tjetër, të cilat teorikisht bëhen pjesë e aktit që ka bërë referencën, në gjendjen që ato ishin në momentin që është bërë referenca dhe si të tilla të gjitha ndryshimet e mëvonshme nuk ndikojnë aktin që bën referencën.

364 Kur është e mundur, referencat materiale sugjerohet të shmangen, pasi është më e përshtatshme të hartohet teksti i aktit në atë mënyrë që të përfshijë vetë dispozitat pa nevojën e referencës.

365 Sidoqoftë, kur i bëhet një referencë materiale një akti tjetër, ai akt duhet të identifikohet me citimin e plotë të titullit të tij (shih pjesën 4 më poshtë), si dhe të tregojë, sipas rastit, nenin, paragrafin dhe nënparagrafin e saktë në të cilin bëhet referenca.

Shembull
Neni 4 (3) i ligjit për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Veprimtaria e këtyre subjekteve përfshihet në kategorinë XI.3 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

366 Në rast se akti i referuar është ndryshuar, referencat e jashtme nuk duhet të citojnë vetë aktin ndryshues, por thjesht të tregojnë se është bërë referencë tek një akt parësor "i ndryshuar".

367 Nëse një tekst ka referenca tek një numër i konsiderueshëm ligjesh ose aktesh nënligjore, për arsye të tjera përveç ndryshimit ose shfuqizimit të tyre, ose nëse i referohet disa herë legjislacionit specifik, për të ndihmuar përdoruesin, duhet t'i kushtohet vëmendje që secilit akt ligjor t'i jepet një përcaktim në bazë të titullit të shkurtër të aktit (shih Pjesën D nënseksioni 2.5).

Shembull
Ligji nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar (më poshtë "Ligji për shoqëritë tregtare")

368 Kjo do të lejojë që hartuesi të përdorë një stil më të rrjedhshëm në tekst, kështu "këto dispozita zbatohen për cilindo që është subjekt i ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

369 Referenca si rregull nuk duhet të bëhet në tekstin e një ligji ose akti tjetër juridik që nuk është pjesë e rendit juridik shqiptar. Sidoqoftë, në lidhje me referencat e drejtpërdrejta te Rregulloret e BE-së duhet bërë cilësimi i mëposhtëm:

- Në momentin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, referenca e drejtpërdrejtë në dispozitat konkrete të Rregullores së BE -së mund të bëhet për shkak të zbatueshmërisë së tyre të drejtpërdrejtë (shih për më tepër Pjesën F seksioni 6).
- Përpara anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, referenca e drejtpërdrejtë mund të bëhet te legjislacioni vendas që mbulon lëndën e Rregullores, por duhen krijuar mekanizma për të siguruar që në momentin e anëtarësimit legjislacioni vendas automatikisht të shfuqizohet dhe të bëhet referencë e drejtpërdrejtë në Rregulloren e BE-së (shih për më tepër Pjesën F nënseksionin 6.2).

4 Citimi i legjislacionit

4.1 Citim i Plotë

370 Kërkohen informacione të sakta që të bëhet e mundur përcaktimi i tekstit të legjislacionit dhe për të mundësuar lokalizimin e tij duke përdorur referencën e publikimit. Rregullat mbi citimin janë veçanërisht të rëndësishme kur:

- referenca bëhet në tekstin kryesor të një dispozite individuale tek një tekst tjetër (shih seksionin 3);
- referenca bëhet në fjalinë hyrëse të një akti ligjor ose nënligjor ndryshues tek akti ligjor që do të ndryshohet (shih Pjesën E nënseksioni 3.4); or
- dispozita përkatëse autorizuese citohet në dispozitën e hyrjes në fuqi të një akti nënligjor (shih pjesën G nënseksioni 3.2).

371 Ligjet dhe aktet nënligjore citohen në parim duke përdorur citimin e tyre të plotë. Citimi i plotë përfshin:

- titullin e citimit (titulli i plotë),
- datën e miratimit ose e botimit (të fundit) me tekst të plotë,
- kur është e aplikueshme, një referencë për ndryshimet.

Shembull
Ligji nr.96, datë 6.10.2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

372 Për ligjet dhe aktet nënligjore të njohura duhet të citohet vetëm titulli i citimit (shih nënseksionin 4.2). Shembuj të ligjeve të njohura janë Kushtetuta, Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Familjes. Në rastin e ligjeve ose akteve nënligjore që do të lexohen nga grupe njerëzish të veçantë, referencat brenda së njëjtës sferë juridike, për shembull, mund të përdorin më mirë titullin e citimit sesa citimin e plotë.

4.2 Titulli i citimit

373 Titulli i citimit të një ligji ose një akti nënligjor është përcaktimi i tij, d.m.th. titulli pa asnjë shkurtim. Një shkurtim nuk përfshihet asnjëherë në citimin e plotë ose të përdoret në tekstin e ligjit (mos shkruani "Neni 3 i KPP-së" por shkruani "Neni 3 i Kodit të Procedurës Penale").

374 Nëse titulli është **ndryshuar**, ligji ose akti nënligjor citohet gjithmonë duke përdorur titullin e ri. Ndryshimet në titullin e citimit nuk do të kenë asnjë rëndësi kur citohet data e miratimit ose të botimit pasi këto informacione nuk ndryshojnë.

375 Nëse rregullimi i parë ligjor ose nënligjor që duhet të citohet është akt gjithëpërfshirës që ndryshon disa akte, citohet vetëm titulli i citimit të aktit parësor, jo ai i aktit "gjithëpërfshirës" (për më shumë informacion mbi aktet gjithëpërfshirëse shih Pjesën E Seksioni 9).

376 Citimi i marrëveshjeve ndërkombëtare (traktate, konventa) ndjek një model të caktuar, duke përfshirë gjithnjë titullin e traktatit plus datën e miratimit të tij. Akti ligjor ose nënligjor me të cilin marrëveshja ndërkombëtare është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm duhet evidentuar në përmbajtjen e relacionit shpjegues përkatës.

4.3 Citimi i elementeve të legjislacionit

377 Dispozitat ligjore shpesh u referohen elementeve individuale të ligjeve ose akteve nënligjore, veçanërisht kur kjo është e nevojshme:

- për të bërë pjesë përmbajtjen e tyre plotësisht ose pjesërisht me anë të një reference të kryqëzuar (shih nënseksionin 3.2),
- për të përcaktuar saktësisht tekstin që do të ndryshohet në formulat ndryshuese (shih Pjesën E nënseksioni 3.5),
- për të cituar autorizimin ligjor në dispozitën e bazës ligjore të një akti nënligjor (shih Pjesën E nënseksioni 3.3).

378 Emërtimet e njësive strukturore dhe nënnjësitë e tyre shkruhen gjithmonë në mënyrë të plotë (p.sh. pjesa, titulli, kreu, seksioni, neni, paragrafi, nënparagrafi dhe nën-nënparagrafi). Duhet të theksohet se ky është stili i citimit të përdorur për referencat e brendshme në Kushtetutën tonë:[191]

> **Shembull**
> Personi të cilit i është privuar liria, sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi "c", ...[192]

379 Sidoqoftë, duhet të kihet parasysh që, në praktikë, **citimi i pjesëve** përbërëse të një neni bëhet duke u referuar atyre si "pikë" në vend të

191 Shih për shembull nenet 28(2), 83(3), 128(7), 134(2) dhe 136(5) të Kushtetutës.
192 Përshtatur nga neni 28(2) i Kushtetutës.

paragrafit, "shkronjë" në vend të nënparagrafit, dhe "nënndarje" në vend të nënnënparagrafit:

Shembull
... sipas shkronjave "b" dhe "c" të nenit 601/a të kreut II, të pjesës IV, të këtij Kodi.[193]

380 Kur citohet një varg njësish individuale, fjala "deri" duhet të shkruhet gjithmonë.

Shembull
Zbatohen nenet 8 deri 12.

381 Kur njësia strukturore e nivelit më të lartë citohet në njëjës, folja gjithashtu do të jetë në njëjës, edhe nëse njësia citohet së bashku me disa nënnjësi.

Shembull
Neni 14, pika 5 deri në pikën 7, zbatohet...

Pika 2, fjalia e parë deri tek e treta dhe e gjashta, zbatohet me ndryshimet përkatëse. Fjalia e parë, shkronjat "ç" dhe "d", zbatohet me ndryshimet përkatëse.

382 Nëse një listë e të njëjtave njësi strukturore përfshin nënnjësi individuale, lista vazhdon vetëm duke përsëritur njësinë strukturore. Ky rregull është veçanërisht i rëndësishëm në rastin e formulave ndryshuese të grupuara.

Shembull
Në nenin 1, pika 1, shkronja "d", nenin 2, pika 5, fjalia e dytë, dhe pika 6, nenin 3, pika 13, shkronja "b", dhe pika 15 dhe nenin 15, fjalët "objekti i këtij ligji" zëvendësohen me fjalën "objekt " në çdo rast.

383 Nëse brenda një citimi, njësitë strukturore janë të lidhura me lidhëzën "ose", përsëritja e njësisë së caktuar pas lidhëzës e bën më të lehtë kuptimin e fjalisë.

Shembull
Në dhënien ose refuzimin e ndihmës, sipas nenit 188 ose nenit 190 të këtij ligji, ose në ndryshimin ose ndërprerjen e ndihmës, sipas pikës 3, të këtij neni, gjykata e falimentimit përcakton se interesat

193 Përshtatur nga neni 601/a i Kodit të Procedurës Civile.

e kreditorëve e të personave të tjerë të interesuar, përfshirë edhe debitorin, janë të mbrojtur në mënyrë të përshtatshme.[194]

384 Nëse njësitë individuale të cilat janë të lidhura në një citim duke përdorur lidhëzën "ose" janë kryefjalë e fjalisë, folja do të jetë në njëjës.

Shembull
Neni 3 ose neni 6 zbatohet me ndryshimet përkatëse.

194 Përshtatur nga neni 191(1) i ligjit nr. 110/2016 "Për falimentimin".

Pjesa D
Aktet parësore

1 Vërejtje të Përgjithshme

385 Sistemi ynë kompleks i legjislacionit duhet të përshtatet vazhdimisht me zhvillimet e reja, qoftë me ndryshimin ose riorganizimin e rregullimeve ekzistuese ose krijimin e rregullave tërësisht të reja. Shpeshherë nuk është e lehtë të vendosësh kur një numër rregullimesh duhet të kombinohen për të krijuar një instrument të veçantë legjislativ. Si rregull i thjeshtë, mund të thuhet se gjithmonë ka kuptim të rregullohet një çështje lëndore duke krijuar një akt të ri parësor (siç është ligji) nëse ekziston një lidhje mjaft e ngushtë midis dispozitave ligjore të planifikuara, nëse ato mund të kufizohen mjaftueshëm nga çështje që tashmë janë rregulluar diku tjetër, ose nëse ato paraqesin interes të veçantë publik. Nëse rregullimet të cilat janë miratuar tashmë nuk duhet të përfshihen në aktin e ri parësor, atëherë duhet të konsiderohet nëse ato duhet të përshtaten ose të shfuqizohen.

386 Për më tepër, parime të caktuara themelore të hartimit të ligjit mbeten gjithmonë konstante. Njëra prej tyre është se legjislacioni duhet të jetë i njëtrajtshëm, koherent dhe i qartë. Këto kërkesa plotësohen më së miri duke aplikuar teknika legjislative të njëtrajtshme që mund të ofrojnë udhëzime të përcaktuara qartë, të qëndrueshme dhe të parashikueshme për strukturën dhe shprehjen e legjislacionit.

387 Në themel të të gjithë procesit të hartimit qëndrojnë njohuritë e mira themelore të gjuhës shqipe. Shumë gabime në hartim nuk janë veçse gabime gjuhësore ose gramatikore. Hartuesit nuk duhet të lejojnë asnjëherë teknikën legjislative ose përkthimet nga gjuhët e tjera, të errësojnë strukturën themelore dhe të qartë të gjuhës shqipe (shiko për më shumë hollësi Pjesa C, seksioni 2). Ata duhet të mendojnë me kujdes për ato që shprehin ligjet dhe sa lehtë kuptohen. Mbi të gjitha, audienca të cilës i drejtohen ligjet është publiku i gjerë. Me qëllim që publiku të lexojë një ligj lehtësisht dhe ta kuptojë atë, duke siguruar kështu kërkesat

kushtetuese të sigurisë juridike, ligji duhet të jetë i formuluar mirë në gjuhën e tyre.

388 Është qartazi e pamundur që hartuesi të adresojë dhe të parashikojë të gjitha rrethanat e ardhshme. Sidoqoftë, hartuesi duhet të shprehë idetë dhe objektivat themelorë të ligjit me një shkallë të lartë saktësie, duke siguruar në të njëjtën kohë që projekti të jetë fleksibël për t'i rezistuar kohës dhe rrethanave të paparashikueshme të së ardhmes. Sidoqoftë, ndonjëherë ndodh që ligjet të hartohen qëllimisht në mënyrë të paqartë, duke u mbështetur në zbatimin praktik të legjislacionit për t'i dhënë atyre efektin e synuar nga hartuesi. Rezultati mund të jetë se ligje të tilla thelbësore deklarative do të kenë vetëm një ndikim të vogël praktik dhe si i tillë duhet të shmanget.

2 Titulli

2.1 Rëndësia dhe pjesët përbërëse

389 Çdo akt parësor ka nevojë për një titull, i cili është pjesë e tekstit zyrtar të ligjit. Shkrimi i titullit është përgjithësisht hapi i fundit në procesin legjislativ, sepse titulli varet nga përmbajtja e ligjit. Deri në arritjen e kësaj pike, duhet të përdoret vetëm një titull pune dhe në rast se përmbajtja ndryshon, titulli i punës do të duhet të rishikohet.

390 Bëhet një dallim midis titullit të aktit dhe titullit të citimit. Titulli i citimit vijon me rregullat e përcaktuara për strukturimin në mënyrë që të sigurojë identifikimin e lehtë të burimit të cituar (për më shumë informacion, shihni Pjesën C, seksioni 4).

2.2 Titulli i plotë

391 Titulli i plotë jep informacion për nivelin hierarkik dhe përmbajtjen e ligjit. Në veçanti, shërben për ta bërë më të lehtë gjetjen e ligjit, për ta ndarë atë nga ligjet e tjera dhe për ta cituar atë (Pjesa C seksioni 4).

392 Titulli i plotë duhet të përmbajë fjalën "Ligj" për të treguar nivelin e instrumentit legjislativ. Niveli hierarkik duhet të tregohet në mënyrë që të ndahet ky lloj legjislacioni nga legjislacioni dytësor (legjislacioni i deleguar), për shembull aktet nënligjore, siç janë urdhrat.

393 Niveli hierarkik mund të përfshijë një pjesë të përmbledhjes së përmbajtjes së ligjit. Kjo është praktikë e zakonshme në rastin e akteve zbatuese dhe

prezantuese. Aktet zbatuese mund të nxirren në lidhje me traktatet ndërkombëtare.

Shembull
Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Europian Dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për Krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Europian

394 Specifikimi i nivelit hierarkik pasohet nga një **përmbledhje** e shkurtër e **përmbajtjes** së ligjit. Fjala "në lidhje me" duhet të shmanget. Në varësi të lëndës, duhet të përdoret "për".

Shembuj
Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore

Ligji për Avokaturën e Shtetit

Kur rregullohen lëndë të reja, mund të ketë kuptim të përdoret një përshkrim më i detajuar. Sidoqoftë, nuk duhet bërë asnjë përpjekje për të përsëritur përmbajtjen kryesore të ligjit në titull, pasi kjo do ta bëjë jashtëzakonisht të vështirë citimin e aktit.

Shembull jo i mirë
Ligj për përcaktimin e parimeve dhe rregullave në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Emërimeve të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës

Shembull i mirë
Ligji për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë

395 Teksti në thonjëza që përmban shpjegime ose përshkruan termat kryesorë në një fushë të veçantë ligjore duhet të shmanget në titullin e gjatë. Shtesa të tilla e bëjnë gjithashtu më të vështirë citimin e ligjit.

396 Aktet prezantuese miratohen kryesisht në lidhje me kodifikimet gjithëpërfshirëse (p.sh. Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile, Kodi Penal, Kodi

i Procedurës Penale). Në këtë rast citohet titulli i instrumentit legjislativ dhe titulli i aktit kodifikues.

Shembull
Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë

397 Nëse akti parësor ka të bëjë me të drejtën e BE-së, kjo duhet të tregohet qartë në titull[195] ose me anë të shkrimit fundor (shih Pjesën F).

2.3 Numri i aktit

398 Një nga elementët më të rëndësishëm dhe praktikë për të dalluar qartë dhe për të referuar legjislacionin është duke numërtuar aktin që është pjesë e titullit të aktit.

399 Tradicionalisht, numërtimi i akteve ishte serial dhe vazhdon nga viti në vit, gjë që çon në përdorimin e numrave pesëshifrorë, duke çuar në vështirësi në aksesimin dhe lehtësinë e përdorimit të këtij sistemi referimi.

400 Për arsyet e mësipërme, duke filluar nga 26 janari 2012, numërtimi i ligjeve dhe vendimeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë bëhet përmes një sistemi të një numri vjetor të vazhdueshëm në formatin "Ligj nr. nn/vvvv" ose "Vendimi nr. nn/vvvv".[196]

Shembull
Ligj nr. 1/2012

2.4 Data e miratimit

401 Data e miratimit tregon datën në të cilën Kuvendi ka miratuar ligjin përkatës në seancë plenare (shih Pjesën H nënseksioni 1.5). Data e miratimit të aktit mund të përfshihet si pjesë e titullit të plotë të aktit, veçanërisht si pjesë e citimit të plotë (shiko Pjesën C seksionin 4.2).

Shembull
Ligji nr. 96/2016, datë 6.10.2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

195 Po aty. f. 126.
196 Neni 1 i vendimit nr. 1/2012 të Kuvendit "Për numrin e ligjeve dhe vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë".

2.5 Shkurtimi i titullit

402 Titulli i plotë është shpesh shumë i gjatë për të qenë i përshtatshëm për t'u përdorur si titull për citimin e ligjit nga gjyqësori si dhe nga ana e praktikantëve. Për këtë arsye, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve Zyrtare duhet të pëgatisë një **Indeks të Titujve të Shkurtër** të ligjeve që janë të miratuara, e cila duhet rishikuar në mënyrë periodike dhe duhet përditësuar me ligjet e miratuara rishtazi.

403 Titulli i shkurtër është një emër i përbërë që përfshin nivelin hierarkik të ligjit dhe një term kyç ose ndonjëherë disa terma kyç.

Shembull
Ligji për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë

(Ligji për arsimin e lartë)

404 Termat kryesore të përdorur në titullin e shkurtër duhet të merren nga vetë titulli i plotë. Ata duhet të zgjidhen me kujdes. Për shembull, kur fjalët ose mbaresat e përdorura në titullin e gjatë lihen jashtë, kjo mund ta bëjë titullin e shkurtër të paqartë, megjithëse nganjëherë kjo mund të jetë më e pranueshme sesa shprehjet me fjalë të tjera.

Shembull
Ligji për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë

(Ligji për prokurorinë)

405 Titujt e shkurtër, në raste të veçanta, mund të formohen jo duke përsëritur termat kryesorë në vetë titullin e gjatë, por duke përmbledhur përmbajtjen e ligjit me anë të një fjale tjetër kyç. Kjo ka kuptim kur është zgjedhur një titull më i detajuar gjatë rregullimit të çështjeve të reja.

Shembuj
Ligj për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

(Ligji për vetingun)

Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit,

korrupsionit dhe krimeve të tjera përmes masave parandaluese kundër pasurisë

(Ligji antimafia)

406 Sidoqoftë, disavantazhi i kësaj qasje është se lidhja midis titullit të gjatë dhe titullit të shkurtër mund të mos jetë e dallueshme dhe si e tillë duhet të përdoret me kujdes.

407 Titulli i shkurtër i një akti parësor si rregull nuk duhet të përfshijë vitin. Përjashtime nga ky rregull mund të ketë në rast se ligji rregullon masa të një natyre të përsëritur të cilat janë të kufizuara në kohë. Ajo që është e veçantë në lidhje me këto ligje është që dispozitave të tyre u pushon efekti menjëherë pasi ato janë zbatuar plotësisht, por rregullime të ngjashme duhet të miratohen në mënyrë të përsëritur.

Shembull
Ligji për regjistrimin e popullsisë dhe familjeve 2020

(Ligji për regjistrimin 2020)

408 Një përjashtim tjetër është kur viti mund të jetë pjesë përbërëse e titullit të asaj që njihet si një akt parësor vjetor që rregullon çështje specifike lëndore dhe pasojat juridike për një vit kalendarik tepër specifik, për shembull aktet e buxhetit.

Shembull
Ligj për buxhetin 2020

409 Shkurtimi që përmban një bashkim shkronjash mund të zgjidhet gjithashtu për secilin ligj, në mënyrë që ta bëjë më të lehtë gjetjen e ligjit. Prandaj, kjo duhet të jetë dalluese dhe duhet të ndryshojë nga shkurtimet e të gjitha akteve parësore që janë të zbatueshme në të njëjtën kohë. Shkurtimi nuk duhet të ndryshohet për sa kohë ekziston akti parësor.

Shembull
Ligji për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë (LMD)

410 Aty ku është krijuar një titull i shkurtër së bashku me titullin e gjatë, titulli i shkurtër dhe shkurtimi vendosen pas titullit të gjatë në kllapa dhe ndahen nga një vijë ndarëse në shqip.

Shembull

Ligj për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar

(Ligji për strukturat antikorrupsion, SPAK)

411 Shkurtimi duhet të ketë ngjashmëri të mjaftueshme me titullin e citimit. Kur shkurtimet tashmë janë përdorur për fjalë të caktuara në ligje të tjera, duhet të përdoren të njëjtat shkurtime. Kur një shkurtim duhet të zgjidhet për një akt parësor të ri, duhet të shqyrtohet nëse shkurtimet specifike janë tashmë të zakonshme për fjalët që duhet të shkurtohen. Nëse po, duhet të përdoren të njëjtat shkurtime.

412 Shkurtimi duhet të përbëhet nga shkronja ose iniciale individuale jo më shumë se një rrokje. Shkurtimet nuk kanë pse të jenë të shqiptueshme si një fjalë. Nuk duhet të përdoren hapësira ose shkronja të posaçme (p.sh. vijat ndarëse).

413 Shkurtimet mund të jenë me rëndësi të veçantë për kërkimet në bazën e të dhënave dhe ndihmojnë në komunikimin në strukturat e specializuara ose në mes atyre që preken nga ligji në fjalë. Prandaj, shkurtimet duhet të koordinohen me Qendrën e Botimeve Zyrtare, e cila është përgjegjëse për Arkivin Elektronik të Akteve (shiko Pjesën B nënseksionin 4.2).

3 Baza ligjore

3.1 Rëndësia dhe statusi

414 Çdo ligj duhet të ketë një bazë ligjore. Baza ligjore tregon kush e ka miratuar ligjin dhe dëshmon për faktin se ligji është miratuar në përputhje me parimet dhe procedurat e përcaktuara në Kushtetutë.[197] Baza ligjore përmban para së gjithash informacionin që Kuvendi miratoi aktin, me shumicë të thjeshtë ose me shumicë të cilësuar dhe propozuesin e nismës ligjore që u miratua.

415 Baza ligjore vendoset poshtë titullit dhe është pjesë e tekstit të ligjit.

416 Baza ligjore është përfshirë mbi tekstin e projektaktit. Kështu, ai siguron mundësinë, gjatë procesit legjislativ, të diskutohet nëse projektakti kërkon një shumicë specifike të Kuvendit.

197 Neni 83 i Kushtetutës.

3.2 Forma të ndryshme

417 Përdoren dispozitat e mëposhtme të bazës ligjore:

- Për ligjet që kërkojnë një shumicë të thjeshtë:
  "Në mbështetje të nenit 78, të nenit 81, pika 1 dhe të nenit 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e ..., Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:"
- Për ligjet që kërkojnë shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:
  "Në mbështetje të nenit 12, pika 3 dhe të nenit 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e ..., Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:"
- Për ligjet që kërkojnë një shumicë të cilësuar:
  "Në mbështetje të nenit 81, pika 2, shkronja "..." dhe të nenit 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e ..., Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:"
- Për ligjet që ndryshojnë Kushtetutën:
  "Në mbështetje të nenit 83, pika 1 dhe të nenit 177, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e më shumë se një të pestës së anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:"

418 Në rastin e ligjeve që vijnë nga një situatë mbrojtjeje (siç parashikohet në nenin 172(2) të Kushtetutës), bazat ligjore të sipërpërmendura nuk marrin parasysh tiparet specifike të procesit legjislativ në raste të tilla, dhe prandaj mund të mos jenë të përshtatshme.

419 Duhet pasur kujdes në sigurimin e njëtrajtshmërisë në strukturimin e bazës ligjore; sidoqoftë, fraza të tjera mund të zgjidhen edhe për ligje që kanë karakteristika specifike rast pas rasti.

4 Organizimi

4.1 Struktura

420 Struktura e një akti parësor diktohet nga përmbajtja e tij. Kjo është arsyeja pse nuk është e mundur të ofrohet një model që t'u përshtatet të gjitha rasteve. Sidoqoftë, ekzistojnë disa rregulla praktike që duhen respektuar gjatë strukturimit të një projektligji:

- dispozita më të rëndësishme vijnë përpara atyre më pak të rëndësishme;
- dispozitat lëndore vijnë përpara dispozitave me natyrë procedurale;
- rregullat paraprijnë përjashtimet e tyre;

- detyrimet përcaktohen përpara sanksioneve.

421 Më konkretisht, një akt parësor ligjor do t'i përmbahej një strukturimi të dispozitave sipas rendit vijues:

- titulli;
- baza ligjore;
- preambula;
- dispozita e qëllimit të ligjit;
- dispozita e objektit të ligjit;
- dispozita e përkufizimeve;
- dispozitat për procedurat administrative;
- dispozitat lëndore;
- dispozitat e vlerësimit;
- dispozitat e delegimit;
- dispozitat e sanksioneve;
- dispozitat e shfuqizimeve;
- dispozitat me efekt ndryshues mbi akte të tjera;
- dispozitat kalimtare dhe ato të përfundimit të afatit të ligjit;
- dispozita e hyrjes në fuqi.

422 Tabelat, listat dhe shifrat, nëse është e mundur, duhet të përfshihen si shtojca për të shmangur mbingarkesën e tekstit faktik të ligjit. Ata kanë forcën e ligjit kur përmenden shprehimisht si pjesë përbërëse e tekstit të aktit.

423 Kur disa **shtojca** ndjekin tekstin e ligjit, ato duhet të jenë të numërtuara. Titulli i shtojcës duhet të krijojë qartë një lidhje me tekstin, nëse është e mundur, me dispozitën të cilës i referohet.

4.2 Preambula

424 Preambula mund të përmbajë informacion lidhur me kontekstin dhe qëllimin e hartimit të ligjit kur për shkak të rëndësisë apo historisë së hartimit të tij është e nevojshme që ky informacion t'i bëhet i ditur lexuesit.

425 Preambulat, me përjashtim të atyre që përcaktojnë bazën ligjore, janë të rralla në Shqipëri. Një nga këto raste është Kushtetuta:

'Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë,

me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit, vendosim këtë Kushtetutë:'

426 Në vend të një preambule, është e zakonshme në praktikën shqiptare të hartimit të legjislacionit që aktet parësore ligjore të fillojnë me dispozitat e qëllimit dhe të fushës së veprimit. Edhe pse kjo praktikë nuk është e detyrueshme, ajo mund të ndihmojë lexuesin, madje edhe hartuesin, për të kuptuar se çfarë synon të rregullojë ligji.

4.3 Dispozita e objektit të ligjit

427 Legjislacioni në përgjithësi përmban si fillim një dispozitë për objektin e ligjit, e cila përcakton fushën e të drejtave dhe detyrimeve, si dhe të kritereve dhe procedurave që përmban ligji.

Shembull
Neni 1 i Ligjit për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për

a) organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës;
b) zbatimin e vendimeve gjyqësore penale dhe urdhërimeve të prokurorit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, të masave të shmangies nga ndjekja penale, të dënimeve jo me burgim për të miturit, ose veprimtari të tjera sipas akteve të tjera ligjore në fuqi;
c) trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit nën mbikëqyrje për të siguruar përshtatjen dhe riintegrimin e tij në shoqëri;
ç) zbatimin e detyrimeve të personave nën mbikëqyrje gjatë kohës së vënies në provë.

4.4 Dispozita e qëllimit të ligjit

428 Dispozitat ligjore janë në thelb një varg urdhrash më tepër sesa deklarime politikash apo qëllimesh. Objektivi i ligjeve është që të autorizojë, urdhërojë ose ndalojë sjellje të caktuara që u drejtohen personave fizikë dhe juridikë të caktuar. Për këtë arsye, projektligjet nuk duhet të përmbajnë dispozita që nuk kanë karakter normativ, ose që janë thjesht deklarata në parim, ose shprehje të filozofisë mbi të cilën është mbështetur ligji.

429 Si e tillë, dispozita e qëllimit duhet të jetë e shkurtër dhe koncize dhe të sigurojë vetëm arsyet kryesore për të kërkuar iniciativën ligjore dhe parimet kryesore që mbështesin këtë iniciativë.

Shembull
Neni 2 i Ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti

Ky ligj ka si qëllim:

a) të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë;
b) të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike;
c) të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive.

430 Deklaratat e gjera të parimeve ose filozofia në mbështetje të iniciativës ligjore trajtohen më mirë në relacionin shpjegues të aktit, si dhe në shpjegimet e dhëna gjatë diskutimeve në Kuvend.

431 Sidoqoftë, dispozitat e qëllimit mund të orientojnë gjykatat dhe përdoruesit në interpretimin e dispozitave themelore të ligjit (në përputhje me rregullat e interpretimit të shtjelluara në Pjesën I të këtij Manuali).

4.5 Dispozita e fushës së zbatimit

432 Në disa ligje, në një dispozitë që vijon, vendoset fusha e zbatimit të ligjit, e cila përmban kufijtë e zbatimit të ligjit.

Shembull
Neni 3 i Ligjit për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar

1. Ky ligj zbatohet për të gjithë përkthyesit zyrtarë në rastet kur kryejnë përkthim zyrtar në territorin e Republikës e Shqipërisë.

2. Ky ligj zbatohet edhe për interpretuesit e gjuhës së shenjave ose lehtësuesit e komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur e në të dëgjuar në rastet kur caktohen nga organet proceduese, sipas legjislacionit procedural në fuqi, ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese.

4.6 Përkufizime

433 Përkufizimet japin kuptimin e termave kryesore të përdorur në tekstin e një ligji. Dispozitat e përkufizimeve vendosen në fillim të ligjit sepse është e rëndësishme që të dihet sa më parë se çfarë kuptojnë fjalët dhe shprehjet e veçanta në ligj.

434 Përkufizimet duhet të renditen sipas **rendit alfabetik** të gjuhës shqipe.

435 Përdorimi i përkufizimeve duhet të jetë i ekuilibruar. Përdorimi i tepërt i teknikës së përkufizimit mund t'ia ndërlikojë punën lexuesit. Gjithashtu, do të bëhet vështirë për lexuesit nëse fjalët dhe frazat përkufizohen jo sipas kuptimeve të tyre të zakonshme.

436 Përkufizimet përdoren për të përkufizuar dhe **nuk** duhet të përdoren për të shprehur rregullime ligjore, si në këtë shembull:

Shembull i keq
"Y" do të thotë një person që vepron në kundërshtim me rregullin X dhe ky person përjashtohet nga marrja e licencës...

437 Çdo përkufizim duhet të përmbajë një koncept ose një fjalë të vetëm. Fjalët dhe shprehjet që janë përkufizuar në ligj mund të tregohen në një mënyrë tipografike në tekstin e ligjit (qoftë me shkronja të pjerrëta, të zeza, me nënvizime etj.). Por rezultati mund të duket disi i ngatërruar, veçanërisht nëse fjala ose shprehja e përkufizuar shfaqet shpesh në të njëjtën pjesë të tekstit.

438 Ekzistojnë metoda të ndryshme për hartimin e përkufizimeve në bazë të funksionit të tyre:

- Emërtimi
- Përcaktimi

- Zgjerimi ose ngushtimi i kuptimit
- Referencat në përkufizime

439 *Emërtimi:* është përkufizimi i një koncepti ose termi i cili mund të përdoret për ta emërtuar atë me qëllim që të mos jetë e nevojshme që të përsëritet në mënyrë të mërzitshme në tekstin legjislativ.

Shembull
"Rregulloret" nënkupton Rregulloren e XYZ të vitit X.

"Ndërmarrje Shtetërore" nënkupton një ndërmarrje të ngritur në bazë të Titullit III të këtij ligji.

Lexuesin e ndihmon përdorimi i një shprehjeje e cila është deri diku përshkruese. Grupmoshat e fëmijëve që lejohen të pranohen në shkollat fillore apo të mesme nuk duhet, për shembull, të përkufizohen si "grupmoshat përkatëse". Kjo gjë i thotë shumë pak lexuesit.

440 *Përcaktimi:* qëllimi i përkufizimit në këtë rast është që të caktojë kufijtë e zbatimit të një fjale apo të një shprehjeje. Ky lloj përkufizimi është veçanërisht i dobishëm kur fjala ose shprehja kanë disa kuptime jo të qarta, por edhe kur ato kanë një numër kuptimesh të ndryshme dhe hartuesi dëshiron të zbatojë njërin prej tyre në ligj.

Shembull
"Shoqëri" nënkupton një shoqëri tregtare të regjistruar në Shqipëri.

441 *Zgjerimi ose ngushtimi i kuptimit*: përkufizimet mund të përdoren për të zgjeruar ose për të ngushtuar përdorimin e zakonshëm të fjalës ose shprehjes. Kjo mund të arrihet në sajë të përdorimit të formave pohuese ose mohuese.

Shembull i një shprehjeje pohore
"Kali" përfshin edhe gomarin dhe mushkën,

Shembull i një shprehjeje mohore
"Kafsha" nuk përfshin "zogjtë" ose "peshqit" ose "kafsha" përfshin gjitarët, zogjtë, peshqit, zvarranikët, insektet dhe çdo organizëm tjetër shumëqelizor që nuk është bimë ose kërpudhë.

Nuk duhet të përdoren përkufizime që janë shumë larg nga kuptimi

i zakonshëm dhe që çorientojnë lexuesin. Për shembull, nuk rekomandohet të përkufizohet "kafsha" vetëm "mace dhe qen" ose të përkufizohet "ushqimi" si "pije, çamçakëz dhe produkte të tjera të një natyre të ngjashme".

442 *Referencat në përkufizime:* Ndonjëherë përkufizimi i referohet një përkufizimi tjetër në të njëjtin legjislacion. Sidoqoftë, kjo teknikë nuk duhet të përdoret shumë sepse mund ta bëjë nenin të vështirë për t'u kuptuar.

Shembull
"Kopsht zoologjik" do të thotë ngrehina ku kafshët e egra, në përputhje me nenin X, mbahen për t'u ekspozuar përpara publikut ..."

443 Duhet bërë kujdes për të dalluar përdorimin e fjalëve "do të thotë" dhe "përfshin":

- "do të thotë" përdoren kur synohet të jepet një kuptim i plotë (fjala "është" përdoret gjithashtu në këtë kuptim);
- "Përfshin" ka për qëllim që të jepet një kuptim jo i plotë.

Shembull
"Prodhim bujqësor" do të thotë (ose janë) perime, fruta, lule dhe bimë.

"Prodhimi bujqësor" përfshin perime dhe fruta.

Në rastin e parë, termi i përkufizuar përfshin të gjithë elementët përbërës, ndërsa në rastin e dytë, elementët përbërës formojnë vetëm një pjesë të kuptimit të plotë të termit të përkufizuar ndërsa elementët e tjerë mbeten të hapur (këtu mund të përfshihen gjithashtu lulet dhe bimët si pjesë e përkufizimit).

444 Përdorimi i formulave të tilla si "do të thotë dhe përfshin" ose "përfshin vetëm" shkakton konfuzion dhe duhet të shmanget.

4.7 Dispozitat për procedurat administrative

445 Në përgjithësi, kompetencat administrative lidhur me zbatimin e ligjit ushtrohen nga autoritetet shtetërore qendrore ose vendore. Nëse hartuesi i ligjit synon t'u japë kompetenca administrative për zbatimin

e ligjit organizmave jashtë hierarkisë së zakonshme të autoriteteve, siç janë bordet ose këshillat e pavarura, ose në raste të rralla, institucioneve private, dispozitat që rregullojnë autorizimin e këtyre organizmave duhet të formulohen në mënyrë të saktë.

446 Për më tepër, këto dispozita duhet të përcaktojnë qartë përgjegjësitë dhe detyrat e institucioneve të ngarkuara me administrimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe detyrat e organeve drejtuese të këtyre institucioneve, sipas rastit.

4.8 Dispozitat lëndore

447 Aktet juridike rregullojnë një numër të madh të çështjeve thelbësore në përputhje me fushën e së drejtës që po rregullohet, objektivat dhe qëllimin e tij të zbatimit. Këto akte janë shumë të larmishme në tipologjitë e normave që ata parashikojnë. Si të tillë, disa akte juridike mund të urdhërojnë sjellje, vendosin të drejta dhe detyrime ose përcaktojnë kritere dhe procedura për krijimin ose zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve.

448 Larmishmëria dhe kompleksiteti i aktit juridik nënkupton se nuk është e mundur të sigurohet një model që të përshtatet për të gjitha rastet. Sidoqoftë, për qëllime ilustruese, mund të bëhen referenca në dispozitat lëndore të ligjit për policinë gjyqësore[198], i cili pas dispozitave lidhur me procedurat administrative (nenet 5-23) përmban dispozitat kryesore lëndore të ligjit (nenet 24-39) që merren me veprimtaritë hetimore të Policisë Gjyqësore, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së oficerëve të policisë gjyqësore, kompensimin financiar, si dhe kriteret dhe procedurat për procedimin disiplinor të punonjësve të policisë gjyqësore.

4.9 Dispozitat e vlerësimit

449 Ligji mund të përmbajë dispozitat e vlerësimit të cilat parashikojnë detyrimin për të bërë vlerësime dhe për të nxjerrë raporte periodike lidhur me zbatimin e ligjit. Edhe pse nuk janë të zakonshme në legjislacionin shqiptar, këto dispozita mund të jenë të dobishme për mirëfunksionimin e qeverisë si dhe të japin informacione të vlefshme për hartuesit e ardhshëm. Përdorimi i tyre duhet marrë në konsideratë.

198 Ligji nr. 25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

Shembull
Neni 7(ç) i Ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti

Ministri i Drejtësisë ka këto përgjegjësi dhe përmbush këto detyra:

[...];

raporton çdo vit në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike;

4.10 Dispozitat për nxjerrjen e akteve nënligjore

450 Dispozitat për nxjerrjen e akteve nënligjore duhet të hartohen sa më saktë të jetë e mundur. Kushtetuta në nenin 118 të saj përcakton se, dispozita për nxjerrjen e akteve nënligjore duhet të specifikojë autorizimin për nxjerrjen e akteve nënligjore, organin që ngarkohet për nxjerrjen e akteve nënligjore, çështjet që duhet të rregullojnë këto akte, si dhe parimet mbi të cilat ato mbështeten (shih për më shumë informacion Pjesën G seksionin 2).

451 Përveç shtjellimit të dispozitave të veçanta të autorizimit për nxjerrjen e akteve nënligjore, është praktikë e zakonshme që të gjitha autorizimet ligjore të mblidhen në një nen të veçantë në fund të ligjit përpara dispozitave kalimtare.

Shembull jo i mirë
Aktet nënligjore

Ministri i Drejtësisë ngarkohet me nxjerrjen e urdhrave dhe udhëzimeve në zbatim të këtij ligji, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përveç nëse parashikohet një afat më i shkurtër kohor në këtë ligj.

Shembull i mirë
Aktet nënligjore[199]

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 15, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 28, pika 3, të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim

199 Neni 34 i ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

të nenit 7, shkronjat "d", "e", "ë", "f", "gj" dhe "i"; nenit 17, pika 2; nenit 19, pika 4; nenit 28, pika 4, dhe nenit 31, pika 1, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 9, shkronja "b", të këtij ligji.

452 Kompetenca e përftuar me delegim nuk mund t'i delegohet një autoriteti tjetër pasi nëndelegimi i akteve nënligjore është i ndaluar (shih për më shumë informacion Pjesën G nënseksionin 3.6).

453 Duhet kushtuar vëmendje e veçantë respektimit të afateve që përcakton ligjvënësi, por jo vetëm, në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative në kohën e duhur, si një mjet për zbatimin me efektivitet të ligjit. Megjithatë, në asnjë rrethanë nuk mund të intepretohet përcaktimi i afateve kohore si limit kohor brenda të cilit pushteti ekzekutiv (Këshilli i Ministrave) duhet të miratojë këto akte nënligjore.

4.11 Dispozitat e sanksioneve

454 Veprat penale dhe sanksionet përkatëse janë kodifikuar në Kodin Penal. Dispozitat që përfshijnë përgjegjësinë penale duhet të hartohen sa më saktë që të jetë e mundur, në përputhje me parimin e ligjshmërisë.

455 Duhet të kihet parasysh që dispozitat, të cilat e klasifikojnë një veprim të caktuar si vepër penale jashtë parashikimeve të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar nga një shumicë e thjeshtë e deputetëve të Kuvendit, bien ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, duke mos respektuar shumicën e kërkuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81 (2) i Kushtetutës.[200]

456 Caktimi i përgjegjësisë penale duhet të bazohet në një këndvështrim të qartë se është e nevojshme të kriminalizohet një veprim që duhet të ndalohet me ligj, në vend që të zbatohen sanksione të tjera më pak radikale.

457 Si alternativë e sanksionit penal për shkelje të dispozitave ligjore është sanksioni administrativ. Ligjet shpesh përmbajnë sanksione administrative për shkelje të dispozitave të tyre.

200 Shih vendimet nr. 3, datë 5.02.2010 dhe nr. 1, datë 12.01.2011 të GJK-së.

Shembull
Neni 58 (1) i Ligjit për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar

Ushtrimi i profesionit të audituesit ligjor apo përdorimi i emërtimeve si shoqëri audituese, pa qenë i regjistruar më parë në regjistrin publik të Audituesve ligjorë, si dhe përdorimi i çfarëdo titulli, që synon të krijojë ngjashmëri ose konfuzion me këta tituj profesionalë apo emërtime, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 5.000.000 deri në 10.000.000 lekë.

458 Në rastet kur shkelja dhe organi kompetent për të ndëshkuar shkeljen nuk parashikohen në të njëjtën dispozitë, neni i sanksionit duhet të referojë saktësisht tek dispozita që autorizon dhënien e tij.

4.12 Dispozitat e shfuqizimeve

459 Çdo ligj duhet të përmbajë një referencë të qartë, në nenet e tij të fundit, që specifikon se cili ligj i mëparshëm ose dispozita të ligjeve të mëparshme shfuqizohen nga ky ligj, sa herë që kjo është e nevojshme. Referencat duhet të jenë shumë të sakta.

460 Në dispozitat që shfuqizojnë ligje nuk duhet përdorur gjuhë e përgjithshme apo e paspecifikuar si për shembull "të gjitha ligjet që bien ndesh me këtë ligj shfuqizohen". Dispozita të tilla duhet të përdoren vetëm në rrethana përjashtimore kur nuk është e mundur për arsye objektive të identifikohen në mënyrë të saktë të gjitha dispozitat e akteve ligjore që duhet të shfuqizohen.

461 Dispozitat shfuqizuese nuk duhen adoptuar me nxitim dhe në momentin e fundit, por ato duhet të jenë rezultat i një rishikimi të kujdesshëm të ligjeve ekzistuese të fushës. Në veçanti, hartuesi duhet të bëjë kujdes që të mos shfuqizojë ligje apo dispozita të ligjeve që janë adoptuar si pasojë e përafrimit të legjislacionit me *acquis*-në e BE-së, përveç kur ka arsye të bazuar dhe specifike për ta bërë këtë.

4.13 Dispozitat me efekt ndryshues mbi akte të tjera

462 Megjithëse nuk është një praktikë që zbatohet shumë në Shqipëri, ligjet gjithashtu mund të përmbajnë dispozita për ndryshime në ligje të tjera (referuar edhe si **ndryshime horizontale**). Sidoqoftë, kur kemi të bëjmë

me ndryshime të rëndësishme të ligjeve të tjera, këto ndryshime duhet të përfshihen në një ligj të veçantë.

Shembull
Neni 79 (3) i Ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë

Ligji nr. 10 270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij", i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të rregullave që lidhen me:

a) taksimin e trojeve shtetërore të marra në përdorim;
b) privatizimin e truallit në përdorim, për personat juridikë, shoqëri tregtare.

463 Kujdes i veçantë duhet kushtuar kur ligji i ri mund të shkaktojë ndryshime në një ligj që është miratuar nga një shumicë votash prej tre të pestash (3/5) të deputetëve në përputhje me procedurën e parashikuar nga neni 81(2) i Kushtetutës. Nenet e ligjit të ri që do të ndryshojnë ligjin që kërkon shumicë të cilësuar nuk mund të miratohen pa patur përsëri shumicën e cilësuar.

5 Njësitë strukturore të aktit dhe emërtimi i tyre

464 Njësitë strukturore kryesore ndihmojnë për të qartësuar mënyrën e strukturimit të ligjit. Një njësi strukturore kryesore grupon disa dispozita së bashku nën një titull, i cili tregon përmbajtjen duke përdorur fjalë kyçe. Titujt nuk janë pjesë e tekstit të ligjit, por ndihmojnë në strukturimin e ligjit, përforcojnë qartësinë dhe ndihmojnë lexuesit kur bëhet fjalë për çështjet e interpretimit.

465 Njësitë kryesore duhet të përdoren vetëm në atë masë sa ato janë të nevojshme për të strukturuar qartë një ligj të gjatë. Numri i niveleve strukturore në një akt parësor varet nga numri i rregullimeve që ai përmban. Përgjithësisht, asnjë njësi kryesore nuk është e nevojshme kur një ligj përfshin më pak se 20 nene.

466 Këto njësi përfshijnë gjithashtu një përcaktim lloji dhe numerik, përveç përcaktimit të përmbajtjes.

Emërtimet e ndarjes, në një rend zbritës, janë:

- Pjesët;
- Titujt;
- Krerët;
- Seksionet.

Numërtimi nuk e bën emërtimin e ndarjes të tepërt. Nuk do të ishte e mundur të citohej saktësisht një njësi strukturore e cila është numërtuar vetëm "3" dhe që nuk përfshin një emërtim në ndarje; emërtimi i saktë është "Seksioni 3".

467 Emërtimi numerik ndjek gjithmonë emërtimin e ndarjes (p.sh. "Kreu II" "Seksioni 1").

468 *Pjesët:* përdoren në rastet e teksteve të ligjeve që përmbledhin shumë çështje, siç janë kodet. Ato janë të numërtuara në mënyrë të njëpasnjëshme, me fjalë ose me numra të mëdhenj romakë.

Shembull
Pjesa I
...

Pjesa e Dytë
...

469 *Titujt:* Mund të jetë e nevojshme që Pjesët e një ligji të ndahen në Tituj, ku secili Titull përmban disa krerë. Ashtu si edhe pjesët, titujt përdoren kryesisht në kode. Titujt numërohen në mënyrë të njëpasnjëshme me numra të mëdhenj romakë.

Shembull
Titulli I
...

Titulli II
...

470 *Krerët:* Kur kemi ligje të gjata, në përgjithësi me më shumë se 15- 20 nene, mënyra më e mirë e organizimit të tyre është bashkimi i neneve me objekt të njëjtë në krerë. Krerët numërohen në mënyrë të njëpasnjëshme me numra të mëdhenj romakë.

Shembull
Kreu I
...

Kreu II
...

471 *Seksionet:* Nenet e një kreu që kanë objekt të njëjtë, nëse janë të shumtë, mund të grupohen më tej në seksione. Seksionet numërohen në mënyrë të njëpasnjëshme me numra arabë.

Shembull
Seksioni 1
...

Seksioni 2
...

472 Nëntitujt e ndarjeve të një ligji janë pjesë e përmbajtjes së ligjit. Ato janë fjalët përshkruese që gjenden jashtë tekstit të neneve.

Shembull
Kreu I
Rregulla të përgjithshme

473 Si rrjedhim, ashtu sikurse çdo pjesë tjetër e tekstit të ligjit, ata duhet të formulohen me saktësi, në mënyrë të tillë që të mos krijojnë probleme lidhur me interpretimin e tyre. Nëntitujt duhet të jenë të shkurtër, por duhet të tregojnë përmbajtjen që përfshihet në ndarjen e ligjit që vijon.

6 Ndarja dhe emërtimi i neneve

6.1 Nenet dhe pjesët e tyre përbërëse

474 Njësia themelore strukturore e një teksti ligjor është *neni*. Formati i neneve duhet të jetë i tillë që ta bëjë nenin të lexueshëm si një të tërë. Nenet duhet të jenë jo shumë të gjatë dhe të numërohen në mënyrë të njëpasnjëshme me numra arabë.

Shembull
Neni 1
...

Neni 2
...

475 Shpesh është e dobishme që nenit t'i vihet një titull me qëllim që ta bëjë më të lehtë të kuptuarit e tekstit, njëlloj si në rastin e nëntitujve të ndarjeve të aktit. Për këtë duhet të tregohet kujdes pasi nëntitulli mund të ndikojë në interpretimin e nenit.

Shembull
Neni 5
Misioni i Ministrisë së Drejtësisë

476 Ndarjet e një neni, në rend zbritës, janë:

- Paragrafët;
- Nënparagrafët;
- Nën-nënparagrafët.

477 *Paragrafët:* janë ndarjet kryesore të një neni. Si rregull i përgjithshëm neni nuk duhet të ketë më shumë se tre ose katër paragrafë. Në rast se është e nevojshme që neni të ketë më shumë paragrafë, hartuesi duhet të marrë në konsideratë mundësinë e ndarjes së mëtejshme të tekstit në nene të ndryshme.

478 Paragrafët e një neni numërohen me numra arabë dhe ndiqen nga një (shenjë pikësimi) pikë.

Shembull
1. ...
2. ...
3. ...

Në rastet kur neni ka vetëm një paragraf, ky paragraf nuk numërtohet.

479 Paragrafi duhet të përmbajë të paktën një fjali të plotë. Kemi të bëjmë me paragraf, vetëm atëherë kur teksti fillon në një rresht të ri dhe rreshti i mëparshëm mbaron me pikë. Gjithashtu, paragrafi konsiderohet si një i vetëm kur fillon me fjalë hyrëse të ndjekura nga nënparagrafë.

6.2 Pjesët përbërëse të paragrafëve

480 *Nënparagrafët:* Në rast se paragrafët e një neni rregullojnë çështje

komplekse ose voluminoze, ata mund të ndahen më tej në nënparagrafë. Nënparagrafët numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme, me shkronja të vogla të alfabetit shqip dhe me një kllapë të vetme.

Shembull
a) ...
b) ...
c) ...

481 Nënparagrafët përdoren zakonisht për të qartësuar tekstin e një paragrafi të gjatë, sidomos kur përmban disa çështje të ndryshme. Megjithatë, ekziston rreziku që përdorimi i nënparagrafëve të mund ta shtyjë hartuesin drejt hartimin të fjalive të gjata.

482 Hartuesi duhet të jetë i kujdesshëm në këtë drejtim dhe duhet të mendojë për ndarjen e tekstit në një numër fjalish të shkurtra në vend të përdorimit të tepruar të nënparagrafëve.

483 Nënparagrafët duhet të lidhen gramatikisht dhe logjikisht me fjalët hyrëse. Kujdes i veçantë duhet treguar për shembull, pas fjalëve hyrëse, nënparagrafët që listojnë kompetencat e një institucioni duhet të formojnë një rend logjik

Shembull i mirë
Drejtoria ka këto kompetenca:
a) jep licencat;
b) transferon pasuri; dhe
c) kërkon raporte nga të licencuarit.

Shembull i keq
Drejtoria ka këto kompetenca:
a) mblidhet çdo muaj;
b) cakton drejtorin e saj.

Çështjet e mësipërme nuk janë kompetenca dhe duhet t'i përkasin një paragrafi ose neni të veçantë që trajton organizimin dhe funksionimin e drejtorisë.

484 *Nën-nënparagrafët:* Në raste të veçanta, nënparagrafi mund të ndahet në nën-nënparagrafë. Rregullat për numërimin e neneve dhe nënparagrafëve në rend rritës zbatohen edhe për numërimin e nën-nënparagrafëve. Nën-

nënparagrafët shënohen me numra romakë të vegjël dhe me një kllapë të vetme.

Shembull

i) ...
ii) ...
iii) ...

485 Përdorimi i shpeshtë i nën-nënparagrafëve nuk është i këshillueshëm pasi e bën më të ndërlikuar leximin e tekstit.

6.3 Lidhja ndërmjet paragrafëve

486 Lidhja mes paragrafëve të nenit është normalisht e qartë nëse neni është organizuar siç duhet. Cilësimet apo referencat mund të përdoren për ta bërë lidhjen edhe më të qartë. Megjithatë, nëse hartuesi vëren se teknika e përdorimit të referencave është përdorur në shumë raste, struktura e nenit duhet të shqyrtohet përsëri për t'u rihartuar në mënyrë më të thjeshtë. Disa teknika të strukturimit të përdorura shpesh janë si më poshtë:

- "sipas pikës 1": pika 1 ka përparësi ndaj pikës 2;
- "Pavarësisht nga pikës 1": pika 2 zbatohet edhe pse parashikon rregulla të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1;
- "në përputhje me pikën 1": pikat 1 dhe 2 kanë të njëjtin status dhe përmbajnë parime që nuk bien në kundërshtim me njëri tjetrin, por ndoshta pika 1 përmban një parim të përgjithshëm dhe hartuesi dëshiron të sqarojë se pika 2 përfshihet brenda tij, ose është një rast i zbatimit të këtij parimi dhe jo përjashtim i tij.

6.4 Lidhja ndërmjet nënparagrafëve

487 Nënparagrafët mund të jenë parashikime të pavarura të cilat lidhen me fjalë hyrëse.

Shembull

Gjykata mund të vendosë të kryejë një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme:

a) të urdhërojë konfiskimin e të ardhurave nga krimi;
b) të lejojë personin e dënuar të bëjë ankim;
c) të lirojë të burgosurin nga burgu gjatë zhvillimit të gjykimit të apelit.

488 Në të vërtetë, këta nënparagrafë nuk kërkojnë që të ketë një formulë hyrëse dhe formulat e tilla hyrëse janë të rralla në legjislacionin shqiptar. As nuk kërkohen fjalët, të cilat tregojnë se cila është lidhja mes tyre, sepse ata përbëjnë veprime të pavarura dhe "vepruesi" (në këtë shembull, gjykata) mund të zgjedhë të kryejë njërin prej këtyre veprimeve, për shembull veprimin e parashikuar në shkronjën "b", ose veprimet e parashikuara në më shumë se një prej tyre, për shembull në shkronjat "b" dhe "c". Megjithatë, për të qenë të sigurt, është e pranueshme që të përdoret formula hyrëse "një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme".

489 Ndonjëherë parashikimet e pavarura përjashtojnë njëra-tjetrën. Kjo ndodh kur vepruesi vendos të zbatojë një nga këto parashikime, duke përjashtuar kështu të tjerat.

Shembuj:
Gjykata mund të kryejë njërin nga veprimet e mëposhtme:

a) të vendosë gjobë;
b) të vendosë dënim me burg;
c) të vendosë gjobë dhe dënim me burg.

Si dhe në shembullin e parë, nuk është e nevojshme që të ketë një formulë apo fjalë që të tregojnë raportin ndërmjet nënparagrafëve. Në këtë rast fjalët hyrëse "njërin nga veprimet e mëposhtme" nuk e ndihmojnë sigurinë ligjore, janë të tepërta dhe nuk duhen shtuar.

490 Nënparagrafët mund të kenë efektiv kumulativ.

Shembull
Një kandidat duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) të ketë shtetësi shqiptare;
b) të jetë mbi 21 vjeç;
c) të mos jetë dënuar penalisht.

491 Sikurse më sipër, kjo mund të tregohet nëpërmjet formulës hyrëse "duhet të ketë të gjitha këto cilësi". Mundet gjithashtu të përdoret fjala "dhe" midis dy nënparagrafëve të fundit, pra pas shkronjës "b"; përdorimi njëkohësisht i të dy këtyre teknikave është i tepërt. Disa hartues, për efekt të sigurisë, vendosin fjalën "dhe" midis të gjithë nënparagrafëve, por kjo gjithashtu është e tepërt.

492 Nënparagrafët mund të jenë gjithashtu alternativë për nga efekti.

Shembull
Një kandidat duhet të përmbushë një nga kërkesat e mëposhtme:

a) të ketë licencë për ushtrimin e profesionit të avokatit në gjykatat shqiptare;
b) të jetë emëruar si pedagog në një universitet për drejtësi në Shqipërisë;
c) të ketë një licencë apo emërim të tillë në një shtet anëtar të BE-së.

493 Efekti alternativ mund të tregohet, duke përdorur formulën hyrëse "duhet të ketë një nga cilësitë e mëposhtme". Mundet gjithashtu të përdoret fjala "ose" midis secilit prej nënparagrafëve, kur parashikimet e pavarura përjashtojnë njëra-tjetrën.

494 Përdorimi i formulës hyrëse në vend të përdorimit të fjalës "dhe" apo fjalës "ose" për të treguar lidhjen ndërmjet nënparagrafëve, edhe pse më i shtjelluar, nuk përdoret shumë në legjislacionin shqiptar ose në ligjet e vendeve të së drejtës civile. Megjithatë, ka kuptim më të sigurt dhe lejon më tepër fleksibilitet në disa raste

Shembull
Në rastin e një të rrituri, agjencia mund të zbatojë një ose disa nga procedurat e mëposhtme; por në rastin e një fëmije ajo mund të zbatojë njërën prej procedurave "a" ose "b" ...

7 Akti gjithëpërfshirës

495 Një akt gjithëpërfshirës ("*omnibus*") është një mjet përmes të cilit ligje të ndryshme mund të ndryshohen, krijohen ose shfuqizohen me një akt ligjor të vetëm. Duhet të ketë një lidhje mjaft të ngushtë midis pjesëve individuale të një akti gjithëpërfshirës.

496 Nxjerrja e një akti gjithëpërfshirës mund të kërkohet në mënyrë të veçantë sa herë që disa akte parësore ligjore preken nga ndryshime kryesore të cilat janë të lidhura ngushtësisht sa i takon përmbajtjes dhe për rrjedhojë, nxjerrja e një akti ndryshues individual nuk është opsion i përshtatshëm.

497 Një akt gjithëpërfshirës mund të kombinojë të gjitha format themelore të legjislacionit. Akti gjithëpërfshirës mund të përdoret, ndër të tjera, për të:

- ndryshuar disa akte parësore, ndonjëherë të shumta në numër;
- shfuqizuar aktet parësore dhe në të njëjtën kohë për të ndryshuar të tjerat, ose
- kombinuar rregullimet e para ligjore me ndryshimet e akteve parësore.

498 Më tej, një akt gjithëpërfshirës përmban ndryshime pasuese që duhet të bëhen në ligje ose akte nënligjore nëse kjo është e nevojshme për të ruajtur njëtrajtshmërinë e pjesës së mbetur të ligjit me dispozitat e ndryshuara ose të krijuara rishtazi në aktin gjithëpërfshirës.

499 Akti gjithëpërfshirës përmban vetëm një dispozitë si bazë ligjore dhe një formulë përmbyllëse, si dhe një dispozitë për hyrjen në fuqi.

500 Rekomandimet e përgjithshme në lidhje me aktet parësore kryesisht zbatohen edhe për aktet gjithëpërfshirëse.

8 Dispozitat kalimtare

501 Ligjet bëhen plotësisht efektive **pas hyrjes në fuqi** të tyre. Ato kuadrojnë sistemin ligjor për të ardhmen, prandaj përgjithësisht mbulojnë të gjitha marrëdhëniet juridike që lindin në të ardhmen. Megjithatë, një ligj i ri mund të ketë një ndikim të gjerë edhe në marrëdhëniet juridike ekzistuese. Po ashtu duhet të bëhet një dallim midis marrëdhënieve juridike që janë shuar dhe atyre që nuk janë shuar ende. Dispozitat kalimtare përcaktojnë procedurën për kalimin nga regjimi i mëparshëm ligjor në regjimin e ri.

502 Sipas ligjit procedural dhe material, në rast dyshimi, zbatohet ligji i ri për marrëdhëniet juridike, të cilat janë ngritur mbi bazën e rregullimeve të vjetra, të cilat janë zëvendësuar, por ato marrëdhënie ende nuk mund të vlerësohen si të përfunduara ose janë **të përhershme** (p.sh. procedimet e papërfunduara, martesat ose marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve ose marrëdhëniet kontraktore të vazhdueshme). Nëse do të zbatohet një e drejtë tjetër nga e drejta e re, kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë.

503 Në të kundërt, rregullimet e reja nuk përfshijnë marrëdhëniet juridike të cilat tashmë janë vendosur përfundimisht në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Këto nuk përfshijnë ato marrëdhënie juridike për të cilat tashmë kanë lindur pasojat e kërkuara me ligj. Kushdo që ka përmbushur kushtet e një dispozite të zbatueshme më parë, në parim gjithashtu mund të pretendojë pasojën juridike të përcaktuar në të. Në marrëdhënie të tilla

juridike, situata juridike e cila mbizotëronte kur u ngrit marrëdhënia është vendimtare. Për shkak të pritshmërive legjitime, nuk mund të ndërhyhet në çështje të tilla të përfunduara, si dhe në çështje të papërfunduara që kanë filluar para hyrjes në fuqi të ligjit të ri.[201]

Shembull
Neni 32(1) i Ligji për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Kërkesat për licencim, që janë paraqitur pranë Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas dispozitave në fuqi të ligjit, në kohën e paraqitjes së kërkesës.

504 Kur bëhet fjalë për akte parësore të reja, duhet të shihet nëse rregullat e përshtatjes duhet të përcaktojnë se si do të trajtohen procedurat në vazhdim dhe marrëdhëniet ekzistuese juridike. Shpesh nuk është i mundur kalimi në mënyrë të papritur nga një situatë juridike në tjetrën, sepse duhet të merren parasysh marrëdhëniet ekzistuese juridike për arsye kushtetuese ose arsye të tjera.

505 Duhet të shqyrtohet nëse personat e prekur nga legjislacioni i ri kanë nevojë për **kohë për t'u përshtatur** me situatën e re juridike pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri (e njohur si "koha ndërmjetëse").

Shembull
Neni 85 (1) i ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë

Gjykata ngre Këshillin e Gjykatës brenda katër muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

506 Rregullat praktike të mëposhtme duhet të merren parasysh kur shihet nëse është i nevojshëm një **rregull kalimtar**:

- Një rregull kalimtar është i nevojshëm nëse situata juridike që do të krijohet në bazë të ligjit të ri nuk mund të arrihet plotësisht menjëherë.
- Kur ka dyshime se në çfarë mase janë përfunduar çështjet, një rregull kalimtar duhet të përcaktojë se si do të trajtohen këto çështje në të ardhmen.
- Gjithmonë peshoni pritshmëritë e lidhura me një situatë të caktuar

201 Ducret kundër Francës, Kërkesa nr. 40191/02, §§ 33-42.

juridike që vazhdojnë përkundër interesit shtetëror për të zbatuar menjëherë një dispozitë të re. Sa më e ngutshme të jetë çështja shqetësuese që legjislativi po adreson duke përcaktuar dispozitën e re dhe sa më e domosdoshme nevoja që ajo të zbatohet menjëherë, aq më e madhe është nevoja për të përshtatur menjëherë situatën juridike me dispozitat e reja.

507 Gjatë formulimit të dispozitave kalimtare duhet të ekzistojë një fleksibiliteti konsiderueshëm.

508 Shprehja e mëposhtme **nuk duhet** të përdoret: "Ky ligj zbatohet vetëm për marrëdhëniet juridike që ekzistojnë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.". Përveç të vërtetës së vetëkuptueshme që ligji zbatohet për çështjet e ardhshme, nuk është lehtësisht e pranueshme se si do të trajtohen çështjet e mëparshme. Rekomandohet që marrëdhëniet ekzistuese juridike të merren si pikë referimi.

Nëse ligji i ri zbatohet për marrëdhëniet ekzistuese juridike, kjo mund të varet nga kushte specifike ose mund të lidhet me kufizime të caktuara. Këto mund të jenë data referimi dhe ngjarje para hyrjes në fuqi të ligjit, si dhe përmbushje e kushteve të caktuara pas hyrjes në fuqi. Në raste të tilla është e mjaftueshme t'i referohemi ligjit të ri me anë të një vetëreferimi.

Shembull
"Ky ligj nuk zbatohet për ..." ose
"Ky ligj zbatohet për ..."

509 Nëse **data e hyrjes në fuqi** e ligjit bëhet pikë referimi në dispozitën kalimtare dhe kjo përcaktohet me anë të një formule fillestare për hyrjen në fuqi të ligjit, dispozita kalimtare gjithashtu mund të përfshijë një formulë fillimi.

510 Nëse dispozita për hyrjen në fuqi përcakton që dispozita të ndryshme do të hyjnë në fuqi në periudha të ndryshme (shiko nënseksionin 9.3), duhet të qartësohet secila nga datat që merr si pikë referimi dispozita kalimtare. Deklarimi i një date specifike ose përdorimi i një formule fillestare janë mënyra lehtësuese për përdoruesin. Megjithatë, data e hyrjes në fuqi mund të specifikohet gjithashtu duke iu referuar dispozitës përkatëse për hyrjen në fuqi ("Hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me nenin ... (...)").

511 Nëse hyrja në fuqi e ligjit të ri lidhet me shfuqizimin e rregullimeve të

mëparshme, por ato rregullime të shfuqizuara do të vazhdojnë të zbatohen për një periudhë kalimtare, rekomandohet që vetëm data e hyrjes në fuqi të përdoret si element i përbashkët. Kur ligji i mëparshëm do të vazhdojë të zbatohet, është e rëndësishme që ata që zbatojnë ligjin të jenë në gjendje të përcaktojnë se cili është versioni i fundit i ndryshuar i ligjit, rregullimet e të cilit do të vazhdojnë të zbatohen për çështjet e vjetra. Për këtë qëllim, duhet të citohet data e ligjit shfuqizues, pasi kjo përmban informacione mbi të cilat ligji do të vazhdojë të zbatohet.

Shembull
Neni 13 (2) i Ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë

Deri në miratimin e akteve nënligjore të parashikuara nga ky ligj, tarifat gjyqësore do të përllogariten dhe zbatohen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për taksat kombëtare dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

9 Dispozitat për hyrjen në fuqi

512 Data e hyrjes në fuqi shënon pikën në të cilën rregullat juridike hyjnë në fuqi. Ekziston një dallim midis kësaj dhe zbatueshmërisë së ligjit: Ligji fillon të ekzistojë pas shpalljes së tij. Data e përcaktuar për sa i përket zbatueshmërisë së ligjit, për shembull në lidhje me çështjet individuale, periudhat specifike të vlerësimit ose vitet specifike të biznesit, mund të ndryshojë nga data e hyrjes në fuqi të tij. Dispozitat mbi zbatueshmërinë janë më shumë si dispozita kalimtare (shiko për më shumë detaje seksionin 8). Prandaj, duhet të tregohet kujdes që të mos ngatërrohen me dispozitat për hyrjen në fuqi të ligjit.

513 Çdo ligj duhet të **specifikojë datën në të cilën hyn në fuqi**. Nëse hyrja në fuqi nuk specifikohet në mënyrë të qartë, ligji hyn në fuqi të paktën 15 ditë nga dita e botimit në FZ.[202]

514 Hartuesi mund të vendosë që një apo disa nene të veçanta të hyjnë në fuqi në një datë të ndryshme nga hyrja në fuqi e ligjit në tërësi. Gjithashtu, mund të ketë raste kur një dispozitë e caktuar e cila mbulon marrëdhënie juridike ose subjekte të veçantë të zgjerojë fushën e saj të mbulimit mbi marrëdhënie juridike ose subjekte të tjerë në një moment të dytë kohor si për shembull pas një apo dy vjetësh. Kjo mund të bëhet për të testuar efektet e dispozitës mbi një rreth më të ngushtë

202 Neni 84(3) i Kushtetutës.

marrëdhëniesh ose subjektesh. Hartuesi duhet të jetë gjithmonë i kujdesshëm në përdorimin e këtyre teknikave të hyrjes në fuqi të ligjit ose dispozitave të veçanta të tij.

515 Përcaktimi i datës së hyrjes në fuqi është pjesë e procesit legjislativ. Prandaj është detyrë vetëm e legjislativit. Nuk lejohet që ligji të autorizojë Këshillin e Ministrave ose një ministri të përcaktojë datën e hyrjes së tij në fuqi ose të shtyjë fillimin e periudhës së vlefshmërisë të specifikuar në ligj.

516 Projekti i parë duhet të përfshijë një dispozitë për hyrjen në fuqi. Ai duhet të rishikohet në mënyrë të përsëritur gjatë gjithë procesit legjislativ.

517 Legjislativi është i lirë të përcaktojë datën në të cilën ligji hyn në fuqi. Duhet të merret parasysh fakti që shumë rregullime kërkojnë një periudhë të caktuar përgatitore përpara se ato të zbatohen (p.sh. në lidhje me miratimin e akteve nënligjore ose përgatitjet organizative të ndërmarra nga administrata). Në raste të tilla, duhet të përfshihet një kohë e përshtatshme ndërmjetëse midis shpalljes dhe hyrjes në fuqi.

518 Për më tepër, ligjet, si rregull, nuk duhet të kenë efekt prapaveprues. Ligjeve mund t'u jepet efekt prapaveprues vetëm në raste të kufizuara dhe të specifikuara, siç është rasti për ligje penale me efekt favorizues siç parashikohet në nenin 29 të Kushtetutës, si dhe ligje që përfshijnë çështje procedurale. Sidoqoftë, efekti prapaveprues i një ligji nuk duhet të jetë në kundërshtim me nenin 7 të KEDNJ-së.

519 Në çdo rast, nëse ligji me fuqi prapavepruese cënon të drejtat e subjekteve të tij, ka të ngjarë të kundërshtohet pasi nuk është në përputhje me parimet bazë të shtetit të së drejtës. Gjithashtu, një ligj i tillë mund të kritikohet me argumentin se, në parim, nuk u jep mundësi subjekteve të tij të përcaktojnë fushën e zbatimit dhe implikimet e tij, në mënyrë që ata të mund të marrin masat e duhura për të rregulluar sjelljen e tyre në përputhje me parimin e sigurisë juridike.[203]

520 Dispozita për hyrjen në fuqi vendoset në **pjesën e fundit** në aktin parësor. Kjo është mënyra e vetme për të garantuar që dispozita i referohet ligjit në tërësi.

203 Shih vendimet nr. 26, datë 02.11.2005; nr. 10, datë 19.03.2008, nr. 33, datë 24.06.2010; nr. 2, datë 18.02.2013 të GJK-së.

9.1 Përkufizimi i saktë

521 Data e hyrjes në fuqi duhet të përcaktohet **sa më saktë të jetë e mundur** për të gjitha pjesët e ligjit, në funksion të qartësisë juridike të normës.

522 Në rastin e ligjeve të cilat as nuk kërkojnë kohë të ndërmjetme dhe as nuk u jepet efekt prapaveprues, dispozita për hyrjen në fuqi në përgjithësi ka këtë formulim:

Ky ligj hyn në fuqi hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

523 Specifikimi i një date konkrete në të cilën ligji hyn në fuqi ofron gjithmonë qartësi dhe në të njëjtën kohë është miqësor për përdoruesit. Kur përdoret kjo teknikë hyrja në fuqi ndodh në orën 0:00 në datën se përcaktuar.

Shembull
Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 qershor 2018.

9.2 Hyrja në fuqi me kusht

524 Legjislativi mund ta kushtëzojë hyrjen në fuqi të një ligji **në varësi të ndodhjes së një ngjarje të jashtme**. Kjo mund të jetë një ngjarje aktuale (p.sh. pagesa e fondeve për një fond shpëtimi) ose një ngjarje juridike (p.sh. përfundimi i një marrëveshje ndërkombëtare, hyrja në fuqi e një akti ligjor).

525 Duhet të jetë e mundur që ata që zbatojnë ligjin të identifikojnë pa mëdyshje ngjarjen e jashtme. Ngjarja e jashtme në përgjithësi është e identifikueshme pa ekuivoke nëse jepet nga FZ-ja. Sidoqoftë, ndodhja e një ngjarje të jashtme gjithashtu mund të mos jetë e dukshme për publikun e gjerë, që do të thotë se hyrja në fuqi mbetet e paqartë. Në raste të tilla, dispozita për hyrjen në fuqi duhet të parashikojë gjithashtu monitorimin dhe njoftimin zyrtar të ndodhjes së ngjarjes. Gjithashtu duhet të specifikohet se kush është përgjegjës për njoftimin e tyre.

526 Ndodhia e ngjarjes së jashtme ndikon në hyrjen në fuqi. Në raste të tilla, njoftimi shërben vetëm që të përcaktohet - menjëherë - dhe të bëhet e ditur që kushti (realizimi i ngjarjes së jashtme) është përmbushur dhe kur ka ndodhur kjo. Kështu që njoftimi nuk ofron ndonjë marzh diskrecioni sa i përket datës së hyrjes në fuqi. Teksti i njoftimit duhet të specifikojë kushtin që ka sjellë hyrjen në fuqi të ligjit.

9.3 Hyrja në fuqi në periudha të ndryshme kohore

527 Kur është e nevojshme, dispozita për hyrjen në fuqi mund të specifikojë që pjesë të ndryshme të të njëjtit akt parësor të hyjnë në fuqi në periudha kohore të ndryshme. Në këto raste, duhet të tregohet vëmendje që rregullimet ligjore që hyjnë në fuqi në një datë më të hershme, të mund të aplikohen në mënyrë të pavarur në kohën e caktuar.

528 Të gjitha rregullimet që hyjnë në fuqi në një moment kohortë caktuar duhet të grupohen së bashku në "**nënndarje**". Dispozita që përcakton datën e hyrjes në fuqi duhet të përcaktojë një moment specifik në kohë për secilën nënndarje. Data për secilën nënndarje duhet të tregohet në një fjali të veçantë. Për secilën datë të hyrjes në fuqi, dispozitat përkatëse renditen sipas renditjes që seksionet paraqiten në tekst.

Shembull
Dispozitat në bazë të Kreut V "Dhënia e ndihmës juridike në mosmarrëveshjet ndërkufitare" të këtij ligji hyjnë në fuqi me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

529 Këshillohet që, së pari, të specifikohet data në të cilën do të hyjnë në fuqi shumica e dispozitave ligjore, pastaj të dallohen datat në të cilat do të hyjnë në fuqi nënndarjet.

Shembull
Neni 15 i ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 qershor 2018.

Përjashtimisht, neni 14 i këtij ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

9.4 Kufizimet kohore dhe pushimi i fuqisë së legjislacionit

530 Në ndryshim nga hyrja në fuqi, fundi i periudhës së vlefshmërisë së ligjit në përgjithësi nuk mund të përcaktohet që në fillim. Prandaj, shumica e ligjeve nuk përmbajnë një dispozitë për përfundimin e afatit. Ata zbatohen për një **periudhë të pacaktuar**.

531 Sidoqoftë, është e mundur të vendoset një afat kohor për periudhën e vlefshmërisë së ligjit.

Shembull
Neni 5 i ligjit për deklarimin e moratoriumit të pyjeve në Republikën e Shqipërisë

Kohëzgjatja e fuqisë
Afati i zbatimit të këtij ligji është 10 (dhjetë) vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi.

532 Kërkohet kujdes kur vendosen kufij në kohëzgjatjen e vlefshmërisë së ligjit, pasi shpesh shkon në kundërshtim me pritshmërinë e përdoruesve në drejtim të qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë së legjislacionit. Përveç kësaj, kjo mbart dy rreziqe: mund të mos ketë kohë të mjaftueshme për të zgjatur ose shfuqizuar afatin kohor dhe për të siguruar që dispozitat të jenë përherë të vlefshme, nëse kjo dëshirohet. Në raste të tilla, dispozitat do të bëhen joefektive; sapo dispozitat të bëhen joefektive, ato duhet të rivotohen. Nga ana tjetër, mbart rrezikun që afati i vendosur të zgjatet pasi afati i kohëzgjatjes në fuqi mund të mos jetë i duhuri për të shqyrtuar me kujdes, nëse dhe në çfarë mase, rregullimi është në fakt ende i nevojshëm.

533 Për shembull, përcaktimi i një afati kohor mund të konsiderohet kur ka të ngjarë që rregullimi ligjor do të nevojitet vetëm përkohësisht. Ky zakonisht supozohet të jetë rasti për ligjet emergjente që sjellin zgjidhje të menjëhershme.

Shembull
Neni 38 i aktit normativ për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike

Kohëzgjatja e fuqia e aktit normativ
Ky akt normativ ka një efekt të përkohshëm dhe zbatohet deri më 31.12.2020.

534 Duhet të jepet një **datë specifike** në të cilën ligji përfundon efektet juridike. Nëse ligji sjell efekte juridike deri në ditën e parë të një muaji ose viti të caktuar në orën 0:00 ose në ditën e fundit të një muaji ose viti të caktuar në orën 24:00, atëherë mund të përdoret formulimi i mëposhtëm:

"... ka efekt të përkohshëm dhe zbatohet deri më ...".

535 Nëse, në të kundërt, ligji i përfundon efektet juridike në një datë e cila

nuk është dita e parë ose e fundit e një muaji ose viti të caktuar, përdoret formulimi i mëposhtëm:

"... përfundon efektet juridike pas kalimit të...".

536 Përfundimi i efekteve juridike mund të lidhet me ndodhinë e një ngjarje të jashtme (p.sh. përfundimi i një akti ligjor tjetër) (i njohur si "**përfundim i kushtëzuar**").

537 Ligjet me afat të kufizuar gjithashtu mund të lidhen me arritjen e një qëllimi rregullator. Në raste të tilla, kufizimi i afatit lind nga vetë natyra e çështjes. Ligje të tilla janë të zbatueshëm deri në kohën kur masat e përshkruara në to kanë përfunduar. Ato automatikisht pushojnë së qeni në fuqi sapo të arrihet qëllimi në fuqi.

Shembull
Ligji për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore

10 Formula përmbyllëse

538 Pasi një ligj të jetë gati për botim në FZ, shtohet një formulë përmbyllëse. Formula përmbyllëse nënkupton se ligji është miratuar në përputhje me dispozitat e Kushtetutës dhe se Presidenti e ka shpallur atë si ligj.

539 Formula përmbyllëse zakonisht formulohet si vijon:

Shpallur me dekretin nr. 3837, datë 17.06.2003, të Presidentit të Republikës, Alfred Moisiu[204]

540 Gjatë viteve të fundit ka qenë praktikë përfshirja si pjesë e formulës përmbyllëse të akteve të miratuara nga Kuvendi, menjëherë pas dispozitave të hyrjes në fuqi, shprehja "Miratuar më: dd, mm, vvvv." si dhe nënshkrimi i Kryetarit të Kuvendit.[205]

541 Formula përmbyllëse nuk ka forcën e ligjit. Qendra e Botimeve Zyrtare kujdeset për përgatitjen dhe botimin e formulës përmbyllëse.

204 Marrë nga formula përmbyllëse e Kodit të Familjes.
205 Neni 2 i vendimit nr. 1/2012 të Kuvendit "Për numrin e ligjeve dhe vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë".

Pjesa E
Aktet ndryshuese

1 Vërejtje të përgjithshme për legjislacionin ndryshues

542 Propozimet legjislative në fushat juridike në të cilat nuk ekziston asnjë ligj i të njëjtit nivel ose i një niveli më të ulët janë të rralla në ditët e sotme. Shumica dërrmuese e veprimtarisë legjislative nuk konsiston më në miratimin e rregullimeve të reja, por në ndryshimin e legjislacionit ekzistues.

543 Çdo propozim për një ndryshim legjislativ duhet të ruajë njëtrajtshmërinë dhe qartësinë e sistemit ligjor:

- Ndryshimet e dëshiruara duhet të përshtaten plotësisht me legjislacionin ekzistues parësor. Është gjithmonë akti parësor që rregullon objektin përkatës i cili ndryshohet.
- Akte parësore të ndryshme që u referohen të njëjtave çështje ligjore - në konceptimin më të gjerë të kuptimit të tyre - krijojnë konfuzion dhe probleme në zbatimin e ligjit. Kur disa akte parësore e fragmentojnë një çështje ligjore pa qenë e nevojshme, ato duhet të bashkohen (përqendrimi i legjislacionit).
- Të gjitha propozimet e ardhshme për ndryshimet legjislative duhet gjithashtu të konsolidohen përtej kufijve të departamenteve. Kur është e mundur të parashikohet që do të duhet të bëhen ndryshime të mëtejshme në të ardhmen e afërt, atëherë duhet të shqyrtohet veçanërisht me kujdes nëse dy akte ndryshuese të veçanta janë absolutisht thelbësore ose nëse ato mund të kombinohen në një akt ligjor (përqendrimi i legjislacionit).
- Ndryshimet duhet të krijojnë rregullime të qëndrueshme (qëndrueshmëria e legjislacionit). Në mënyrë që të shmangen ndryshimet që duhen bërë, por të cilat nga ana tjetër mund të ndryshohen përsëri, mund të përdoren teknika të ndryshme legjislative, për shembull referencat e kryqëzuara (shih Pjesën C nënseksioni 3.2) ose autorizimet për të nxjerrë

akte nënligjore (shih Pjesën G seksioni 2) .

- Për të garantuar konsolidimin në vazhdimësi të ligjit dhe për të siguruar mospasjen e akteve të veçanta për konsolidimin e legjislacionit, projektaktet ligjore ndryshuese duhet të merren si një mundësi për të shqyrtuar nëse dispozitat në ligjin objekt ndryshimi janë bërë të panevojshme ose të tepërta (p.sh. dispozitat e vjetra kalimtare), duhet të përditësohen (p.sh. emërtimet e vjetruara), ose të hiqen(konsolidimi i legjislacionit).

544 Mjetet bazë të mëposhtme mund të përdoren për ndryshimin e akteve ligjore në fuqi, megjithëse nuk janë të njëjtë përsa i takon strukturës së tyre:

- akti zëvendësues, i cili rishikon thelbësisht aktin parësor;
- akti ndryshues individual, i cili ndryshon kryesisht vetëm një akt parësor;
- akti ndryshues gjithëpërfshirës, i cili ndryshon, krijon ose shfuqizon disa ligje në një akt legjislativ; konsolidimi, i cili përfshin integrimin e të gjitha normave ligjore ekzistuese në fuqi në një tekst ligjor.

545 Se cila prej tyre është më e përshtatshme në një rast konkret varet nga shkalla e ndryshimeve që do të bëhen. Lloji dhe shtrirja e ndryshimeve të nevojshme duhet të përcaktohet qartë para se të merret një vendim se cili lloj i aktit ndryshues është më i përshtatshmi.

546 Ndryshimet në një akt mund të jenë të shprehura ose të heshtura. Një ndryshim i shprehur ndryshon një ligj ekzistues duke e përcaktuar këtë shprehimisht. Një ndryshim i heshtur ndryshon një ligj ekzistues pa e parashikuar këtë shprehimisht.

547 Ndërsa rregulli i përgjithshëm i interpretimit ligjor është që një ligj i mëvonshëm shfuqizon një ligj të mëparshëm, i lihet lexuesit të krahasojë dispozitat e dy ligjeve dhe të përcaktojë shkallën dhe objektin e ndryshimit të nënkuptuar të ligjit të mëparshëm në rast se ka paqartësi në lidhje me masën e ndryshimit. Ndryshimi i heshtur është një burim paqartësie dhe konfuzioni dhe, për aq sa është e mundur, duhet të shmanget. Për këtë arsye, Manuali shqyrton vetëm ndryshimet e shprehura.

548 Është bërë një dallim midis ndryshimeve kryesore dhe atyre pasuese. **Ndryshimet kryesore** shërbejnë për të zbatuar drejtpërdrejt një objektiv të politikës. Nëse duhet të rishikohen dispozitat e tjera për shkak të

ndryshimeve kryesore që janë bërë, atëherë **ndryshimet pasuese** sigurojnë qëndrueshmëri midis dispozitave të reja dhe legjislacionit ekzistues. Ndryshimet pasuese nuk bëhen kurrë të veçuar, vetëm në kombinim me ndryshimet kryesore.

549 Para hartimit të një akti ndryshues, shpesh ka kuptim të hartohet një përmbledhje me tre kolona në një fazë të hershme, e cila krahason versionin e dëshiruar dhe të njëtrajtësuar të aktit parësor me formulimin në fuqi dhe thekson ndryshimet e nevojshme përmes vënies në dukje të:

- aktit parësor që do të ndryshohet;
- projektaktit ndryshues të propozuar;
- ndryshimeve në aktin ndryshues të propozuar gjatë konsultimeve.
- Komisionet e Kuvendit mund të kërkojnë gjithashtu hartimin e përmbledhjeve të tilla për t'u përdorur në diskutimet e tyre.

550 Nëse teksti nuk do të rishikohet në mënyrë thelbësore me anë të një akti zëvendësues, një teknikë e paracaktuar ndryshimi duhet të përdoret për të ndryshuar ligjin në fuqi në mënyrë që formulimi i teksteve ekzistuese, të specifikuara saktësisht, të mund të shfuqizohet plotësisht ose pjesërisht, të plotësohet ose zëvendësohet nga një formulim i ri. Në terma legjislativë, një ndryshim gjithmonë përfshin dy pjesë të dallueshme:

- Pjesa e gjuhës ndryshuese që përfshin fjalinë hyrëse, e cila specifikon aktin parësor që do të ndryshohet, dhe formulën ndryshuese. Formula ndryshuese tregon se ku duhet të bëhet ndryshimi në formulimin e aktit parësor (p.sh.: "Në nenin ... paragrafi ... ").
- Pjesa e gjuhës rregullatore, e cila është e përfshirë në formulën ndryshuese dhe përmban gjithçka që do të bëhet pjesë e formulimit të ri të aktit parësor (p.sh. "Në ... fjala "certifikon" zëvendësohet me fjalën "licencon"."). Pjesa e gjuhës rregullatore dhe formulimi i pandryshuar, kur lexohen së bashku, duhet të ndjekin rekomandimet e përgjithshme për hartimin e akteve juridike të përcaktuara në Pjesën C.

551 Teknika ndryshuese ka disavantazhet e saj. Është e vështirë të identifikohet rëndësia kontekstuale e ndryshimeve në akte të tilla ndryshuese. Formulat ndryshuese zakonisht u referohen fjalëve, frazave ose fjalive konkrete. Ndryshimet nuk renditen sipas rëndësisë së tyre, por ndjekin renditjen e neneve në aktin parësor. Ndryshimet mund të kuptohen vetëm duke krahasuar formulimin e ndryshuar me formulimin e vjetër të aktit parësor.

Formulimi i ligjit, që do të zbatohet në të ardhmen, duhet të bëhet një i tërë. Si rezultat, është e vështirë për publikun e gjerë të shohë se si do të ndryshojë situata ligjore.

552 Përparësitë e teknikës ndryshuese konsistojnë në faktin se janë vetëm ndryshimet dhe jo akti parësor në tërësi, të cilat diskutohen dhe miratohen gjatë procesit legjislativ. Për ata që zbatojnë ligjin, ndryshimet bëhen të dukshme si të tilla, duke e bërë më të lehtë për të kuptuar procedurën e ndryshimit. Përdorimi i teknikës ndryshuese do të thotë gjithashtu që ata që punojnë rregullisht me aktin parësor mund të përftojnë shpejt një pasqyrë të asaj se çfarë duhet të mësohet dhe të ndryshohet.

553 Përparësitë dhe disavantazhet e teknikës ndryshuese duhet të vlerësohen rast pas rasti. Përparësitë zakonisht i tejkalojnë disavantazhet kur:

- akti ligjor përqendrohet në shtrirjen aktuale të ndryshimeve që do të bëhen,
- ndryshimet duhet të vihen në dukje, dhe
- shtrirja e ndryshimeve tekstuale është e vogël krahasuar me shkallën e prekjes së aktit parësor.

554 Nëse qëllimi i propozimit legjislativ është të riorganizojë në mënyrë gjithëpërfshirëse një fushë lëndore, atëherë vetëm përdorimi i teknikës së ndryshimit mund ta bëjë këtë procedurë konfuze dhe të paqartë dhe mund të mos nxjerrë në pah mjaftueshëm rëndësinë politike të propozimit legjislativ. Subjektet të cilëve u drejtohet ligji do të kishin qasje në tekstin e plotë të aktit parësor nëse akti ndryshues do të pasohej nga ribotimi. Për atë arsye, kur një lëndë e caktuar duhet të riorganizohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, duhet të krijohet një akt parësori ri dhe ligji i zbatueshëm, i mëparshëm, të shfuqizohet (i ashtuquajturi "akt zëvendësues").

2 Aktet zëvendësuese

555 Një akt zëvendësues është një mjet formulimi për ndryshimet ligjore ose nënligjore. Ai përfaqëson një alternativë ndaj një akti ndryshues konkret.

556 Një akt zëvendësues krijon një akt parësor të ri për të zënë vendin e një ose disa akteve në fuqi. Ndryshimet gjithëpërfshirëse këtu nuk trajtohen në kontekstin e një akti ndryshues i cili ndryshon pjesë konkrete të tekstit, përkundrazi rishikohet i gjithë formulimi i aktit parësor. Ky quhet edhe rishikim thelbësor. Në këtë mënyrë, akti parësor "i vjetër" shfuqizohet.

557 Siç është edhe rregullimi i parë ligjor, një akt zëvendësues shkruhet në një gjuhë rregullatore. Kjo është arsyeja pse nuk është e mundur të identifikohet se çfarë është dhe çfarë nuk është ndryshuar në aktin e ri parësor.

558 Si rregull, sugjerohet që në rast se një akt parësor ndryshohet në më shumë se 50% në përmbajtjen e tij nga ndryshimet e mëvonshme, në vend të një akti ndryshues, duhet të miratohet një akt zëvendësimi.

559 Meqenëse akti zëvendësues është një akt parësori ri, ai strukturohet dhe citohet në të njëjtën mënyrë si çdo akt tjetër parësor (shih më shumë Pjesën C të këtij Manuali).

560 Rishikimi thelbësor ofron mundësinë për të bërë përmirësime, veçanërisht ato të një natyre gjuhësore ose sistematike. Kjo mundësi duhet të shfrytëzohet plotësisht. Duhet të merren parasysh rekomandimet në Pjesët C dhe D.

561 Duhet pasur kujdes i veçantë për të verifikuar referencat e kryqëzuara në aktin parësor "të vjetër" të përfshirë në ligjin e ri. Referencat në aktin e zëvendësuar ndonjëherë mund të ruhen si referenca të kryqëzuara në aktin zëvendësues. Kjo presupozon që titulli i plotë i aktit të zëvendësuar është ruajtur dhe vendndodhja e dispozitës së referuar nuk ka ndryshuar.

3 Aktet individuale ndryshuese

3.1 Tiparet karakteristike

562 Një akt ndryshues konkret është një mjet për formulimin e ndryshimeve. Është një alternativë ndaj një akti zëvendësues, por ndryshon nga akti gjithëpërfshirës ndryshues.

563 Kryesisht, një akt ndryshues konkret bën ndryshime vetëm në një akt parësor. Nëse dispozitat në aktet ligjore ose aktet nënligjore të tjera bëhen si rezultat të pasakta, atëherë ai gjithashtu përmban ndryshimet pasuese të nevojshme në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e ligjit të mbetur.

564 Një akt ndryshues konkret përdor një teknikë ndryshimi të veçantë, e cila nuk ndikon në përmbajtjen e aktit parësor. Ekzistojnë tri lloje të teknikave ndryshuese që përdoren:

- **Shtimi** është vendosja e tekstit (do të thotë gjithashtu togfjalëshi ose një fjalë të vetme) brenda tekstit ekzistues të një ligji, për shembull, vendosja e një fjalie të re midis fjalisë të parë dhe të dytë ekzistuese të një paragrafi. Shtesa është gjithashtu shtimi i tekstit para ose pas tekstit ekzistues të një ligji, për shembull, vendosja e një fjalie të re në fillim ose në fund të një paragrafi, ose vendosja e një nënparagrafi të ri në fund të nënparagrafëve ekzistues.
- **Zëvendësimi** do të thotë që një ose disa pjesë ekzistuese të tekstit zëvendësohen me tekst të ri, për shembull, një paragraf në ligjin ekzistues zëvendësohet me një paragraf të ri.
- **Shfuqizimi** është thjesht heqja e disa pjesëve ose e tërë tekstit të një ligji. Shfuqizimi mund të shoqërohet me ndryshime në të njëjtin ligj ose në ligje të tjera.

Shembull
Në një ligj të caktuar, së bashku me shfuqizimin e nenit 7 të një ligji, hartuesi mund të zëvendësojë tekstin e nenit 8 dhe të shtojë një paragraf në nenin 9, ose hartuesi mundet që në hartimin e ligjit Z të shfuqizojë disa nga dispozitat e ligjit X dhe të shfuqizojë plotësisht ligjin Y.

3.2 Titulli i akteve ndryshuese

565 Titulli i akteve ndryshuese duhet të tregojë faktin e ndryshimeve, duke përdorur formulime të përshtatshëm si për shembull fjala "shtesa", "ndryshime" ose "shtesa dhe ndryshime". Ky rregull zbatohet si në rastin kur ligji ndryshon si edhe kur shfuqizon ligjet ekzistuese. Por kur ligji vetëm shfuqizon një ligj të mëparshëm, titulli duhet të përdorë fjalën "shfuqizim".

566 Për hartimin e titullit të një ligji ndryshues është e mjaftueshme të përcaktohet ligji i ndryshuar me numrin, datën dhe titullin e tij, pa shtuar asgjë që lidhet me përmbajtjen e vetë ligjit ndryshues.

Shembull:
Ligji nr. 38/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996,"Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

3.3 Dispozita e bazës ligjore

567 Një akt ligjor ndryshues është një ligj i pavarur dhe për këtë arsye ka nevojë për një bazë ligjore. Rekomandimet në lidhje me bazën në aktet parësore zbatohen edhe për bazën ligjore në aktet ndryshuese individuale.

3.4 Dispozitat hyrëse

568 Çdo ndryshim i një akti parësor paraprihet nga një fjali hyrëse e cila specifikon ligjin që do të ndryshohet. Kjo është mënyra e vetme që formulat ndryshuese që vijojnë të mund të zbatohen saktësisht.

569 Në fjalinë hyrëse të aktit ndryshues thuhet se cili akt parësor është objekt i ndryshimit.

570 Akti parësor - edhe nëse përgjithësisht është i mirënjohur - duhet të referohet në fjalinë hyrëse duke përdorur citimin e plotë të tij (shih Pjesën C nënseksionin 4.1). Citimi i plotë pasohet nga shprehja standarde "... ndryshohet si më poshtë:".

Shembull
Në ligjin nr. 96/2016, datë 06.10.2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

3.5 Formulat ndryshuese

571 Dispozita hyrëse pasohet nga ndryshimet konkrete të aktit parësor. Renditja e ndryshimeve bazohet në strukturën e aktit parësor. Nuk ka rëndësi nëse ndryshimet e planifikuara në aktin parësor janë pak a shumë të rëndësishme, ose nëse ato janë ndryshime kryesore ose pasuese. Ndjekja e strukturës së aktit parësor e bën më të lehtë përfshirjen e ndryshimeve në formulimin e ligjit të zbatueshëm.

572 Çdo ndryshim duhet të hartohet në mënyrë që të jetë shumë e qartë se cili do të jetë formulimi i ardhshëm i ligjit. Nuk duhet të ketë vend për interpretim. Kjo arrihet duke përdorur shprehje të standardizuara për formulën ndryshuese.

573 Formula ndryshuese duhet të tregojë saktësisht se ku duhet të ndryshohet teksti ligjor dhe çfarë ndryshimi duhet të bëhet.

574 Ndryshimi mund t'i referohet një njësie të tërë strukturore (p.sh. shfuqizimi i një neni) ose mund të ndikojë në pjesë të formulimit brenda një njësie strukturore (p.sh. zëvendësimi i fjalëve konkrete në një fjali).

575 Këto janë formula konkrete ndryshuese:

- nëse teksti aktual pushon së zbatuari dhe nuk zëvendësohet me tekst të ri:
- "... shfuqizohet(n)."
- nëse teksti i ri do t'i shtohet tekstit aktual:
- "... shtohet(n) ... përpara ... / ...pas..."
- nëse teksti i mëparshëm ndryshohet me tekstin e ri:
- "... ndryshohet(n) si më poshtë ... / ... zëvendësohet(n) nga ..."

576 Për hir të thjeshtësisë, një fragment teksti i përzier, për shembull, që përmban një numër dhe më shumë se një fjalë të shkruar, referohet si "togfjalësh".

577 Të gjitha citimet e tekstit aktual dhe të ardhshëm shënohen duke përdorur thonjëza në dispozitën ndryshuese.

Shembuj
Në nenin 3, fjalët "reklama ose" që paraprijnë fjalën "programe" shfuqizohen.
Në nenin 4, togfjalëshi pas fjalëve "këshilli i personelit" shfuqizohet.

4 Struktura

4.1 Numërtimi i neneve të akteve ndryshuese

578 Numërtimi i dispozitave të një ligji ndryshues duhet të lidhet qartë me tekstin e ligjit parësor në mënyrë që të lehtësojë konsolidimin dhe të lejojë krijimin e kontekstit ligjor në një kohë të caktuar. Për pasojë:

- numrat ose identifikimi alfabetik i dispozitave të shfuqizuara nuk duhet të rivendosen në dispozitat ndryshuese, përveç kur ndryshohet e gjithë dispozita;
- duhet të shmanget rinumërtimi dhe riformulimi i identifikimit alfabetik të dispozitave të një ligji që ndryshohet. Në mënyrë të ngjashme, kur ndryshohet një dispozitë që përmban pjesë të paidentifikuara me numër ose shkronjë, është e këshillueshme që të gjithë pjesët të numërtohen ose të pajisen me shkronja. Këto çështje duhet të

trajtohen me shfuqizimin e plotë të ligjit, me konsolidimin (shih Pjesën E, seksioni 10) ose me kodifikimin (shih Pjesën A, seksioni 4);

- kur një dispozitë zëvendësohet tërësisht, është e lejueshme të rinumërohet ose riformulohet identifikimi alfabetik.

579 Për shembull, nëse ndryshohet një nen, paragrafët e nenit mund të rinumërtohen, ose nëse një paragraf ndryshohet, nënparagrafët mund të pajisen me shkronja, por hartuesi duhet të sigurojë që ndryshimet pasuese të bëhen në referencat e brendshme dhe të jashtme tek këto dispozita.

580 Për të futur një ose disa nene pasardhës në një vend të caktuar në tekstin e ndryshuar, nenit të ri i jepet numri i nenit paraardhës në tekstin e ndryshuar, i pasuar nga një vijë e pjerrët dhe një numër rendor arab.

Shembull
... pas nenit 17 shtohet neni 17/1, 17/2 dhe 17/3 ...

581 Hartuesi shqiptar duhet të jetë i vetëdijshëm se disa ligje, të tilla si Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, më parë kanë shtuar nene që identifikohen nga një vijë e pjerrët dhe një shkronjë, në rendin alfabetik të shqipes. Hartuesi nuk duhet të përdorë dy stile të ndryshme dhe gjithmonë duhet të kontrollojë ndryshimet e mëparshme dhe të përdorë të njëjtin stil hartimi.

582 Për të vendosur një ose disa nene pasues në një vend të caktuar midis neneve, titujt e të cilave përmbajnë vija të pjerrëta për shkak të ndryshimeve të mëparshme, nenit të ri i jepet numri i nenit paraardhës në tekstin e ndryshuar të pasuar nga një shkronjë në rendin alfabetik të shqipes.

Shembull
Nenet 28/2a dhe 28/2b shtohen midis neneve 28/2 dhe 28/3.

Zbatohet e anasjellta për ato ligje, të tilla si Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, ku nenet ndryshuese identifikohen nga një vijë e pjerrët dhe një shkronjë, dhe, në këtë rast, shtohet një numër rendor arab.

Shembull
Nenet 34/a1 dhe 34/a2 shtohen midis neneve 34/a dhe 34/b.

4.2 Veprimi ndryshues "shtohet"

583 Veprimi ndryshues "shtohet" përdoret kur njësitë e reja strukturore vendosen midis dy njësive strukturore ekzistuese.

584 Formula ndryshuese tregon fragmentin pas të cilit do të vendoset teksti i ri. Kur vendosen njësitë strukturore, kjo do të jetë njësia strukturore pas së cilës do të bëhet vendosja.

Shembull
1. Pas nenit 7 shtohen nenet 7/1 deri 7/4 me përmbajtjen si vijon:
"Neni 7/1..."
2. Pas nenit 9, pika 1, shkronja "c" shtohet shkronja "c/1" me përmbajtjen si vijon:
"c/1) ..."

585 Kur teksti duhet të futet brenda një njësie strukturore, citohet pjesa pas së cilës vendoset teksti i ri. Duhet të citohet vetëm aq tekst sa është e nevojshme për të identifikuar saktësisht tekstin përtej çdo dyshimi. Ndonjëherë një formulë ndryshuese mund të formulohet në mënyrë më koncize duke cituar fragmentin para të cilit duhet të vendoset teksti i ri. Togfjalëshi i cili shërben si pikë referimi vendoset në thonjëza. Gjithashtu, teksti që duhet të vendoset identifikohet duke përdorur thonjëza.

Shembull
Në nenin 19, pika 4, shkronja "b", pas fjalës "..." shtohet togfjalëshi "...".

586 Kur një njësi strukturore e një niveli më të lartë vendoset pa ndërprerë rendin ekzistues të neneve, vendoset njësia e re strukturore (numri fillestar i njësisë i ndjekur nga një vijë e pjerrët dhe një numër rendor arab) dhe titulli i njësisë strukturore të nivelit më të lartë. Vendi ku kjo ndërhyrje bëhet, duhet të tregohet qartë.

Shembull
Para/pas nenit .... shtohet kreu vijues:

"Kreu 8/1
Dispozitat përfundimtare"

587 Nëse do të shtohen fjali të plota, vetëm fjalia e cila shërben si pikë referimi për ndryshimin referohet me anë të një emërtimi numerik. Meqenëse

fjalitë nuk janë të numërtuara në aktet parësore, fjalive të vendosura nuk u jepet një emërtim numerik, as fjalitë pasuese nuk rinumërohen. Ata zhvendosen automatikisht më poshtë.

Shembull
Pas fjalisë së parë shtohen fjalitë e mëposhtme:
"..."

588 Kur duhet të bëhen ndryshime në një fjali e cila ka lëvizur automatikisht më lart ose më poshtë për sa i përket numërtimit, referenca tek ajo bëhet nëpërmjet përdorimit të emërtimit të ri numerik.

Shembull
"... në fjalinë e katërt të re."

589 Kur fjalitë zhvendosen automatikisht më lart ose më poshtë, **referencat e kryqëzuara** për fjali specifike në dispozitat e tjera do të duhet të verifikohen dhe, sipas rastit, të përshtaten.

590 Çdo veprim ndryshues duhet të shkruhet në atë mënyrë që teksti i ri ligjor të respektojë rregullat e gramatikës, drejtshkrimit dhe pikësimit.

4.3 Veprimi ndryshues "ndryshohet si më poshtë"

591 Veprimi ndryshues "ndryshohet si më poshtë" përdoret për të treguar që formulimi i një njësie strukturore është ndryshuar plotësisht pa ndryshuar përcaktimin numerik të njësisë strukturore. Ky veprim ndryshues mund të përdoret kur një njësi strukturore rishkruhet plotësisht ose përmbajtja është plotësisht ose kryesisht e re. Zakonisht është më mirë të rishkruhet (rishikohet) një njësi strukturore, nëse përdorimi i veprimeve të tjera ndryshuese do të shkaktonte konfuzion për shkak të shtrirjes së ndryshimeve që do të bëhen. Kjo zakonisht ndodh kur duhet të ndryshohet më shumë se gjysma e parashikimit ekzistues.

Shembuj
Kreu V ndryshohet si më poshtë:
"Kreu V
..."

Nenet 3 deri 5 ndryshohen si më poshtë:
"Neni 3
...

Neni 5
...”

Pika 3 ndryshohet si më poshtë:
“3. ...”
Pika 2, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:
“ç) ...”

Fjalia e parë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:
“2. ...”

592 Teksti i rishikuar shkruhet në gjuhën rregullatore pasi do të bëhet pjesë e aktit parësor dhe identifikohet duke përdorur thonjëza. Kur një njësi strukturore rishkruhet, formulimi i ri fillon me llojin përkatës dhe përcaktimin numerik dhe, ndoshta, me titullin, edhe nëse ato nuk kanë ndryshuar.

593 Ndryshimet në përmbajtjen e një neni mund të kërkojnë rishikimin e titullit të tij.

Shembull
1. Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:
a) Titulli ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3
Përfaqësimi i bordit”
b) Pika 3 shtohet si më poshtë:
“3. ...”

594 Referencat ndaj dispozitave të tjera, veçanërisht referencat e kryqëzuara, për shkak të veprimit ndryshues duhet të verifikohen dhe, kur është e nevojshme, të përshtaten. Së pari, ndryshimi i përmbajtjes mund të çojë në mospërputhje me dispozitat e tjera që i referohen dispozitës së ndryshuar. Së dyti, rishkrimi i një njësie strukturore mund të ndryshojë strukturën e saj, kështu që dispozitat e tjera që u referohen njësive konkrete mund të mos jenë më të sakta.

4.4 Veprimi ndryshues “zëvendësohet”

595 Veprimi ndryshues “zëvendësohet” do të thotë që një fragment teksti të shkëmbehet me një tjetër. Veprimi ndryshues “zëvendësohet” përdoret, për shembull, kur një ose disa njësi strukturore të ndërlidhura duhet të

zëvendësohen nga një numër i caktuar i njësive strukturore, në veçanti nga nenet, paragrafët ose fjalitë.

Shembuj
Krerët II dhe IV zëvendësohen nga Kreu II i mëposhtëm:
"Kreu II
..."

Nenet 3 deri 5 zëvendësohen nga nenet 3 deri 5 si më poshtë vijon:
"Neni 3
...
Neni 5
..."

Fjalia e tretë e nenit 8 zëvendësohet me fjalitë e mëposhtme:
"..."

Në nenin 14, pika 2, shkronjat "dh" dhe "e" zëvendësohen nga shkronjat "dh" dhe "e", si më poshtë vijon:
"dh) ...
e)..."

596 Veprimi ndryshues "zëvendësohet" mund të përdoret gjithashtu për të zëvendësuar një togfjalësh ose dispozita konkrete. Në raste të tilla u referohen pjesëve përkatëse të tekstit të mëparshëm dhe ato identifikohen duke përdorur thonjëza. Teksti i ri gjithashtu vihet në dukje duke përdorur thonjëza.

Shembull
Në pikën 3, fjalët "jo më shumë se një vit" zëvendësohen me fjalët "jo më shumë se tre vjet".

Kur një fjalë, togfjalësh ose një numër përdoret disa herë në njësinë strukturore që ndryshohet dhe duhet të zëvendësohet në secilin rast, kjo tregohet duke shtuar "në secilin rast".

Shembull
Në nenin 2, pikat 2 dhe 3, fjala "..." zëvendësohet me fjalën "..." në secilin rast.

597 Veprimi ndryshues "zëvendësohet" përdoret gjithashtu kur teksti pasues shtohet në fund të një fjalie. Në raste të tilla, teksti i ri zëvendëson pikën

në fund. Në interes të krijimit të një gjuhe ndryshuese të njëtrajtshme, ky veprim është gjithmonë i qartë dhe i preferuar krahasuar me opsionet e tjera. Teksti i ri shkruhet në gjuhën rregullatore dhe identifikohet duke përdorur thonjëzat. Pika në fundin e ri të fjalisë nuk duhet të harrohet.

Shembull
Në nenin 5, pika 2, pika në fund zëvendësohet me fjalët: "Neni 5 zbatohet sipas rastit.".

598 Kur një fragment zëvendëson një tjetër, pasojat për tekstin legjislativ në tërësi duhet të verifikohen me shumë kujdes. Për shembull, zëvendësimi i fragmenteve konkrete të tekstit mund të ketë pasoja në lidhje me drejtshkrimin, gramatikën dhe pikësimin në pjesën e mbetur të tekstit. Mund të lindë pyetja nëse njësitë strukturore pasuese duhet të rinumërohen. Mund të jetë e nevojshme të kontrollohen dhe mundësisht të përshtaten referencat e kryqëzuara në përputhje me rrethanat përkatëse.

4.5 Veprimi ndryshues "shfuqizohet"

599 Veprimi ndryshues "shfuqizohet" është heqja e disa pjesëve strukturore (p.sh. pjesë, tituj, Krerë, seksione, nene, paragrafë, shkronja) ose e tërë tekstit ekzistues të ligjit.

Shembull
Neni(et)..... shfuqizohet(n).

600 Shfuqizimi i njësive strukturore të nivelit më të lartë do të thotë që ato shfuqizohen në tërësinë e tyre, d.m.th. duke përfshirë të gjitha njësitë strukturore të nivelit më të ulët që ato përmbajnë.

601 Nëse një njësi e vetme strukturore e nivelit të lartë synohet të hiqet, por jo njësitë strukturore që përmban, atëherë hiqet vetëm titulli i njësisë strukturore të nivelit më të lartë.

Shembull
Titulli "Pjesa 3" shfuqizohet.

602 Nëse nga shfuqizimi i një ose më shumë paragrafëve mbetet vetëm një paragraf në nen, nënndarja ekzistuese në paragrafë bëhet e tepërt dhe duhet të hiqet. E njëjta gjë vlen përkatësisht për numrat dhe shkronjat.

Shembuj

1. Neni 133 ndryshohet si më poshtë:
   a) Emërtimi i pikës "1." hiqet.
   b) Pika 2 shfuqizohet.
2. Neni 134 ndryshohet si më poshtë:
   a) Pika 1 shfuqizohet.
   b) Emërtimi i pikës "2." hiqet.
   c) Pika 3 shfuqizohet.

603 Shfuqizimi i njësive strukturore të numërtuara në një akt parësor krijon boshllëqe në numërtim.

604 Për të ulur sasinë e punës që përfshin procesi i rinumërimit dhe referimit të kryqëzuar, boshllëqet në numërtim shpesh në praktikë tolerohen. Kur ribotohet ligji, shtohet pas përcaktimit numerik përkatës: "(Shfuqizuar)".

605 Fjalitë nuk numërtohen në aktet parësore. Kur, sidoqoftë, shfuqizohen fjalitë konkrete, ato duhet të përshkruhen saktësisht në formulën ndryshuese duke përdorur një përcaktim numerik. Fjalitë e mëposhtme nuk rinumërohen, ato zhvendosen më lart automatikisht. Nëse duhet të bëhen ndryshime në këto fjali, përdoret numërtimi i ri.

Shembull

1. Neni 3 ndryshohet si më poshtë:
   a) Fjalia e dytë shfuqizohet.
   b) Në fjalinë e re të tretë, fjala "..." zëvendësohet me fjalën "...".

606 Për shkak se fjalitë lëvizin automatikisht më lart në kuptimin e numërtimit, referimet e kryqëzuara në fjali specifike në dispozitat e tjera mund të kenë nevojë të ndryshojnë. Kjo është arsyeja që, kur shfuqizohen fjalitë, vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet përshtatjes së referencave të tërthorta që i referohen fjalive të shfuqizuara ose fjalive që ngrihen lart.

607 Kur hiqen fjalë konkrete, numra konkretë, etj., fragmentet e prekura të tekstit identifikohen duke përdorur thonjëza. Kur një fjalë ose një numër etj., përdoret disa herë në njësinë strukturore që ndryshohet dhe duhet të fshihet në secilin rast që është përdorur, kjo tregohet duke shtuar "në secilin rast".

Shembuj

1. Në nenin 3, fjala "....." shfuqizohet në secilin rast.
2. Në nenin 5, pika 2, fjalët "..." pas fjalës " ... " shfuqizohen.

608 Kur teksti shfuqizohet ose hiqet, teksti i mbetur duhet të jetë përsëri i **saktë nga ana gjuhësore**. Prandaj mund të jenë të nevojshme ndryshime shtesë.

Shembull

Në fjalinë "Njoftimet e përmendura në nenet 5 dhe 6 ose kërkesa e referuar në nenin 7 duhet t'i paraqiten me shkrim autoritetit kompetent së bashku me dokumentet e referuara në nenin 12" mundësia e përfshirjes së njoftimeve duhet të eliminohet, ndaj formula ndryshuese duhet të ketë këtë tekst:

Në fjalinë e parë kryhen ndryshimet e mëposhtme:

a) togfjalëshi "Njoftimet e përmendura në nenet 5 dhe 6 ose" shfuqizohet;
b) fjala "kërkesa" zëvendësohet me fjalën "Kërkesa".

Ndonjëherë në vend që të jepen udhëzime për disa ndryshime konkrete që do të bëhen, mund të jetë e nevojshme të zëvendësoni një fragment të tekstit me formulimin e ri. Në shembullin e mësipërm formula e ndryshimit mund të jetë me këtë tekst:

Në fjalinë e parë, togfjalëshi "Njoftimet e referuara në nenet 5 dhe 6 ose kërkesa e referuar në nenin 7" zëvendësohet me togfjalëshin "Kërkesa e referuar në nenin 7".

609 Po kështu, duhet të bëhet kujdes që pikësimi të përdoret në mënyrë korrekte.

610 Nëse ekziston rreziku që një shenjë pikësimi të neglizhohet, veçanërisht sepse përdoret në fillim të një citimi në thonjëza, kësaj mund t'i bëhet referencë specifikisht në formulën ndryshuese.

Shembull

Në pikën 3, togfjalëshi ", në çdo rast dhe jo më vonë se pas dy vjetësh" pas fjalës "..." shfuqizohet.

5 Lloje të tjera të ndryshimeve

5.1 Ndryshimi i titullit

611 Kur duhet të ndryshohet titulli i një ligji, ky është ndryshimi i parë dhe vjen para të gjitha formulave të tjera ndryshuese.

612 Ndryshimi i titullit duhet të shmanget nëse është e mundur. Ndryshimi i titujve përgjithësisht të njohur në veçanti mund të shkaktojë konfuzion dhe pasiguri. Për shembull, pavarësisht se ka një titull citimi të ri, ligji do të duhet ende të citohet duke përdorur datën e tij të vjetër të miratimit dhe referencën e tij të vjetër të botimit. Sidoqoftë mund të jetë e mundur të ndryshohet titulli nëse nuk pasqyron më në mënyrë të përshtatshme objektin e ligjit.

613 Një titull i shkurtër mund të shtohet në një akt parësor nëse deri në atë moment ai ka pasur vetëm një titull të gjatë gjë që e bën citimin të vështirë. Në raste të tilla, megjithatë, dispozitat në ligjet dhe aktet nënligjore e tjera që i referohen këtij akti do të duhet të përshtaten sepse titulli i ri i shkurtër bëhet më pas titulli i citimit.

5.2 Ndryshimet gjuhësore të passjella nga propozimi për ndryshime ligjore

614 Çdo propozim për ndryshime ligjore ofron mundësinë për të bërë gjithashtu ndryshimet e nevojshme gjuhësore në aktin parësor përkatës. Për shembull, emërtimet e vjetruara për zyrat, autoritetet, institucionet etj., zëvendësohen me emërtimet e tyre aktualë.

615 Ndryshime të tilla shpesh duhet të bëhen në disa dispozita konkrete në një ligj. Rekomandohet përdorimi i **formulave ndryshuese të përbashkëta**.

5.3 Ndryshimi i shtojcave

616 Shtojca është një element përbërës i një ligji dhe ndryshohet në të njëjtën mënyrë si njësitë strukturore e tjera.

617 Ndryshimet në një ligj mund t'u referohen vetëm shtojcave të tij. Në raste të tilla dispozita hyrëse dhe referimi në ndryshimin e fundit formulohen në të njëjtën mënyrë si bërja e një ndryshimi në një dispozitë të vetme.

618 Nëse bëhen edhe ndryshime të mëtejshme në aktin parësor, formula

ndryshuese në lidhje me shtojcën vjen e fundit.

Shembull

...

17. (p.sh. shfuqizimi i dispozitave kalimtare)
18. Shtojca ... shfuqizohet.

619 Kur shtojcat ndryshohen, zëvendësohen ose shtohen, formula ndryshuese duhet japë drejtpërdrejt formulimin e saj.

Shembull

18. Shtojca ..... ndryshohet si më poshtë: ...

620 Sidoqoftë, nëse teksti i shtojcës është shumë i gjatë dhe vendosja e saj në një vend konkret do ta bënte strukturën e aktit ndryshues konfuz dhe të paqartë, formulimi i ri i shtojcës mund të bëhet me të njëjtën formë, d.m.th. si një shtesë e aktit ndryshues.

Shembuj

1. Shtojca ... sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Shtohen Shtojcat 1 deri 5 si pjesë përbërëse e këtij ligji.

621 Nëse teksti në një tabelë ose grafikë ndryshon plotësisht, titujt ekzistues mbi kolonat konkrete duhet të përfshihen në formulën ndryshuese së bashku me fushën përkatëse në tabelë.

6 Ndryshimet me pasojë mbi akte të tjera

622 Aktet ndryshuese mund të çojnë gjithashtu në ndryshime pasuese që duhet të bëhen në ligje ose akte nënligjore të tjera. Ndryshimet pasuese të cilat garantojnë që dispozitat e ndryshuara janë në përputhje me ligjet e tjera duhet të formulohen duke përdorur formulën e duhur ndryshuese në secilin rast. Në çdo rast, kur kemi të bëjnë me ndryshime të rëndësishme të ligjeve të tjera, këto ndryshime duhet të përfshihen në një ligj të veçantë.

623 Kujdes i veçantë duhet kushtuar kur ligji i ri mund të shkaktojë ndryshime në një ligj që është miratuar nga një shumicë votash prej tre të pestash (3/5) të deputetëve në përputhje me procedurën e parashikuar nga neni 81(2) i Kushtetutës. Nenet e ligjit të ri që do të ndryshojnë ligjin me shumicë të cilësuar nuk mund të miratohen pa patur përsëri shumicën e cilësuar.

Shembull

Neni 72 i LGJA-së

Shfuqizime dhe ndryshime

1. Në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative hyjnë në fuqi ndryshimet e mëposhtme:

a) në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar:

i) në nenin 35, shkronja "b" shfuqizohet;
ii) në nenin 320, shkronja "a" shfuqizohet;
iii) nenet nga 324 deri në 333 shfuqizohen;

b) në ligjin nr. 8927, datë 25.7.2002 "Për prefektin", në nenin 14 nënndarjet "i" dhe "ii", në nenin 15 pika 2, si dhe në nenin 18 pika 4, ku respektivisht gjenden fjalët "gjykatës, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i qeverisjes vendore", "gjykatë, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i qeverisjes vendore", "gjykatës" dhe "gjykatës, nën juridiksionin e së cilës ndodhet subjekti i interesuar" zëvendësohen me fjalët "gjykatës administrative kompetente".

624 Ndryshimet që prekin ligjet e tjera zakonisht grupohen së bashku në një nen. Në praktikën aktuale këto ndryshime zakonisht grupohen së bashku me dispozitat shfuqizuese nën titullin "Shfuqizime dhe ndryshime" në fund të aktit, si në shembullin e sipërcituar. Gjithsesi, sugjerohet që të bëhet ndarja midis dispozitave të shfuqizimeve dhe dispozitave të ndryshimeve në ligje të tjera, ku parashikimet për ndryshime të grupohen në titullin "*Ndryshime në ligje të tjera*".

625 Në ndryshim nga neni që përmban ndryshime të aktit parësor, neni që përmban ndryshimet që prekin ligjet e tjera ndahet në paragrafë (pika më vete). Për secilin ligj apo akt nënligjor që preket krijohet një paragraf i veçantë në dispozitën përkatëse. Secili paragraf fillon me një fjali hyrëse për ligjin ose aktin nënligjor përkatës.

7 Dispozita kalimtare

626 Kur ndryshohet ligji në fuqi, shpesh nuk është e mundur të krijohet një kalim pa ndërprerje midis situatës ligjore të vjetër dhe asaj të re, pasi, për arsye kushtetuese ose arsye të tjera, duhet të merren parasysh

marrëdhëniet juridike ekzistuese. Në raste të tilla nevojitet një dispozitë kalimtare. Ajo përcakton se si duhet të trajtohen marrëdhëniet juridike ekzistuese.

627 Pa një dispozitë kalimtare nuk do të ishte e mundur trajtimi i çështjeve që nuk janë përfunduar ende në përputhje me dispozitat e aplikuara më parë, meqenëse ato ndërkohë janë shfuqizuar ose ndryshuar. Rregullat kalimtare mund të përdoren gjithashtu për të sqaruar të gjitha ato raste në të cilat nuk është e qartë nëse për një çështje të caktuar duhet të zbatohet ligji i vjetër apo i ri.

628 Meqenëse ato modifikojnë zbatueshmërinë e ligjit të ri, dispozitat kalimtare janë të ngjashme, në terma strukturorë, me rregullimet në aktin parësor. Kjo është arsyeja pse ato vendosen në aktin parësor përkatës. Kështu që subjektet të cilëve u drejtohet ligji mund të gjejnë dispozitat e reja ose të ndryshuara dhe dispozitat kalimtare shoqëruese në të njëjtin ligj.

629 Nëse akti ndryshues do të përmbante një nen të vetin me rregulla kalimtare, kjo do të çonte në një ndërthurje të padëshirueshme të gjuhës ndryshuese dhe gjuhës rregullatore. Akti ndryshues do të bënte më shumë sesa thjesht ndryshimin e aktit parësor ekzistues dhe vetë do të bëhej një lloj "akti parësor ndihmës" me një periudhë vlefshmërie e cila do të ishte e vështirë të përcaktohej. Kjo do të rriste në mënyrë të panevojshme numrin e akteve parësore të zbatueshme, prandaj duhet të shmangen.

630 Kur ekzistojnë ende akte ndryshuese me rregulla kalimtare, këto duhet të eliminohen duke i shfuqizuar ato ose - nëse ato ende zbatohen për rastet përkatëse - duke i transferuar ato në dispozitat përfundimtare të një akti parësor të duhur. Kjo procedurë ndihmon në **konsolidimin e legjislacionit** (shih seksionin 10 më poshtë).

631 Dispozitat kalimtare vendosen rregullisht në dispozitat përfundimtare të aktit parësor. Ato mund të bashkohen në një nen ose të grupohen së bashku në disa nene të ndryshme. Në raste të caktuara mund të jetë e dobishme të vendosen diku tjetër.

8 Hyrja në fuqi

632 Data e hyrjes në fuqi duhet të **përcaktohet qartë dhe saktë** në aktet ndryshuese. Ato aspekte që duhet të merren në konsideratë në lidhje me dispozitën e hyrjes në fuqi tashmë janë detajuar në lidhje me miratimin e

akteve parësore (shih Pjesa D seksionin 9); e njëjta vlen për aktet konkrete ndryshuese nëse nuk bëhet referencë në vijim për tipare të tjera specifike.

633 Dispozita për hyrjen në fuqi vendoset në nenin e fundit të aktit ndryshues.

634 Shprehja *"Ky ligj hyn në fuqi më ..."* përdoret gjithashtu në aktet ndryshuese. Ai tregon fillimin e fuqisë juridike të aktit ndryshues. Kjo do të thotë që formulat ndryshuese pasi bëhen efektive, përfshihen në aktin parësor dhe, kësisoj, bëhen të pavlefshme.

635 Formulat ndryshuese i referohen gjithmonë një versioni shumë specifik të një teksti ligjor. Nëse hyrja në fuqi e ndryshimeve përcaktohet shumë larg në të ardhmen, ekziston një rrezik më i madh që teksti të cilit i referohen ndryshimet të ndryshohet gjatë kësaj kohe. Ndryshimet të cilat janë shpallur, por që ende nuk kanë hyrë në fuqi (ndryshimet në pritje), mund të shkaktojnë mospërputhje në tekst ose të mos jetë më e mundur të realizohen ndryshimet. Për këtë arsye, afati i hyrjes në fuqi të ndryshimeve **nuk duhet të jetë shumë i gjatë**.

636 Nëse ndryshimet hyjnë në fuqi në periudha të ndryshme, grupimi i ndryshimeve të cilat hyjnë në fuqi në të njëjtën datë në një paragraf të veçantë i bën dispozitat për hyrjen në fuqi shumë më të qarta.

9 Akti gjithëpërfshirës ndryshues

637 Një akt gjithëpërfshirës ndryshues është një mjet me të cilin ligje të ndryshme mund të ndryshohen, krijohen ose shfuqizohen me një **akt ligjor të vetëm**. Duhet të ketë një lidhje mjaft të ngushtë midis pjesëve individuale të një akti gjithëpërfshirës ndryshues.

Shembull
Ligji nr.10 137, datë 11.5.2009, "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"

638 Forma e një akti ndryshues gjithëpërfshirës kërkohet në mënyrë të veçantë sa herë që disa akte parësore preken nga ndryshimet kryesore të cilat janë të lidhura ngushtë sa i takon përmbajtjes dhe në këtë mënyrë një akt ndryshues individual me ndryshime pasuese nuk është opsion.

639 Një akt ndryshues gjithëpërfshirës mund të kombinojë të gjitha format kryesore të legjislacionit. Në nene individualë dhe nën një titull mund të përdoret, ndër të tjera, për të:

- ndryshuar disa akte parësore, ndonjëherë të shumta në numër,
- zëvendësuar aktet parësore dhe në të njëjtën kohë të ndryshojë të tjerët, ose
- kombinuar rregullimet e para legjislative me ndryshimin ose zëvendësimin e akteve parësore.

640 Më tej, një akt gjithëpërfshirës ndryshues përmban ndryshime pasuese që duhet të bëhen në ligje ose akte nënligjore nëse kjo është e nevojshme për të ruajtur njëtrajtshmërinë e pjesës së mbetur të ligjit me dispozitat e ndryshuara ose të krijuara rishtazi në aktin ndryshues gjithëpërfshirës.

641 Akti gjithëpërfshirës ndryshues ka vetëm një dispozitë si bazë ligjore dhe një formulë përmbyllëse, si dhe një dispozitë për hyrjen në fuqi.

642 Rekomandimet në lidhje me aktet fillestare, aktet zëvendësuese dhe aktet individuale ndryshuese kryesisht zbatohen edhe për aktet ndryshues gjithëpërfshirës. Kjo është arsyeja pse vetëm tiparet specifike të aktit gjithëpërfshirës ndryshues do të detajohen në vijim.

10 Konsolidimi i akteve

10.1 Statusi Ligjor

643 Legjislacioni i konsoliduar, në formën më të thjeshtë të tij, nuk i ndryshon ligjet; ai thjeshtë përmbledh normat ligjore ekzistuese. Nëse konsolidimi nuk është i saktë, kjo nuk ndryshon ligjet; në këtë rast do të zbatohen dispozitat e ligjeve që janë përmbledhur në tekstin e konsoliduar.

644 Konsolidimit, si rrjedhim, i duhet vendosur një parathënie që përcakton efektet ligjore të tij. Të tilla konsolidime mund të përgatiten pa qenë e nevojshme që të parashikohet kompetencë specifike.

645 Qendra e Botimeve Zyrtare është institucioni përgjegjës për përgatitjen e konsolidimit të kodeve dhe ligjeve të tjera në Shqipëri.

10.2 Objektivat e konsolidimit

646 Ligjet ndryshuese mund të krijojnë vështirësi dhe ndoshta konfuzion. Përdoruesit e ligjit nuk mund të përcaktojnë gjendjen juridike të tij duke iu referuar vetëm një ligji. Ky problem është më i mprehtë në fushat ku ka pasur ndryshime thelbësore, ose ku ndryshimet janë veçanërisht të rëndësishme.

647 Përgatitja e një teksti të konsoliduar është një mjet i dobishëm për të përmirësuar qasjen në ligj dhe duhet të ndërmerret rregullisht. Kjo veçanërisht kur legjislacioni ka një rëndësi të menjëhershme praktike për individin.

648 Konsolidimi duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe mund të lehtësohet nga teknikat kompjuterike të përparuara. Personat që merren me konsolidimin e ligjeve duhet t'i shfrytëzojnë ato teknika.

10.3 Rregullat formale të konsolidimit

649 Data para së cilës janë konsoliduar të gjitha ndryshimet në ligjin në fjalë duhet të tregohet menjëherë pas titullit të ligjit të konsoliduar me shënimin e numrave dhe datave të miratimit të ligjeve ndryshuese.

650 Teksti i konsoliduar duhet të përmbajë tekstin origjinal të ligjit me të gjitha ndryshimet pasuese dhe referencat tek ligjet ndryshuese.

Shembull
Neni 23/2

Riorganizimi
(*shtuar me ligjin nr. 2545, datë 10.03.1996, në fuqi që nga data 30.04.1996*)

651 Nëse dispozitat e tekstit origjinal të ligjit janë shfuqizuar më vonë, kjo duhet të tregohet në konsolidim duke iu referuar ligjeve që i shfuqizojnë ato.

Shembull
Neni 35 (i *shfuqizuar nga ligji nr. 2545, datë 10.03.1996, në fuqi që nga data 30.04.1996*)
Sidoqoftë, siç tregohet në këtë shembull, nëntitulli dhe teksti i një dispozite të shfuqizuar nuk duhet të përfshihen në tekstin e konsoliduar.

652 Dispozitat kalimtare të ligjeve parësore dhe të atyre ndryshuese nuk duhet të përfshihen në tekstin e konsoliduar.

Pjesa F
Aktet e përafrimit me *acquis* e Bashkimit Evropian

1 Konsiderata të përgjithshme mbi traktatet dhe institucionet e BE-së

653 Bashkimi Europian (BE) është një bashkim i 27 shteteve evropiane i ngritur mbi një numër gjithëpërfshirës traktatesh që kanë evoluar me kalimin e kohës. Këto traktate vendosin strukturat, organet dhe procedurat të cilat rregullojnë dhe u japin trajtë marrëdhënieve midis Shteteve Anëtare të BE-së.

654 BE-ja e ka origjinën në Komunitetet Evropiane. Këto ishin Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut (KEQÇ) dhe Komuniteti Evropian Ekonomik (KEE). KEE-ja u riemërtua Komuniteti Evropian (KE) në vitin 1993 nga Traktati i Mastrihtit. Komuniteti themelues i procesit të integrimit evropian është Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike (KEEA ose Euratom).

655 Në vitin 1993, Traktati i Mastrihtit krijoi BE-në bazuar në tre shtylla. Shtylla e parë, e ashtuquajtura 'Shtylla e Komunitetit', e cila ka një karakter supra-kombëtar, përfshin tri Komunitetet Evropiane. Shtylla e dytë dhe e tretë, të cilat kanë një karakter ndërqeveritar, kanë të bëjnë përkatësisht me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (PPJS) dhe bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale (BPGP).[206] KEQÇ-ja pushoi së ekzistuari në vitin 2002 kur përfundoi traktati themeluesi tij. Komuniteti Evropian u shndërrua në BE nga Traktati i Lisbonës[207] në vitin 2009, ku BE-ja është pasardhësi ligjor i Komunitetit. Emërtimi "*Bashkimi Europian*" qysh atëherë zëvendëson Komunitetin Evropian. Sidoqoftë, sistemi ligjor i BE-së ende i referohet Komunitetit nën të cilin u miratua. Euratom-i mbeti një subjekt i ndryshëm nga BE-ja, por ai drejtohet prej të

206 Struktura me tre shtylla është suprimuar nga Traktati i Lisbonës në vitin 2009.
207 Traktati i Lisbonës u nënshkrua nga vendet anëtare të BE-së në 13 dhjetor 2007 dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009.

njëjtave institucioneve duke përfshirë Komisionin Evropian dhe është nën juridiksionin e GJED-së.

656 Titulli i Direktivave të miratuar para hyrjes në fuqi të Traktatit të Mastrihtit fillon me "Direktiva VVVV/NN/**KEE** (ose një referencë tjetër për Traktatin e Komunitetit nën të cilin u miratua).". Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, titulli i Direktivës fillon me "Direktiva VVVV/NN/**BE**" ose "Direktiva VVVV/NN/**EURATOM**". Që nga viti 2015 referencat janë harmonizuar dhe kanë formatin e mëposhtëm: "Direktiva **(BE) VVVV/NN**".

Shembuj

Direktiva e Këshillit 92/29/KEE e 31 Marsit 1992 mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për trajtimin e përmirësuar mjekësor në bordin e anijeve, është miratuar përpara themelimit të KE-së në vitin 1993 dhe për këtë arsye ende i referohet KEE-së, nën të cilën u miratua.

Kjo Direktivë - ndër të tjera - u ndryshua nga Direktiva 2007/30/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 Qershorit 2007 që ndryshon Direktivën e Këshillit 89/391/KEE, Direktivat individuale të saj dhe Direktivat e Këshillit 83/477/KEE, 91/383/KEE, 92/29/KEE dhe 94/33/KE.

Ndryshimi i fundit i kësaj Direktive u realizua nga Direktiva e Komisionit (BE) 2019/1834 e 24 Tetor 2019 që ndryshon Anekset II dhe IV të Direktivës së Këshillit 92/29/KEE.

657 BE-ja bazohet në Traktatin e Bashkimit Evropian (**Traktati i BE**-së) dhe Traktatin për Funksionimin e BE-së (**TFBE**). Traktati Themelues i Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike (**Traktati i Euratom**-it) vazhdon të zbatohet në formë të modifikuar. Traktati i KE-së është zëvendësuar nga **TFBE**-ja. Neni 6 i Traktatit të BE-së është ndryshuar, si rezultat i së cilës bëhet ligjërisht e detyrueshme për shtetet anëtare **Karta e të Drejtave Themelore** të BE-së kur bëhet fjalë për zbatimin e së drejtës së BE-së dhe për këtë arsye parimet e saj duhet të respektohen gjatë rishikimit të legjislacionit. Nuk është e nevojshme të përdoren **citimet e plota** të këtyre traktateve (për informacione më të hollësishme mbi citimet shihni pjesën 9 më poshtë).

658 **Institucionet kryesore** të BE-së parashtrohen si më poshtë:

- *Parlamenti Evropian* luan një rol të rëndësishëm në hartimin e akteve ligjore të BE-së.
- *Këshilli Evropian* përbëhet nga kryetarët e shteteve ose qeverive të 27 Shteteve Anëtare të BE-së, Presidenti i Këshillit Evropian dhe Presidenti i Komisionit Evropian. Këshilli Evropian përcakton drejtimin dhe përparësitë e përgjithshme politike të BE-së. Nuk është një nga institucionet ligjvënëse të BE-së, kështu që nuk negocion ose miraton aktet ligjore të BE-së. Në vend të kësaj, Këshilli Evropian përcakton axhendën e politikave të BE-së, tradicionalisht duke miratuar 'konkluzione' gjatë takimeve të tij, të cilat identifikojnë çështjet e interesit dhe veprimet që duhen ndërmarrë.
- *Këshilli* ose Këshilli i BE-së është një organ vendimmarrës thelbësor i BE-së. Këshilli negocion dhe miraton akte ligjore në shumicën e rasteve së bashku me Parlamentin Evropian. Në këto raste, Këshilli nxjerr ligje në bazë të propozimeve të paraqitura nga Komisioni Evropian. Në aktet ligjore dhe në fjalinë hyrëse t Rregulloreve, Direktivave dhe Vendimeve, termi "Këshilli i Bashkimit Europian" përdoret për t'iu referuar Këshillit të përbërë nga përfaqësues të Shteteve Anëtare në nivelin ministror; "Këshilli" përdoret në titullin e aktit ligjor dhe në vetë marrëveshjen.
- *Komisioni* (KE) ose Komisioni i Bashkimit Evropian; këto emërtime përdoren në tekstet ligjore, megjithëse vetë Komisioni përdor emërtimin "Komisioni Evropian".
- *Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian* (GJDBE) është e ndarë në dy gjykata: GJED-ja - merret me kërkesat për vendimet paraprake nga gjykatat e brendshme, veprimet e caktuara për anulim dhe ankimimet dhe Gjykata e Përgjithshme - vendos mbi paditë shfuqizuese të ngritura nga individë, kompani dhe, në disa raste, qeveri të BE-së. Në praktikë, kjo do të thotë që kjo gjykatë merret kryesisht me ligjin e konkurrencës, ndihmën shtetërore, tregtinë, bujqësinë, markat tregtare.
- *Gjykata Evropiane e Auditorëve*, e cila është agjencia e jashtme profesionale e kontrollit financiar e ngarkuar me auditin e llogarive dhe mbikëqyrjen e implementimit të buxheteve të institucioneve të BE-së.

2 Burimet e së drejtës së BE-së

659 Në themel të çështjes së burimeve të së drejtës së BE-së janë dy nocione që janë ngushtësisht të lidhura, por të dallueshme nga njëra-tjetra, konkretisht, *acquis* i BE-së[208] dhe legjislacioni i BE-së.

208 Versioni më i fundit i korpusit të *acquis-së* së BE mund të vizitohet në www.eur-lex.europa.eu/en/index.htm

660 *Acquis* i BE-së – '*acquis*' i BE-së është sistemi i të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta që janë detyruese për të gjitha vendet e BE-së, si Shtete Anëtare të BE-së. Ky koncept evoluon vazhdimisht dhe përfshin:

- përmbajtjen, parimet dhe objektivat politike të Traktateve;
- legjislacionin e miratuar në zbatim të traktateve dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së;
- deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga BE-ja;
- masat në lidhje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë;
- masat në lidhje me drejtësinë dhe punët e brendshme;
- marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga BE-ja dhe ato të lidhura nga vendet e BE-së mes tyre në fushën e aktiviteteve të BE-së.[209]

661 Vendeve kandidate u kërkohet të pranojnë *acquis*-në para se të mund të anëtarësohen në BE. Shmangiet nga *acquis*-ja lejohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe janë të kufizuara në fushën e zbatimit të tyre. *Acquis*-ja duhet të përfshihet nga shtetet kandidate në rendin e tyre juridik të brendshëm përpara momentit së pranimit të tyre në BE dhe ata janë të detyruar ta zbatojnë atë nga ajo datë.

662 Legjislacioni i BE-së – Legjislacioni i BE-së përbëhet nga Traktatet themeluese (e drejta parësore), marrëveshjet ndërkombëtare me vendet jo-anëtare të BE-së dhe aktet ligjore që miratohen nga institucionet europiane, të cilat i mundësojnë BE-së të ushtrojë kompetencat e saj (e drejta dytësore: rregulloret, direktivat, vendimet, rekomandimet dhe opinionet) si dhe burimet plotësuese të së drejtës (shih më poshtë).

663 Marrëveshjet ndërkombëtare me vendet jo-anëtare të BE-së ose me organizata ndërkombëtare janë gjithashtu pjesë integrale e legjislacionit të BE-së. Këto marrëveshje janë të ndryshme nga e drejta parësore dhe dytësore dhe formojnë një kategori *sui generis*. Sipas disa vendimeve të GJDBE-së, ato kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe efekti i tyre juridik është mbizotërues përkundrejt legjislacionit dytësor, që duhet të përputhet me to.[210]

2.1 E drejta parësore

664 Burimet kryesore të së drejtës parësore janë traktatet themeluese të

209 https://eur-lex.europa.eu/summary/glossary/acquis.html
210 https://eur-lex.europa.eu/summary/glossary/community_law.html

BE-së: Traktati i BE-së, TFBE-ja dhe Traktati i Euratom-it.[211] Këto traktate përcaktojnë shpërndarjen e kompetencave ndërmjet BE-së dhe Shteteve Anëtare të BE-së, duke përshkruar kompetencat e institucioneve evropiane. Prandaj, ato përcaktojnë kuadrin ligjor në të cilin institucionet e BE-së funksionojnë për të zbatuar politikat komunitare

665 E drejta parësore gjithashtu përfshin:

- traktatet ndryshuese të BE-së;
- protokollet e bashkëlidhura traktateve themeluese dhe traktateve ndryshuese;
- traktatet për aderimin e vendeve të reja në BE;
- Kartën e të Drejtave Themelore (qysh nga Traktati i Lisbonës — dhjetor 2009);
- parimet e përgjithshme të së drejtës të konstatuara nga GJDBE-ja.

666 **Traktatet** janë baza politike dhe ligjore për të gjitha Vendimet e institucioneve të BE-së dhe bëhen pjesë e sistemit ligjor vendas sapo një shtet bëhet pjesë e BE-së. Ata nuk kërkojnë transpozimin në sistemet e brendshme juridike.

2.2 E drejta dytësore

667 Legjislacioni dytësor i BE-së përpilohet nga institucionet e BE-së. Pesë instrumentet juridike të BE-së të parashikuara posaçërisht në nenin 288 të TFBE-së janë të natyrës detyruese (Rregullore, Direktiva, Vendime) dhe të natyrës jodetyruese (Rekomandime dhe Opinione). Secili prej këtyre akteve ka veçoritë e veta dhe u nënshtrohet rregullave të ndryshme kur bëhet fjalë për përfshirjen ose transpozimin e tyre në sistemin juridik të brendshëm të Shteteve Anëtare.

668 **Rregulloret** kanë zbatim të përgjithshëm (neni 288 i TFBE-së). Ato janë detyruese në tërësinë e tyre dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

- Rregulloret zbatohen si për Shtetet Anëtare ashtu edhe për personat fizikë dhe juridikë. Dispozitat e tyre mund të kenë efekt të drejtpërdrejtë mbi individët nëse ato janë formuluara qartë, janë të pakushtëzuara,

211 Traktati i Lisbonës, në fuqi që nga 1 dhjetori 2009, prezantoi ndryshime si në Traktatin e Bashkimit Evropian (Traktati i Mastrihtit), ashtu edhe në Traktatin e Themelimit të Komunitetit Evropian (Traktati i Romës). Traktati themelues i Komunitetit Evropian është riemërtuar 'Traktati i Funksionimit të Bashkimit Evropian' dhe termi 'Komunitet' është zëvendësuar me 'Bashkim' në të gjithë tekstin.

si dhe nëse ato shtrijnë të drejta ose detyrime ndaj subjekteve të tyre.

- Rregulloret përbëjnë instrumentin themelor të unifikimit të legjislacionit në të gjitha Shtetet Anëtare.
- Para aderimit së një vendi në BE, ato nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme, por mund të duhet të integrohen (për më tepër shihni në seksionin 6 më poshtë).
- Pas aderimit, Rregulloret janë drejtpërdrejt të zbatueshme në rendin juridik të Shteteve Anëtare, që do të thotë se legjislacionet e brendshme nuk lejohen t'i transpozojnë ato. Në raste specifike, një Shteti Anëtar mund t'i kërkohet të miratojë legjislacionin zbatues për t'i dhënë efekt një rregulloreje (për shembull, kur legjislacioni është i nevojshëm për të krijuar një autoritet kombëtar përgjegjës për mbikëqyrjen dhe detyrat e tjera në fushat specifike të mbuluara nga Rregullorja).

669 **Direktivat** janë detyruese për të gjitha Shtetet Anëtare, ndaj të cilave ato janë adresuar, në lidhje me rezultatin që do të arrihet, por i lënë hapësirë autoriteteve vendase për zgjedhjen e formës dhe çështjeve të lidhura me to (neni 288 i TFBE-së).

- Direktivat zbatohen për Shtetet Anëtare dhe, si rregull, vetëm pasi ato të jenë transpozuar në të drejtën e brendshme, për personat fizikë ose juridikë.
- Direktivat gjithmonë kërkojnë transpozim (referenca e drejtpërdrejtë nuk siguron përputhshmëri faktike, nëse përmbajtja nuk është transpozuar siç duhet).
- Dispozitat e tyre mund të kenë efekt vertikal të drejtpërdrejtë kur Shteti Anëtar nuk ka arritur të transpozojë Direktivën në kohën e duhur dhe në mënyrë të saktë, si dhe kur ato janë të formuluara qartë dhe janë të pakushtëzuara dhe i shtrijnë të drejtat tek personat fizikë ose juridikë. Direktivat nuk kanë efekt horizontal të drejtpërdrejtë, domethënë ato nuk mund të paraqiten para një gjykate të brendshme në gjykimet ndërmjet personave fizikë ose juridikë.

670 **Vendimet** janë detyruese në tërësinë e tyre. Vendimet që specifikojnë subjektet ndaj të cilëve adresohen janë të detyrueshme vetëm për ta (Neni 288 i TFBE-së). Ata janë akte juridike individuale të cilët përcaktojnë posaçërisht subjektet (një shtet, një numër shtetesh, persona fizikë, persona juridikë). Vendimet janë drejtpërdrejt të zbatueshëm, përveç kur përmbajtja e dispozitave të tyre kërkon zbatimin nëpërmjet miratimit të ligjeve të brendshme.

671 **Vendimi kuadër** është një lloj akti juridik me karakter detyrues që nuk përdoret më që kur Traktati i Lisbonës hyri në fuqi në dhjetor 2009. Një Vendim kuadër përcaktonte objektivat që Shtetet Anëtare duhet të përmbushnin. Shtetet Anëtare ishin të lira të zgjidhnin mënyrën në të cilën do të zbatonin objektivat e kërkuara. Vendimi kuadër u përdor ekskluzivisht në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme.[212] Sidoqoftë, Vendimet kuadër të miratuar para hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës janë pjesë e *acquis*-së së BE-së dhe kanë nevojë për transpozim, si Direktivat e BE-së (shih më lart).

672 **Instrumentet ligjorë jo-detyrues** të përcaktuar në nenin 288 të TFBE-së janë si më poshtë:

- *Rekomandimet* që i bëjnë thirrje palës së cilës i adresohen të sillet në një mënyrë të posaçme pa i vendosur ato nën ndonjë detyrim ligjor;
- *Opinionet* e dhëna nga institucionet e BE-së japin vlerësime të situatave ose zhvillimeve në Bashkim ose në Shtetet Anëtare individuale. Ato gjithashtu mund të përgatisin rrugën për akte të mëvonshme, juridikisht detyruese, ose të jenë një parakusht për fillimin e procedurave para GJED-së.
- *Rekomandimet* dhe *Opinionet* kanë rëndësi morale dhe politike, pa qenë ligjërisht të detyrueshme, por mund të përmbajnë udhëzime të rëndësishme. Si të tilla, ato mund të konsiderohen si "ligj i butë".

673 Forma të tjera kryesore të veprimeve që i japin formë rendit juridik të BE-së pa pasur efekt juridikisht detyrues janë Rezolutat, Deklaratat dhe Programet e Veprimit.

674 **Burimet plotësuese të së drejtës** janë elemente të së drejtës që nuk përmenden posaçërisht në traktate. Kjo kategori përfshin:

- *praktikën gjyqësore* e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së;
- *të drejtën ndërkombëtare* - shpesh një burim frymëzimi për GJED-në kur zhvillon praktikën e saj gjyqësore. GJDBE-ja citon ligjin e shkruar, të drejtën ndërkombëtare zakonore dhe praktikën;
- *parimet e përgjithshme të së drejtës* - burime të pashkruara të së drejtës të zhvilluara nga praktika gjyqësore e GJDBE-së. Ato i kanë lejuar GJDBE-në të zbatojë rregulla në fusha të ndryshme që nuk përmenden në traktate.

212 Një shembull i një Vendimi kuadër është 'Vendimi Kuadër i Këshillit i 13 Qershorit 2002 mbi urdhrin evropian të arrestit dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet Shteteve Anëtare (2002/584/JHA).

675 **GJDBE**-ja ka autoritetin përfundimtar për interpretimin juridik të Traktatit dhe legjislacionit të BE-së. Ajo ka zhvilluar parime të rëndësishme në lidhje me harmonizimin e së drejtës drejtpërdrejtë të zbatueshme të BE-së dhe transpozimin e Direktivave. Prandaj, vendet duhet të konsiderojnë me kujdes ndikimin e vendimeve të GJDBE-së në interpretimin e së drejtës së BE-së dhe pasojat e tyre në lidhje me harmonizimin dhe transpozimin e së drejtës së BE-së.

	Efektet	**Adresuar**	**Përafrimi për Shtetet Anëtare**	**Përafrimi për Shqipërinë**
Rregullore	Drejtpërdrejt të zbatueshme dhe detyruese në tërësinë e tyre	të gjithë shtetet Anëtare dhe personat fizikë dhe juridikë	Nuk është e nevojshme: drejtpërdrejt e zbatueshme	E nevojshme - në pajtim me prioritetet e brendshme dhe planin e përafrimit të legjislacionit **Për dispozitën e integruar duhet të përfshihet një shënim i posaçëm në aktin normativ të miratuar, duke e bërë atë të identifikueshëm për shfuqizimin në datën e aderimit.**
Direktiva	Detyruese në lidhje me rezultatin e synuar	Të gjithë ose Shtete Anëtarë të caktuar	E nevojshme	E nevojshme - në pajtim me prioritetet e brendshme dhe planin e përafrimit të legjislacionit

	Efektet	Adresuar	Përafrimi për Shtetet Anëtare	Përafrimi për Shqipërinë
Vendime	Drejtpërdrejt e zbatueshme dhe detyruese në tërësinë e tyre	të gjithë ose Shtete Anëtare të caktuar, persona fizikë dhe juridikë të caktuar	Nuk është e nevojshme: drejtpërdrejt e zbatueshme	Nuk është e nevojshme - vetëm nëse specifikisht është e nevojshme për Shqipërinë **Për dispozitën e integruar duhet të përfshihet një shënim i posaçëm në aktin normativ të miratuar, duke e bërë atë të identifikueshëm për shfuqizimin në datën e aderimit.**
Rekoman-dimet dhe opinionet	jo-detyrues	Të gjithë ose Shtete Anëtarë të caktuar, organe të tjera të BE-së, individë	Nuk është e nevojshme	Përgjithësisht, nuk është e nevojshme - vetëm nëse specifikisht është e nevojshme për Shqipërinë

3 Aksesi në të drejtën e BE-së

676 EUR-Lex-i është porta zyrtare online për legjislacionin e BE-së. Ai siguron qasjen zyrtare dhe më gjithëpërfshirëse në dokumentet juridike të BE-së. Është në dispozicion në 24 gjuhët zyrtare të BE-së dhe përditësohet çdo ditë. EUR-Lex-i administrohet nga Zyra e Publikime të Bashkimit Evropian, duke ofruar qasje në dokumentet e mëposhtëm juridikë të BE-së:

- Traktatet;
- Aktet ligjore të institucioneve të BE-së;
- Dokumentet përgatitore në lidhje me legjislacionin e BE-së;
- Praktika gjyqësore në BE;
- Marrëveshjet ndërkombëtare;
- Dokumentet e EFTA-s;
- Referencat dhe, për ato Shtete Anëtare që kanë dhënë pëlqimin, edhe tekstet e masave të brendshme të përafrimit;
- Referencat në praktikën gjyqësore të brendshme në lidhje me të drejtën e BE-së.

677 Çdo dokument në EUR-Lex është i pasuruar me informacion të detajuar, të tillë si marrëdhëniet me dokumente juridike të tjera, interpretimet e praktikës gjyqësore, datat e miratimit/hyrjes në fuqi/zbatueshmërisë, bazës ligjore, akteve ndryshuese, etj. (shih gjithashtu Pjesën B, nën-seksionin 7.2).

678 EUR-Lex-i ofron qasje në të gjitha numrat e Fletores Zyrtare të Bashkimit Europian (FZBE) që nga numri i parë i saj, i dhjetorit 1952. Që nga 1 korriku 2013, botimi elektronik i FZ-së që botohet në EUR-Lex është autentik dhe prodhon efekte juridike.

679 EUR-Lex-i ndihmon gjithashtu përdoruesin të kuptojë legjislacionin e BE-së duke siguruar:

- fazat kryesore të procedurave që çojnë në miratimin e akteve juridike;
- tekstet e përditësuara që kombinojnë aktet juridike fillestare dhe të gjitha ndryshimet e tyre në dokumente të vetme;
- mbi 2000 përmbledhje të legjislacionit të BE-së që shpjegojnë legjislacionin në një mënyrë të thjeshtë, të lehtë për t'u lexuar dhe koncize.

3.1 Numri CELEX

680 Shumicës së dokumenteve në EUR-Lex - pavarësisht nga gjuha në të cilën janë shkruar - u caktohet një numër CELEX, i cili është një identifikues unik. Të mësuarit si lexohen këto numra e ndihmon përdoruesin të kërkojë më shpejt dhe të kuptojë se si dokumentet lidhen me njëri-tjetrin. Ekzistojnë 4 pjesë të një numri CELEX:



fig. 2. Detajimi i numrit CELEX

681 Numri CELEX përbëhet nga një renditje prej nëntë deri në njëmbëdhjetë numrash dhe shkronjash (SyyyyTnnnn) që interpretohet si më poshtë:

S - tregon numrin e sektorit të aktit. Baza e të dhënave CELEX është e ndarë në dhjetë sektorë, ku secili përfaqëson një kategori të gjerë informacioni, për shembull, numri 3 korrespondon me legjislacionin dytësor (Rregulloret, Direktivat, Vendimet dhe të tjera). Sektorët janë si më poshtë:

Sektori 1	Traktate
Sektori 2	Marrëveshje me Jashtë
Sektori 3	Legjislacioni
Sektori 4	Marrëveshje të brendshme
Sektori 5	Propozime dhe dokumente përgatitore
Sektori 6	Jurisprudenca
Sektori 7	Zbatimi i legjislacionit nga vendet anëtare
Sektori 9	Pyetje të Parlamentit Evropian
Sektori C	Dokumentet publikuara në serinë C të FZBE
Sektori E	Dokumente të EFTA-s

yyyy - është viti i miratimit të dokumentit, i cili përfaqësohet me katër shifra.

T - tregon llojin e instrumentit juridik, për shembull (R) qëndron për Rregulloret, (L) qëndron për Direktivat, (D) për Vendimet dhe kështu me radhë. Një tabelë e plotë CELEX që tregon ndërlidhjen midis sektorit dhe llojit të instrumentit juridik mund të aksesohet nëpërmjet internetit.[213]

nnnn- tregon numrin e referencës së instrumentit ligjor. Kur numri i referencës përmban më pak se 4 shifra, shtohen zero për të formuar një numër 4-shifror, p.sh. numri i referencës për Direktivën 89/392/KEE është 0392. Përjashtim bëjnë nenet e traktatit, ku numri i referencës duhet të jetë një numër 3 shifror, p.sh., Neni 87 i Traktatit të Romës është 087.

4 Parime dhe procedura për përafrimin e legjislacionit

682 Përafrimi i së drejtës është kusht për anëtarësimin në BE. Kjo do të thotë që vendet që aspirojnë të anëtarësohen në BE duhet të përafrojnë ligjet, rregulloret dhe procedurat e tyre të brendshme, në mënyrë që t'i japin fuqi të gjithë korpusit të së drejtës të BE-së, të përfshirë në *acquis*-në e BE-së. Ndërsa detyrimi për të përafruar të drejtën e brendshme me të drejtën e BE-së vazhdon edhe pas anëtarësimit, procesi i përafrimit para aderimit është një mundësi për vendet për të organizuar institucionet dhe procedurat e tyre dhe për të trajnuar stafin e tyre për proceset e përditshme dhe përgjegjësitë e hartimit dhe zbatimit të së drejtës së BE-së.

683 Detyrimi specifik për të përafruar legjislacionin shqiptar me atë të BE-së rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA). Në lidhje me afatet, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian[214] është gjithashtu një instrument i mirë për identifikimin dhe prioritizimin e *acquis*-së së BE-së që duhet të transpozohet në periudha të ndryshme kohore. Në 25 Mars të vitit 2020, Këshilli Evropian vendosi të hapë negociatat e aderimit me Shqipërinë, që do të thotë se përafrimi i legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e BE-së është bërë edhe më i rëndësishëm. Parimet që rregullojnë negociatat e aderimit, përmbajtja e negociatave dhe procedura e negociatave përcaktohen nga e ashtuquajtura korniza negociuese.[215]

213 Njëra nga këto faqe është: http://ec.europa.eu/translation/language_aids/freelance/documents/romanian/about_celex_numbers_en.pdf

214 PKIE-ja përfshin ndër të tjera një program afatshkurtër dhe afatmesëm për përafrimin e legjislacionit me *acquis*-në e BE-së. PKIE-ja përditësohet çdo vit dhe hartuesit duhet, natyrisht, t'i referohen versionit të fundit.

215 Në fund të vitit 2021, korniza e negociatave është ende në procesin e miratimit nga Shtetet Anëtare të BE-së.

684 Procesi i përafrimit ligjor është detyra më e madhe dhe më gjithëpërfshirëse gjatë procesit të aderimit. Çdo Shtet Anëtar i ardhshëm i BE-së duhet të harmonizojë sistemin e tij ligjor në të gjitha fushat ku Shtetet Anëtare i kanë transferuar kompetencat BE-së - dhe nuk ka përjashtime në plan afatgjatë – rrallë mund të negociohet për periudhat tranzitore gjatë procesit të negociatave për aderimin. BE-ja nuk mund të funksionojë nëse legjislacioni kryesor nuk është i harmonizuar midis Shteteve Anëtare të saj.

685 Në përputhje me nenin 4(3) të Traktatit të BE-së, Shtetet Anëtare të BE-së marrin çdo masë të përshtatshme, të përgjithshme ose të veçantë, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet ose që rezultojnë nga aktet e institucioneve të BE-së. Ato gjithashtu lehtësojnë arritjen e detyrave në BE dhe heqin dorë nga çdo masë, e cila mund të rrezikojë arritjen e objektivave të BE-së.

686 Përafrimi duhet të kuptohet si më poshtë:

- Në kuptimin e gjerë, përafrimi i legjislacionit nënkupton harmonizimin e së drejtës së brendshme me të drejtën drejtpërdrejt të zbatueshme të BE-së dhe përafrimin e dispozitave të së drejtës së BE-së në legjislacionin e brendshëm, zbatimin e dispozitave të BE-së nga autoritetet publike të brendshme kompetente, dhe zbatimin e tyre nga gjykatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit.
- Në terma praktikë, një nga treguesit më të qartë të progresit të një vendi në lidhje me integrimin dhe përafrimin në BE është sasia dhe cilësia e akteve ligjore të brendshme që janë në pajtim me të drejtën e BE-së dhe që transpozojnë dispozitat e së drejtës së BE-së si dhe zbatimi efektiv i tyre.

687 Dallimi ndërmjet tri llojeve të përafrimit të legjislacionit jepet më poshtë:

- *Harmonizimi:* legjislacioni i brendshëm zëvendësohet nga legjislacioni i BE-së në një fushë të caktuar ku BE-ja ka kompetencë të plotë. Shtetet Anëtare nuk i rregullojnë vetë ato çështje. Rregulloret janë instrumentet kryesore që përdoren për harmonizimin;
- *Transpozimi:* legjislacioni i brendshëm respekton objektivat e parashikuara në aktet e BE-së, por Shtetet Anëtare vendosin mbi mënyrën se si do të rregullojnë teknikisht çështjen brenda kuadrit të parashikuar nga akti i BE-së. Direktivat janë instrumentet kryesore që kërkojnë transpozim;

- *Koordinimi:* disa akte ligjore të BE-së parashikojnë koordinimin e aktiviteteve dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe përfundimin e marrëveshjeve midis Shteteve Anëtare për tema të veçanta.

688 Në përgjithësi, hapat kryesore në procesin e përafrimit ligjor mund të përshkruhen si më poshtë:

- **Faza përgatitore:** krijimi i institucioneve të nevojshme për përafrimin e legjislacionit dhe zhvillimi i një sërë aktivitetesh teknike duke përfshirë shpërndarjen dhe prezantimin e akteve ligjore të BE-së në fusha të veçanta dhe të parimeve të përafrimit të legjislacionit në përgjithësi.
- **Faza analitike:** përcaktimi i përparësive duke u bazuar në përparësitë shtetërore, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ardhshme, në dokumentet e njëanshme të BE-së të pranuara nga Shqipëria, si Vendimi i Këshillit i datës 18 Shkurt 2008 mbi parimet, prioritetet dhe kushtet që përmbahen në Partneritetin Evropian me Shqipërinë, përkthimi i akteve të nevojshme ligjore të BE-së në gjuhën (gjuhët) zyrtare dhe përfshirja e tyre në PKIE në përputhje me përparësitë e përcaktuara më parë.
- **Harmonizimi dhe transpozimi:** hartimi në praktikë i legjislacionit të ri në përputhje me planin e përcaktuar më parë. Në këtë fazë synohet përafrimi faktik i legjislacionit të brendshëm shqiptar me të drejtën e BE-së dhe ekspertët vendas, me ndihmën e ekspertëve të BE-së kur është e mundur, duhet të përgatisin projektligje të reja ose të propozojnë ndryshime në ligjet dhe aktet nënligjore ekzistuese, në mënyrë që të arrijnë pajtueshmërinë me të drejtën e BE-së.
- **Zbatimi:** përfshin jo vetëm miratimin e ligjeve të reja ose i ndryshimeve të ligjeve ekzistuese apo aktet nënligjore, sipas rastit, por edhe zbatimin e tyre të përshtatshëm në praktikë dhe menaxhimin e efektit të tyre mbi infrastrukturën institucionale ekzistuese.
- **Ekzekutimi:** pas miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore, janë të nevojshme masat e autoriteteve kompetente (për shembull, monitorimi, mbikëqyrja, kontrollet inspektuese, ndëshkimet, masat gjyqësore) për të siguruar që ligji po respektohet plotësisht dhe rregullisht dhe performanca e politikës sektoriale është përmirësuar.

689 Përgjegjësia për përafrimin i takon ministrisë së linjës (ose ministrive, kur legjislacioni i BE-së kërkon më shumë se një institucion përgjegjës) të caktuar për të kryer detyrat e Institucionit përgjegjës nga grupi i ndërinstitucional i punës (shih për më tepër nënseksionin 4.2.1 më poshtë).

690 Gjatë procesit të hartimit të akteve për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis*-në, hartuesi duhet të përgatisë tekstin në përputhje me parimet e sistemit ligjor të brendshëm dhe parimet themelore ligjore dhe administrative të BE-së, duke përfshirë respektimin e shtetit ligjor, qeverisjes së mirë, sigurisë ligjore dhe transparencës. Hartuesi gjithashtu duhet të identifikojë problemet e mundshme me terminologjinë kur transpozon terminologjinë e BE-së në rendin juridik shqiptar (shih gjithashtu Pjesën C seksioni 2 të këtij Manuali).

691 Hartuesit duhet ta krahasojnë legjislacionin ekzistues kombëtar për lëndën që duhet të rregullohet me aktin ligjor të BE që do të transpozohet, i cili bëhet përmes plotësimit të tabelës së përputhshmërisë (TP) (shih për më tepër nënseksionin 4.3.1 më poshtë).

692 Ndërsa formati i TP është i dakordësuar,[216] metodologjia për plotësimin e TP-së ndryshon në rast të transpozimit të Direktivave të BE-së përkundrejt harmonizimit me Rregulloret dhe Vendimet e BE-së:

- për Direktivat e BE-së analiza fokusohet mbi nevojën që të miratohen dispozita ligjore vendase për të transpozuar Direktivën, ku shtetit miratues i jepet lirshmëri mbi mënyrën e transpozimit (shih për më shumë seksioni 7 më poshtë)
- për Rregulloret dhe Vendimet e BE-së analiza fokusohet nëse ka rregulla të ngjashme ose të njëjta të brendshme me parashikimet në Rregulloren e BE-së (të cilat duhet të shfuqizohen me aderimin), ka dispozita të ngjashme me detyrimet e BE-së por që kanë pjesërisht ose plotësisht një fushëveprim tjetër (ku vetëm masat konfliktuale duhet të shfuqizohen), dhe nëse është e nevojshme të miratohen dispozita shoqëruese për të siguruar zbatueshmërinë e plotë të Rregullores së BE-së (shih për më shumë nënseksionin 6.1 më poshtë).

693 Në çdo rast, TP-të duhet të kontrollojnë nëse një ose më shumë çështje specifike janë rregulluar tashmë në legjislacionin e brendshëm, dhe në çfarë mase. Nëse çështja është rregulluar tashmë, hartuesi duhet të krahasojë nëse çështja është e mbuluar plotësisht apo pjesërisht në legjislacionin ekzistues dhe nëse është bërë në përputhje dhe në përputhje me *acquis*-në e BE-së.

694 Sipas PKIE-së, ekzistojnë nivele të ndryshme të përafrimit, dhe në secilin

216 Lista e kontrollit për përafrimin e *acquis* të BE-së dhe modeli i Tabelës së Pajtueshmërisë (TP) është bashkëlidhur si Shtojca K e këtij Manuali

rast niveli duhet të tregohet në TP-të dhe të justifikohet nga hartuesit.

- "Plotësisht i përputhshëm" - projekti i aktit normativ është në përputhje (nuk bie ndesh) me dispozitat e të drejtës parësore dhe dytësore të *acquis*-së të BE-së dhe është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin nga këto dispozita;
- "Pjesërisht i përputhshëm" - projekti i aktit normativ është në përputhje (nuk bie ndesh) me parimet kryesore të së drejtës parësore dhe dytësore të *acquis*-së të BE-së, por nuk përputhet me të gjitha dispozitat e tij.
- "I papërputhur" - projekti i aktit normativ bie ndesh me dispozitat e të drejtës parësore dhe dytësore të *acquis*-së të BE-së dhe nuk është në përputhje me parimet që rrjedhin nga këto dispozita.
- "Nuk ka detyrime" - nuk ekziston asnjë dispozitë e të drejtës parësore dhe dytësore të *acquis*-së të BE-së që mund të krahasohet me projektaktin normativ për të përcaktuar nivelin e përputhshmërisë së tij.

4.1 Hapat përgatitorë për përafrimin e së drejtës së brendshme me legjislacionin e BE-së

695 Shumë nga hapat konkrete që ndiqen rregullisht në procesin e përafrimit janë të njëjtat për të gjitha aktet detyruese të BE-së. Këto janë renditur në faqet vijuese, së bashku me disa nga çështjet më specifike që duhet të vendosen në procesin e përafrimit të legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së.

Hapi 1. Identifikoni llojin e aktit dhe kërkesat e tij

1. Çfarë lloji: Direktivë, Rregullore, Vendim?
2. Cilat janë qëllimet dhe objektivat e tij?
3. Cilat autoritete kompetente janë të nevojshme?
4. Çfarë informacioni duhet të mblidhet dhe t'i sigurohet Komisionit?
5. Çfarë planifikimi kërkohet?
6. Çfarë njohurish shkencore ose teknike kërkohen?
7. Cilat procedura konsultimi kërkohen?
8. Çfarë investimesh kërkohen?

Hapi 2. Përcaktoni zgjedhjet e brendshme tuajat

1. Cilat kërkesa (në legjislacionin e BE-së) lejojnë të bëhen zgjedhje?
2. Cilat kërkesa nuk lejojnë zgjedhje?

3. Ligjet apo aktet administrative të brendshme?
4. Legjislacion i ri apo i ndryshuar?
5. Përmbajtja e masave ligjore të brendshme?
6. Cilat janë kostot dhe përfitimet për ekonominë dhe mjedisin?
7. Cilët sektorë do të mbajnë barrën?
8. Si duhet të organizohet kalimi në kërkesat e reja: afatet, periudhat e tranzicionit, programet e zbatimit, investimet dhe raportet?

Hapi 3. Përcaktoni si do të zbatohet dhe ekzekutohet e drejta e brendshme

1. Zbatimi i nivelit qendror, rajonal apo lokal? Nevojat për personel dhe teknik?
2. Çfarë kompetencash duhet të kenë nëpunësit?
3. Çfarë bashkërendimi dhe konsultimi ndërmjet organeve rregullatore është i nevojshëm?
4. Cila është nevoja për informacion, udhëzime, trajnime?
5. Kostot dhe përfitimet e zgjedhjeve të ndryshme të zbatimit?
6. Çfarë financimi nevojitet për administrim? Për investime?
7. Si do të rikuperohen kostot dhe merren financimet?
8. Çfarë monitorimi nevojitet?
9. Kush do ta kryejë monitorimin? A kanë nevojë për trajnim, personel, pajisje?
10. Cilat sanksione duhet të zbatohen(administrative, gjyqësore)? Si do të zbatohen ato?

Hapi 4. Vendosni procedurat e informimit dhe konsultimit

1. Kush duhet të konsultohet? Departamentet qeveritare, autoritetet lokale dhe rajonale, bashkimet profesionale, OJQ-të, grupet e interesit?
2. Cila formë e konsultimit është e nevojshme?
3. Në cilën fazë të procesit?
4. Rolet e tjerë të mundshëm të organizatave jashtë qeverisë qendrore?

Hapi 5. Përcaktoni Programin e Zbatimit

1. Grafiku legjislativ;
2. Përgatitja e rregullave administrative, dekreteve të zbatimit, etj.;
3. Grafiku buxhetor;
4. Institucionet, personeli dhe burimet;
5. Materiale trajnimi formuese, takime me zyrat përkatëse qeveritare, industrinë, publikun, etj. dhe aktivitetet e komunikimit;

6. Investimet;
7. Shpenzimet operacionale;
8. Monitorimi;
9. Mbledhja dhe raportimi i informacionit;
10. Ekzekutimi.

696 Gjatë harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me të drejtën e BE-së dhe transpozimit të akteve ligjore të BE-së, hartuesit duhet t'i kushtojnë vëmendje implikimeve që kjo mund të ketë për legjislacionin shqiptar në sektorin përkatës. Prandaj, gjatë zhvillimit të një mase të veçantë legjislative, hartuesi duhet të marrë në konsideratë nëse kjo masë do të përkufizojë kuadrin e përgjithshëm dhe parimet kryesore për një sektor specifik ose thjesht plotëson kuadrin ekzistues, nëse masa do të përshtatet me sistemin ligjor të brendshëm dhe modalitetet e përshtatjes, nëse do të kërkohet miratimi rregullimeve me natyrë më teknike, nëse përcaktohen procedura të reja administrative apo nëse kërkohet ngritja e një strukture mbikëqyrëse ose monitoruese.

697 Në mënyrë që të realizohet analiza e mësipërme, Raportet e Vlerësimit të Ndikimit duhet të përfshijnë në vlerësimin çështjet e lidhura me përafrimin. Kjo kërkon, për shembull, një vlerësim të kapaciteteve praktike për zbatimin e masës legjislative; një vlerësim të kapaciteteve praktike për përfundimin e aktiviteteve, për sigurimin e rregullimeve institucionale dhe për zbatimin e sanksioneve siç kërkohet nga *acquis* e BE-së;[217] dhe një vlerësim të masës në të cilën masa legjislative plotëson objektivat e *acquis*-së (shih për më tepër Pjesën C nënseksioni 1.1 dhe Shtojcën F të këtij Manuali).

4.2 Planifikimi i përafrimit

4.2.1 Identifikimi dhe zgjedhja e akteve ligjore të BE-së për t'u përafruar

698 Procesi i planifikimit dhe përzgjedhjes së aktit ligjor të BE-së, që do të përafrohet me korpusin e së drejtës së brendshme, mund të jetë një nga hapat më të vështirë që duhen ndërmarrë në procesin e përafrimit, pasi përfshin jo vetëm identifikimin e aktit ligjor specifik të BE-së që do të

217 Ekziston një praktikë e re gjyqësore e GJDBE-së (Çështja C-176/03, ECR [2007]) që e bën të qartë se në rrethana të caktuara, Shtetet Anëtare janë të detyruara të mbrojnë *acquis*-në përmes sanksioneve të së drejtës penale. Vendet aplikuese duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë detyrim dhe duhet të marrin parasysh implikimet kur përafrojnë legjislacionin e tyre.

transpozohet (me rëndësi për Shqipërinë), por edhe:

- cila pjesë e *acquis* sektoriale është prioritet për t'u përafruar;
- cilat dispozita specifike do të përafrohen;
- cili lloj i normës së brendshme do të përdoret për përafrim;
- cili institucion ka të drejtë të ketë iniciativën ligjore;
- si do të harmonizohet projektakti i brendshëm me legjislacionin në fuqi (cilat akte normative në fuqi/dispozita do të kenë nevojë të ndryshohen/shfuqizohen);
- cilat masa nënligjore dhe administrative duhet të ndërmerren për të siguruar zbatimin e një akti të veçantë ligjor të BE-së, etj.

699 Duke pasur parasysh se për secilin nga 33 Kapitujt e *Acquis* të BE-së janë caktuar Grupet Ndërinstitucionale të Punës (GNPIE) të përbëra nga përfaqësues të ministrive të linjës, institucioneve qendrore ekzekutive dhe organeve të pavarura (Institucionet në varësi të Kuvendit), procesi i prioritizimit dhe planifikimit të procesit të transpozimit mbështetet në këto grupe pune. Në këtë proces, GNPIE-t duhet të ndihmohen nga Sekretariati i Integrimit Europian si organ koordinues i strukturave kombëtare përgjegjëse për Negociatat e Aderimit.

Identifikimi

700 Mjetet kryesore që ndihmojnë në procesin e identifikimit, planifikimit, prioritizimit dhe përzgjedhjes së aktit ligjor të BE-së që do të përafrohet në korpusin e së drejtës së brendshme janë:

- lista e *acquis*-së e ofruar/shpjeguar nga Komisioni i BE-së për atë kapitull specifik gjatë Shqyrtimit Shpjegues;
- acquis-ja/rekomandimet e reja të identifikuara/ofruara gjatë nën-komiteteve përkatëse të MSA-së për atë kapitull specifik;
- rekomandimet/gjetjet në Raportin Vjetor të Komisionit Europian;
- planet ekzistuese për kapitullin(jt) përkatës në Planin Kombëtar të Integrimit Europian;
- temat e ngritura në pyetësorin e përgatitur nga KE-ja (Në disa raste të veçanta KE-ja mund të kërkojë nga një vend kandidat që të japë përgjigje për grupin e pyetjeve).

- raportet shqyrtuese për kapitullin përkatës për vendet tashmë të avancuara në këtë proces.

Caktimi i Institucionit Përgjegjës

701 Pas identifikimit dhe prioritizimit të aktit ligjor të BE-së që do të përafrohet nga GNPIE përkatëse, Kreu i grupit të punës me mbështetjen e Sekretariatit dhe pas konsultimit të brendshëm, do t'i caktojë një institucioni pëgjegjësitë për të koordinuar detyrat e palëve për procesin e përafrimit.

4.2.2 Planifikimi dhe priorizimi i akteve ligjore të BE-së për t'u përafruar

702 Planifikimi dhe priorizimi i akteve ligjore të BE-së, që do të përafrohen me korpusin e të drejtës së brendshme, do të jenë gjithnjë e më kërkues dhe intensifikohen në kuadrin e zbatimit të MSA-së dhe Negociatave të Aderimit. Procesi i planifikimit dhe priorizimit ka dy qëllime:

- Programimin dhe planifikimin e përafrimit dhe zbatimit të *Acquis* në përputhje me agjendën dhe reformat kombëtare;
- Monitorimin dhe raportimin e harmonizimit të aspekteve të brendshme ligjore, institucionale, administrative, ekonomike dhe sociale me *Acquis*-në.

703 Këto dy objektiva i shërbejnë Qeverisë Shqiptare në përpjekjen e saj drejt Procesit të Integrimit Europian, si dhe Komisionit Europian si mbikëqyrës për zbatimin e *acquis* së BE-së në Shqipëri. Për të kryer monitorimin e përafrimit dhe zbatimit të legjislacionit të BE-së, Komisioni Europian kërkon nga vendet kandidate për anëtarësim në BE të zhvillojnë një program kombëtar që përmban planin për përafrimin ligjor.

704 Në Shqipëri plani për përafrimin ligjor paraqitet nëpërmjet Planit Kombëtar për Integrimin Europian, përmes masave kombëtare që nënkuptojnë masat kombëtare të planifikuara që duhet të miratohen në mënyrë që të arrihet përafrimi me *acquis*-në e BE-së. PKIE-ja gjithashtu përcakton afatet e parashikuara për miratimin e këtyre masave kombëtare dhe krijon institucionet përgjegjëse për të. Kështu, plani kombëtar parashikon masa për rritjen e kapaciteteve administrative shqiptare për të marrë përsipër detyrimet për anëtarësimin në BE.

705 Një plan i tillë gjithëpërfshirës shkon përtej një plani të pastër të përafrimit të ligjit teknik sepse përcakton:

- Prioritetet kombëtare përmes objektivave zhvillimore dhe strategjike;
- Politikat, reformat dhe masat e duhura të nevojshme për zbatimin e këtyre objektivave;
- Një plan i detajuar të përafrimit të së drejtës;
- Nevojat për ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative; dhe
- Burimet njerëzore dhe buxhetore të përcaktuara.

706 PKIE-ja siguron një listë prioritare 1-vjeçare të akteve ligjore të BE-së që do të përafrohen me korpusin e së drejtës së brendshme, si dhe një prioritet 3-vjeçar të procesit të përafrimit, duke shërbyer kështu jo vetëm si një mjet programimi dhe planifikimi, por edhe si një pasqyrë e përgjithshme në prioritetet shqiptare në procesin e Integrimit Europian.

707 Prioritizimi i akteve ligjore të BE-së që do të përafrohen dhe masat e tjera mbështetëse që duhen ndërmarrë, bëhen kryesisht përmes:

1. Programit Qeveritar;
2. Rekomandimeve të identifikuara/ofruara gjatë nën-komiteteve përkatëse të MSA-së për atë kapitull specifik;
3. Rekomandimeve/gjetjeve në Raportin Vjetor të Komisionit Europian;
4. Temave të ngritura në pyetësorin e përgatitur nga KE-ja.
5. Ndarjes së *acquis*-së së BE-së në kapitujt përkatës;
6. Informacionit të marrë gjatë takimeve shpjeguese të legjislacionit të BE-së sipas kapitujve negociues, *acquis*-së së re të përcjellë nga Komisioni Evropian dhe rezultateve paraprake të analizës screening të mangësive ligjore/ administrative/ institucionale për çdo kapitull negociues;
7. Rezultateve të monitorimit të zbatimit të PKIE-së ekzistuese dhe raporteve të paraqitura tek autoritetet kombëtare dhe Komisioni Evropian;
8. Raporteve të organizatave ndërkombëtare të tilla si Organizata e Kombeve të Bashkuara, Banka Botërore, etj., mbi vlerësimin e reformave social-ekonomike;
9. Raporteve të vlerësimit të projekteve të asistencës teknike në kuadër të programit IPA apo të financuara nga donatorë të tjerë;
10. Programit Buxhetor Afatmesëm aktual;
11. Programit të Reformave Ekonomike;
12. Dokumenteve të programimit të Instrumentit të Para-Aderimit.

708 Për më tepër, përmes monitorimit të nivelit të zbatimit të masave të parashikuara për secilin seksion të PKIE-së, të cilat përputhen me një kapitull specifik të *Acquis*, si autoritetet kombëtare (GNPIE, Sekretariati i Integrimit Evropian, Negociatorët dhe Kryenegociatori), dhe Komisioni Europian, duhet të jetë në gjendje të gjenerojnë raporte vlerësimi për Kapituj të veçantë ose Grupet e Kapitujve në përgjithësi.

709 Rishikimi i PKIE-së bëhet në tremujorin e fundit të vitit në vazhdim për vitin e ardhshëm. Në procesin e planifikimit të aktiviteteve për PKIE-në për vitin e ardhshëm, institucionet përgjegjëse për përafrimin ligjor në kapituj të ndryshëm raportojnë masat kombëtare të planifikuara për t'u miratuar për vitin ose vitet e ardhshme dhe deklarojnë masat ligjore të BE-së me të cilat do të harmonizohen këto masa kombëtare. Kjo është mënyra se si masat ligjore të BE-së lidhen me procesin e planifikimit në sistemin kombëtar dhe futen rregullisht në sistemin "e-akte" të planifikimit, monitorimit dhe raportimit.

4.2.3 Përkthimi

710 Bazuar në planifikimin dhe priorizimin e akteve ligjore të BE-së që do të hamonizohen me korpusin se së drejtës së brendshme të parashikuar në PKIE, Sekretariati i Integrimit Evropian do të përgatisë planin vjetor për përkthimin e *Acquis*-ve përkatëse.

711 Për sa i përket planifikimit të përkthimit, masat që parashikohen për përafrimin ligjor në PKIE-në e vitit të ardhshëm do të përkthehen në vitin aktual. Procesi i përkthimit të *Acquis*-së rregullohet me një vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

4.3 Monitorimi dhe raportimi mbi përafrimin

712 Mjeti kryesor i brendshëm për monitorimin dhe raportimin e përafrimit të akteve ligjore të BE-së në korpusin e brendshëm të ligjeve është PKIE (shih seksionin 4.2 më sipër). Ky instrument ofron një këndvështrim të përgjithshëm të procesit të përafrimit, dhe mbështetet nga një grup instrumentesh të cilët shërbejnë për vlerësimin specifik të përafrimit të akteve ligjore të BE-së në kuadrin ligjor të brendshëm, si edhe për nivelin e tyre të harmonizimit.

713 Instrumentet kryesore që vlerësojnë nivelin e përafrimit të akteve ligjore të BE-së me kuadrin ligjor të brendshëm, të cilat janë edhe instrumentet kryesore që përdoren për monitorimin dhe raportimin e këtij procesi gjatë

Negociatave të Aderimit për BE janë:

- Tabelat e Përputhshmërisë (TP);
- Analiza e Hapësirave Ligjore (LGA);
- Vlerësimi i Hapësirave Institucionale dhe Administrative (IAGA).

714 Qëllimi i TP-ve dhe LGA-ve është vlerësimi i nivelit të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me aktet ligjore të BE-së. TP-ja garanton një analizë të detajuar të harmonizimit të aktit(eve) specifike të brendshme me aktin(et) respektive ligjore të BE-së, ndërsa LGA-ja garanton një këndvështrim të përgjithshëm të harmonizimit të sistemit ligjor të brendshëm në një tematikë/kapitull/nënkapitull të caktuar të *acquis*-së së BE-së. LGA-ja i referohet edhe parimeve të përgjithshme (që do të thotë të drejtat dhe detyrimet) në *acquis*-në e BE-së në një tematikë/kapitull/nënkapitull të caktuar, dhe vlerëson nëse të njëjtat parime ekzistojnë në nivel kombëtar.

715 IAGA-ja është vetëvlerësimi i një shteti, i cili përcakton nëse zbatohen strukturat e brendshme, të përmendura drejtpërdrejtë ose të nënkuptuara nga aktet ligjore të BE-së, si edhe nëse ka një kapacitet të mjaftueshëm administrativ për t'i zbatuar ato. Të gjithë këta instrumente synojnë përgatitjen e një plani të besueshëm për përafrimin në të ardhmen, zbatim dhe hyrjen në fuqi të *acquis-së* së BE-së dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe financiare të mjaftueshme për këtë qëllim.

716 Formalisht, relacioni shoqërues model duke përfshirë modelin për TP parashikohet nga vendimi nr. 584, i datës 28.8.2003 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave", të ndryshuar, ndërkohë që disa modele të tjerë të TP-ve, IAGA-ve dhe LGA-ve janë përpiluar sipas kërkesave të Komisionit Evropian me asistencën e projekteve të ndihmës teknike në fushën e Integrimit në BE (shih më poshtë).

4.3.1 Tabela e Përputhshmërisë (TP)

717 Tabelat e Përputhshmërisë janë një instrument kyç vlerësimi legjislativ që kërkohet nga Komisioni Europian për vendet kandidate për aderim në BE, që këto të fundit të demonstrojnë nivelin e përgatitjes së tyre dhe përshtatjen sipas *acquis* së BE-së, gjatë procesit të negociatave për Kapitujt e *acquis*-së së BE-së.

718 TP-të nuk kërkohen për të gjithë *acquis*-në e BE-së. Një TP duhet të përbëhet nga të paktën një Tabelë – të dakordësuar nga Komisioni Evropian – e ndarë në një sërë kolonash (nga një minimum prej 4 deri në maksimalen normale prej 7 tabelash). Qëllimi është që të bëhet një krahasim i përmbajtjes së legjislacionit të brendshëm me përmbajtjen e ligjit të BE-së nen për nen. Modeli bazë i TP-së përbëhet nga 7 kolona: i) Kolona e para tregon numrin e nenit të ligjit të BE-së; ii) kolona e dytë paraqet tekstin e nenit të ligjit të BE-së; iii) kolona e tretë identifikon legjislacionin e brendshëm korrespondues dhe nenet korresponduese: iv) kolona e katërt, kur është e mundur, përmban tekstin e legjislacionit të brendshëm në gjuhën shqipe; v) kolona e pestë përmban tekstin e legjislacionit të brendshëm në gjuhën angleze; vi) kolona e gjashtë paraqet vlerësimin specifik të harmonizimit të BE-së (d.m.th. "Nuk ka detyrime", "I papërputhur", "pjesërisht i përputhshëm", ose "plotësisht i përputhshëm". Një vlerësim tjetër pak më i vështirë mund të kryhet me anë të numrave 0 - i papërputhshëm deri 5 - plotësisht i përputhshëm); dhe vii) kolona e shtatë paraqet komentet për nivelin e harmonizimit dhe shpjegon arsyet se përse legjislacioni i brendshëm ka një përputhshmëri të pjesshme ose të pamjaftueshme. Qëllimi i kësaj kolone është edhe parashikimi i strategjive dhe i masave, dhe i shtrirjeve kohore respektive, për të zbatuar harmonizimin e plotë të *acquis* së BE-së në sistemin e brendshëm.

719 Është e rëndësishme të theksohet se jo çdo akt ligjor i BE-së ka nevojë të ketë edhe TP. Për më tepër, shpesh ekziston mundësia që parimet ligjore të BE të reflektohen dhe transpozohen nga më shumë se një akt ligjor i brendshëm. Në po të njëjtën mënyrë, gjatë analizës së TP-së, duhet të nënvizohet fakti se neni i ligjit të BE-së mund të transpozohet nga më shumë se një nen i ligjeve të brendshme. Për këtë arsye, kërkimet e sakta ligjore janë themelore në garantimin e ushtrimit të duhur të TP-së.

4.3.2 Analiza e Hapësirave Ligjore (LGA)

720 Analizat e Hapësirave Ligjore[218] janë dokumente kyçe që ofrojnë një **përmbledhje të nivelit të përputhshmërisë** së legjislacionit të brendshëm me *acquis*-në përkatëse të BE-së. LGA-ja trajton një fushë të plotë tematike, ose një kapitull të plotë të acquis-së së BE-së duke krahasuar përmbajtjet e aktit ligjor të BE-së (d.m.th. të drejtat dhe detyrimet) me

218 Lista e kontrollit për përgatitjen e analizës së hapësirave ligjore (LGA) dhe modeli i LGA është bashkëlidhur si Shtojca L e të këtij Manuali.

përmbajtjet përkatëse (d.m.th. të drejtat dhe detyrimet) e aktit(eve) ligjore të brendshme. LGA-ja është e strukturuar edhe në formë Tabele. Megjithatë, ashtu si përcaktohet edhe më sipër, analiza nuk realizohet nen për nen por në vija të përgjithshme.

721 Modeli i LGA-ve tashmë i miratuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme përbëhet nga 5 kolona:

i) kolona e parë i referohet aktit ligjor të BE-së;
ii) kolona e dytë identifikon institucionin përgjegjës për të gjithë procesin e harmonizimit;
iii) kolona e tretë liston legjislacionin të brendshëm korrespondues;
iv) kolona e katërt jep një përmbledhje të legjislacionit të brendshëm dhe parimeve të tij, me qëllim reflektimin e përmbajtjes së *acquis* së BE-së, të hapësirave të identifikuara në nivel të brendshëm dhe vlerësimin e harmonizimit të BE-së; dhe
v) kolona e pestë paraqet strategjitë dhe masat e parashikuara, me afatet korresponduese, të cilat do të miratohen për të siguruar harmonizimin e plotë.

4.3.3 Vlerësimi i Hapësirave Institucionale dhe Administrative (IAGA)

722 Vlerësimi i Hapësirave Institucionale dhe Administrative[219] është **vetëvlerësimi i një shteti**, i cili përcakton nëse zbatohen strukturat e brendshme, të përmendura drejtpërdrejtë ose të nënkuptuara nga aktet ligjore të BE-së, si edhe nëse ka një kapacitet të mjaftueshëm administrativ për të zbatuar *acquis* të BE-së. Ky është një element i rëndësishëm në inventarin e instrumenteve për kontrollin dypalësh dhe negociatat e aksesimit. Të gjithë këta instrumente synojnë përgatitjen e një plani të besueshëm për përafrimin e ardhshëm, implementimin dhe ekzekutimin e *acquis* të BE-së dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe financiare të mjaftueshme për këtë qëllim.

723 Koncepti i kapaciteteve administrative dhe zbatimi i tij në praktikë është zhvilluar me kohën. Ky koncept i ka fillimet me kriterin për aderim që njihet si 'Kriteri i Madridit' i vitit 1994, dhe parashikon që kandidatët e ardhshëm për aderim në BE duhet të kenë kapacitete administrative të mjaftueshme për të zbatuar *acquis* të BE-së. Që prej asaj kohe, është zhvilluar tashmë në

219 Lista e kontrollit për përgatitjen e vlerësimin e hapësirave institucionale dhe administrative (IAGA) dhe modeli i IAGA është bashkëlidhur si Shtojca L e të këtij Manuali.

një strukturë komplekse që pasqyron implikimet institucionale të *acquis*-së, parashikuar në udhëzuesit e KE-së dhe është përgatitur në stilin Weberian për administratat publike dhe një gjyqësor autonomn.

724 Gjatë procesit të aderimit të Ballkanit Perëndimor, koncepti është zhvilluar edhe më tej duke e vënë theksin tek institucionet e shtetit të së drejtës dhe parashikime të detajuara për strukturat administrative.

725 Strukturat administrative të nënkuptuara nga *acquis* përshkruhen në Guidën e KE-së për Strukturat Kryesore Administrative të nevojshme për zbatimin e *Acquis*. Nuk ekziston një version zyrtar i kësaj Guide, e cila përditësohet dhe përshtatet rregullisht, edhe individualisht gjatë procesit të kontrollit si pjesë e etapave hapëse, të ndërmjetme dhe përmbyllëse.

726 Shumë etapa të parashikuara nga BE-ja shkojnë përtej *acquis*-së dhe lidhen me funksionet kryesore të shtetit, të tilla si demokracia dhe tregu funksional, shteti i së drejtës, dhe institucione të tjera. Në fushën e tatimeve, për shembull, BE-ja me të drejtë nuk fokusohet shumë mbi *acquis*-në në këtë fushë, e cila është pak e zhvilluar, por mbi kapacitetin e shtetit për të mbledhur taksat. Në politikën sociale, kushtet e BE-së nuk lidhen aq shumë drejtpërdrejtë me *acquis*-në lidhur me koordinimin e sistemeve të sigurisë sociale, por, më tepër për tendencat e punësimit, kapacitetet e zyrave të punësimit për ritrajnim, dhe kapacitetet e inspektorateve të punës për të luftuar ekonominë informale. Shembulli më i qartë i zhvillimit të kushteve indirekte është Kapitulli 23 për shtetin e së drejtës dhe të drejtat themelore.

727 IAGA-t në Shqipëri përgatiten sipas një modeli të posaçëm. Rekomandohet që IAGA të përdoret duke e vendosur theksin tek një pjesë e re e përmbledhjes dhe tek informacioni thelbësor si edhe tek parimet metodologjike të paraqitura më poshtë.

728 Analiza e një sërë IAGA-ve (marrë nga Kapitujt 1, 5, 18, 32 të kuadrit Negociues/*Acquis*) paraqet një interpretim disi të gjerë të modelit, si dhe ka përsëritje të të njëjtit informacion. Informacionet për hapësirat, kostimin, buxhetin, mungojnë pothuajse krejtësisht, ashtu si edhe informacioni për zbatimin (në statistika dhe në shumicën e pjesëve në lidhje me kontrollin financiar), dhe rekomandohet përgatitja e këtij informacioni duke përdorur RVN-të e disponueshme dhe analizat sektoriale.

729 Rekomandohet dhënia e detajeve më thelbësore në IAGA, si dhe

rekomandohet përgatitja e përmbledhjes me një vlerësim të situatës aktuale, hapësirat dhe planit për të mbyllur këto hapësira.

730 Masat për mbulimin e këtyre hapësirave zakonisht kanë të bëjnë me rritjen e kapaciteteve të stafit dhe të trajnimeve. Konceptualisht, ajo mbështetet edhe në parashikimin se hapësirat mund të mbulohen më mirë duke ngritur institucione dhe njësi të reja brenda atyre ekzistuese, si edhe duke punësuar më shumë staf. Një qasje ndryshe mund të fokusohej në strukturat ekzistuese. Një qasje e tillë njihet dhe si një qasje e integruar. Parimi i saj kryesor është se ajo rekomandon trajtimin e implikimeve të *acquis* së ri me anë të përshtatjes së strukturave të vjetra, si riorganizimet, në vend që të krijohen të reja, dhe ritrajnimit në vend që të punësohet staf i ri. Administrata shqiptare ka mundësi të jetë e limituar me burime të limituara. Megjithatë, në disa raste, do të jetë i nevojshëm krijimi i institucioneve të reja dhe punësimi i stafit të ri.

5 Harmonizimi i së drejtës së brendshme me të drejtën parësore

731 Legjislacioni i Shteteve Anëtare nuk mund të jetë në kundërshtim me të drejtën parësore të BE-së. Në këtë kuptim, e drejta parësore e BE-së paraqet një kufizim për ligjvënësin e brendshëm. Çdo akt ligjor i ri i miratuar në një Shtet Anëtar të BE-së, qoftë ai i miratuar në procesin e harmonizimit me një normë të BE-së ose i transpozimit të një norme të BE-së (për shembull, një Direktivë), ose në mënyrë të pavarur nga çdo kërkesë e vendosur nga e drejta e BE-së, nuk mund të jetë në kundërshtim me Traktatin ose parimet e përgjithshme të BE-së.

732 Për shkak të karakteristikave kushtetuese të rendit juridik të BE-së, të zhvilluara përmes praktikës së GJED-së, si dhe gjykatave kushtetuese të brendshme ose gjykatave të tjera, e drejta parësore e BE-së është drejtpërdrejt e zbatueshme në rendet juridike të Shteteve Anëtare (e ashtuquajtura doktrina me efekt të drejtpërdrejtë) dhe i jepet përparësi (e ashtuquajtura doktrina e përparësisë).Pasoja e këtyre doktrinave kushtetuese në praktikë është se një normë juridike kombëtare që është në kundërshtim me normën e së drejtës parësore të BE-së nuk mund të zbatohet nga organet e shtetit, qofshin ato gjykatat e brendshme apo administrata.

733 Në çështjen *Simmenthal*[220], GJED-ja mori në shqyrtim interpretimin e një

220 106/77 Amministrazione delle Finanze dello Stato v. Simmenthal S.p.A., (1978) ECR 643

norme të së drejtës parësore të BE-së dhe në lidhje me këtë sqaroi se:

- *zbatueshmëria e drejtpërdrejtë në rrethana të tilla do të thotë që rregullat e së drejtës komunitare duhet të zbatohen plotësisht dhe në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha shtetet anëtare nga data e hyrjes së tyre në fuqi dhe për aq kohë sa ato vazhdojnë të jenë në fuqi.*
- *këto dispozita janë si pasojë një burim i drejtpërdrejtë i të drejtave dhe detyrimeve për të gjithë ata që preken prej tyre, qofshin shtetet anëtare apo individë, të cilët janë palë në marrëdhëniet juridike sipas së drejtës komunitare.*
- (...)
- Nga sa më sipër rrjedh se çdo gjykatë e brendshme duhet që, në një çështje brenda juridiksionit të saj, të zbatojë të drejtën komunitare në tërësinë e saj dhe të mbrojë të drejtat që kjo e fundit u jep individëve dhe duhet që, në përputhje me rrethanat, të shfuqizojë çdo dispozitë të së drejtës së brendshme që mund të bjerë ndesh me të, pavarësisht nëse është miratuar para apo pas rregullit komunitar.
- Megjithëse paragrafi 21 i vendimit t Gjykatës u referohet gjykatave të brendshme, i njëjti detyrim, d.m.th., për të lënë mënjanë ligjin e brendshëm që është në kundërshtim me të drejtën e BE-së ekziston edhe për administratën e brendshme.

734 Kështu, një rregull që bie ndesh me një rregull të së drejtës parësore të BE-së duhet të shfuqizohet në momentin e hyrjes në fuqi të traktatit të aderimit të Shqipërisë në BE. Për më tepër, edhe nëse një rregull i Traktatit nuk kërkon në vetvete ndonjë veprim nga legjislatori i brendshëm, ai gjithmonë kërkon një lloj veprimi pasiv - një rregull i tillë duhet të merret në konsideratë në lidhje me të gjithë legjislacionin tjetër të miratuar nga legjislatori i brendshëm. Kështu, për shembull, të gjitha rregullat e integrimit negativ në tregun e brendshëm, kufizojnë zgjedhjet që legjislatori i brendshëm mund të bëjë në çdo fushë të politikës, jo vetëm në atë që ka të bëjë me tregtinë.

Shembull

Neni 34 i TFBE-së ndalon kufizimin sasior të importeve dhe të gjitha masat që kanë efekt ekuivalent mbi tregtinë midis Shteteve Anëtare. Nuk kërkon ndonjë veprim pozitiv nga ligjvënësi i brendshëm. Ligjvënësi i brendshëm nuk e ka të nevojshëm të miratojë ndonjë ligj ose akt nënligjor për t'i dhënë efekt kësaj dispozite (mund të kërkohet që të shfuqizohet legjislacioni që bie në kundërshtim me

të). Sidoqoftë, kur miraton ligjet me qëllim mbrojtjen e konsumatorit, për shembull, ligjvënësi i brendshëm duhet të marrë parasysh nenin 34 të TFBE-së.

Kështu, ligjvënësi nuk mund të përcaktojë përqindjen minimale të alkoolit të nevojshëm për të quajtur një pije alkoolike "liker", nëse kjo do të pengonte importimin e produkteve të emërtuara kështu nga Shtetet e tjera Anëtare (çështja *Cassis de Dijon*); apo nuk mund të kërkojë që makaronat të prodhohen vetëm nga gruri i fortë (çështja *Zoni*). Edhe pse ligjvënësi i brendshëm mund të mbetet i lirë në miratimin e ligjeve për hir të parandalimit të konfuzionit të konsumatorëve në territorin e tij, zgjedhja e masave në dispozicion që mund të përdorë për atë qëllim është e kufizuar nga kërkesa për të mos krijuar pengesa për importin e produkteve nga Shtetet Anëtare të tjera, ose të paktën nga kërkesa që masa e zgjedhur të krijojë pengesat minimale të mundshme për tregti. Kjo mbetet e tillë edhe nëse krijimi i një pengese nuk është qëllimi i ligjvënësit. Kështu, traktatet ngushtojnë zgjedhjet në dispozicion të ligjvënësve të brendshëm në përpjekje për të arritur qëllimet politike legjitime.

735 E drejta parësore duhet të respektohet gjithashtu kur ligjvënësi i brendshëm bën zgjedhjet si të transpozojë normat e tjera të së drejtës së BE-së në rendin juridik të brendshëm. Si shembull, mund të përdorim çështjen *Mangold* [221]:

Shembull

Në këtë rast, Gjermania miratoi ligjin me të cilin transpozoi Direktivën e Këshillit 1999/70/KE në lidhje me marrëveshjen kuadër për punën me afat të caktuar. Sidoqoftë, zgjidhja gjermane diskriminonte punëtorët e moshuar në raport me të rinjtë. Kështu, GJDBE-ja e konsideroi atë në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit në lidhje me moshën, i cili, sipas Gjykatës, ekziston si një shprehje e parimit të përgjithshëm të barazisë në rendin juridik të BE-së, i cili është pjesë e së drejtës parësore të BE-së. Kështu, parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së kufizojnë zgjedhjen në dispozicion të ligjvënësit të brendshëm kur vendos për zgjidhjen e duhur për transpozimin e Direktivës.

736 Së fundmi, rregullat e Traktatit ndonjëherë kërkojnë që ligjvënësit e

221 C-144/04 Werner Mangold v Rüdiger Helm, [2005] ECR I-9981.

brendshëm të nxjerrin ligje të reja. Shembulli i një dispozite të tillë është neni 157 i TFBE-së:

Çdo Shtet Anëtar siguron që të zbatohet parimi i pagës së barabartë për punëtorët meshkuj dhe femra për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë.

737 Në fazën e përafrimit të së drejtës së brendshme me të drejtën e BE-së, legjislacioni i brendshëm duhet të shqyrtohet në lidhje me ekzsitencën e normave të papërputhshme dhe konfliktuale. Norma të tilla duhet të shfuqizohen dhe, gjatë miratimit të normave të reja dhe këto dispozita duhet të merren parasysh.

6 Harmonizimi i së drejtës së brendshme me Rregulloret e BE-së

738 Rregulloret e BE-së janë drejtpërdrejt detyruese në Shtetet Anëtare dhe zëvendësojnë çdo ligj të brendshëm që bie në kundërshtim me to (një parim i njohur si "zbatueshmëri e drejtpërdrejtë"). Shtetet Anëtare nuk mund të transpozojnë dispozitat e Rregullores në të drejtën e brendshme, edhe nëse e drejta e brendshme është identike me Rregulloren. Ky ndalim i çdo mase implementimi në të drejtën e brendshme lind nga fakti që Rregulloret e BE-së duhet të zbatohen drejtpërdrejt nga gjykatat e brendshme dhe organet administrative të brendshme; çdo ligj implementues i brendshëm do të ishte në kundërshtim me natyrën e veçantë juridike të Rregulloreve sipas Traktatit të BE-së.

739 Në lidhje me këtë, GJDBE-ja në çështjen *Variola*[222] u shpreh:

"duke ndjekur natyrën e saj dhe vendin e saj në sistemin e burimeve të së drejtës komunitare, një Rregullore ka efekt të menjëhershëm dhe, rrjedhimisht, vepron për t'u dhënë palëve private të drejtat të cilat gjykatat e brendshme kanë për detyrë t'i mbrojnë. Zbatimi i drejtpërdrejtë i një Rregulloreje do të thotë që hyrja e saj në fuqi dhe zbatimi i saj në favor ose kundër atyre që i nënshtrohen asaj janë të pavarura nga çdo masë e integrimit në legjislacionin e brendshëm. Një dispozitë e ligjit të brendshëm që riprodhon përmbajtjen e një rregulli të zbatueshëm drejtpërdrejt të së drejtës komunitare nuk mund të ndikojë në asnjë mënyrë në zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë, ose në juridiksionin e gjykatës sipas traktatit."

222 GJDBE, Çështja 34/73, Fratelli Variola S.p.A. v Amministrazione italiana delle finanze.

740 Në Çështjen *Fratelli Zerbone*[223] GJDBE-ja u shpreh:

'megjithëse është e vërtetë që në rast të vështirësisë së interpretimit administrata e brendshme mund të detyrohet të miratojë rregulla të hollësishme për zbatimin e një rregulloreje komunitare dhe në të njëjtën kohë për të sqaruar çdo dyshim të ngritur, ajo mund ta bëjë këtë vetëm për sa kohë është në përputhje me dispozitat e së drejtës komunitare dhe autoritetet e brendshme nuk mund të nxjerrin rregulla të detyrueshme të interpretimit.'

Veçanërisht, Gjykata theksoi se:

'dispozitat e Nenit 4(2) të Rregullores nr. 1013/71 në vetvete janë plotësisht efektive dhe për këtë arsye duhet të interpretohen duke ua lënë gjykatave të Shtetit Anëtar në fjalë të vendosin nëse kontrata është ekzekutuar në kushtet që do të kishin ekzistuar në mungesë të masave monetare të referuara në Nenin 1 të Rregullores nr. 974/71.'

741 Në çështjen 272/83[224], GJDBE-ja sqaroi më tej se:

"Rregulloret e komunitetit, si të tilla, zbatohen drejtpërdrejt në të gjitha vendet anëtare dhe hyjnë në fuqi vetëm me anë të botimit të tyre në fletoren zyrtare të komuniteteve. Si pasojë, një Shtet Anëtar nuk është i lirë të krijojë një situatë në të cilën efekti i drejtpërdrejtë i Rregulloreve të komunitetit kompromentohet. Sidoqoftë, kur zbatimi në një Shtet Anëtar i rregullave të komunitetit varet nga kombinimi i një numri dispozitash të miratuara në nivel komuniteti, kombëtar dhe rajonal, fakti që ligjet rajonale përfshijnë, për hir të koherencës dhe për t'i bërë ato të kuptueshme për personat për të cilët ata aplikojnë, disa elemente të Rregulloreve të komunitetit, nuk mund të konsiderohen si shkelje e ligjit të komunitetit. "

742 Rregulloret e BE-së rrjedhimisht janë kryesisht jashtë procesit të përafrimit në Shtetet Anëtare. Sidoqoftë, Rregulloret e BE-së kërkojnë rregullisht masa shtesë të brendshme për zbatim.

Shembull

Llojet e masave shoqëruese që normalisht vendet do të duhet të marrin përfshijnë emërimin e autoriteteve kompetente për të zbatuar detyrimet e Rregullores, botimin e udhëzuesve dhe

223 GJDBE, Çështja 94/77, Fratelli Zerbone Snc v Amministrazione delle finanze dello Stato.
224 GJDBE, Çështja 272/83, Komisioni i Komuniteteve Europiane kundër Republikës Italiane.

formularëve të njoftimit ose përcaktimin e sanksioneve kombëtare për shkelje të ligjit dhe do të duhet të përcaktohen paraprakisht.

743 Rregulloret sidoqoftë mund tu lënë opsione Shteteve Anëtare.

Shembull
Neni 4(2) i Rregullores së Auditimit[225] parashikon që '*Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që një autoritet kompetent, me kërkesë të auditit ligjor ose firmës së auditimit, mbi një bazë të jashtëzakonshme, mund të lejojë që auditi ligjor ose firma e auditimit të përjashtohen nga kërkesat e nënparagrafit të parë në lidhje me një njësi të audituar për një periudhë që nuk i kalon dy vite financiare*'.

Në raste të tilla, Shtetet Anëtare duhet të miratojnë një dispozitë e cila sqaron nëse e përdor opsionin apo jo; dhe nëse po, si e përdor ajo opsionin.

744 Në shtetet kandidate për anëtarësim, Rregulloret e BE-së hyjnë automatikisht në fuqi në momentin e aderimit. Në atë moment asnjë dispozitë nuk duhet të jetë në kundërshtim me një rregull të një Rregulloreje dhe asnjë dispozitë nuk duhet të ekzistojë që të marrë masa për përfshirjen e dispozitave të Rregullores në të drejtën e brendshme (shih më sipër GJDBE-në, në çështjen *Variola*). Sidoqoftë, Rregulloret nuk mund të injorohen plotësisht përpara aderimit.

745 Në mënyrë që të përgatiten për aderim, vendet kandidate ashtu si Shtetet Anëtare duhet të krijojnë institucione dhe procedura për të siguruar zbatueshmëri të plotë të Rregulloreve të BE-së. Për më tepër, ato duhet të shfuqizojnë dispozitat e brendshme konfliktuese dhe të miratojnë dispozita shoqëruese. Meqenëse Rregulloret e BE-së janë drejtpërdrejt detyruese në datën e hyrjes në fuqi, dispozitat që janë miratuar para hyrjes në fuqi të Traktatit të Aderimit dhe që ishin dispozita përsëritëse të Rregulloreve, duhet të shfuqizohen në momentin e hyrjes në fuqi të Traktatit të Aderimit.

746 Kështu, autoritetet shqiptare duhet së pari të sqarojnë nëse një Rregullore e caktuar e BE-së do të jetë e zbatueshme para aderimit apo jo. Në rast se konsiderohet se nuk është e nevojshme të sigurohet zbatueshmëria e Rregullores para hyrjes në fuqi të Traktatit, mund të jetë e nevojshme të

225 Rregullorja (BE) Nr. 537/2014 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 16 Prillit 2014 mbi kërkesat specifike në lidhje me kontrollin ligjor të enteve me interes publik dhe shfuqizimin e Vendimit të Komisionit 2005/909/KE.

sigurohet zbatueshmëria e saj përpara aderimit, për shembull për shkak të kompleksitetit të fushës të së drejtës, ose për arsye politike. Në çdo rast, TP-të në lidhje me Rregulloret e BE-së duhet të identifikojnë masat që do të merren për ta përgatitur vendin për datën e aderimit.

6.1 Zbatueshmëria e një Rregulloreje të BE-së në momentin e aderimit në BE

747 Në rast se një Rregullore nuk është e zbatueshme para aderimit, kërkohen hapat e mëposhtëm:

- Hapi 1: Vlerësimi (TP) nëse ka legjislacion të brendshëm që mbulon këtë çështje?
- Hapi 2: Aty ku ekziston legjislacioni i brendshëm, çdo nen i Rregullores së BE-së duhet të krahasohet me ligjin(et) përkatës të brendshëm. Legjislacioni i brendshëm mund të:
  - Vendosë rregulla të ngjashme ose të barabartë si detyrimet në Rregulloren e BE-së, ku në këtë rast TP-ja do të identifikojë nevojën për shfuqizimin e kësaj dispozite në momentin e hyrjes në fuqi të Traktatit të Aderimit;
  - Vendosë dispozita të ngjashme si detyrimet e BE-së, të cilat megjithatë kanë pjesërisht ose plotësisht një objekt tjetër dhe prandaj nuk bien ose bien vetëm pjesërisht në kundërshtim me të drejtën e BE-së; në këtë rast hartuesi duhet të identifikojë nevojën për të ndryshuar dispozitën pjesërisht konfliktuale;
  - Rezulton se nuk ka ndonjë dispozitë që bie ndesh me legjislacionin e BE-së.

- Hapi 3: Vlerësimi nëse është e nevojshme të miratohen dispozita shoqëruese, duke përfshirë për shembull përcaktimin e autoritetit kompetent, të cilat sigurojnë zbatueshmërinë e plotë të Rregullores së BE-së.

Shembull

Rregullore (BE) Nr. 2013/606/BE mbi njohjen e ndërsjellë të masave të mbrojtjes në çështjet civile prezanton një proces të thjeshtë certifikimi me anë të të cilit një urdhër ndalimi, mbrojtjeje ose kufizimi i lëshuar në një Shtet Anëtar të BE, njihet shpejt dhe lehtë në të gjithë BE-në.[226]

226 Kjo Rregullore funksionon së bashku me Direktivën 2011/99/BE, e cila krijon një mekanizëm që lejon personat që përfitojnë nga një urdhër mbrojtje në një vend të BE-së të kërkojnë një Urdhër Europian të

- Në fakt, kjo Rregullore parashikon rregulla të veçanta për ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes të lëshuara nga autoritetet kompetente në vendet e tjera të BE-së.
- Shqipëria ka rregulla në fuqi për ekzekutimin e urdhrave të brendshëm të mbrojtjes, të cilat nuk bien ndesh me të drejtën e BE-së.
- Ekziston nevoja për të vlerësuar nëse ekzistojnë rregulla për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes të autoriteteve të vendeve të huaja.
  - Nëse po, këta rregulla do të binin ndesh me Rregulloren e BE-së me hyrjen në fuqi të traktatit të aderimit, për sa u përket urdhrave të mbrojtjes të Shteteve Anëtare të BE-së.
  - Por, nuk do të binte ndesh me Rregulloren e BE-së me hyrjen në fuqi të Traktatit të Aderimit, për sa u përket shteteve të tjera që nuk janë anëtare të BE-së ose shteteve që kanë traktate të posaçme bashkëpunimi me BE-në (të ashtuquajturat "vendet e treta").

748 Hartuesi duhet të identifikojë cilat dispozita janë (pjesërisht) në kundërshtim dhe të sugjerojë ndryshimet përkatëse Në çdo rast, si në rastin kur ka konflikte dhe gjithashtu kur nuk ka konflikte, ekziston nevoja për të parashikuar dispozita shoqëruese, të cilat përfshijnë për shembull emërimin e autoriteteve kompetente të brendshme ose dispozitat mbi sanksionet; hartuesi duhet të identifikojë opsionet për modifikimin e ligjeve të brendshme përkatëse (për shembull: nëse duhen përshtatur ligjet ekzistuese ose duhen zëvendësuar ato, ose duhet krijuar regjim ligjor tërësisht i ri); në këtë drejtim duhet të merren parasysh të gjitha pjesët e legjislacionit të brendshëm përkatës.

Shembull

Duke iu referuar përsëri shembullit të Rregullores (BE) Nr. 2013/606/BE mbi njohjen e ndërsjellë të masave të mbrojtjes në çështjet civile, TP-ja duhet të:

- Identifikojë dispozitat që gjejnë zbatim për masat e mbrojtjes;
- Sqarojë nëse do të ketë një konflikt të detyrimeve të BE-së me ligjin e brendshëm apo jo;
- Sugjerojë hapat e mëtejshme, përfshirë në veçanti:
  - Dispozitat që duhet të shfuqizohen me hyrjen në fuqi të

Mbrojtjes që u jep atyre mbrojtje në të gjithë BE-në.

Traktatit të Aderimit;
- Dispozitat që duhet të ndryshohen me hyrjen në fuqi të Traktatit të Aderimit (për shembull kufizimi i objektit së zbatueshmërisë së dispozitave për zbatimin e Vendimit të autoriteteve të huaja për autoritetet në vendet e treta);
- Dispozitat që duhet të futen rishtas dhe të cilat duhet të jenë efektive në datën e hyrjes në fuqi të Traktatit të Aderimit në mënyrë që të sigurohet zbatueshmëria efektive e Rregullores, përfshirë, për shembull, dispozitat sipas të cilave autoriteti do të jetë kompetent për lëshimin e urdhrit për ekzekutimin ose përshtatjen e urdhrit të ekzekutimit sipas nenit 11 të Rregullores, cilat tarifa për ekzekutimin do të zbatohen, etj.

6.2 Zbatueshmëria e Rregullores para momentit të aderimit

749 Në rast se kërkohet zbatueshmëria e Rregullores përpara aderimit në BE, duhet të ndërmerren hapat e mësipërme si dhe parimet e mëposhtme duhet të merren parasysh:

- Duke qenë në një rast të tillë, ligjvënësi i brendshëm duhet të marrë masa për pranimin e rregullave të Rregullores së BE-së në të drejtën e brendshme, ekziston nevoja për të siguruar që këto dispozita të shfuqizohen në datën e aderimit në BE.
- Nëse këto dispozita janë të përhapura në të gjithë sistemin ligjor, kjo do të kërkonte një proces 'shqyrtimi' të veçantë. Për të shmangur këtë, mund të konsiderohet si opsion që dispozitat vendase për integrimin e dispozitave të Rregullores së BE-së:
  - të identifikohen qartë si të tilla;
  - të jenë thjesht përsëritje të rregullave të BE-së;
  - të janë strukturuar eventualisht në një kapitull të veçantë ose pjesë të aktit juridik të brendshëm; dhe
  - të jenë të lidhura me një dispozitë kalimtare e cila parashikon se këto dispozita shfuqizohen automatikisht në datën e aderimit të Shqipërisë në BE.

7 Transpozimi i Direktivave të BE-së

750 Në ndryshim nga Rregulloret e BE-së, të cilat kanë zbatim të drejtpërdrejtë në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së, Shtetet Anëtare si rregull duhet të transpozojnë Direktivat në të drejtën e brendshme. Direktivat janë

detyruese për Shtetet Anëtare si subjekte ndaj të cilave i adresohen në lidhje me objektivin që duhet të arrihet, por në të njëjtën kohe u lihet autoriteteve përkatëse vendase të zgjedhin formën dhe metodat për arritjen e këtij objektivi. Direktivat përcaktojnë afatin për transpozimin, zakonisht dy vjet pas hyrjes në fuqi.

751 Kur bëhet fjalë për nivelin e dispozitave transpozuese, duhet siguruar që të:

- vetëm ligjet dhe aktet nënligjore duhet të përzgjidhen për transpozim, pasi rregulli i përcaktuar në Direktivë duhet të transpozohet **në norma ligjore të detyrueshme për të gjithë**[227] (aktet e brendshme administrative mund të përdoren më së shumti si shtesa të transpozimit);

  Në çështjen 239/85, Komisioni kundër Belgjikës, Gjykata u shpreh që:

  "... Sipas praktikës gjyqësore të qëndrueshme të Gjykatës, secili Shtet Anëtar duhet të zbatojë direktivat në një mënyrë që plotëson plotësisht kërkesën e sigurisë juridike dhe si rrjedhojë duhet të transpozojë kushtet e tyre në të drejtën e brendshme si dispozita detyruese. Prandaj, Mbretëria e Belgjikës nuk mund të përmbushë detyrimet e saj sipas Direktivës Nr. 78/319 me anë të një qarkoreje të thjeshtë e cila mund të ndryshohet nga administrata sipas dëshirës ".

- autoritetet kompetente, brenda kuadrit të sistemeve të tyre ligjore vendase, miratojnë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që Direktiva është **plotësisht efektive**, në përputhje me objektivin që ndjek Direktiva.[228]

  Në çështjen 14/83, *Von Colson dhe Kamann*, gjykata vendosi që:

  "Sipas paragrafit të tretë të Nenit 189: "Një direktivë do të jetë detyruese, për sa i përket rezultatit që do të arrihet, për secilin Shtet Anëtar të cilit i adresohet, por do t'u lërë autoriteteve të brendshme zgjedhjen e formës dhe metodave". Megjithëse kjo dispozitë i lë Shtetet Anëtare të zgjedhin mënyrat dhe mjetet për të siguruar zbatimin e direktivës, kjo liri nuk ndikon në detyrimin e vendosur ndaj të gjithë Shteteve Anëtare të cilave u drejtohet direktiva, për të miratuar, në sistemin e tyre ligjor të brendshëm, të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që direktiva është plotësisht efektive, në përputhje me objektivin që ndjek".

227 Çështja 239/85, Komisioni kundër Belgjikës, 1986.
228 Çështja 14/83, Von Colson dhe Kamann, 1984.

752 Duhet të kihet parasysh se Direktivat e BE-së shpesh përdorin terminologji dhe teknika rregullimi të huaja për të drejtën shqiptare. Gjatë transpozimit të Direktivave, nuk është e mjaftueshme thjesht të deklarohet teksti i dispozitave të tyre si i detyrueshëm[229]. Puna më e rëndësishme do të përfshijë hartimin e legjislacionit në përputhje me Direktivën dhe që **përshtatet në mënyrë të përsosur** në sistemin ligjor shqiptar.

753 Në mënyrë që të përcaktohet se cilat dispozita të një Direktive duhet të transpozohen, legjislacioni ekzistues duhet të krahasohet me kërkesat e përcaktuara në Direktivë. Mund të jetë e nevojshme paraqitja e dispozitave në një fushë të mbuluar nga Direktiva në të cilën ekzistojnë dispozita ligjore sipas së drejtës së brendshme kur një dispozitë e Direktivës nuk është e mbuluar plotësisht nga dispozitat e së drejtës së brendshme.

754 Kur përcaktohet nëse, në cilën masë dhe si duhet të zbatohet një Direktivë, mund të jetë e dobishme të **bëhen pyetjet e mëposhtme**:

- Cili është fushëveprimi material i Direktivës? Mos harroni të përfshini dispozitat hyrëse në analizë.
- Cilat dispozita duhet të shtjellohen më tej dhe cilat nuk lejojnë hapësirë veprimi në lidhje me transpozimin?
- Cilat fusha ligjore të së drejtës shqiptare preken?
- A ka ndonjë dispozitë të brendshme që trajton temën e Direktivës në këto fusha ligjore?
  - Cilat dispozita ligjore korrespondojnë plotësisht me Direktivën?
  - Cilat dispozita ligjore janë më të gjera se ato në Direktivë?
  - Cilat dispozita ligjore janë më kufizuese sesa ato në Direktivë?
- A është e domosdoshme të bëhen ndryshime në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Direktivë?
  - A duhet të shfuqizohet ndonjë dispozitë ligjore?
  - A është e mjaftueshme të ndryshohen dispozitat ligjore ekzistuese?
  - A duhet të hartohet ndonjë dispozitë e re ligjore?
- Nëse duhet të hartohen rregulla të reja:
  - A mund të përfshihet transpozimi në një akt të ri parësor ose në një akt të ri nënligjor parësor?
  - A duhet të bëhet ndonjë shtesë në legjislacionin ekzistues?
- Çfarë ndikimi kanë këto ndryshime në ligje të tjera?

Një mjet efikas në lidhje me pyetjet e mësipërme janë TP-të (shih

229 Çështja 8/81, Becker, 1982.

nënseksionin 4.3.1 më sipër).

755 Kur lindin dyshime se si të interpretohen frazat konkrete në një Direktivë kur shqyrtohet nevoja për transpozimin e saj, rekomandohet që të konsultohen versionet e tjera të botuara në Gazetën Zyrtare për të përcaktuar vullnetin e ligjvënësit. Kjo vlen edhe kur përkthimi në shqip i Direktivës përmban fraza të rëndësishme ligjore, të cilat zakonisht formulohen ndryshe në të drejtën shqiptare.

756 Kur çështja e rregulluar nga Direktiva është rregulluar tashmë në një ligj ekzistues, nuk është e nevojshme të transpozohet Direktiva. Direktiva mund të jetë transpozuar vetëm pjesërisht dhe miratimi i dispozitave të veçanta ligjore mund të jetë i nevojshëm për të zbatuar plotësisht Direktivën. Në një rast të tillë, **ofrohen opsionet e mëposhtme**:[230]

- Dispozita të reja në ligjin ekzistues;
- Transpozimi literal i dispozitave konkrete të Direktivës, ose
- Një referencë në dispozitat konkrete të Direktivës.

757 Nëse një Direktivë nuk është transpozuar ende, hartuesi duhet të sqarojë nëse është e nevojshme miratimi i një akti ligjor apo nëse një akt nënligjor është mjeti më i përshtatshëm. Në rast se nevojitet një akt ligjor i nivelit kushtetues do të duhet të ndryshohet Kushtetuta. Nëse akti ligjor transpozues u referohet fushave të renditura në Nenin 85(2) të Kushtetutës, akti ligjor duhet të miratohet me shumicë të cilësuar; dispozitat e tjera mund të transpozohen me shumicë të thjeshtë. Mundësia e një transpozimi me akt nënligjor është i mundur vetëm kur ekziston autorizimi përkatës për miratimin e aktit nënligjor nga akt ligjor.[231]

758 Nëse dispozitat e Direktivës transpozohen pjesërisht, hartuesi duhet të:

- përcaktojë nëse ndryshimet janë aq të mëdha sa që nevojitet një ligj i ri,
- ose ndryshimet në aktet ekzistuese (aktet ligjore ose aktet nënligjore) janë të mjaftueshme.

759 Është e mundur të vlerësohet vetëm se cili opsion është i përshtatshëm në lidhje me Direktivën në fjalë. Opsioni i zgjedhur duhet të jetë i përshtatshëm për arritjen e objektivit detyrues të përcaktuar në Direktivë

230 Çështja 102/79, Komisioni kundër Belgjikës, 80.
231 Çështja 100/77, Komisioni kundër Republikës Italiane.

dhe për përmbushjen e parimit të qartësisë dhe përcaktueshmërisë.

760 Gjatë zbatimit të një Direktive me anë të një ligji të vetëm ose një paketë ligjesh, vëmendje e madhe duhet t'i kushtohet sigurimit që Direktiva të transpozohet plotësisht, që të hartohen vetëm ato dispozita që janë vërtet të nevojshme, që të jenë të lehta për t'u kuptuar dhe të përshtaten normalisht në sistemin ekzistues ligjor.

Shembull

Direktiva Seveso[232] përmban rregulla në lidhje me menaxhimin e një ndërmarrjeje, në lidhje me planifikimin e tokës, në lidhje me mënyrën e parandalimit dhe menaxhimit të katastrofave. Këto çështje rregullohen normalisht në ligje të veçanta. Ligjvënësi ka mundësinë të miratojë një akt të ri ligjor i cili ndryshon ose plotëson aktet e ndryshme ligjore ose të ndryshojë ose plotësojë aktet e ndryshme. Për transpozimin është më lehtë të miratohet një akt i ri, për zbatimin është më lehtë të ndryshohen aktet ekzistuese.

761 **Transpozimi literal** i dispozitave konkrete është një opsion vetëm nëse dispozitat përkatëse janë mjaftueshëm të përcaktuara në Direktivë dhe ato janë të lehta për t'u kuptuar. Para transpozimit literal të dispozitave dhe termave ligjorë të Direktivave, duhet të shqyrtohet me kujdes nëse dhe si ato përshtaten në ligjin shqiptar në fuqi, duke marrë parasysh sa vijon:

- Kur një Direktivë përdor terma, të cilët janë gjithashtu në përdorim të zakonshëm në legjislacionin shqiptar, është e mundur të transpozohen ato pa ndonjë problem, nëse këto terma përfshijnë gjithashtu të njëjtën përmbajtje.
- Një term i zbatuar në një kuptim të caktuar në të drejtën e BE-së nuk mund të transpozohet me anë të një termi identik në shqip që ka një kuptim të ndryshëm, por me një term në shqip që përçon të njëjtin kuptim.

762 Transpozimi me anë të një reference në dispozitat specifikë të një Direktive është i mundur vetëm kur Direktiva është përcaktuar mjaftueshëm dhe është e lehtë për tu kuptuar dhe lënda e saj nuk është rregulluar ende ndryshe në të drejtën shqiptare. Zakonisht referimi bëhet thjesht në dispozitat konkrete në një Direktivë. Avantazhet dhe disavantazhet e

232 Direktiva 2012/18/BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 4 korrikut 2012 mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, duke ndryshuar dhe më pas shfuqizuar Direktivën e Këshillit 96/82/EC, FZ L 197, 24.7.2012.

referencës (shihni Pjesa C, seksioni 3) duhet të peshohen me kujdes kur u referohen dispozitave në Direktiva, në mënyrë që të shqyrtohet nëse subjektet mund t'i kuptojnë lehtësisht dispozitat e referuara, kur ato lexohen veçmas ose së bashku me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

7.1 Pasojat e mostranspozimit ose transpozimit të papërshtatshëm të një Direktive

763 Nëse ligjvënësi i një Shteti Anëtar nuk transpozon një Direktivë, ose e transpozon atë në mënyrë të pasaktë, ka disa mënyra të mundshme për të vepruar kundër këtij Shteti sipas së drejtës së BE-së.

764 Së pari, Komisioni Evropian ka një mundësi për të filluar procedurat e shkeljes kundër një shteti në kundërvajtje. Ato mund të përfundojnë në fazën gjyqësore, në të cilën do t'i takojë GJDBE-së të deklarojë nëse shteti ka shkelur detyrimin e tij për të transpozuar një Direktivë.

765 Së dyti, falë cilësive të caktuara kushtetuese të së drejtës së BE-së të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJDBE-së dhe të pranuara më pas nga autoritetet e Shteteve Anëtare dhe gjykatat e tyre, individët mund të 'detyrojnë' pushtetin legjislativ të zbatojë një Direktivë për përfitimin e tyre edhe nëse nuk është transpozuar.

766 Gjykatat dhe autoritetet administrative të një Shteti Anëtar janë gjithashtu të detyruara sipas së drejtës së BE-së të interpretojnë ligjin e brendshëm ekzistues në përputhje[233] me kërkesat e një Direktive. Një detyrim i tillë interpretues është kuptuar gjerësisht nga GJDBE-ja dhe kërkon nga gjykatat vendase dhe autoritetet administrative më shumë kreativitet në interpretim sesa shumica e gjykatave dhe autoriteteve administrative janë mësuar në rendin ligjor të brendshëm.

767 Përfundimisht, nëse për shkak të mostranspozimit ose transpozimit të papërshtatshëm të një Direktive, individët pësojnë dëm, ata mund të ngrenë padi për dëmshpërblim në gjykatat e brendshme. Gjykatat e brendshme janë të detyruara të shqyrtojnë padi të tilla në bazë të konceptit të ligjit të BE-së për përgjegjësinë e shtetit për dëmshpërblim, jo sipas konceptit të së drejtës së brendshme.[234]

233 Çështja 8/81, Becker, 1982.
234 Çështjet C-6/90 dhe C-9/90 Francovich dhe të Tjerë kundër Italisë, 1991.

8 Harmonizimi i së drejtës së brendshme me Vendimet e BE-së

768 Vendimet e BE-së, ashtu si Rregulloret e BE-së, janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Ato hyjnë në fuqi me njoftimin e palës së cilës i adresohen dhe janë detyruese për palët të cilave u adresohen në datën kur hyjnë në fuqi. Vendimet e BE-së përdoren për të specifikuar kërkesat e hollësishme administrative ose për të përditësuar aspektet teknike të Rregulloreve ose Direktivave të BE-së. Parimet e zhvilluara nga praktika gjyqësore e GJED-së janë të zbatueshme *mutatis mutandis* për Vendimet e BE-së.

Shembull
Komisioni mund të ndryshojë listat e mbetjeve sipas Rregullores për transportin ndërkufitar të mbetjeve, të specifikojë format dhe kërkesat e dokumentacionit dhe çështje të tjera administrative. Komisioni ka marrë një seri Vendimesh që përcaktojnë kushtet për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së grupeve të ndryshme të produkteve.

9 Rishikimi i legjislacionit vendas në varësi të ndryshimit të rrethanave

9.1 Rishikimi i legjislacionit vendas në varësi të statusit të anëtarësimit të Shqipërisë

769 Gjatë periudhës para aderimit, është i nevojshëm përafrimi i korpusit të së drejtës së brendshme me Rregulloret dhe Vendimet të BE-së, por me anëtarësimin në BE, aktet normative të brendshme që inkorporojnë tërësinë ose pjesë të Rregulloreve ose Vendimeve të BE-së, sipas rastit, duhet të shfuqizohen në tërësinë e tyre ose duhet të shfuqizohen ato dispozita specifike që duplikojnë Rregulloren (shih gjithashtu nënseksionin 6.1 më lart).

770 Ka shumë raste kur autoritetet ligjvënëse priren të përfshijnë Rregullore, Direktiva ose Vendime të veçanta të BE-së (sipas rastit) përmes urdhrave të ministrave bazuar në Nenin 119 të Kushtetutës, të cilat nuk publikohen automatikisht në Fletoren Zyrtare dhe nuk janë të natyrës të përgjithshme detyruese (shih Pjesën A nënseksioni 1.3 i këtij Manuali).

771 Përdorimi i kësaj procedure ka prodhuar shumë akte administrative të cilat nuk mund të krijojnë detyrime ligjore ndaj palëve të treta, përveç administratës publike, në përputhje me dispozitat e nenit 119 të

Kushtetutës së Shqipërisë. Transpozimi i Direktivave të BE-së me akte të brendshme administrative në kuptimin e nenit 119 të Kushtetutës nuk është në përputhje me legjislacionin e BE-së (shih më lart).

772 Prandaj, gjatë procesit të shqyrtimit dhe negocimit dhe veçanërisht para aderimit, ligjvënësi duhet të sigurojë që të gjitha aktet e brendshme transpozuese/harmonizuese, të miratohen si akte nënligjore normative, përfshirë aktet nënligjore në kuptim të nenit 118 të Kushtetutës. Aktet e tilla duhet të autorizohen me ligj, i cili gjithashtu duhet të caktojë organin kompetent dhe të përcaktojë, brenda çështjeve të deleguara për t'u rregulluar dhe parimeve në bazë të të cilave do të nxirret akti nënligjor sipas parashikimeve të nenit 118 të Kushtetutës. Përveç kësaj, aktet nënligjore në kuptimin e nenit 118 të Kushtetutës duhet të publikohen dhe të botohen në mënyrë të rregullt në Fletoren Zyrtare sipas nenit 117 të Kushtetutës.

773 Prandaj, në rast se një Direktivë është transpozuar nga një akt administrativ i brendshëm në kuptimin e nenit 119 të Kushtetutës, autoritetet legjislative duhet të vlerësojnë nëse ligji siguron autorizimin, përcakton autoritetin kompetent, lëndën dhe parimet. Vetëm në këto kushte, autoriteti kompetent administrativ mund të miratojë një akt nënligjor në kuptim të nenit 119 të Kushtetutës.

9.2 Rishikimi i legjislacionit vendas në varësi të ndryshimit të legjislacionit të BE-së

774 *Acquis* i BE-së është një kuadër ligjor gjithnjë në zhvillim; ndaj, në rast ndryshimi të një akti të BE-së, akti ligjor vendas i transpozuar ose rregullat harmonizuese duhet të përshtaten në përputhje me rrethanat e reja, duke ndjekur parimet e parashikuara më sipër.

10 Kërkesat për citim sipas së drejtës së Bashkimit Evropian

10.1 Citimi i së drejtës së Bashkimit Evropian

775 E drejta e BE-së citohet gjithmonë në përputhje me konventat e vendosura në nivelin Evropian. Kjo vlen për traktatet, aktet legjislative të Komuniteteve Evropiane. Udhëzimet e Përbashkëta për Cilësinë e Hartimit të Legjislacionit Komunitar[235], për të cilat arritën marrëveshje Parlamenti

235 Marrëveshja Ndër-Institucionale e Parlamentit Evropian, Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane të datës 22 Dhjetor 1998 (FZ C 73, 17.3.1999, f. 1).

Europian, Këshilli i Bashkimit Europian dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, dhe Udhëzuesi Praktik i Përbashkët i Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit për personat e përfshirë në hartimin e legjislacionit të BE-së duhet të respektohen.[236]

776 Kur metoda e citimit nuk është specifikuar saktësisht nga BE-ja, citimet duhet të ndjekin modelet e mëparshme. Kur referimi bëhet në një ligj ose akt nënligjor në një akt legjislativ të Komuniteteve Evropiane ose të BE-së, duhet të përdoret emërtimi i plotë (citimi i plotë).

777 Titulli i një Rregulloreje të BE-së në shqip ndjek këtë renditje:

- Emërtimi *"Rregullore"*,
- Emërtimi i shkurtuar i komunitetit miratues në kllapa (KE, KEE),
- Numri rendor zyrtar, që përmban shkurtimin "Nr.", numrin rendor, vijë tërthore dhe vitin e miratimit,
- Institucioni(et) miratues(e),
- Data e miratimit,
- Përcaktimi i përmbajtjes së Rregullores, dhe
- Referenca në FZBE.

778 Titulli i një Direktive të BE-së në shqip ndjek këtë renditje:

- Emërtimi "*Direktivë*",
- Numri rendor zyrtar, që përfshin vitin e miratimit, numrin rendor dhe emërtimin e shkurtuar të komunitetit miratues (KE, KEE, BE),[33]
- Institucioni(et) miratues(e),
- Data e miratimit,
- Përcaktimi i përmbajtjes së Direktivës, dhe
- Referenca në FZBE.

779 Titulli i një Vendimi Kuadër ose i një Vendimi të Bashkimit Evropian në shqip ndjek këtë renditje:

- Emërtimi "*Vendim Kuadër*" or "*Vendim*",
- Numri rendor zyrtar, që përfshin vitin e miratimit, numrin rendor dhe emërtimin e shkurtuar të institucionit miratues,
- Institucioni(et) miratues(e),

236 Udhëzuesi Praktik i Përbashkët i Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit për personat e përfshirë në hartimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian mund të shkarkohet në: www.eur-lex.europa.eu/content/techleg/KB0213228ENN.pdf

- Data e miratimit,
- Përcaktimi i përmbajtjes së Vendimit kuadër ose Vendimit, dhe
- Referenca në FZBE.

780 Referenca tek një korrigjim duhet të citojë vetëm numrin e botimit të FZBE-së dhe numrin e faqes. Nëse korrigjimi është botuar në një vit tjetër të FZBE-së, kjo gjithashtu duhet të shënohet.

781 Kur citohet e drejtën e BE-së në shqip, citimi i plotë i një akti legjislativ të BE-së përfshin një referencë tek çdo ndryshim të bërë në tekst. Kur një akt legjislativ është ndryshuar disa herë, referenca bëhet vetëm për ndryshimin e fundit. Referenca për një amendament përcakton vetëm aktin legjislativ ndryshues, numrin e tij rendor dhe referencën në FZBE.

782 Aty ku duhet të bëhet referencë e përsëritur tek një akt legjislativ të BE-së, mjafton të përdoret citimi i plotë herën e parë që përmendet në tekstin legjislativ. Pas kësaj, citimi i shkurtuar mund të përdoret në vend të citimit të plotë, d.m.th. që përfshin vetëm llojin e aktit legjislativ dhe numrin e referencës.

783 Lindin një numër veçorish kur përmenden dispozitat konkrete të së drejtës së BE-së, sepse nënndarjet e dispozitave ligjore ndryshojnë nga ato të përdorura në të drejtën shqiptare. Këto nënndarje duhet të merren siç janë.

784 Ashtu si ndarja e neneve në paragrafë, numra dhe shkronja, e drejta e BE-së gjithashtu përmban nënparagrafë, shkronja dhe rradhë.

Shembuj
Neni 23, pika 2, shkronja (c), e Rregullores (KE) Nr 1774/2002 ...
Neni 4, pika 1, rradha e parë, e Rregullores (KE) Nr. 2580/2001 ...

785 Referenca tek akti ligjor i *acquis* së BE-së vihet si shënim në fund të faqes së parë të ligjit, e lidhur me titullin e ligjit. Shënimi në fund të faqes duhet të përmbajë numrin CELEX dhe titullin e plotë me datën e miratimit të aktit ligjor të *acquis* së BE-së që është transpozuar në ligj.[237]

786 Më poshtë, ilustrohet se si duhet strukturuar një referencë e plotë për instrumentin ligjor të *acquis*-së së BE-së, i cili përfshin numrin CELEX, titullin dhe datën e miratimit të instrumentit.

237 Paragrafi 21/1 i RKM-së.

Shembull
32000L0013 Direktiva 2000/13/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 Mars 2000 mbi përafrimin e së drejtës së Shteteve Anëtare në lidhje me etiketimin, prezantimin dhe reklamimin e produkteve ushqimore.

787 Për të përfunduar detyrën e referimit në aktin juridik të BE-së, pas titullit të ligjit duhet të vendoset një yll (*) në faqen e parë dhe citimi përkatës i aktit juridik duhet të futet si shënim në fund të faqes.

Shembull
"Ligji nr. xxxx datë xx.xx .xxxx
'Për.....'*

* [Në fund të faqes]: Përafruar me [numri i CELEX] [data e miratimit] [titulli i plotë i aktit juridik]

10.2 Kërkesat për citim gjatë transpozimit të Direktivave të BE-së

788 Në përputhje me një marrëveshje të përgjithshme të arritur midis Këshillit dhe Komisionit Europian, kur transpozojnë Direktivat, Shtetet Anëtare duhet t'u referohen dispozitave transpozuese me Direktivën. Kjo **kërkesë për citim** përfshihet gjithmonë në dispozitat përmbyllëse të Direktivës. Referenca për Direktivën që do të transpozohet përmban informacionin e nevojshëm. Së pari, lexuesit mësojnë se cili burim tjetër i së drejtës së BE-së duhet të konsultohet; së dyti, referenca identifikon dispozitat e brendshme në një mënyrë të tillë që të mund të konstatohet se në çfarë mase ligji ndikohet nga Direktivat e BE-së. Duhet të respektohen disa rregulla që referenca të përmbushë të dyja këto qëllime.

789 Referenca në Direktivën që transpozohet bëhet me anë të një **citimi të plotë**, d.m.th. përfshirë referencën e FZBE-së dhe citimin e ndryshimit të fundit. Kërkesa për citim mund të plotësohet në mënyra të ndryshme dhe në vende të ndryshme kur zbatohen Direktivat në të drejtën e brendshme.

790 Mënyra më e zakonshme për ta bërë këtë është me anë të një referimi në një **shkrim fundor** tek titulli i ligjit ose aktit nënligjor, i cili formulohet si më poshtë:

Ky ligj / akt nënligjor përafron Direktivën e Këshillit ... / ... / ... të datës ... për ... (GZ L ..., ..., f).

Kur mund të përcaktohen, pjesë të veçanta, të mirëpërcaktueshme, të ligjit ose aktit nënligjor i referohen Direktivës, për shembull një seksion në një akt nënligjor ose një nen në një akt gjithëpërfshirës, shkrimi fundor duhet të shënohet saktësisht dhe t'i shtohet seksionit përkatës ose titullit të nenit:

> Neni ... i këtij ligji/urdhri përafron Direktivën e Këshillit ... / ... / ... të ... për ...
> (GZ L ..., ..., f ...).

Kur transpozohen disa Direktiva, të gjitha ato duhet **të citohen sa më saktësisht** që të jetë e mundur në shkrimin fundor:

> Neni X i këtij ligji përafron Direktivën ... dhe neni Y përafron Direktivën ... .

Shënimet e posaçme fundore mund të përfshihen në vendin përkatës në ligj ose aktin nënligjor.

791 **Shkrimi fundor nuk ka fuqi ligjore** pasi ai thjesht ofron informacione pas shpalljes. Megjithatë, ai duhet të përfshihet në projektligjin ose aktin nënligjor në mënyrë që të tërheqë vëmendjen për përafrimin me Direktivën përkatëse.

792 Kur një referencë tek një Direktive është bërë gabimisht ose mungon informacioni i duhur, duhet të korrigjohet referenca, ose të bëhet një shtesë me anë të korrigjimit; kur është hequr një referencë, mund të përdoret e njëjta procedurë për ta shtuar atë.

793 Direktiva gjithashtu mund të referohet në titullin e një ligji ose akti nënligjor për të përmbushur kërkesën për citim. Kjo ka kuptim kur zbatimi i Direktivës është përmbajtja e vetme rregullatore e një akti parësor ose akti parësor nënligjor. Meqenëse citimi i plotë, i cili përgjithësisht përfshin referencën e botimit, do ta bënte titullin të gjatë dhe të vështirë për t'u lexuar, duhet të përdoret një shënim shtesë për të treguar referencën e botimit të Direktivës në Gazetën Zyrtare të BE-së (referenca GZ), përveç kur Direktiva është cituar plotësisht në tekstin e ligjit ose aktit nënligjor.

> **Shembull**
> Udhëzim për zbatimin e Direktivës së Këshillit 80/68/KEE të datës 17 dhjetor 1979 mbi mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja e

shkaktuar nga disa substanca të rrezikshme

794 Titulli nuk mund ta përfshijë referencën nëse duhet të përdoret një ligj ose akt nënligjor për të zbatuar disa Direktiva. Titulli do të bëhej shumë i gjatë dhe do të përmbante shumë informacion nëse do të përfshiheshin citimet e plota të disa Direktivave. Kjo nuk mund të rregullohet duke përfshirë një përshkrim përmbledhës të disa Direktivave në titull, sepse kërkesa për citim nuk do të plotësohej. Një opsion tjetër i mundshëm do të ishte referimi i zbatimit të Direktivës në tekstin e dispozitave konkrete. Të paktën në përmendjen e parë, duhet të përdoret citimi i plotë i Direktivës.

795 Kërkesa për citim **duhet të respektohet** gjithashtu kur njoftohen versionet e rishikuara të një ligji ose akti nënligjor. Kur kërkesa për citim është përmbushur duke përfshirë një referencë në një shkrim fundor kur shpallet një ligj ose një akt nënligjor, versioni i rishikuar gjithashtu duhet të njoftohet me një referencë në shkrimin fundor për zbatimin e Direktivës. Meqenëse ligji ose akti nënligjor do të citohet në të ardhmen vetëm duke përdorur referencën e njoftimit të botimit, atje duhet të përfshihet referenca për të gjitha Direktivat e zbatuara.

796 E njëjta gjë zbatohet në përputhje me rrethanat, kur dispozitat e brendshme të zbatueshme përputhen tashmë me një Direktivë të miratuar në një moment të mëvonshëm në kohë. Meqenëse në raste të tilla nuk është e nevojshme të transpozohet Direktiva me anë të një akti legjislativ, kërkesa për citim mund të përmbushet kur ky ligj ose akt nënligjor ribotohet. Referenca është formuluar në të njëjtën mënyrë si për shpalljen.

797 Vendimet e BE-së përgjithësisht nuk janë të nevojshme të transpozohen në të drejtën e brendshme, ato thjesht duhet të zbatohen. Sidoqoftë, citimi mund të jetë i nevojshëm në aktet e përgjithshme detyruese. Megjithatë, nuk ka ndonjë kërkesë për citim. Sidoqoftë, ekziston një kërkesë që duhet të përfshihen informacione të caktuara, si dhe një kërkesë etiketimi e ngjashme me atë që zbatohet për Rregulloret. Për të vënë në dukje lidhjet me të drejtën e Bashkimit Europian, në rastin e legjislacionit që i shërben zbatimit të Vendimeve kuadër dhe Rregulloreve, duhet të përfshihet informacioni i duhur.

798 Opsioni i preferuar për Vendimet e BE-së është gjithashtu **shënimi në fund të faqes** pasi emërtimet e akteve legjislative të Bashkimit Europian janë shpesh shumë të gjata dhe prandaj vështirë se janë të përshtatshme për t'u përdorur në titull. Prandaj, një emërim i lidhur me lëndën duhet

të zgjidhet për ligjin ose aktin nënligjor; gjithashtu mbi atë bazë mund të krijohet një titull i shkurtër. Është e pranueshme që një titull i shkurtër të reflektojë vetëm pjesërisht referencën në të drejtën e Bashkimit Europian nëse shkrimi fundor i referohet Vendimit që do të zbatohet në citimin e plotë.

10.3 Referencë për përputhshmërinë me procedurën në pajtim me Direktivën (BE) 2015/1535 (Direktiva e Njoftimit)

799 Kur një projektligj ose akt nënligjor përmban **dispozita teknike ose dispozita për shërbimet e shoqërisë së informacionit**, duhet të respektohen dispozitat e Direktivës së Njoftimit që përcaktojnë një procedurë për dhënien e informacionit në fushat e Rregulloreve teknike dhe rregullimeve për shërbimet e shoqërisë së informacionit (Direktiva e Njoftimit).

800 Në përputhje me Nenin 8 të Direktivës së Njoftimit, Shtetet Anëtare janë të detyruar t'i komunikojnë Komisionit Evropian çdo projekt rregulloreje teknike dhe projektaktet për shërbimet e shoqërisë së informacionit. Shtetet Anëtare mund të miratojnë dispozitat ligjore vetëm pas skadimit të afateve të përcaktuara në Nenin 9 të Direktivës (BE) 2015/1535. Çdo shkelje e detyrimeve për njoftim të përcaktuara në Nenet 8 dhe 9 të Direktivës së Njoftimit çon në **moszbatueshmëri të dispozitave në fjalë**.

801 Pajtueshmëria me Direktivën e Njoftimit duhet të sigurohet gjatë miratimit të standardeve dhe Rregulloreve teknike. Kjo **referencë** bëhet me anë të **shkrimit fundor** të mëposhtëm momentin e botimit zyrtar:

Detyrimet e përcaktuara në Direktivën (BE) 2015/1535 të Parlamentit Europian dhe e Këshillit të 22 qershorit 1998 që përcakton procedurën për dhënien e informacionit në fushën e standardeve dhe rregullimeve teknike si dhe të rregullave mbi shërbimet e Shoqërisë së Informacionit (GZ L 241, 17.9.2015, f. 1–15), janë përmbushur.

Në ndryshim nga shkrimi fundor i përfshirë gjatë zbatimit të Direktivave, ky shkrim fundor nuk do të ndryshohet derisa nuk është ndryshuar Direktiva e Njoftimit.

802 Rekomandimet e bëra në lidhje me shkrimet fundore të shtuara gjatë zbatimit të kërkesës së përgjithshme për citim zbatohen në përputhje me rrethanat në lidhje me **vendin e vendosjes** së shkrimit fundor dhe

procedurës përkatëse. Referenca në Direktivën (BE) 2015/1535, duhet të përfshihet tashmë në **projekt** ligj ose akt nënligjor. Në këtë mënyrë mund të tërhiqet vëmendja gjatë konsultimeve mbi projektin për detyrimet sipas kësaj Direktive. Në veçanti, referenca shërben si një kujtesë që Komisionit Europian duhet t'i jepet mundësia për të kryer rishikimin e nevojshëm para se të miratohen dispozitat teknike. Këto periudha kohore, pas momentit të aderimit, duhet të kihen parasysh kur shkruhet dispozita për hyrjen në fuqi.

803 Referenca në Direktivën e Njoftimit nuk bëhet as në titullin e ligjeve dhe akteve nënligjore dhe as në vetë dispozitat konkrete pasi informacioni nuk e bën më të lehtë për të kuptuar ligjin ose aktin nënligjor. Ai shpreh vetëm faktin se dispozitat ligjore janë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Direktivën e Njoftimit dhe tregon se legjislacioni i brendshëm është ai që ka një lidhje të veçantë me të drejtën e BE-së.

804 Pasi ato të jenë shtuar në legjislacion, referencat për njoftimin **nuk janë të nevojshme të përshtaten** kur Direktiva e Njoftimit të ndryshohet më pas. Kështu, referencat për pararendësin e Direktivës (BE) 2015/1535 (p.sh. Direktiva 83/189/KEE), të cilat janë shpallur tashmë, nuk ndryshojnë. E njëjta gjë vlen kur ky legjislacion ribotohet. Vetëm kur legjislacioni ndryshohet pas hyrjes në fuqi të Direktivës (BE) 2015/1535 ose ndryshimet e saj ndryshohen, referenca do të duhet të bëhet në versionin aktual të Direktivës së Njoftimit në momentin e ndryshimeve.

805 Sipas Direktivës (BE) 2015/1535 Shtetet Anëtare duhet të informojnë Komisionin për çdo projekt rregullore teknike para miratimit të saj. Duke filluar nga data e njoftimit të draftit, një periudhë pritjeje tre-mujore - gjatë së cilës Shteti Anëtar njoftues nuk mund të miratojë rregulloren teknike në fjalë - i mundëson Komisionit dhe Shteteve të tjera Anëtare të shqyrtojnë tekstin e njoftuar dhe të përgjigjen në mënyrë të përshtatshme.

806 Kur rezulton që drafte të njoftuara mund të krijojnë pengesa në lëvizjen e lirë të mallrave ose sigurimin falas të shërbimeve të shoqërisë së informacionit ose të drejtës dytësore të BE-së, Komisioni dhe Shtetet e tjera Anëtare mund ti paraqesin një mendim të hollësishëm Shtetit Anëtar që ka njoftuar projektin. Opinioni i hollësishëm ka efektin e zgjatjes së periudhës së pritjes me tre muaj shtesë për produktet dhe me një muaj shtesë për shërbimet. Në rast të paraqitjes së një mendimi të hollësishëm, Shteti Anëtar i interesuar duhet të shpjegojë veprimin që synon të

ndërmarrë në përgjigje të opinionit të detajuar.

807 Shtetet Anëtare të BE-së e kanë të detyrueshme t'u referohen Direktivave të cilat janë transpozuar në legjislacionin e brendshëm. Për Shqipërinë, megjithëse në fazën e saj të hershme të aderimit, rekomandohet të fillojë me referencën e Direktivave.

808 Në rastet kur transpozohet legjislacioni i BE-së, dispozitat për qëllimin e aktit normativ duhet gjithashtu të rendisin legjislacionin e BE-së të transpozuar gjatë hartimit të aktit normativ.

Shembull

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj rregullon dhënien e azilit dhe njohjen e statusit të refugjatit dhe dhënien e mbrojtjes plotësuese ose të përkohshme ndaj personave në nevojë dhe kthimin e tyre në vendin e tyre të origjinës, prejardhjes ose një vend të tretë. Ky ligj është në përputhje me Direktivën për Procedurat e Azilit (Direktiva 2005/85/KE) dhe Direktivën për kushtet e pranimit për azilkërkuesit (Direktiva 2003/9/KE).

Pjesa G
Aktet nënligjore

1 Vërejtje të Përgjithshme

809 Termi "akt nënligjor" përdoret për t'iu referuar rregullave të ligjit të cilat grupohen së bashku nën një titull dhe nxirren nga organe të caktuar referuar në Kushtetutë[238] (përfshirë Këshillin e Ministrave, Kryeministrin, ministrat dhe organet drejtuese të institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor) në kushte të caktuara të specifikuara nga Kushtetuta (shih për më shumë detaje Pjesën A, nënseksioni 1.3). Ashtu si ligjet, aktet nënligjore përbëjnë legjislacion detyrues. Në ndryshim nga ligjet, megjithatë, ato nuk miratohen nga Parlamenti, por nxirren nga organet administrative. Një akt nënligjor nxirret në bazë të një autorizimi ligjor i cili specifikohet në lidhje me përmbajtjen, qëllimin dhe objektin (neni 118 (2) i Kushtetutës).

810 Është veçanërisht e rëndësishme të respektohet kërkesa për citim sipas nenit 118(1) të Kushtetutës. Si pasojë, çdo akt nënligjor duhet të citojë bazën e tij ligjore. Kur një referencë e tillë nuk përfshihet, gabimi nuk mund të plotësohet me anë të një ndryshimi ose shtese në dispozitën e bazës ligjore. Dispozitat në një akt nënligjor për të cilin autorizimi nuk është deklaruar ose nuk është deklaruar plotësisht duhet të rinxirren duke respektuar kërkesën për citim të GJK-së. Baza ligjore për një akt nënligjor përcaktohet në **dispozitën miratuese**, e cila gjithashtu tregon se cili autoritet e ka nxjerrë aktin nënligjor.

811 Për nxjerrjen e akteve nënligjore zbatohen kërkesa për formën dhe procedurën. Këto janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe në dispozitat ligjore autorizuese. Përmbajtja rregullatore e një akti nënligjor duhet të mbulohet nga autorizimi ligjor i cituar në dispozitën miratuese. Ajo duhet të përputhet me përmbajtjen dhe qëllimin e specifikuar në autorizim dhe nuk mund të shkojë përtej masës së parashikuar në të. Gjykata administrative vendos rast pas rasti nëse një akt nënligjor është

238 Pika 21/1 e RKM-së.

i paligjshëm nga pikëpamje lëndore ose formale.[239] Kjo është arsyeja pse duhet të tregohet kujdes i veçantë gjatë nxjerrjes së një akti nënligjor për të siguruar që të mos lindin dyshime për vlefshmërinë e tij.

812 Ekzistojnë dy lloje të akteve nënligjore: *aktet nënligjore parësore* (shih seksionin 3) dhe *aktet nënligjore ndryshuese* (shih seksionin 4). Aktet nënligjore ekzistuese mund të përshtaten ose zgjerohen nëpërmjet ndryshimit të tyre. Aty ku duhet të bëhen ndryshime thelbësore, rekomandohet që të nxirret një akt nënligjor zëvendësues. Aktet nënligjore parësore duhet të nxirren vetëm aty ku këto akte krijohen për herë të parë.

813 Duhet të theksohet se rekomandimet e mëposhtme për strukturimin e akteve nënligjore bazohen në një rishikim të akteve nënligjore, të kryer përmes identifikimit të akteve nënligjore të miratuar ndër vite në tre fusha përfaqësuese të politikës qeveritare, përkatësisht në fushat e drejtësisë, e financave dhe arsimit.

2 Autorizimi për nxjerrjen e akteve nënligjore

814 Parimi themelor kryesor i sistemit kushtetues dhe ligjor shqiptar është që i gjithë legjislacioni të miratohet nga Kuvendi. Sidoqoftë, në raste të caktuara Kuvendi mund t'i delegojë administratës shtetërore detyrën për të siguruar rregullime më të hollësishme dhe teknike. Kjo ka kuptim, për shembull, për të shmangur mbingarkimin e ligjeve me shumë detaje ose për të siguruar që dispozitat të mund të përshtaten më shpejt me ndryshimet tashmë të parashikueshme.

815 Për këtë arsye, neni 118 i Kushtetutës parashikon që:

- Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.
- Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.
- Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në pikën 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.

816 Neni 118 i Kushtetutës ndihmon për t'i dhënë kuptimin kushtetues dhe

239 Neni 7(a) i LGJA-së.

doktrinar konceptit të **rezervës ligjore**, nëpërmjet të cilit kufizohet ose orientohet pushteti normativ i organeve ekzekutive për të rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. Kjo rezervë ligjore krijon mundësinë që çështja konkrete e rregulluar pjesërisht me ligj të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, duke iu përmbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuar nga ligji. Vetëm në këtë mënyrë autorizimi i ligjvënësit për nxjerrjen e akteve nënligjore mund të konsiderohet i realizuar brenda kufijve të kushtetutshmërisë.[240]

817 Sa i përket fushës së akteve nënligjore, si rregull, Kushtetuta nuk përmban dispozita të përgjithshme që kufizojnë nivelin e detajimeve që mund të përmbahet në dispozitat e një ligji, as nuk e kufizon shkallën në të cilën një ligj mund t'i japë kompetencë legjislative të deleguar ekzekutivit. Sidoqoftë, Kushtetuta specifikon që ligjbërja për qëllime të caktuara dhe në fusha të caktuara i rezervohet ekskluzivisht Kuvendit dhe nuk mund t'u delegohet organeve të administratës. Ky është rasti për legjislacionin që kufizon të drejtat e njeriut[241], vendosjen e taksave[242] dhe çështje të tjera.[243]

818 Në vendimmarrjen nëse një normë duhet të jetë çështje ligjore e miratuar nga Kuvendi apo çështje që do t'u delegohet organeve administrative, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Nëse norma është një nga parimet e përgjithshme, ose parimi i përgjithshëm brenda një fushe të caktuar të ligjit, ose është një udhëzues përgjithësisht i zbatueshëm në zbatimin e parimeve të tilla, duhet të preferohet një ligj i miratuar nga Kuvendi. Për shembull, është doktrinë e njohur që, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe të demokracisë, për shumicën e veprimeve shtetërore që prekin të drejtat themelore të qytetarit kërkohet një ligj i miratuar nga Kuvendi.
- Ndonjëherë prakticiteti mund të luajë një rol në vendim. Kështu, për shembull, nëse parashikohet që mund të kërkohet ndryshim i shpeshtë i një dispozite ligjore, legjislacioni i deleguar mund të jetë i përshtatshëm, sepse procedura legjislative e deleguar është relativisht e thjeshtë dhe e shpejtë.

819 Prandaj, kur vendoset për shkallën e kompetencës legjislative të deleguar

240 Shih vendimet nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 4, datë 15.02.2021 të GJK-së.
241 Neni 17 i Kushtetutës.
242 Neni 155 i Kushtetutës.
243 Shih *ndër të tjera* nenin 156 të Kushtetutës.

tek organet administrative, është e rëndësishme që vlerësimi të jetë më shumë cilësor sesa sasior. Nuk duhet të jetë shqetësuese që një ligj përmban shumë dispozita delegimi, për sa kohë që secila dispozitë konsiderohet dhe justifikohet siç duhet. Meqenëse një institucion me kompetencë legjislative të deleguar mund të veprojë vetëm brenda kufijve të asaj kompetence, projektligji duhet ta shprehë atë delegim në mënyrë të qartë dhe të saktë. Gjithashtu, si çështje praktike, para delegimit të kompetencave legjislative te një institucion i caktuar, është e rëndësishme garancia se institucioni ka kapacitetin për ta përmbushur atë.

819 Sidoqoftë, kurdoherë që jep autorizim/delegim për miratimin e akteve nënligjore, ligjvënësi duhet të marrë në konsideratë ekuilibrin midis funksionit legjislativ të Kuvendit dhe funksionit legjislativ të deleguar që do t'u delegohet organeve administrative. Përfshirja në ligj e dispozitave që normalisht trajtohen me akt nënligjor mund të krijojë kompleksitet dhe ngurtësi të panevojshme, megjithatë, rregullimi në nivelin e ligjit siguron publicitet dhe siguri ligjore më të lartë për publikun.

820 Për shkak të këtij akti delikat balancues, arsyetimi dhe shkaqet për dhënien e një kompetence legjislative të deleguar duhet të përshkruhen gjithmonë në raportin shpjegues të projektligjit.

821 Kur jepet një autorizim për nxjerrjen e akteve nënligjore, ligjvënësi mund të nxjerrë rregullime të mëtejshme mbi çështjen, por vetëm me anë të një ligji.

3 Aktet nënligjore parësore

3.1 Titulli

822 Titulli i një akti parësor nënligjor shkruhet në përputhje me rregullat e zbatueshme për aktet parësore (shih Pjesën D seksionin 2).

823 Titulli i plotë dhe, aty ku është krijuar, titulli i shkurtër, duhet të tregojë nivelin e instrumentit legjislativ duke përfshirë sipas rastit fjalën "Vendim", "Rregullore", "Urdhër" ose "Udhëzim".[244]

824 Titulli i plotë i një akti parësor nënligjor gjithashtu pasqyron përmbajtjen me anë të fjalëve kyçe (shih Pjesën D nënseksionin 2.2).

244 Shih Pjesën A nënseksioni 1.3 si dhe Shtojcën A të këtij Manuali për debatin e hapur në lidhje me tipologjinë e akteve nënligjore në administrative në referencë me praktikën e deritanishme kundrejt terminologjisë së Kushtetutës.

825 Meqenëse është miratuar një akt nënligjor për të zbatuar një akt, akti duhet të referohet me titullin e citimit të tij (shih Pjesën C nënseksionin 4.2) në titullin e aktit nënligjor. Vetëm atëherë do të jetë e mundur të përdoret titulli i citimit ose shtesa "e ligjit" në vend të citimit të plotë në tekstin e aktit nënligjor kur u referohemi dispozitave të përcaktuara në akt.

826 Nëse një akt parësor përmban **disa autorizime** dhe miratohen disa akte nënligjore për të zbatuar atë akt, titujt e gjatë të akteve nënligjore duhet të ndërtohen në një mënyrë që i bën ato të dallohen lehtësisht nga njëri-tjetri.

Shembuj
Vendimi i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti

Vendim i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuara për sigurimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit dhe mënyrën e financimit të tyre

827 Kur miratohet një akt parësor nënligjor për të zbatuar një rregullore të BE-së ose një direktivë të BE-së, a vendim kuadër ose një vendim të Bashkimit Europian, marrëdhënia me të drejtën e BE-së duhet të tregohet qartë. Kjo do të bëhet duke iu referuar instrumentit ligjor të *acquis*-së së BE-së përmes një shënimi në fund të faqes së parë, e lidhur me titullin e projektaktit, duke treguar datën e miratimit dhe titullin e plotë të instrumentit ligjor të *acquis*-së së BE-së, të cilin projekti kërkon ta përafrojë, përfshirë CELEX-in dhe atë natyror.[245]

3.2 Dispozita miratuese

828 Dispozita miratuese e një akti nënligjor ka dy funksione, duke vënë në dukje:

- organin që e ka nxjerrë dhe është përgjegjës për aktin nënligjor; dhe
- bazën ligjore për aktin nënligjor.

245 Ky detyrim buron nga pika 21/1 e RKM-së.

829 Dispozita miratuese nuk është pjesë e tekstit të aktit nënligjor; ajo nuk mund të ndryshohet në një datë të mëvonshme.

830 Dispozita miratuese përmbush kërkesën për citim sipas nenit 118 (1) të Kushtetutës, i cili përcakton që të citohet baza ligjore për aktin nënligjor. Për këtë qëllim shprehja "Në zbatim të ..." përdoret për të treguar të gjitha dispozitat konkrete mbi të cilat bazohet akti nënligjor.

831 Baza ligjore për një akt nënligjor duhet të deklarohet **sa më saktë** që të jetë e mundur. Një referencë e përgjithshme për një akt nënligjor parësor të veçantë nuk përmbush kërkesën sipas nenit 118 (1) të Kushtetutës. Nëse dispozita miratuese është e ndarë, duhet t'u bëhet referencë të gjitha nënndarjeve të cilat mund të përdoren për të përcaktuar bazën ligjore (p.sh. neni, pika, shkronja).

Shembull
Në zbatim të nenit 100 pika 5, të Kushtetutës dhe të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", ...

832 Dispozita miratuese duhet të specifikojë të gjitha autorizimet përkatëse në datën në të cilën është miratuar akti nënligjor. Këto jo vetëm që duhet të jenë shpallur, por ato duhet të jenë në fuqi tashmë.

833 Nëse akti parësor si bazë ligjore nuk është ndryshuar që nga hera e fundit që është botuar teksti i plotë i aktit parësor, duhet referuar duke përdorur titullin cites të aktit parësor, dhe datën e miratimit:

Shembull
Në zbatim të ... nenit ... të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", ...

834 Nëse akti parësor si bazë ligjore është ndryshuar, atëherë kjo duhet të bëhet e qartë në citimin e aktit si bazë ligjore të aktit nënligjor parësor.

Shembull
Në zbatim të nenit .... të ligjit nr. 96/2016, datë 6.10.2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

835 Në të kundërt, një ndryshim diskret i aktit parësor që nuk e prek dispozitën e bazës ligjore duhet të referohet në dispozitën e bazës ligjore vetëm nëse

ndikon drejtpërdrejt në autorizim (p.sh. nëse ndryshohet një dispozitë të cilës i referohet dispozitën e bazës ligjore). Në raste të tilla përdoret shprehja e mëposhtme:

> ... në zbatim të nenit ... të ligjit nr. 48/2019, datë 18.07.2019, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" ...

3.3 Organi që nxjerr aktin nënligjor

836 Dispozita miratuese e një akti nënligjor tregon se cili organ e miratoi aktin nënligjor siç është përcaktuar në autorizimin për të nxjerrë aktin nënligjor. Kur disa ministri janë të autorizuara të nxjerrin një akt të përbashkët nënligjor, ato renditen sipas radhës në të cilën janë përcaktuar në autorizim.

837 Kur disa ministri nxjerrin një akt nënligjor në bazë të autorizimeve të ndryshme, dispozita miratuese mund të formulohet si më poshtë, për shembull:

> Në zbatim të nenit ... të ligjit ... dhe të nenit ... të ligjit ... , Ministri i / për ... dhe Ministri i / për ... miratojnë:

838 Organi miratues vërteton dhe është përgjegjës për dispozitën e bazës ligjore. Kjo duhet të bëhet e qartë në formulën përmbyllëse përmes nënshkrimit.

3.4 Kërkesa të posaçme

839 Kur jep autorizimin për nxjerrjen e akteve nënligjore, ligji si bazë ligjore mund t'u caktojë detyra të qarta organeve kompetente për të përfshirë dhe dëgjuar organe ose persona të caktuar para miratimit të aktit nënligjor. Në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës, mosrespektimi i plotë i kërkesave për përfshirjen dhe dëgjimin e organeve të caktuara mund të çojë në kundërshtimin e aktit në gjykatën administrative[246].

840 Nëse dispozita miratuese imponon detyra të qarta për të përfshirë dhe dëgjuar organe ose persona të caktuar në organin që nxjerr aktin nënligjor, shprehjet "në konsultim me ..." ose "pas mendimit të ..." tregojnë se detyrimet përkatëse janë respektuar siç duhet .

246 Neni 7(a) i KPA.

Shembull
Neni 42(13)(n) i Ligjit për noterinë
Ministri i Drejtësisë, me propozim të Dhomës, miraton rregulla më të hollësishme për skemën e kompensimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor.

Shembull
Dispozita miratuese në urdhrin për miratimin e Rregullores për skemën e kompensimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor të Noterëve
Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, dhe të nenit 42, pika 13 të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Dhomës Kombëtare të Noterisë, urdhëron: ...

841 Nëse **të drejtat e pjesëmarrjes** nuk janë përshkruar në vetë dispozitën e bazës ligjore, por në një dispozitë tjetër, duhet gjithashtu të bëhet referencë në dispozitën e bazës ligjore për këtë dispozitë duke përdorur fjalët "lexuar së bashku me", përveç nëse vetë dispozita miratuese i referohet shprehimisht dispozitës në fjalë.

842 Dispozita miratuese duhet të jetë **e qartë dhe e prerë**.

3.5 Struktura e akteve nënligjore

3.5.1 Praktika e deritanishme

843 Një numër karakteristikash të përbashkëta dhe të dallueshme janë bërë të dukshme nga një ushtrim i tillë që mund të formojë bazën e punës në të ardhmen për unifikimin e praktikës midis departamenteve të ndryshme qeveritare në përpunimin e akteve nënligjore, të cilat janë shtjelluar si më poshtë për secilin lloj të akteve nënligjore.

844 *Vendimi i Këshillit të Ministrave:* Për sa i përket formës, vendimet e Këshillit të Ministrave ("VKM") duket se janë më të unifikuarat, ku zakonisht organizohen në:

- paragrafë (të numërtuar përmes numrave rendorë); dhe
- nënparagrafë (të numërtuar me shkronja).

Sidoqoftë, në praktikë, vendimet më të gjata priren të strukturohen në

Krerë, të cilët grupojnë një numër paragrafësh me të njëjtën çështje ose çështje të ndërlidhura. Vlen të përmendet gjithashtu që zakonisht numërtimi i paragrafëve fillon me 1 sa herë që fillon një Kre i ri në vendim.

845 Për krahasim, vendimet në fushën e drejtësisë nuk priren të përdorin Krerët dhe nuk grupojnë paragrafë, por përkundrazi kanë çështje të ndryshme (të tilla si kriteret, administrimi dhe procedurat) që rrjedhin nga njëra te tjetra.

846 Është e kuptueshme që vendimet në fushën e financave përdorin gjerësisht të dhënat dhe tabelat për vendime të ndryshme; në fushën e financave nuk i përdorin gjerësisht nënparagrafët si ato në fushën e drejtësisë dhe arsimit dhe kanë tendencë t'i ndajnë ato përmes pikave në vend të numërimit përmes shkronjave. Në të kundërt, vendimet në fushën e arsimit jo vetëm që përdorin gjerësisht nënparagrafët, por gjithashtu kanë tendencë t'i ndajnë ato më tej në nënparagrafë të cilët numërtohen përmes numrave romakë.

847 Gjithashtu, vendimet në fushën e financave kanë tendencë të përdorin shtojca, të cilat formojnë pjesë të tekstit të vendimit dhe përmbajnë tabela që detajojnë të dhënat financiare. Nga ana tjetër, vendimet në fushën e drejtësisë dhe arsimit nuk duket se përdorin shtojca aq shpesh sa janë zbatuar në çështjet e financave.

848 *Udhëzim i ministrit:*[247] Për sa i përket formës, duket se ka qasje të ndryshme në përpunimin e udhëzimeve të ministrit përgjegjës, në varësi të fushës së veprimtarisë. Për shembull, në çështjet e drejtësisë, udhëzimet e Ministrave të Drejtësisë si dhe udhëzimet e përbashkëta me ministrat e tjerë të linjës priren të ndjekin një stil të ngjashëm me atë të VKM-ve, duke i organizuar ato në:

- paragrafë (*të numërtuar me numra rendorë*); dhe
- nënparagrafët (*të numërtuar me shkronja*),

pa përdorur Krerë për të grupuar paragrafë të ndërlidhur, por përkundrazi kanë çështje të ndryshme (të tilla si kriteret, administrimi dhe procedurat) që rrjedhin nga njëri në tjetrin.

849 Përkundrazi, udhëzimet në fushën e financave, ndonëse ndonjëherë ndjekin stilin e VKM-ve, shpesh kanë stilin e tyre të veçantë të formatimit.

247 Neni 7(a) i LGJA-së.

Si të tilla, këto udhëzime shpesh organizohen në:

- Krerë (*të numërtuar me numra rendorë si 1*) të cilët më pas ndahen në
- Nënkrerë (*të numërtuar me numra dhjetorë si 1.1*) që grupohen së bashku të ndërlidhur
- paragrafë (*të numërtuar me numra dhjetorë si 1.1.1*), të cilat më pas mund të ndahen në
- nënparagrafë,

të cilët herë ndahen me pika dhe ndonjëherë numërtohen me shkronja. Në shkallën e dytë nënparagrafi mund të ndahet në nën-nënparagrafë të cilët numërtohen përmes numrave romakë.

850 Duhet gjithashtu të theksohet se udhëzimet në fushën e financave priren të jenë shumë më të gjata dhe shumë më të hollësishme sesa udhëzimet në çdo fushë tjetër, përfshirë edhe fushën e drejtësisë dhe arsimit dhe se sa i përket VKM-ve në këtë fushë; ata përdorin gjerësisht të dhënat dhe tabelat si dhe shtojcat që formojnë pjesë të tekstit të udhëzimit.

851 Nga ana tjetër, udhëzimet në fushën e arsimit shpesh përdorin një stil formatimi shumë të ngjashëm me atë të ligjeve, duke u strukturuar në nene që grupohen brenda Krerëve. Secili nen është i numërtuar dhe ka një titull dhe përmban një numër paragrafësh në lidhje me titullin e nenit. Paragrafët numërtohen përmes numrave rendorë dhe ndahen në nënparagrafë të cilët numërtohen përmes shkronjave. Këto udhëzime përdorin gjerësisht nënparagrafët për të detajuar informacionin përkatës, si dhe shpesh përdorin shtojcat që formojnë pjesë të tekstit të udhëzimit.

852 *Urdhër i Kryeministrit:*[248] Për sa i përket formës, urdhrat e Kryeministrit priren të kenë një strukturë të thjeshtë dhe të ndahen në:

- paragrafë (të numërtuar përmes numrave rendorë) të cilat mund të ndahen më tej në
- nënparagrafë (të numërtuar me shkronja).

Kjo strukturë e thjeshtë u shërben mirë këtyre urdhrave pasi ato tentojnë të miratohen për çështje konkrete, përgjithësisht për rregullimin e strukturës dhe organizimit të strukturave apo agjencive qeveritare.

248 Shih Pjesën A nënseksioni 1.3 si dhe Shtojcën A të këtij Manuali për debatin e hapur në lidhje me tipologjinë e akteve nënligjore në administrative në referencë me praktikën e deritanishme kundrejt terminologjisë së Kushtetutës.

853 *Urdhër i ministrit*:[249] Urdhrat e ministrit kanë tendencë të jenë koncize dhe konkrete, gjë që reflektohet edhe në formën e tyre. Kështu, ato priren të strukturohen thjesht në:

- paragrafë (të numërtuar me numra rendorë), të cilat ndahen më tej në
- nënparagrafë (të numërtuar me shkronja në rastin e urdhrave në fushën e drejtësisë dhe arsimit ose përmes pikave në fushën e financave).

3.5.2 Perspektiva krahasuese dhe rekomandime

854 Në Gjermani ekzistojnë dy lloje të akteve nënligjore: instrumentet ligjore parësore (zakonisht të quajtura 'Rregullore' (*Verordnung*)) dhe instrumentet ligjore ndryshuese. Në parim, ato janë të strukturuara dhe formuara në të njëjtën mënyrë si aktet parësore dhe aktet ndryshuese dhe rregullat kryesore të teknikës legjislative të përcaktuara në lidhje me projektligjet zbatohen në përputhje me rrethanat për projektaktet nënligjore[250].

855 Në Austri, aktet nënligjore quhen 'Rregullore' dhe sipas formatit ose strukturës ato ndjekin të njëjtën qasje si ligjet, d.m.th. pas fjalisë hyrëse, e cila i referohet bazës ligjore të Rregullores përkatëse, Rregullorja ndahet në nene (që kanë secili një titull) dhe nenet ndahen në paragrafë. Rregulloret më të gjata gjithashtu ndahen në Krerë. Detaje shumë teknike zakonisht përmbahen në shtojca, të cilat shpesh përmbajnë tabela dhe lista.

856 Në Poloni ndiqet i njëjti model si në Austri, ku formati i akteve nënligjore (i quajtur ndryshe 'Rregulloret') është i njëjtë me atë të një ligji dhe ndryshimi i vetëm është se Nenet e Rregullores nuk kanë tituj. Sidoqoftë, sipas Kushtetutës, Rregullorja është akti më i ulët juridik në hierarkinë e listës së mbyllur (*numerus clausus*) të burimeve të ligjit, të cilat përgjithësisht janë të detyrueshme dhe duhet të bazohen gjithmonë në ligj (sipas parimit të "delegimit ligjor" që organi shtetëror të nxjerrë rregulloren) dhe nuk mund të jetë në kundërshtim me ligjin ose me Kushtetutën ose të shkojë përtej delegimit.

857 Në Hollandë ekzistojnë dy lloj aktesh nënligjore siç parashikohet në Kushtetutë:

249 Shih Pjesën A nënseksioni 1.3 si dhe Shtojcën A të këtij Manuali për debatin e hapur në lidhje me tipologjinë e akteve nënligjore në administrative në referencë me praktikën e deritanishme kundrejt terminologjisë së Kushtetutës.

250 Shih seksionin 62(2) të Rregullave të Përbashkëta të Procedurës së Ministrive Federale.

- Rregullore e Përgjithshme Administrative (*Algemene Maatregel van Bestuur*);
- Rregullore Ministrie (*Ministeriële Regeling*).

858 Të dy llojet e akteve nënligjore kanë të njëjtën strukturë si ligjet. Kjo rrjedh nga Rekomandimet për Rregullat Legjislative (*Aanëijzingen voor de Regelgeving).* Këto Rekomandime janë nxjerrë me një *'qarkore'* të Kryeministrit më 18 nëntor 1992 dhe përditësohen rregullisht, ku botimi i fundit është miratuar në vitin 2018). Kjo qarkore shërben si manual për nëpunësit civilë që punojnë në një departament kodifikimi.

859 Qëllimi i Rregullave Legjislative është të përmirësojë cilësinë e legjislacionit (si ligjet ashtu edhe aktet nënligjore) më shumë në veçanti përmes harmonizimit/ unifikimit të rregullave për hartimin e legjislacionit. Në Rregullat Legjislative janë vendosur rregulla për strukturën (titulli, preambula, teksti kryesor, dispozita përfundimtare, nënshkrimi, shtojcat), kur të përdoren Krerët/ titujt/ paragrafët, shkurtimet, përdorimi i gjuhës shqipe, përdorimi ose mos përdorimi i termave latine, përdorimi i shkronjave korsive, ndër të tjera. Rregullat Legjislative përcaktojnë që devijimi nga rregullat siç parashikohet në *qarkore* është i mundur vetëm kur zbatimi i përshtatur i rregullave rezulton në legjislacion të pakuptueshëm.

860 Rekomandohet që teknika legjislative e përdorur për hartimin dhe strukturimin e akteve nënligjore të **jetë e njëjtë me atë të ligjeve**, sipas dhe praktikës së vendeve të tjera evropiane. Pra, projektakti nënligjor kompleks ose që përmban një sërë parashikimesh rregullatore në varësi të objektit të rregullimit, në funksion të qartësisë të tij, është i nevojshëm strukturimi i përmbajtjes së projektaktit me krerë, nene, paragrafë, nënparagrafë, duke ndjekur strukturën për hartimin e ligjeve.

861 Për qëllim orientimi janë paraqitur shembuj të akteve nënligjore standarde në Shtojcën D, të cilët janë përshtatur në përputhje me rregullat e strukturimit të përcaktuara në këtë Manual.[251]

3.6 Nëndelegimi i akteve nënligjore

862 Neni 118(3) i Kushtetutës e bën të qartë se nën-delegimi nuk lejohet duke parashikuar që organi i autorizuar nga ligji të nxjerrë akte nënligjore siç specifikohet në ligjin autorizues nuk mund të delegojë pushtetin e tij në një organ tjetër (*nën-delegimi vertikal*).

251 Shih për informacion më të detajuar rregullat në Pjesën D, seksioni 6, të këtij Manuali.

863 Po ashtu, neni 118(2) parashikon që një ligj duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

864 Kur lexohet së bashku me nenin 118(1) të Kushtetutës bëhet e qartë se organi kompetent duhet të merret me të gjitha parimet dhe çështjet që do të rregullohen në bazë dhe për zbatimin e Ligjit dhe si të tilla këto çështje nuk mund të rregullohen në akte të tjera të dallueshme nënligjore (*nën-delegimi horizontal*).

865 Nën-delegimi i akteve nënligjore është e ndaluar si i tillë në rendin juridik shqiptar.

3.7 Hyrja në fuqi

866 Vlefshmëria e një akti nënligjor **varet nga akti autorizues**. Një akt nënligjor mund të bëhet efektiv vetëm nëse ekziston një dispozitë si bazë ligjore që mundëson mbulimin e përmbajtjes së saj në datën e miratimit të tij. Kjo është arsyeja pse ai mund të konsiderohet me fuqi juridike vetëm pasi të ketë hyrë në fuqi dispozita autorizuese në akt. Më tej, akti nënligjor mund të mos hyjë në fuqi para aktit të cilit i shërben.

867 Dispozitat si bazë ligjore mund të parashikojnë që aktet nënligjore të zbatohen vetëm për një periudhë kohore të caktuar. Në raste të tilla, dispozita e bazës ligjore specifikon tashmë një datë konkrete për përfundimin e efekteve të aktit nënligjor. Për arsye të qartësisë juridike, data konkrete për përfundimin e efekteve të aktit nënligjor duhet gjithashtu të tregohet në vetë aktin nënligjor, veçanërisht pasi periudha ligjore maksimale nuk ka nevojë të shterohet plotësisht.

868 Dispozita për periudhën e vlefshmërisë në aktin nënligjor mund të formulohet si më poshtë:

> **Shembull**
> *Kohëzgjatja e fuqisë së aktit nënligjor*
> Ky akt nënligjor ka efekt të përkohshëm dhe zbatohet deri në datën xx.xx.20xx.

869 Ligjvënësi gjithashtu mund të bëjë që periudha e vlefshmërisë së një akti nënligjor të varet nga kushte të caktuara. Dispozita për periudhën e vlefshmërisë së aktit nënligjor në këtë rast mund të formulohet si më poshtë:

Shembull
Kohëzgjatja e fuqisë së aktit nënligjor
Ky akt nënligjor ka efekt të përkohshëm dhe është në fuqi deri në fund të periudhës së pandemisë COVID-19.[252]

870 Leja për botim mund të përfshihet në një akt nënligjor parësor kur ligji autorizues parashikon që akti nënligjor duhet të botohet në FZ dhe në ndonjë kanal tjetër të botimit ose kur akti nënligjor parashikon mënyrën e botimit të tij.

Gjithsesi, duhet të kihet parasysh që aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në FZ.[253]

Organi përgjegjës për nxjerrjen e aktit nënligjor do të jetë gjithashtu përgjegjës për njoftimin e tij në publik.

Shembull i lejes së parashikuar në ligj
Neni 49(1) i Ligjit për Mediat Audiovizuale në Republikën e Shqipërisë
Kodi dhe Rregulloret e miratuara për transmetim publikohen në faqen zyrtare të AMA-s.

Shembull i lejes së parashikuar në aktin nënligjor
Udhëzim për miratimin e kritereve, përzgjedhjen dhe procedurat e kompensimit të ekspertëve të jashtëm të pavarur të përfshirë në inspektimin e përmbaruesve gjyqësorë privatë

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

3.8 Formula përmbyllëse

871 Aktet nënligjore kanë një formulë të ndryshme nga ligjet, në atë që formula mbyllëse përbëhet vetëm nga nënshkrimi ose nënshkrimet e titullarëve të organit ose organeve përgjegjëse për nxjerrjen e aktit nënligjor.

Shembull
Ministri
[nënshkrimi i Ministrit]

252 Një parashikim i tillë duhet të jetë në përputhje me vendimin nr. 11 datë 09.03.2021 të GJK-së.
253 Neni 117(1) i Kushtetutës.

4 Ndryshimi i akteve nënligjore

872 Rekomandimet në lidhje me aktet ndryshuese (të paraqitura në Pjesën E) zbatohen në përputhje me rrethanat për ndryshimin e akteve nënligjore. Sidoqoftë, vëmendje duhet t'u kushtohet veçorive të strukturimit dhe formatimit të akteve nënligjore (siç është shtjelluar në nënseksionin 3.5 më lart).

873 Ndryshimi i akteve nënligjore zakonisht merr formën e një akti nënligjor individual ndryshues, i cili përmban kryesisht ndryshime në një akt nënligjor parësor.

874 Ashtu si një ligj, një akt nënligjor parësor mund të rishikohet në mënyrë konstitutive me anë të një akti zëvendësimi të ri.

4.1 Titulli

875 Titulli i një akti nënligjor ndryshues ose i një akti nënligjor zëvendësues duhet të shkruhet në atë mënyrë që bën referencë të qartë në aktin nënligjor që ndryshohet ose zëvendësohet dhe si i tillë duhet të përdoret titulli i plotë i aktit nënligjor parësor.

> **Shembull**
> Udhëzimi "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 07.07.2000, 'Për sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të nëpunësve civilë"

876 Një akt nënligjor ndryshues konkret nuk kërkon një titull të shkurtër ose një shkurtim. Citueshmëria e këtyre akteve nënligjore nuk ka rëndësi, pasi ato konsiderohen të ekzekutuara sapo të hyjnë në fuqi dhe për këtë arsye nuk citohen përgjithësisht diku tjetër.

4.2 Dispozita miratuese

877 Dispozitat e bazës ligjore në aktet nënligjore ndryshuese janë formuluar **në të njëjtën mënyrë si** dispozitat në aktet nënligjore parësore (shih seksionin 3.2). Sidoqoftë, dispozita miratuese në aktin parësor nënligjor nuk mund të transferohet tërësisht në aktin nënligjor ndryshues pa u kontrolluar më parë me kujdes.

878 Kujdes i veçantë duhet të tregohet për të siguruar që kërkesa për citim sipas nenit 118 (1) të Kushtetutës të jetë përmbushur.

879 Dispozita miratuese në një akt nënligjor ndryshues duhet të tregojë saktësisht se cilat dispozita të bazës ligjore janë relevante në lidhje me ndryshimin specifik.

880 Të gjitha dispozitat e bazës ligjore që janë të rëndësishme për nxjerrjen e aktit nënligjor në tërësi duhet të citohen në një akt nënligjor zëvendësues. Megjithëse përmban elemente të aktit nënligjor të zëvendësuar, përmbajtja e të cilit nuk është ndryshuar, akti legjislativ përfshin të gjithë tekstin. Kështu që një akt nënligjor zëvendësues është i barabartë me ribotimin.

881 Nëse akti nënligjor parësor bazohet në disa dispozita si bazë ligjore, mund të ndodhë që vetëm njëra prej tyre të jetë e rëndësishme për një akt nënligjor ndryshues konkret. Për sa i përket ndryshimeve pasuese në aktet e tjera nënligjore, dispozitat si bazë ligjore të cilat formojnë bazën për ndryshimet specifike, duhet të specifikohen saktësisht.

882 Autorizimi mund të jetë ndryshuar qysh nga nxjerrja e aktit nënligjor parësor. Nëse një akt nënligjor ndryshues do të nxirret pas kësaj, jo vetëm që duhet t'i kushtohet vëmendja për të siguruar që dispozita si bazë ligjore është përcaktuar saktë në dispozitën e bazës ligjore, por duhet të bëhet edhe një kontroll i kujdesshëm nëse dispozita e ndryshuar si bazë ligjore mbulon ndryshimet e propozuara.

883 Nëse dispozita si bazë ligjore ka pësuar thjesht një ndryshim formal, për shembull nëse është zhvendosur diku tjetër në një ligj, por përmbajtja e saj nuk ka ndryshuar, dispozita si bazë ligjore në aktin nënligjor ndryshues i referohet emërtimit të ri të dispozitës, duke iu referuar aktit ndryshues.

884 Përmbajtja e dispozitës si bazë ligjore mund të jetë zgjeruar. Kur është ndryshuar gjithashtu edhe struktura e dispozitës, për shembull me anë të nënndarjes, dispozita si bazë ligjore në aktin nënligjor ndryshues duhet vetëm të citojë dispozitën duke treguar atë nën-njësi nga e cila faktikisht varet.

885 Nëse përmbajtja e dispozitës si bazë ligjore është ngushtuar, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e rregullimeve në aktin nënligjor të cilat janë nxjerrë më parë mbi atë bazë. Sidoqoftë, akti parësor nënligjor mund, pra, të ndryshohet vetëm në bazë të një autorizimi të ri. Organi i autorizuar për të nxjerrë aktin nënligjor është ende i autorizuar të shfuqizojë rregullimet "e tepërta" pa i zëvendësuar ato.

886 Nëse dispozita si bazë ligjore shfuqizohet, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e aktit nënligjor të nxjerrë në bazë të tij, përveç nëse akti nënligjor nuk mund të qëndrojë më vetëm. Ky akt nënligjor mund të ndryshohet vetëm në atë masë sa një organ i autorizuar për të nxjerrë një akt nënligjor lejohet të rregullojë fushën që mbulon në bazë të një dispozite tjetër ose të re si bazë ligjore. Përndryshe, opsioni i vetëm në dispozicion do të ishte shfuqizimi i aktit nënligjor pa e zëvendësuar atë. Prandaj, duhet të kontrollohet kur shfuqizohet dispozita si bazë ligjore deri në çfarë mase mund të shfuqizohen dispozitat në aktet nënligjore të krijuara në bazë të saj.

887 Një akt nënligjor ekzistues mund të ndryshohet në bazë të një dispozite krejtësisht të re si bazë ligjore e cila ende nuk ekzistonte kur doli akti nënligjor parësor, nëse ka të bëjë me çështjen e rregulluar më parë nga akti nënligjor.

4.3 Struktura

888 Rekomandimet në lidhje me strukturën e akteve ligjore ndryshuese. Në lidhje me aktet nënligjore individuale dhe aktet nënligjore gjithëpërfshirës, referencë të veçantë u bëhet rekomandimeve për aktet ndryshuese (të trajtuara në Pjesën E) në lidhje me:

- strukturën;
- fjalinë hyrëse;
- përdorimin e formulës ndryshuese;
- ndryshimin e një dispozite të vetme;
- lloje të tjera të ndryshimeve;
- rregullat kalimtare;
- ndryshimet me pasojë mbi akte të tjera.

889 **Leja për botim** mund të përfshihet në një akt nënligjor parësor kur ligji autorizues parashikon që akti nënligjor duhet të botohet në Fletoren Zyrtare dhe ndonjë kanal tjetër të botimit ose kur akti nënligjor parashikon mënyrën e botimit të tij. Organi përgjegjës për nxjerrjen e aktit nënligjor do të jetë gjithashtu përgjegjës për njoftimin e tij në publik (shih seksionin 3.7).

890 Dispozitat për hyrjen në fuqi dhe pushimin e fuqisë në ndryshimin e akteve nënligjore janë formuluar në parim në të njëjtën mënyrë si ato në aktet ndryshuese (shih Pjesën E seksioni 8).

4.4 Hyrja në fuqi

891 Formula e hyrjes në fuqi në një akt nënligjor ndryshues shkruhet në të njëjtën mënyrë si formula e hyrjes në fuqi në një akt parësor (shih pjesën 3.7). Sidoqoftë, nuk mund të merret pa ndryshime nga akti parësor nënligjor pa u kontrolluar më parë me kujdes.

4.5 Formula përmbyllëse

892 Aktet nënligjore ndryshuese kanë të njëjtën formulë përmbyllëse si aktet nënligjore parësore (seksioni 3.8), në atë që formula përmbyllëse përbëhet vetëm nga nënshkrimi ose nënshkrimet e titullarëve të organit ose organeve përgjegjëse për nxjerrjen e aktit nënligjor.

Pjesa H
Asistenca hartuese gjatë procesit legjislativ parlamentar

1 Procedura Legjislative

1.1 Paraqitja e projektligjeve në Kuvend

893 Kushtetuta[254] parashikon që e drejta për të propozuar ligje i takon Këshillit të Ministrave, çdo deputeti dhe 20 000 zgjedhësve, parashikim që reflektohet edhe në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (RK).[255]

894 Projektligjet duhet të hartohen në formën e akteve normative dhe të shoqërohen nga një relacion që përmban objektivat që miratimi i tij synon të përmbushë, argumentet që këto objektiva nuk mund të përmbushen me instrumentet ligjore ekzistuese, përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe harmonizimin me legjislacioni në fuqi dhe legjislacionin e BE-së, efektet e tij gjinore, mjedisore, sociale dhe ekonomike.

895 Për projektligjet me karakter financiar, relacioni duhet të përmbajë efektet financiare dhe pasojat e zbatimit të tij. Ndërsa, për projektligjet që konsultohen me publikun, relacioni përmban të dhëna mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik; personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektligjit; shpjegime në lidhje me identifikimin e palëve të interesuara; pjesëmarrësit në konsultimin publik dhe kohëzgjatjen e procesit të konsultimit; çështjet e diskutuara dhe mendimet e shprehura nga palët e interesuara; reflektimin ose jo në projektligj të mendimeve të grupeve të interesit.[256]

896 Asnjë projektligj joqeveritar që rrit shpenzimet e buxhetit të shtetit ose zvogëlon të ardhurat e tij nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e

254 Neni 81(1) i Kushtetutës.
255 Miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 166, më 16.12.2004.
256 Neni 68(2/1) i RK-së.

Këshillit të Ministrave që duhet ta shprehë atë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së projektligjit. Nëse Këshilli i Ministrave nuk jep një përgjigje brenda këtij afati, projektligji kalon për shqyrtim sipas procedurës normale.

897 Kryetari i Kuvendit mund t'ia kthejë projektligjin e depozituar iniciuesit, në një mënyrë të motivuar, nëse kërkesat e parashikuara në dispozitat përkatëse të RK-së nuk plotësohen.[257]

898 Projektligjet regjistrohen së pari, në një regjistër të veçantë sipas paraqitjes së tyre dhe i bëhen të njohura Kryetarit të Kuvendit. Kryetari urdhëron shpërndarjen e tyre të menjëhershme te deputetët dhe kopjet e projektligjeve u vihen në dispozicion përfaqësuesve të medias ose personave të tjerë të interesuar, me kërkesë të tyre. Projektligjet nuk mund të përfshihen në rendin e ditës të punimeve të Kuvendit, të paktën dy javë nga paraqitja e tyre.[258]

1.2 Shqyrtimi nga Komisionet e Kuvendit

899 Në pajtim me programin dhe rendin e punës së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit ia referon projektligjet komisionit përgjegjës dhe komisioneve që sipas RK-së duhet të japin mendimin e tyre.

900 Komisionet shqyrtojnë projektligjin dhe për këtë qëllim mund të organizojnë dëgjesa publike me anëtarët e Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të shtetit ose institucioneve publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit ose grupe të tjerë të interesuar. Komisioni është i detyruar të mbajë seanca dëgjimore të tilla, nëse një e treta e anëtarëve të komisionit e kërkon këtë në mënyrë të motivuar me shkrim.[259]

901 Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë ndryshimet me shkrim dhe të arsyetuar gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës.[260] Ndryshimi i propozuar nga Këshilli i Ministrave duhet të shoqërohet nga vlerësimi i përputhshmërisë së tij me legjislacionin e BE-së.[261]

902 Pas shqyrtimit të projektligjit, komisioni përgjegjës përgatit një raport

257 Neni 68(4) i RK-së.
258 Neni 69 i RK-së.
259 Neni 36(1) i RK-së.
260 Neni 71(1) i RK-së.
261 Neni 71(2) i RK-së.

duke propozuar miratimin e tij në formën që paraqitet, miratimin me ndryshime ose refuzimin e tij.[262] Në këtë raport, komiteti përgjegjës paraqet ndryshimet e propozuara nga deputeti ose Këshilli i Ministrave dhe jep shpjegime të arsyetuara për miratimin ose refuzimin e tij.[263]

1.3 Shqyrtimi në Seancën Plenare të Kuvendit

903 Raporti i komisionit përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit dhe i komisioneve të tjera që kanë dhënë mendimin e tyre mbi projektligjin vihet në dispozicion në disa kopje dhe i shpërndahet deputetëve dhe Këshillit të Ministrave të paktën 4 ditë para datës së shqyrtimit të projektligjit në një seancë plenare.[264]

904 Iniciuesi i projektligjit mund ta tërheqë projektin e tij deri në momentin kur nuk është votuar në parim në seancën plenare. Shqyrtimi i projektligjit në seancë plenare përfshin diskutimin në parim të projektligjit dhe diskutimin e neneve të tij.

905 Para diskutimit në parim, deputetët ftohen nga drejtuesi i seancës për t'u bërë pyetje iniciuesve ose Këshillit të Ministrave në lidhje me projektligjin. Projektligji shqyrtohet në seancën plenare në prani të ministrit nënshkrues dhe zyrtarëve të autorizuar me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

906 Diskutimi në parim i projektligjit bëhet kur komisioni përgjegjës ose Këshilli për Legjislacionin janë për votimin në parim dhe kur ato janë kundër miratimit të tij. Në rastin kur komisioni përgjegjës ose Këshilli janë kundër miratimit në parim dhe seanca plenare vendos miratimin e tij, projektligji i kthehet komisionit përgjegjës për vazhdimin e shqyrtimit të tij nen për nen.[265]

907 Projektligji i pa miratuar në parim në seancën plenare nuk mund të paraqitet përsëri para se të kalojnë 6 muaj nga data e refuzimit të tij.

1.4 Shqyrtimi në parim

908 Diskutimi në parim i projektligjit fillon me prezantimin nga iniciuesi të arsyeve që çuan në propozimin e këtij projektligji dhe prezantimin e

262 Neni 70(3) i RK-së.
263 Neni 71(3) i RK-së.
264 Neni 70(2) i RK-së.
265 Neni 73(3) i RK-së.

raportit të komisionit përgjegjës dhe sipas rastit, të raportit të Këshillit për Legjislacionin. Kryetari i komisionit lexon raportin dhe relatorit mund t'i jepet fjala jo më shumë se 10 minuta, me kërkesën e tij.

909 Për diskutimin në parim, kryesuesi i seancës u jep fjalën deputetëve të cilët kanë kërkuar të diskutojnë, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup parlamentar. Para përfundimit të diskutimeve, fjala i jepet relatorit të komisionit përkatës për jo më shumë se 5 minuta dhe kryetarëve të grupeve parlamentare, duke filluar nga grupi me numrin më të vogël të deputetëve.

910 Asnjë ndryshim nuk mund të përcillet gjatë kohës së diskutimit në parim.[266]

911 Drejtuesi i seancës, pas përgjigjes së pyetjeve të deputetëve dhe diskutimeve në parim, bën të njohur kohën kur Kuvendi do të vendosë me votim. Punimet e Kuvendit vazhdojnë me përgjigjet e pyetjeve dhe diskutimin në parim mbi projektligjet e tjera të rendit të ditës.

1.5 Shqyrtimi nen për nen dhe miratimi

912 Pas miratimit në parim, vazhdohet me shqyrtimin e projektligjit nen për nen.

913 Gjatë diskutimit nen për nen çdo deputet ka të drejtë të diskutojë jo më shumë se 5 minuta. Kjo kohë dyfishohet në rastet e diskutimit të projektligjeve që kanë nevojë për një shumicë të cilësuar për miratimin e tyre.

914 Gjatë diskutimit nen për nen, mund të paraqiten ndryshime me shkrim. Çdo ndryshim duhet t'i referohet përmbajtjes së një neni të vetëm.

915 Si rregull, ndryshimet duhet të paraqiten dhe diskutohen së pari në komisionin përgjegjës. Autori i ndryshimit ka të drejtë të paraqesë ndryshimet në seancën plenare jo më shumë se 7 minuta.[267]

916 Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancën plenare ndryshimet në lidhje me projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës me kusht që ato të regjistrohen në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe tu jenë shpërndarë deputetëve të tjerë.

266 Neni 74(3) i RK-së.
267 Neni 75(1) i RK-së.

917 Ndryshimet votohen përpara tekstit të projektligjit. Para se të vazhdojë me votimin e secilit ndryshim, kryesuesi i seancës plenare u kujton deputetëve mendimin e komisionit përgjegjës.[268]

918 Votimi për ndryshimet fillon me ata që kërkojnë heqjen e plotë ose të pjesshme të nenit ose zëvendësimin e tij ose formulimin e ndryshuar. Në rast se janë paraqitur dy ose më shumë ndryshime për të njëjtin nen ose një pjesë të tij, ndryshimi i parë që do të votohet do të jetë ai më pak i ngjashëm me formulimin aktual.

919 Në fund të diskutimeve nen për nen kalohet në votim të plotë të projektligjit.[269]

2 Procedura legjislative për aktet specifike

2.1 Shqyrtimi i projektligjeve në lidhje me financat dhe buxhetin

920 Kryetari i Kuvendit njofton menjëherë në Kuvend paraqitjen e projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe projektligjeve financiare që lidhen drejtpërdrejt me të.

921 Shqyrtimi i projektligjit të buxhetit dhe i ligjeve financiare që lidhen drejtpërdrejt me të, përfshihen menjëherë në programin e punës së Kuvendit, i cili miraton në këtë rast një kalendar shqyrtimi të tyre të veçantë.[270]

922 Komisioni për Ekonominë dhe Financat është komisioni përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit dhe projektligjeve financiare, të lidhura drejtpërdrejt me të. Për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të Shtetit, Kryetari i Komisionit, cakton relatorin kryesor që, si rregull, i caktohet në mënyrë të përhershme një deputeti që drejton të gjithë punën për përgatitjen e raportit të projektligjit të Buxhetit të Shtetit; për çështje të veçanta caktohen relatorë të veçantë.[271]

923 Paralelisht, komisionet e përhershme, në ndjekje të fushave që ato mbulojnë, organizojnë punën për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit dhe të projektligjeve financiare që lidhen drejtpërdrejt me të. Në mbledhjet e komisioneve marrin pjesë ministrat, relatori kryesor dhe në

268 Neni 76(2) i RK-së.
269 Neni 77(1) i RK-së.
270 Neni 78(3) i RK-së.
271 Neni 79(1) i RK-së.

raste të caktuara relatorët e veçantë që prezantojnë dhe japin shpjegimet përkatëse.[272]

924 Komisionet e Kuvendit mund të organizojnë seanca dëgjimore publike me qëllim marrjen e mendimeve dhe komenteve të institucioneve, personave ose grupeve të interesuara për projektligjin e Buxhetit të Shtetit dhe projektligje të tjerë financiarë që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta me ta.

925 Në fund të shqyrtimit, komisionet hartojnë një raport vlerësimi në lidhje me projektligjin e Buxhetit të Shtetit dhe projektligjet financiare që lidhen drejtpërdrejt me të. Raporti i dërgohet menjëherë Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

926 Pas përfundimit të diskutimeve dhe votimit në parim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat i paraqet seancës plenare raportin e vlerësimit në parim të projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të. Raporti përmban një vlerësim të plotë të strukturës së projektligjit të Buxhetit të Shtetit, si treguesit makroekonomikë, treguesit kryesorë, të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara, financimet dhe realizimin e tyre, sipas programit të Këshillit të Ministrave të miratuar në Kuvend, si dhe vlerësime për projektbuxhetet e institucioneve kushtetuese dhe të pavarura.[273]

927 Kuvendi, në seancë plenare, pas paraqitjes së raportit të vlerësimit në parim të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, diskuton dhe vendos për miratimin në parim të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me buxhetin dhe më vonë të projektligjit të Buxhetit të Shtetit.[274]

928 Me miratimin në parim të projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe projektligjeve financiare Komisioni për Ekonominë dhe Financat fillon diskutimin e tyre nen për nen, duke mbajtur parasysh edhe problematikën e trajtuar Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit dhe nga komisionet e përhershme ose nga Kuvendi në seancë plenare.[275]

929 Pas prezantimit të raportit të komisionit për diskutimin nen për nen dhe miratimit në tërësi, Kuvendi, në seancën plenare fillon shqyrtimin nen

272 Neni 80(1) i RK-së.
273 Neni 81(4) i RK-së.
274 Neni 82 i RK-së.
275 Neni 83(1) i RK-së.

për nen dhe votimin në tërësi të projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe projektligjeve financiare që lidhen drejtpërdrejt me të.

930 Gjatë shqyrtimit nen për nen, relatori kryesor dhe relatori i posaçëm kanë të drejtë të marrin fjalën për jo më shumë se 10 minuta. Autorët e ndryshimeve të refuzuara në komision kanë të drejtë të paraqesin propozimet e tyre jo më shumë se 5 minuta.

931 Votimi nen për nen dhe votimi në tërësi kryhet në të njëjtën mënyrë si për të gjithë projektligjet e tjera.[276]

2.2 Shqyrtimi i nismës legjislative për rishikimin e Kushtetutës dhe zbatimin e vendimeve të GJK-së

932 Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga jo më pak se një e pesta e deputetëve.[277] Kryetari i Kuvendit njofton Kuvendin në seancën plenare pasuese dhe u shpërndan deputetëve tekstin e projektligjit. Projektligji futet menjëherë në rendin e ditës të Kuvendit.

933 Projektligji shqyrtohet në takimin e përbashkët të mbajtur midis Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Këshillit për Legjislacionin jo më herët se dy javë nga data e depozitimit. Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Kuvendit.

934 Në takimin e parë caktohen të paktën dy relatorë. Kjo mbledhje vendos për mënyrën se si projektligji do t'u bëhet i njohur zgjedhësve dhe për thirrjen e ekspertëve kushtetues. Takimet për rishikimin e Kushtetutës dhe seancat dëgjimore janë të hapura për median dhe publikun.

935 Në rast se do të ketë ndryshime të reja të propozuara në kuadrin e iniciativës së propozuar, ato duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 177(1) të Kushtetutës.

936 Në fund të shqyrtimit, takimi i përbashkët midis Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut dhe Këshillit për Legjislacionin del me një raport i cili i paraqitet Kuvendit në një seancë plenare nga relatorët. Ky raport duhet të përmbajë gjithashtu mendimin e pakicës, në rast se ekziston një i tillë.[278]

276 Neni 84(3) i RK-së.
277 Neni 177(1) i Kushtetutës.
278 Neni 77/a(6) i RK-së.

937 Seanca plenare për miratimin e ndryshimeve kushtetuese thirret jo më parë se dy javë dhe jo më vonë se tre javë nga paraqitja e raportit. Seanca e debatit është e hapur dhe transmetohet drejtpërdrejt nga televizioni publik.

938 Votimi për miratimin e ndryshimeve është i hapur.[279] Ndryshimet konsiderohen të miratuara nëse votohen pro nga të paktën 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit.[280]

939 Vendimet e GJK-së, të cilat kanë efekt mbi legjislacionin, merren në konsideratë nga Këshilli për Legjislacionin brenda 30 ditëve pas botimit në FZ.

940 Kryetari i Kuvendit i përcjell Këshillit për Legjislacionin vendimet e GJK-së në lidhje me:

- vlerësimin e kushtetutshmërisë së legjislacionit që ka nismëtar deputetin/deputetët;
- interpretimin përfundimtar të Kushtetutës;
- zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës kur Kuvendi është palë;
- shkarkimin e zyrtarëve kushtetues, të cilët zgjidhen nga Kuvendi.

941 Këshilli për Legjislacionin analizon dhe diskuton efektet e vendimeve të GJK-së mbi çështjet e parashikuara më sipër. Këshilli harton një raport dhe ia paraqet Kryetarit të Kuvendit.

942 Raporti i Këshillit, kur gjykohet i nevojshëm, mund t'i dërgohet GJK-së, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.

943 Kur është e nevojshme të merret iniciativa legjislative për shtesa ose ndryshime në legjislacion, Këshilli i paraqet rekomandimet e nevojshme komisionit përgjegjës dhe iniciuesit ose ndërmerr vetë nismën legjislative.[281] Shqyrtimi dhe miratimi në komisione dhe seancë plenare kryhet në të njëjtën mënyrë si për të gjithë projektligjet e tjera.[282]

279 Neni 77/b(3) i RK-së.
280 Neni 177(3) i Kushtetutës.
281 Neni 87 i RK-së.
282 Neni 84(3) i RK-së.

3 Asistenca hartuese gjatë procesit legjislativ parlamentar

944 Ministri përgjegjës ka një rol të rëndësishëm për shqyrtimin e projektakteve gjatë procesit parlamentar, veçanërisht për çështjet nën kompetencën e tij, duke marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve përkatëse ose seancës plenare të Kuvendit, si dhe duke dorëzuar mendimin për këto çështje.[283] Për më tepër, strukturat e specializuara të Ministrisë së Drejtësisë mund të bashkëpunojnë me Shërbimin Ligjor të Kuvendit gjatë procesit të shqyrtimit të projektakteve në komisionet e Kuvendit për çështje të teknikës legjislative, si dhe për çështje nën kompetencën e kësaj Ministrie.

283 Neni 47 i RK-së.

Pjesa I
Interpretimi i legjislacionit

1. Vërejtje të Përgjithshme

945 Rregullat tradicionale të interpretimit mund të përdoren për të zgjidhur konfliktet midis ligjeve, pavarësisht statusit të tyre të barabartë hierarkik. Për shembull, nëse nuk ka dispozita për të kundërtën, një miratim i mëvonshëm do të interpretohet si mbizotërues ndaj një të mëparshmi, dhe një miratim i shprehur në terma specifikë do të mbizotërojë mbi atë në terma të përgjithshëm.

946 Legjislacioni procedural shqiptar nuk përmban në mënyrë të hollësishme dispozita të përgjithshme që parashikojnë metodat për interpretimin e ligjit. Sidoqoftë, duhet të theksohet se Kodi i parë Civil Shqiptar, i miratuar në 1 Prill 1929, fillonte me "Dispozita mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjave përgjithësisht", i cili parashikonte:[284]

> Neni 2. - N'aplikim, ligjave nuk munt t'u epet tjetër sens veç atij që del qartazi nga kuptimi i vet fjalëve tue marrë parasysh lidhja (connexion) e tyne, si dhe nga qëllimi i ligjëvuësit.
>
> Kur një kontestim nuk munt të zgjidhet me një dispozitë të çmueme të ligjës, merren parasysh dispozitat që rregullojnë raste shëmbëllore ose çashtje analloge: kur me gjith këtë rasti mbetet i errët, zgjidhja bahet sipas parimevet të përgjithëshme të së drejtës.
>
> Neni 3. - Ligjat që përmbajnë dispozita ndëshkimore dhe ato që përkufizojnë ushtrimin e lirë të së drejtave ose që formojnë përjashtime në rregullat e përgjithëshme ose në të tjera ligja, nuk shtrihen tej rasteve dhe kohënave që tregohen në 'to.
>
> Neni 4. - Ligjat abrogohen vetëm kur ligjat e mapasme përmbajnë një deklarim të shprehun të ligjvuësit për këtë, ose kur dispozitat e reja

284 Kodi Civil i vitit 1929 ishte bazuar në Kodin Civil Italian të vitit 1865 dhe Kodin Civil Austriak të vitit 1811.

nuk pajtohen me ato të maparëshmet, ose kur ligja e re rregullon të tanë landën që ka qënë rregullue me ligjën e maparëshme.

947 Ndërkohë, Kodi i Procedurës Civile aktualisht në fuqi parashikon vetëm që:[285]

Neni 1
Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.

948 Për më tepër, Kodi Penal aktualisht në fuqi ofron një rregull të qartë për interpretimin e normave penale juridike:[286]

Neni 1/c
Zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet.

949 GJK-ja ka dhënë disa udhëzime për interpretimin e normave kushtetuese dhe ligjore, si vijon:

- "Për interpretimin e këtyre normave, Gjykata Kushtetuese nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit pozitiv, duke parashikuar një për një të gjitha rastet që mund të përfshihen në këto shkaqe kushtetuese, sepse do të ishte e pamundur një gjë e tillë ndërkohë që Kushtetuta, ligjet, apo edhe vendimet gjyqësore nuk mund të kodifikojnë me saktësi aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit a prokurorit, apo rastet se kur ligji është shkelur rëndë.
  Interpretimi që Gjykata Kushtetuese i bën dispozitave apo termave konkrete të Kushtetutës ka për qëllim që në mënyrë analitike të japë dhe të përcaktojë kriteret, konceptet bazë si dhe parimet mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë si dhe të Prokurorit të Përgjithshëm."[287]
- "Interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.".[288]
- "Sipas standardeve jurisprudenciale për legjitimimin, është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet

285 Miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996.
286 Miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01. 1995.
287 Vendimi nr. 75, datë 19.04.2002 i GJK-së.
288 Shih vendimet nr. 4, datë 23.01.2017; nr. 22, datë 11.04.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të GJK-së.

kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej.".[289]

- "Në vlerësimin e kushtetutshmërisë të ligjeve, edhe Gjykata Kushtetuese niset nga prezumimi i kushtetutshmërisë së tyre me Kushtetutën, si dhe mundësia e interpretimit pajtues të tyre. Interpretimi pajtues është i mundur kur një ligj ose dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve."[290]
- "Gjykata niset nga premisa që një akt normativ duhet të interpretohet në kuptimin që lejon zbatimin e tij, jo në atë që e përjashton këtë zbatim (*actus interpretandus est potius ut valeat quam ut pereat*).".[291]
- "Interpretimet pajtuese, si teknikë interpretative, Gjykata i ka përdorur edhe në rastet kur para saj janë kundërshtuar ligjet e fushës penale.".[292]
- "Fakti që një dispozitë ligjore mund të ketë më shumë se sa një mënyrë interpretimi, nuk e bën atë të paqartë. Përkundrazi, ligji nuk duhet të jetë shterues dhe i ngurtë, por duhet t'u lërë hapësirë interpretimi organeve administrative dhe gjyqësore, në varësi të rrethanave konkrete dhe zhvillimit të normave në kontekst të praktikës.".[293]

2 Rregullat e interpretimit

950 Rregullat e interpretimit më të përdorura gjatë shqyrtimit dhe zbatimit, në mënyrë të përmbledhur paraqiten si vijon:

- Interpretimi tekstual kur dispozita ligjore interpretohet duke marrë parasysh tekstin/ fjalët e ligjit;
- Interpretimi sistematik kur dispozita ligjore interpretohet në bazë të vendit të saj në ligj (në cilin Titull, Kre, nen, paragraf);
- Interpretimi me analogji kryhet duke marrë parasysh dispozitat që rregullojnë raste të ngjashme ose raste analoge në ligje të tjera;
- Interpretimi *a contrario* kryhet duke i dhënë dispozitës ligjore kuptimin

289 Shih vendimet nr. 13, datë 16.04.2013; nr. 71, datë 27.11.2015; nr. 55, datë 21.07.2015 të GJK-së.
290 Shih vendimet nr.5, datë 16.02.2012; nr. 33, datë 24.06.2010; nr. 29, datë 31.05.2010 të GJK-së.
291 Shih vendimin nr. 7, datë 24.02.2016 të GJK-së.
292 Shih vendimet nr. 37, datë 19.09.2011; nr. 26, datë 13.06.2011; nr.30, datë 17.06. 2010 të GJK-së.
293 Shih vendimin nr.20, datë 20.04.2021 të GJK-së.

e kundërt të asaj që duket se përfaqëson në fakt.

- Interpretimi teleologjik kur dispozita ligjore interpretohet sipas qëllimit të ligjit (qëllimi i ligjvënësit);
- Interpretimi historik ku dispozita ligjore interpretohet në bazë të historikut të krijimit të saj. Kjo metodë është e ndarë në historikun parlamentar dhe në një koncept më të gjerë të historik, si historiku i përgjithshëm, ngjarjet përkatëse historike, e drejta romake dhe e drejta zakonore dhe tradicionale shqiptare;
- Parashikimi paraprak i interpretimit kur interpretimi i gjyqtarit bazohet në interpretimin e një projektligji (ende pezull në parlament).

951 Në nënseksionet vijuese do të shtjellohen më tej rregullat kryesore të interpretimit të zbatuara nga gjykatat dhe prakticienët shqiptarë kur interpretojnë dhe zbatojnë legjislacionin. Në përgjithësi, interpretimi i legjislacionit si i tillë duhet të ndërmerret duke filluar me interpretimin tekstual të normave, dhe në rast paqartësie duhet të kalohet në interpretimin për analogji dhe interpretimin *a contrario* dhe në rast se paqartësia vazhdon norma duhet të interpretohet në përputhje me qëllimin e ligjvënësit. Secila prej këtyre teknikave të interpretimit do të shtjellohet më tej në seksionin vijues.

2.1 Interpretimi tekstual

952 Interpretimi tekstual është një teknikë formaliste në të cilën interpretimi i ligjit bazohet kryesisht në kuptimin e zakonshëm të tekstit ligjor, ku nuk u kushtohet vëmendje burimeve jo-tekstuale, të tilla si qëllimi i ligjit kur miratohet, problemi për të cilin ishte menduar për të zgjidhur, ose pyetje të rëndësishme në lidhje me drejtësinë ose rregullsinë e ligjit.

953 Interpretimi tekstual nënkupton se qëllimi i Kuvendit gjendet më së miri në kuptimin e zakonshëm dhe natyror të fjalëve të përdorura. Si pjesa demokratike legjislative e shtetit, Kuvendi duhet të konsiderohet që dëshiron të zbatojë saktësisht atë që thotë në ligjet e tij. Nëse gjyqtarëve u lejohet të japin një kuptim jo të qartë ose jo-tekstual për fjalët e ligjit të Kuvendit, atëherë vullneti i Kuvendit, dhe kështu vullneti i popullit, po kundërshtohet.

954 Në rast se një normë juridike ka një kuptim të ngushtë (kufizues), por, në të njëjtën kohë, ka edhe një kuptim të gjerë (të zgjeruar), atëherë, si kuptim i duhur i normës do të merret kuptimi i ngushtë, sepse ky kuptim është

përfshirë domosdoshmërish, ndërsa kuptimi i gjerë është vetëm i mundur.

955 Kur të jenë përdorur të gjitha metodat e interpretimit të normës dhe ligji mbetet i paqartë, ose kuptimi që rezulton ndryshon nga përmbajtja reale, pra nuk lidhet me atë, ose rezultatet që dalin janë të pakuptimta, jo logjike, atëherë kjo dispozitë duhet të konsiderohet e pavlefshme. Ky është një interpretim abrogativ, i cili është një metodë e përdorur zakonisht gjatë kontrollit të kushtetutshmërisë së një norme juridike.[294]

2.2 Interpretimi me analogji

956 Interpretimi me analogji kryhet në ato raste kur, gjatë shqyrtimit të një çështjeje konkrete, interpretuesi konstaton se ligji nuk parashikon një rregull specifik për zgjidhjen e saj. Interpretimi për analogji nuk duhet të ngatërrohet me interpretimin e zgjeruar. Këto mënyra interpretimi janë të ndryshme. Ndryshimi i tyre qëndron në faktin që kur një çështje zgjidhet përmes interpretimit të zgjeruar, zbatohet ligji që rregullon çështjen konkrete nën shqyrtim, ndërsa gjatë interpretimit me analogji zbatohet ligji që nuk parashikon çështjen konkrete, por një rast tjetër analog që është i ngjashëm me të.

957 Interpretimi me analogji nuk i shmanget ligjit, por është një mjet që siguron zbatimin e drejtë të tij. Analogjia është e ndaluar kur çështja nën shqyrtim parashikohet shprehimisht nga ligji. Sidoqoftë, në ato raste kur zgjidhja e çështjeve nën shqyrtim nuk është parashikuar shprehimisht nga ligji, interpretuesi duhet të orientohet nga mënyra sesi ligji zgjidh rastet e tjera të së njëjtës natyrë, të cilat, në thelbin e tyre, janë të njëjtë.

958 Interpretimi me analogji duhet të përdoret si përjashtim dhe jo si rregull dhe zbatimi i ligjit penal, ligjit të taksave ose ligjeve të së drejtës publike (të paktën për aq sa lejon ndërhyrjet e shtetit në sferat e individit) për analogji nuk lejohet.

2.3 Interpretimi *a contrario*

959 Interpretimi a contrario është një mjet interpretimi që përdoret për zgjidhjen e një çështjeje nën shqyrtim, duke i dhënë dispozitës ligjore kuptimin e kundërt të asaj që duket se përfaqëson në fakt. Kjo metodë e interpretimit do të thotë që interpretuesi duhet t'i japë normës juridike atë kuptim që në realitet del nga i gjithë kuptimi dhe qëllimi i ligjit dhe

294 Simoni, A. Sadushi, S. Çomo, S. "Vështrim Krahasues për Procedurën Civile". Tirana: 2006. f. 17.

parimeve themelore ligjore mbi të cilat bazohen normat. Me anë të interpretimit të normës juridike në kuptimin e kundërt, dikush është në gjendje të nxjerrë kuptimin e duhur të dispozitës konkrete, nga e cila varet zgjidhja e çështjes.

960 Një shembull konkret i zbatimit të interpretimit *a contrario* siç përdoret nga Gjykata e Lartë:[295]

> Në këtë rast ndeshja midis dy dispozitave është evidente. Ndërsa neni 444, në paragrafin e parë të tij, parashikon se, kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në mungesë të njërës palë, afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Pra, kjo dispozitë parashikon në mënyrë të shprehur detyrimin e gjykatës së shkallës së parë që t`i njoftojë vendimin palës që ka qenë në mungesë, ndërsa hesht për gjykatën e Apelit. Prej interpretimit nga e kundërta (*ad contrario*) të dispozitës së mësipërme konkludohet se afati i rekursit kundër vendimit të Apelit edhe për palën tjetër që ka qenë në mungesë fillon nga dita e dhënies së vendimit dhe jo nga dita e njoftimit të vendimit. Kjo është në harmoni me nenin 472, paragrafi i fundit të K.Pr.Civile, por bie ndesh me nenin 476/1 të këtij Kodi.
>
> Janë pikërisht mungesat, paqartësitë e kundërthëniet e dispozitave procedurale te cituara me lart, arsyet që imponojnë arritjen e interpretimit të unifikuar në bazë të analizës e përfundimeve të parashtruara.

2.4 Interpretimi teleologjik

961 Kur dispozita ligjore nuk e jep në mënyrë të qartë kuptimin e saj, atëherë, nga metodat e interpretimit që ndiqen, një metodë e tillë është marrja në konsideratë e qëllimit që ligjvënësi ka pasur në hartimin e dispozitës konkrete.

962 Interpretimi i qëllimit të ligjvënësit (*ratio legis*) i konceptuar si qëllimi i ligjvënësit për krijimin e një rregullimi specifik, d.m.th., një dispozitë ligjore, një grup dispozitash ose një akt i tërë normativ, mund të kuptohet si mjet ndihmës - si konfigurimi i caktuar i marrëdhënieve shoqërore që duhet të arrihet përmes një rregullimi të tillë - ose si aksiomë - si vlera që një rregullim i caktuar shërben për të mbrojtur ose përshtatur.

295 Vendimi unifikues nr. 14, datë 16.02.2001 i Gjykatës së Lartë.

963 Objektivi i këtij neni është të diskutojë mënyra të mundshme që *ratio legis* ndikon në rezultatin e procesit të interpretimit dhe të përcaktojë lidhjen e rregullave të lidhura me qëllimin (teleologjike) të interpretimit me ato që janë tekstuale ose sistemike. Duhet të theksohet se thjesht fakti që mund të ngrihen çështje të tilla bazohet në premisën që formulimi i dispozitave ligjore nuk reflekton gjithmonë në mënyrë të përshtatshme qëllimin e organit ligjvënës, që do të thotë se mund të ketë një konflikt midis një teksti ligjor dhe qëllimit të ligjvënësit.

2.5 Specifikat e interpretimit të së drejtës së BE-së

964 Ekzistojnë disa specifika të rëndësishme që duhet të respektohen në interpretimin e legjislacionit të BE-së, ku vlen të përmendet kërkesa që e drejta e BE-së duhet të interpretohet në bazë të rregullave të interpretimit të së drejtës së BE-së.[296] Është përgjegjësi e GJEDBE-së të sigurojë që e drejta e BE-së interpretohet dhe zbatohet njëtrajtshmërisht në çdo vend të BE-së.[297]

965 Traktatet nuk përmbajnë asnjë dispozitë që rendit ose cakton ndonjë rend përparësie ndaj metodave të interpretimit që duhet të ndjekë GJDBE-ja. Në mungesë të një dispozite të tillë në Traktate, GJDBE-ja, në parim, është e lirë të zgjedhë se cila nga metodat e interpretimit që disponon i shërben më mirë rendit juridik të BE-së.[298] Në këtë drejtim, disa studiues pohojnë se metodat e interpretimit të GJDBE-së nuk u largohen të ashtuquajturave 'metoda klasike të interpretimit', përkatësisht interpretimi tekstual, interpretimi kontekstual dhe interpretimi teleologjik, të cilat njihen nga rendet ligjore kombëtare, si dhe nga e drejta ndërkombëtare publike, veçanërisht nga Konventa e Vjenës e vitit 1969 për të drejtën e Traktateve.[299]

966 Lidhur me Rregulloret e BE-së, megjithëse është e vërtetë që në rast të vështirësisë së interpretimit administrata e brendshme mund të detyrohet të miratojë rregulla të hollësishme për zbatimin e një Rregulloreje dhe në të njëjtën kohë për të sqaruar çdo dyshim të ngritur, ajo mund ta bëjë këtë vetëm për sa kohë është në përputhje me dispozitat e së drejtës së BE-së dhe autoritetet e brendshme nuk mund të nxjerrin rregulla të

296 GJDBE, Çështja 6/64 Costa v ENEL
297 Lenaerts, K. Gutiérrez-Fons, J. A. "To Say What the Law of the EU Is: Methods of Interpretation and the European Court of Justice". Florence: 2013.
298 G. Itzcovich, 'The Interpretation of Community Law by the European Court of Justice' (2009) 10 German Law Journal 539.
299 H. Kutscher, 'Methods of Interpretation as Seen by a Judge at the Court of Justice' in Reports of a Judicial and Academic Conference held in Luxemburg on 27-28 September 1976, 1-21.

detyrueshme të interpretimit.[300]

3 Implikimet për hartuesin

967 Teknikat e interpretimit janë thelbësore për të siguruar zbatimin e duhur të ligjeve. Sidoqoftë, hartuesi nuk duhet të mbështetet në rregullat e interpretimit kur është e mundur të bëhen parashikime gjatë hartimit në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet dispozitave të ndryshme legjislative. Kështu, për shembull, është praktikë e mirë të thuhet shprehimisht se një dispozitë specifike mbizotëron mbi një dispozitë të përgjithshme në të njëjtin ligj ose në një ligj tjetër.

968 Rregullat e interpretimit dhe, nëse është e nevojshme, paracaktimet e qarta përdoren për të përcaktuar se si dispozitat individuale lidhen me njëra-tjetrën. Për shembull, zgjedhja e fjalëve të përdorura në një citim tregon nëse përdoret një referencë statike ose dinamike.

969 Kërkesat kushtetuese dhe taksonomia ligjore (p.sh. hierarkia e normave, personat fizikë dhe juridikë) merren si të ditura dhe nuk është e nevojshme të përsëriten ose shpjegohen në tekstin ligjor. Gjatë hartimit të legjislacionit, mund të supozohet se autoritetet dhe - në raste mosmarrëveshjesh - gjykatat ose praktikuesit do të zbatojnë rregullat e interpretimit të njohura përgjithësisht.

300 GJDBE, Çështja 94/77, Fratelli Zerbone, 1978.

Shtojca A

Lista e akteve të nxjerra nga organet administrative në përputhje me praktikën e deritanishme kundrejt terminologjisë së Kushtetutës

A.1 Lista e akteve të nxjerra nga organet administrative në përputhje me praktikën e deritanishme

Aktet nënligjore

- Vendimet, udhëzimet e organeve administrative të autorizuara shprehimisht nga ligji.

Aktet administrative individuale

- Urdhrat (jo të autorizuar nga ligji)

Aktet e brendshme administrative:

- Rregulloret ose urdhrat pa efekte ndaj palëve së treta.

Tabela 1
Aktet nënligjore

Afati i veprimit	Autoriteti	Efektet	Lënda	Autorizimi me ligj	Publikimi
1. Vendime Neni 116 (1)(ç) 2. Udhëzime Neni 100(5)	Këshilli i Ministrave	Efekte të përgjithshme detyruese	publiku i gjerë ose publiku i përshkruar nga karakteristika të përgjithshme	Po Neni 118(1)	Fletorja zyrtare Neni 117(1)

1. Udhëzime	Ministri	Efekte të përgjithshme detyruese, brenda juridiksionit	Si më sipër	Po	Fletorja Zyrtare Neni 117 (1)

Tabela 2
Aktet administrative individuale

Afati i veprimit	**Autoriteti**	**Efektet**	**Lënda**	**Autorizimi me ligj**	**Publikimi**
Vendimi/ Urdhri	Kryeministri / Ministri	Individual	Subjekte individuale	Asnjë autorizim i veçantë; bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative	asnjë botim; njoftimi i subjekteve individuale

Tabela 3
Aktet administrative të brendshme

Afati i veprimit	**Autoriteti**	**Efektet**	**Lënda**	**Autorizimi me ligj**	**Publikimi**
1. Rregullore Neni 119	Këshilli i Ministrave / Ministri / organet qendrore shtetërore	Të brendshme	akti vetë-detyrues i organit lëshues ose / dhe adresuar institucioneve vartëse	Jo	Meqenëse këto akte nuk janë 'normative', ato mund të botohen për arsye transparence
2. Urdhra	Kryeministri / Ministri / organet qendrore shtetërore	Të brendshme	akti vetë-detyrues i organit lëshues ose / dhe adresuar institucioneve vartëse	Jo	Meqenëse këto akte nuk janë 'normative', ato mund të botohen për arsye transparence

A.2. Lista e akteve të nxjerra nga organet administrative në përputhje me terminologjinë e Kushtetutës

Akte nënligjore

Aktet administrative individuale

Aktet administrative

Aktet administrative të brendshme
Rregulloret e Këshillit të Ministrave, ministrave ose institucioneve qendrore shtetërore
Urdhrat e Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve qendrore të shtetit
Udhëzimet e organeve administrative

Tabela 1
Akte nënligjore

Afati i veprimit	**Autoriteti**	**Efektet**	**Lënda**	**Autorizimi me ligj**	**Publikimi**
Akt nënligjor	Këshilli i Ministrave	Efektet e përgjithshme detyruese	publiku i gjerë ose publiku i përshkruar nga karakteristika të përgjithshme	Po Neni 118(1)	Fletorja Zyrtare Neni 117(1)
Akt nënligjor[301]	Ministri/ institucionet qendrore shtetërore	Efektet e përgjithshme detyruese	Si më sipër	Po Neni 118 (1)	Fletorja Zyrtare Neni 117(1)

301 Neni 117 i Kushtetutës bën të qartë se ministrat mund të miratojnë akte nënligjore me efekt të përgjithshëm detyrues, të cilat duhet të botohen në FZ. Neni 102 (4) i Kushtetutës i referohet vetëm 'urdhrave' dhe 'udhëzimeve' të ministrave. Urdhrat sipas nenit 119 të Kushtetutës janë vetëm akte administrative të brendshme, dhe për këtë arsye nuk janë akte nënligjore në kuptim të nenit 118 të Kushtetutës. Udhëzimet, siç u tha më lart, janë gjithashtu vetëm akte administrative të brendshme. Prandaj, aktet nënligjore të ministrave propozohen të referohen si 'akte nënligjore'.

Tabela 2
Aktet individuale administrative

Afati i veprimit	Autoriteti	Efektet	Lënda	Autorizimi me ligj	Publikimi
Akti administrativ	Çdo organ administrativ	Individual	Lëndë individuale	Asnjë autorizim i veçantë; bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative	asnjë botim; njoftimi i subjekteve individuale

Tabela 3
Aktet e brendshme administrative

Afati i veprimit	Autoriteti	Efektet	Lënda	Autorizimi me ligj	Publikimi
1. Rregullore Neni 119(1)	Këshilli i Ministrave/ Ministri/ organet qendrore të shtetit	Të brendshme	akti vetë-detyrues i organit lëshues ose/ dhe adresuar institucioneve vartëse	Jo	Meqenëse këto akte nuk janë 'normative', ato mund të botohen për arsye trans-parence
2. Urdhra Neni 119(1)	Kryeministri/ Ministrat/ drejtuesit e in-stitucioneve qendrore shtetërore	Të brendshme	akti vetë-detyrues i organit lëshues ose/ dhe adresuar institucioneve vartëse	Jo	Meqenëse këto akte nuk janë 'normative', ato mund të botohen për arsye trans-parence

3. Udhëzime neni 100 (5) dhe neni 102 (4)	Këshilli i Ministrave/ Ministri	Të brendshme	akti vetë-detyrues i organit lëshues ose/ dhe adresuar institucioneve vartëse	Jo	Meqenëse këto akte nuk janë 'normative', ato mund të botohen për arsye trans-parence

Shtojca B
Udhërrëfyes për procesin ligjbërës



Bashkërendimi i projektakteve dhe reflektimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve
Paraqitja e projektaktit në Këshillin e Ministrave
Shqyrtim në Këshillin e Ministrave
Korrigjim nga Sekretari i Përgjithshëm i KM
Shqyrtim nga Komitetet Ndërministrore
Miratimi i projektaktit nga Këshilli i Ministrave & paraqitja pranë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim

Shtojcat

Shtojca C
Shembuj të akteve ligjore standarde

Akti ligjor parësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **KUVENDI**	Institucioni miratues
LIGJ **Nr. 95/2016**	Lloji dhe numri i aktit
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR	Titulli i plotë
Në mbështetje të nenit 81, pikat 1 dhe 2, shkronja "a" dhe nenit 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,	Baza ligjore
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:	Dispozita miratuese
Neni 1 **Objekti i ligjit**	Numri dhe titulli i nenit
Objekti i këtij ligji është: a) Përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njësisë së Pavarur Hetimore, si organe kushtetuese, sipas pikës 4, të nenit 148, të Kushtetutës. b) Përcaktimi i kushteve dhe procedura për emërimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. c) Përcaktimi i kompetencave lëndore parësore dhe të tjera të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme.	Përmbajtja e nenit

ç) Përcaktimi i kushteve dhe kriteret shtesë që duhet të përmbushin shtetasit për t'u emëruar, transferuar apo për t'u ngritur në detyrë si gjyqtarë ose punonjës pranë gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorë dhe punonjës pranë Prokurorisë së Posaçme, si dhe për t'u punësuar pranë Njësisë së Pavarur Hetimore. Përmbajtja e nenit

d) Përcaktimi i marrëdhënieve të Prokurorisë së Posaçme me institucione të tjera shtetërore, subjekte të tjera publike apo private, si dhe me publikun.

dh) Organizimi dhe funksionimi i procesit të kontrollit të figurës, vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, Drejtorit, Zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre.

Neni 58

Hyrja në fuqi Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI Firma

[Kryetari i Kuvendit]

Miratuar në datën 6.10.2016 Data e miratimit

[Shembulli origjinal i mësipërm është përshtatur në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Manual.]

Shtojcat

Akti ligjor ndryshues

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **KUVENDI**	Institucioni miratues
LIGJ **Nr. 47/2021**	Lloji dhe numri i aktit
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 95/2016 **"PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR"**	Titulli i plotë
	Baza ligjore
Në mbështetje të nenit 81, pikat 1 dhe 2, shkronja "a" dhe nenit 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,	
K U V E N D I I R E P U B L I K Ë S SË S H Q I P Ë R I S Ë V E N D O S I :	Dispozita miratuese
Në ligjin nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:	Dispozita hyrëse
Neni 1	Numri i nenit
Në nenin 8, pika 1, togfjalëshi "*por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës*" shfuqizohet.	Formula ndryshuese
Neni 2	Numri i nenit
Pas nenit 20 shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje :	Formula ndryshuese
"Neni 20/1 **Bërthama komanduese elektronike**	Parashikimet rregullatore
1. Me qëllim funksionimin normal të bërthamës komanduese elektronike në Prokurorinë e Posaçme caktohen specialistë të fushës, të cilët gëzojnë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore.	
2. Paga e specialistit të bërthamës komanduese elektronike është e njëjtë me pagën e oficerit nga shërbimet e Policisë Gjyqësore, sipas përcaktimit të nenit 39/1 të këtij ligji.	

Shtojcat

3. Specialistët e bërthamës komanduese elektronike përfitojnë të njëjtin trajtim si punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas përcaktimit të nenit 40/1 të këtij ligji.”.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Firma

[**Kryetari i Kuvendit**]

Miratuar në datën 23.03.2021

Data e miratimit

[Shembulli origjinal i mësipërm është përshtatur në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Manual.]

Akti ligjor për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **KUVENDI**	Institucioni miratues
LIGJ **Nr. 103/2015**	Lloji dhe numri i aktit
PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS "KONVENTA E PUNËS DETARE (MLC) 2006"	Titulli i plotë
Në mbështetje të nenit 78, nenit 81, pika 1, nenit 83, pika 1 dhe nenit 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,". *(Pra, ndonëse ligji konkret nr. 95/2016 nuk e ka, baza ligjore e një ligji gjithmonë duhet ta kete edhe nenin 81, pika 1 sepse tregon organin iniciues të nismes ligjore, të cilat (subjektet) jo pa qëllim janë përcaktuar në Kushtetutë).*	Baza ligjore
K U V E N D I I R E P U B L I K Ë S SË S H Q I P Ë R I S Ë V E N D O S I:	Dispozita miratuese
Neni 1 **Aderimi** Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Konventa e Punës Detare (MLC) 2006", bërë në Gjenevë në datën 23 shkurt 2006, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.	Numri dhe titulli i nenit Përmbajtja e nenit
Neni 2 **Autoritet zbatuese** Ministria e Punëve të Jashtme miraton, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet mbi kërkesat që duhet të respektojnë anijet që mbajnë flamurin Shqiptar, sipas pikës 4 të Standardit A2.1 të parashikuar në Konventë.	Dispozita mbi autoritetet dhe afatet për rregullat suplementare
Neni 58 **Hyrja në fuqi** Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.	Hyrja në fuqi
K R Y E T A R I **[Kryetari i Kuvendit]**	Firma

Shtojcat

Miratuar në datën 15.10.2015	Data e miratimit

[Shembulli origjinal i mësipërm është përshtatur në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Manual.]

Shtojca D
Shembuj të akteve nënligjore standarde

Akti nënligjor parësor (VKM)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **KËSHILLI I MINISTRAVE**	Institucioni miratues
VENDIM **Nr. 112, datë 23.2.2018**	Lloji dhe numri i aktit
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" DHE TË STANDARDEVE SHTETËRORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË "PROFESOR I ASOCIUAR" DHE "PROFESOR"	Titulli i plotë
Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 60, pika 3, dhe 79, pika 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,	Baza ligjore
KËSHILLI I MINISTRAVE VENDOSI:	Dispozita miratuese
KREU I **KRITERET PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"**	Numri dhe titulli i kreut
Neni 1 **Zhvillimi i studimeve për gradën shkencore "doktor"**	Numri dhe titulli i nenit
1. Studimet për gradën shkencore "doktor" zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur, në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit "universitet" ose "akademi", të cilat plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në këtë vendim.	Përmbajtja e nenit

2. Grada shkencore "doktor" fitohet pas mbrojtjes me sukses të tezës së disertacionit, në përfundim të studimeve të doktoratës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, sipas kritereve dhe brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

Përmbajtja e nenit

Neni 2
Grupet kërkimore doktorale

Numri dhe titulli i nenit

Studimet e doktoratës zhvillohen në formën e grupeve kërkimore, që drejtohen nga personeli akademik, që ka titullin akademik "profesor i asociuar" ose "profesor". Numri i doktorantëve në përbërje të secilit grup kërkimor, i cili përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar, është:

Përmbajtja e nenit

a) jo më shumë se 7 (shtatë), në rastin e personelit akademik që mban titullin "profesor";
b) jo më shumë se 5 (pesë), në rastin e personelit akademik që mban titullin "profesor i asociuar";
c) jo më shumë se 3 (tre), në rastin kur personeli akademik, që ka titullin akademik "profesor i asociuar" ose "profesor", është i angazhuar me kohë të pjesshme.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Firma

[Kryeministri]

Miratuar në datën 23.02.2018

Data e miratimit

[Shembulli origjinal i mësipërm është përshtatur në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Manual.]

Shtojcat

Akti nënligjor ndryshues (VKM)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **KËSHILLI I MINISTRAVE**	Institucioni miratues
VENDIM **Nr. 808, datë 11.12.2019**	Lloji dhe numri i aktit
PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 112, DATË 23.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE 'DOKTOR' DHE TË STANDARDEVE SHTETËRORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË 'PROFESOR I ASOCIUAR' DHE 'PROFESOR'"	Titulli i plotë
Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 60, pika 3, dhe 79, pika 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,	Baza ligjore
KËSHILLI I MINISTRAVE VENDOSI:	Dispozita miratuese
Në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i Asociuar' dhe 'Profesor'" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:	Dispozita hyrëse
Neni 1 Në nenin 2, të Kreut I, bëhen këto ndryshime:	Numri i nenit Formula ndryshuese
i) shkronjat "a" dhe "b" ndryshohen, si më poshtë vijon: "a) jo më shumë se 3 (tre), në rastin e personelit akademik që mban titullin "profesor"; b) jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin "profesor i asociuar";"; ii) shkronja "c" shfuqizohet.	Parashikimet rregullatore
Neni 7 **Autoritetet zbatuese**	Numri i nenit

Shtojcat

Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.	Parashikimet rregullatore
Neni 8 **Hyrja në fuqi**	Hyrja në fuqi
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.	
K R Y E M I N I S T R I	Firma
[**Kryeministri**]	
Miratuar në datën 11.12.2019	Data e miratimit

[Shembulli origjinal i mësipërm është përshtatur në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Manual.]

Shtojcat

Akti nënligjor parësor (URDHËR)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **MINISTRIA E DREJTËSISË**	Institucioni miratues
URDHËR **Nr. 191, datë 29.3.2021**	Lloji dhe numri i aktit
PËR PËRCAKTIMIN E SHUMËS MINIMALE TË MBULIMIT ME SIGURIM PËR NJË NGJARJE TË SIGURUAR DHE SHUMËS MINIMALE TË TËRËSISË SË DËMSHPËRBLIMEVE NGA SIGURIMI, QË JANË TË PAGUESHME GJATË VITIT TË SIGURIMIT PËR NJË APO MË SHUMË NGJARJE	Titulli i plotë
Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, dhe të nenit 65, pika 6, të ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018, "Për noterinë",	Baza ligjore
MINISTRI I DREJTËSISË URDHËRON:	Dispozita miratuese
Neni 1 **Shuma minimale e mbulimit me sigurim**	Numri dhe titulli i nenit
Shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje, përcaktohet çdo vit, në bazë të mesatares së vëllimit të punës së veprimtarisë noteriale për 3 (tri) vitet e fundit, për çdo noter, e përllogaritur nga numrat e koleksionit, si më poshtë:	Përmbajtja e nenit

a) nga 1 deri në 1000 numra koleksioni, shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje është 18 000 000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekë;
b) nga 1001 deri në 3000 numra koleksioni, shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 18 000 000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekë dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më

Shtojcat

shumë ngjarje është 54 000 000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekë;

c) nga 3001 deri në 5000 numra koleksioni, shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 25 000 000 lekë (njëzet e pesë milionë) dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje është 75 000 000 (shtatëdhjetë e pesë milionë) lekë;

ç) mbi 5001 numra koleksioni, shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekë dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje është 105 000 000 (njëqind e pesë milionë) lekë.

Neni 4
Autoritetet zbatuese

Numri dhe titulli i nenit

Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Përmbajtja e nenit

Neni 5
Hyrja në fuqi

Hyrja në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Firma

[**Ministri i Drejtësisë**]

Miratuar në datën 29.03.2021

Data e miratimit

[Shembulli origjinal i mësipërm është përshtatur në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Manual.]

Shtojcat

Akti nënligjor parësor (UDHËZIM)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE** **MINISTRIA E DREJTËSISË**	Institucioni miratues
UDHËZIM I PËRBASHKËT **Nr. 650, datë 13.9.2019**	Lloji dhe numri i aktit
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFAQËSUESVE PROCEDURALË PËR FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN, FËMIJËT VIKTIMA DHE DËSHMITARË NË PROCESIN PENAL	Titulli i plotë
Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 49, pika 4, të ligjit 18/2017, datë 23.02.2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës",	Baza ligjore
MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE DHE MINISTRI I DREJTËSISË UDHËZOJNË:	Dispozita miratuese
Neni 1 **Qëllimi**	Numri dhe titulli i nenit
1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktima dhe dëshmitarë në procesin penal.	Përmbajtja e nenit
Neni 2 **Roli i përfaqësuesve proceduralë**	Numri dhe titulli i nenit
1. Përfaqësuesit proceduralë kryejnë përfaqësimin procedural të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktima dhe dëshmitarë në procesin penal në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 37/2017, datë 30.3.2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur".	Përmbajtja e nenit
2. Përfaqësuesit proceduralë, ushtrojnë funksionet e tyre kur kërkohet nga organi procedues, duke i shërbyer në çdo rast interesit më të lartë të fëmijës në konflikt me ligjin, fëmijës viktimë dhe dëshmitar në procesin penal.	

Shtojcat

3. Njësia për mbrojtjen e fëmijës harton dhe përshtat, një herë në vit, listën me përfaqësuesit proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktima dhe fëmijët dëshmitarë në procesin penal. Përmbajtja e nenit

Neni 17 Hyrja në fuqi

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI Firma

[**Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**]

MINISTRI

[**Ministri i Drejtësisë**]

Miratuar në datën 13.09.2019 Data e miratimit

[Shembulli origjinal i mësipërm është përshtatur në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Manual.]

Shtojcat

Shtojca E
Formular për relacionin shoqërues

RELACION
PËR PROJEKTAKTIN
"PËR ..."

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHET

[Sqaroni qëllimin e projektaktit dhe objektivat e përgjithshëm që synon të rregullojë projektakti, të cilat mund të jenë: modernizimi, racionalizimi, trajtimi i një çështjeje, rregullimi i aktiviteteve informuese, etj., që synohen të arrihen nëpërmjet ndërmarrjes së kësaj nisme legjislative]

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

[Kryeni vlerësimin politik dhe lidhjen ose jo të projektaktit me programin politik të Këshillit të Ministrave, aktet që kanë miratuar drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, si dhe dokumente të tjera për strategjitë dhe politikat e zhvillimit]

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

[Kryeni argumentimin e propozimit të projektaktit, duke bërë analizën lidhur me përparësitë dhe problemet e mundshme në zbatimin e projektaktit, nivelin e efektivitetit, zbatueshmërisë, efiçencës, impaktit dhe efekteve përkatëse, si dhe kostos ekonomike që rezulton në raport me legjislacionin në fuqi.

Në këtë pjesë duhet të përfshihet gjithashtu një vlerësim i përgjithshëm i efekteve të projekt aktit. Të rëndësishme për këtë pjesë të relacionit janë edhe komentet mbi pikat kryesore të projekt aktit. Ato janë thelbësore

për ta kuptuar atë dhe përbëjnë mjetin më të rëndësishëm për deputetët që të njihen me projekt aktin pa qenë nevoja të njohin të gjitha hollësitë e tij]

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

[Kryeni vlerësimin paraprak të ligjshmërisë dhe përputhshmërisë së formës dhe përmbajtjes së projektaktit me Kushtetutën, harmonizimin e tij me legjislacionin në fuqi dhe me normat e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

Kjo pjesë e relacionit duhet t'i paraqesë lexuesit projekt aktin. Për këtë arsye duhet të japë një shpjegim për arsyet kryesore të ndërhyrjeve të sjella nga projekt akti ashtu edhe për ligjshmërinë e tij sipas Kushtetutës dhe legjislacionit ekzistues. Informacioni lidhur me marrëdhënien e projekt aktit me të drejtën ndërkombëtare duhet të trupëzohet në këtë pjesë të relacionit në mënyrë organike.

Nëse për përputhshmërinë me traktatet ose marrëveshjet ndërkombëtare është e nevojshme të nxirret legjislacion zbatues, në relacionin e projekt aktit duhet të përcaktohet shprehimisht mbi tipologjinë e legjislacionit dhe kur është parashikuar të miratohet]

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE-së

[Kryeni vlerësimin e shkallës së përafrimit me *acquis* të Bashkimit Europian në rast se është i zbatueshëm. Vlerësimi kryhet në përputhje me zhvillimin e elementëve të mëposhtme:

- Objektivat specifikë në lidhje me zbatimin e MSA të cilat synohen të adresohen përmes projektaktit; angazhimet e ndërmarra në Planin Kombëtar të Integrimit Europian; mangësitë e vëna në dukje nga Bashkimi Europian në raportet e Komisionit Europian për Shqipërinë;
- Ndryshimet e mundshme ose të pritshme të legjislacionit në fuqi si pasojë e miratimit të projektaktit. Gjithashtu, në rastet kur një pjesë e dispozitave të legjislacionit vendas që do të amendohet apo do të konsolidohet janë të përafruara me *acquis*-në e BE-së, duhet të përmenden dhe të analizohen dispozitat që nuk shfuqizohen në kuadër të përafrimit të mëtejshëm të këtij akti;
- Modelet e akteve të ngjashme të vendeve anëtare të Bashkimit

Europian ose të vendeve kandidate të marra parasysh gjatë hartimit të projektaktit dhe përkthimin në sistemin ligjor shqiptar të *acquis* që përafrohet përmes projektaktit;

- Arsyet për përputhshmëri të pjesshme ose për mospërputhje, nëse synohet përafrim i pjesshëm i projektaktit me *acquis* ose nuk synohet përafrim i projektaktit me *acquis*, organi kompetent duhet të përcaktojë arsyet, pavarësisht nëse janë ekonomike, financiare, sociale ose të tjera. Arsyetimi duhet të shoqërohet nga referenca në analiza specifike impakti, studime ose dokumente të tjera dhe jo vetëm në konstatimin e arsyes/ve në terma të përgjithshëm.
- Hapat e mëtejshëm të parashikuar për përafrimin gradual deri në përafrimin e plotë të projektaktit, duke bërë analizën e boshllëqeve për të evidentuar përmbajtjen e fazave të mbetura dhe periudhën kohore brenda së cilës do të adresohet përafrimi i plotë]

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

[Paraqisni një përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektaktit, duke pasur kujdes të veçantë sidomos në lidhje me shpjegimin e normave të reja ose çështjeve që mund të hasin qasje të ndryshme në praktikë. Ndërsa komentet e përgjithshme japin një pamje të përgjithshme të ndryshimeve të propozuara, synimi i komenteve specifike është që të japë udhëzime lidhur me pyetjet që mund të lindin nga dispozitat e veçanta të projekt aktit në mënyrë të detajuar. Komentet e veçanta duhet t'u referohen krerëve dhe neneve të veçantë të tekstit dhe nëse është e nevojshme, paragrafëve të veçantë të neneve.

Si rregull i përgjithshëm, komentet e veçanta duhet të përmbajnë informacione për rregullat në fuqi, ndryshimet që propozon projekt akti, arsyet për ndryshime, efektet e pritshme të ndryshimeve, si dhe shkallën e përputhshmërisë me parimet dhe dispozitat të veçanta të akteve të BE-së. Masa dhe natyra e komenteve sigurisht varen, midis të tjerash, nga përmbajtja e dispozitës së dhënë. Dispozitat e veçanta mund të referojnë edhe tek komentet e përgjithshme nëse këto të fundit janë të hollësishme.

Duhet theksuar se komentet që thjesht riprodhojnë ose përsërisin dispozitën që propozohet janë të pamjaftueshme. Ajo që kërkohet të bëhet në këtë pjesë është përshkrimi i saktë i përmbajtjes së dispozitave dhe shpjegimi i përputhjes së tyre me rregullat e tjera të projekt aktit.

Shtojcat

Komentet e neneve që parashikojnë kompetencë për të nxjerrë akte nënligjore duhet të përshkruajnë mënyrën se si kjo kompetencë do të ushtrohet.

Legjislacioni ndryshues duhet të shoqërohet gjithashtu me relacion. Por, në praktikë relacionet shpeshherë janë më të shkurtra se relacionet e projekt akteve origjinale. Gjithsesi, këto relacione duhet të plotësojnë të njëjtat kërkesa thelbësore. Ato gjithashtu duhet të përmendin shkurtimisht procedurat që çuan në hartimin e ligjit origjinal dhe të ligjeve të mëvonshme ndryshuese që kanë rëndësi të veçantë për vlerësimin e projekt aktit]

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

[Shtjelloni institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e aktit]

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

[Paraqisni institucionet dhe grupet e punës që kanë kontribuar në hartimin e projektaktit. Nëse për përgatitjen e projekt aktit është kryer konsultim, kjo pjesë e relacionit duhet të specifikojë sipas rastit grupet që kanë vlerësuar tekstin legjislativ; përfundimet dhe rekomandimet e tyre; listën e autoriteteve, organizatave dhe të konsultuarve të tjerë, së bashku me një shpjegim të përgjigjeve të marra prej tyre; si dhe ndryshimet e pasqyruara në projekt akt të cilat reflektojnë konkluzionet dhe rekomandimet e marra]

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

[Sqaroni nëse projektakti ka ose jo efekte financiare dhe shtjelloni efektet financiare në rast se ekzistojnë, në përputhje me çështjet e parashtruara në vijim:

- shumën e përgjithshme të shpenzimeve vjetore për zbatimin e aktit;
- parashikimet e hollësishme për çdo zë të buxhetit, të nevojshme për zbatimin e aktit;
- kohën e fillimit të efekteve financiare;
- shpenzimet e detajuara për strukturat që ngarkohen me zbatimin e aktit;
- burimet e sigurta dhe të pritshme të financimit;

Shtojcat

- analizën e rritjes apo të pakësimit të shpenzimeve buxhetore, të paktën për tre vitet e para të zbatimit të tij;
- vlerën e detyrimeve fiskale të pritshme apo të përjashtuara, që parashikon projektakti;
- kur projektakti ka për objekt miratimin e përdorimit apo të shpërndarjes së fondeve publike, shoqërohet me preventivin përkatës;

Neni 81 i Kushtetutës si dhe RKM-ja janë mjaft të qarta lidhur me nevojën për të vlerësuar efektet financiare të projekt aktit dhe për të përfshirë një shpjegim të tyre në relacion.

Efektet financiare të projekt aktit duhet të përfshihen si për vitin fiskal në të cilin ligji hyn në fuqi, ashtu edhe për vitet pasardhëse, në rast se efekti i plotë ekonomik do të jetë i dukshëm vetëm më vonë. Gjithashtu duhet të përmenden edhe shpenzimet e bëra në kuadër të masave të mundshme përgatitore të nevojshme përpara hyrjes në fuqi të ligjit. Në relacion duhet të tregohet nëse implikimet financiare i takojnë buxhetit të pushtetit qendror apo atij vendor.

Në lidhje me projekt aktet për projekte të mëdha investimesh duhet marrë në konsideratë shprehja e rezultateve të vlerësimit social-ekonomik të pasojave të projekt aktit. Duhet të bëhet një vlerësim i rritjes/uljes vijuese të shpenzimeve për sa i përket administratës, në lidhje me burimet njerëzore, sistemet e teknologjisë së informacionit, si dhe godinat.

Nëse projekt akti përmban një dispozitë për nxjerrjen e akteve nënligjore, duhet të tregohet nëse veprimi i kryer në bazë të kësaj dispozite pritet të ketë efekte ekonomike]

PROPOZUESI

[Ministri propozues]

Shtojcat

Shtojca F
Formulari i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit (RVN)

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj për ...
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e ...
FAZA E POLITIKËS/E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim/konsultim/finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm/transpozim i BE-së/ndërkombëtar
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva xxx e BE-së/jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	[Jepni titullin e strategjisë ose të dokumentit të politikave që ka të bëjë me projektligjin]
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	[Data/asnjë konsultim publik]
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[Data e përfundimit të vlerësimit të ndikimit/data kur është përgatitur versioni i fundit të vlerësimit të ndikimit]
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	xxxx
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[Viti – ML- nr. VN]
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, *E-MAIL*-I, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Emri, mbiemri, *e-mail*-i dhe numri i telefonit:

PJESA 1. MBLEDHJE KZEKUTIVE aksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT
Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

OBJEKTIVAT
Cilët janë objektivat dhe efektet e synuar të propozimit?

OPSIONET E POLITIKAVE
Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/të përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

ANALIZA E NDIKIMEVE
Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR
Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lekë, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
p.sh., 300 000	p.sh., 300 000	p.sh., 100 000

KONSULTIMI
Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?

ZBATIMI DHE MONITORIMI
Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Shtojcat

PJESA 2. BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

-***Jepni kontekstin e politikës***

_____
_____
_____
_____
_____

Problemi në shqyrtim

- **Përshkruani natyrën e problemit.**
- **Identifikoni shkaqet e problemit.**
- **Përshkruani shtrirjen e problemit.**
- **Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria/biznesi /shoqëria civile /qytetarët.**
- **Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.**

_____
_____
_____
_____
_____

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

_____
_____
_____
_____
_____

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifikë, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

_____
_____
_____
_____
_____
_____

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

_____
_____
_____
_____
_____
_____

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
- *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*

- *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
- *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
- *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmblidhni vlerësimin e opsioneve:*
- *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- *Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

_____
_____
_____
_____
_____

Shtojcat

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela. Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kostoja për buxhetin – një herë										
Kostoja për buxhetin – në vazhdim										
Kostoja për biznesin – një herë										
Kostoja për biznesin – në vazhdim										
Kostoja për grupet e tjera – një herë										
Kostoja për grupet e tjera – në vazhdim										
Kostoja në total										
Kostoja e zbritur në total = Kostoja në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kostoja për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Shtojcat

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë. Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kostoja	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

Shtojcat

Shtojca G
Listë kontrolli për kushtetutshmërinë e projektaktit

Listë-kontrolli për kontrollin e kushtetutshmërisë së projektligjeve

Pyetje paraprake

- Cili është objektivi i ligjit?
- Pse po zhvillohet?
- Pse është i nevojshëm?
- Cili është qëllimi i tij?
- Cilat grupe njerëzish ka më shumë të ngjarë të preken ky objektiv?

1. A ndikojnë rregullat e planifikuara të ligjit në ndonjë të drejtë themelore?

1.1 A preken liritë civile?
1.2 Cila liri specifike civile mund të preket?
1.3 Përcaktoni dhe përkufizoni zonën e mbrojtur nga e drejta themelore e identifikuar (→ njohja e praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese)
1.4 A ka ndonjë ndërhyrje në këtë fushë të mbrojtjes?
1.5 A është ndërhyrja e pranueshme në përputhje me dispozitat e Kushtetutës?
1.5.1 E lejueshme nga ligji ose në bazë të një ligji (dispozitë e thjeshtë ligjore)?
1.5.2 E lejueshme vetëm në kushte të caktuara të përcaktuara ose për qëllime të caktuara (dispozitë e kualifikuar ligjore)?
1.5.3 Në rastin e të drejtave themelore të pakushtëzuara (të drejtat absolute): a i respekton rregullimi kufijtë e vendosur nga të drejtat themelore të bartësve të tjerë të të drejtave apo nga të drejtat e tjera kushtetuese (kufizimet e qenësishme të të drejtave themelore)?
1.6 A është respektuar parimi i proporcionalitetit?
1.6.1 A synon rregullimi të arrijë një objektiv legjitim?
1.6.2 A është rregullimi i përshtatshëm për arritjen e këtij qëllimi? (= parimi i

dobisë ose efektivitetit)

1.6.3 A është ai i nevojshëm për këtë qëllim apo do të mjaftonte një mjet më pak i rreptë, po aq i përshtatshëm? (parimi i ndikimit më të pakët)

1.6.4 A është rregullimi i duhuri duke pasur parasysh qëllimin e tij dhe a mund të pritet që personat e prekur të pranojnë zbatimin e tij? (parimi i arsyeshmërisë)

1.6.5 A e prish rregullimi thelbin e së drejtës themelore?

2. A preket ndonjë e drejtë barazie?

2.1 A janë respektuar të drejtat specifike të barazisë (ndalimi absolut i diskriminimit)? (p.sh. një njeri një votë)

2.2 A është respektuar parimi i përgjithshëm i barazisë?

2.2.1 Cilat janë të krahasueshme?

2.2.2 Marrin të barabartët trajtim të pabarabartë? (Ose: Marrin të pabarabartët trajtim barabartë?)

2.2.3 Cilat janë të përbashkëtat ekzistuese, cilat janë të ndryshmet ekzistuese?

2.2.4 A ka argumente të arsyeshme objektivisht për të justifikuar diferencimin? (justifikim i arsyeshëm për diferencimin?)

2.2.5 Parimi i proporcionalitetit: A janë diferencat ekzistuese (në rastin e trajtimit të pabarabartë) apo të përbashkëtat (në rastin e trajtimit të barabartë) me peshë të mjaftueshme për të justifikuar trajtimin e pabarabartë ose trajtimin e barabartë?

3. A janë rregullat e planifikuara ligjore të pajtueshme me parimet e përgjithshme kushtetuese?

3.1 A janë respektuar parimet e qartësisë ligjore dhe të sigurisë ligjore?

- A është e kuptueshme çdo dispozitë ligjore në vetvete?
- A munden qytetarët të parashikojnë dhe vlerësojnë se çfarë barre do t'u imponohet atyre?

3.2 A është respektuar parimi i rezervës ligjore? (→ legjislativi duhet të marrë vetë të gjitha vendimet kryesore dhe nuk mund t'ia lërë këto ekzekutivit)

- Merrni parasysh lëndën dhe intensitetin e rregullimit së planifikuar ose të miratuar
- A i nënshtrohen rregullimit të drejtat themelore të dhëna nga kushtetuta? (→ kufizimi i lirive themelore dhe balancimi i të drejtave themelore kontradiktore me njëra-tjetrën i rezervohen parlamentit)

3.3 Përputhshmëria me parimin e ndarjes së pushteteve?

3.4 A është respektuar parimi i pritshmërisë legjitime (prapaveprimi i ligjit)?

- A ka ndonjë efekt të vërtetë prapaveprues me pasoja juridike (= ndërhyrje në situata që kanë lindur në të kaluarën të cilat tashmë janë përmbyllur?

→ Në parim i papranueshëm

- A ka ndonjë rast të efektit artificial prapaveprues (= ndërhyrje në rrethanat aktuale të cilat ende nuk janë përmbyllur)?

→ E lejueshme kur parimi i pritshmërisë legjitime është respektuar

- në rastin e një ligji penal, dispozita mbi gjobat administrative, gjobat dhe detyrimet e vendosura nga gjykatat disiplinore dhe në procedurat disiplinore: ndalimi absolut i efektit prapaveprues

Shtojca H
Listë-kontrolli për përgatitjen ose shqyrtimin e projektaktit

Listë-kontrolli për përgatitjen ose shqyrtimin e projektaktit

Vlerësimi paraprak

- A është identifikuar qartë problemi që duhet të rregullohet? A ka pasur një vlerësim të nevojës për ndërhyrje legjislative? (Manuali Pjesa C nënseksioni 1.1)
- A është planifikuar ndërhyrja legjislative në përputhje me programin analitik të Qeverisë dhe përparësitë e përcaktuara nga Plani i fundit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit? (Manuali Pjesa C nënseksioni 1.1)
- Nëse ndërhyrja legjislative është e nevojshme në kuadrin e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis-në* e BE-së, a janë identifikuar saktë pjesët e zbatueshme të këtij të fundit me të cilën legjislacioni shqiptar do të përafrohet? (Manuali Pjesa B seksioni 5)
- A janë formuluar me qartësi objekti dhe fusha e zbatimit të projektit? (Rregullorja e KM-së, Kreu III, par 12, shkronja (a))
- A janë identifikuar qartë çështjet që duhet të rregullohen me ligj dhe ato që mund të rregullohen me akte nënligjore? A është përdorur mënyra më racionale për ndryshimin e legjislacionit ekzistues? (Manuali Pjesa E seksioni 1 dhe nënseksioni 3.1)
- A është bërë një vlerësim i përputhshmërisë së projektit me Kushtetutën dhe legjislacionin tjetër në fuqi? (Rregullorja e KM-së, Kreu III, par 12, shkronja (c); Manuali Pjesa B seksioni 3)
- A ka pasur një vlerësim paraprak të efektivitetit, efiçencës dhe efikasitetit të projektit? (Rregullorja e KM-së, Kreu III, par 12, shkronja (ç); par 19, shkronja (c); Manuali Pjesa C nënseksioni 1,1)
- A janë vlerësuar saktë dhe në mënyrë të detajuar kostot për sektorin

publik dhe ato për sektorin privat? (Rregullorja e KM-së, Kreu III, par 12, shkronja (d))

Procesi i hartimit

- A është e nevojshme që të ngrihet një grup pune me ekspertë në fushën që duhet të rregullohet nga projekti? Nëse po, a janë bërë rregullimet për këtë në kohën e duhur? (Rregullorja e KM-së, Kreu III, par 14, 15; Manuali Pjesa C nënseksioni 1.2)
- Nëse konsultimi me grupet e interesit ose subjekte të tjerë të interesuar është i rëndësishëm për çështje thelbësore ose çështje teknike të projektit, a janë bërë rregullimet e duhura për të ftuar dhe për të siguruar pa diskriminim pjesëmarrjen e këtyre grupeve dhe subjekteve në procesin e hartimit? (Rregullorja e KM-së, Kreu III, par 14; Manuali Pjesa C nënseksioni 1.3)
- A janë bërë rregullimet e nevojshme për transparencën e konsultimit me grupet e interesit ose publikun e gjerë? A u është lënë koha e duhur subjekteve të konsultuar për të përgatitur komentet e tyre? A janë analizuar komentet e marra dhe a janë pasqyruar rezultatet e kësaj analize në projekt? (Manuali Pjesa C nënseksioni 1.3)
- A është i qartë dhe i saktë teksti i projektit?
- A i respekton raporti shpjegues i projektit kërkesat e Rregullores së Këshillit të Ministrave? (Rregullorja e KM-së, Kreu V, par 19)
- A janë kërkuar mendimet e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Punës, Çështjet Sociale dhe Shanset e Barabarta dhe Departamentit të Administratës Publike nëse projekti i propozuar prek fushat e mbuluara nga këto institucione? (Rregullorja e KM-së, Kreu IV, par 23, 24, 26, 27)
- A është kërkuar mendimi i Ministrisë së Drejtësisë për ligjshmërinë e formës dhe përmbajtjes së projektit, si dhe për teknikën legjislative, duke i dhënë këtij institucioni kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur? A është pasqyruar mendimi i Ministrisë së Drejtësisë në projektin e rishikuar dhe a i është bashkangjitur propozimit të paraqitur në Këshillin e Ministrave? Rregullorja e KM-së, Kreu IV, par 22, Kreu V, par 28, 31; Kreu I, par 45(c); Manuali Pjesa B seksionet 1 dhe 2)
- Nëse ligji transpozon një akt ligjor të *acquis-së* së BE-së, a është bërë një vlerësim i përputhshmërisë së projektit me *acquis-në* e BE-së në përputhje me Instrumentet e Përafrimit dhe a i është dërguar projekti së bashku me tabelat e përputhshmërisë Ministrisë për Europën dhe

Punët e Jashtme? A është pasqyruar mendimi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme në projektin e rishikuar? Rregullorja e KM-së, Kreu IV, par 25, Kreu V, par 31; Manuali Pjesa F seksion 2)

- Nëse ligji transpozon një akt ligjor të *acquis-së* së BE-së, a është vendosur referenca e duhur me numrin CELEX, titulli i plotë dhe data në fund të faqes së parë të ligjit? (Rregullorja e KM-së, par 21/1; Manuali Pjesa F nënseksioni 3.1)

Shtojcat

Shtojca I
Listë kontrolli për vlerësimin e hapësirave për korrupsion

1. DYKUPTUESHMËRIA	
1.1 Stili gjuhësor	
1.1.1 Fjalët e përzgjedhura a janë të sakta?	
1.1.2 A janë ndërtuar fjalitë dhe frazat saktë duke mos lënë hapësirë për dykuptimësi?	
1.2 Harmonizimi	
1.2.1. A ka dispozita kontradiktore brenda ligjit apo aktit nënligjor? A ka dispozita kontradiktore me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore?	
1.2.2 A është terminologjia e përdorur e saktë dhe konsistente?	
1.2.3 A janë referencat e sakta dhe të qarta brenda ligjit dhe aktit nënligjor? A janë referencat e sakta dhe të qarta tek ligjet dhe aktet nënligjore të tjera?	
1.2.4 A i mbulon teksti i ligjit apo aktet nënligjor të gjitha çështjet? A ekziston ndonjë vakuum ligjor apo nënligjor?	
2. RREZIQET SUBSTANCIALE	
2.1 Objektivat e ligjit apo të aktit nënligjor	
2.1.1 A është kryer vlerësimi paraprak dhe a është i saktë? A janë përcaktuar objektivat e ligjit dhe të aktit nënligjor në përputhje me vlerësimin paraprak?	
2.1.2 Rregullat e hartuara të ligjit ose të aktit nënligjor a janë koherente me objektivat e ligjit apo të aktit nënligjor?	
2.2 Procedurat	

2.2.1 A është përcaktuar diskrecioni në masën e duhur, që të mos jetë i gjerë? A ka kritere që përcaktojnë diskrecionin? A ka diskrecion për të zbatuar përjashtimin nga rregulli?	
2.2.2 A ka diskrecion rregullator?	
2.2.3 A janë përcaktuar të gjitha hapat e procedurës gjer në vendimmarrje?	
2.2.4 A është e qartë procedura e përcaktuar?	
2.2.5 A është e thjeshtë procedura, pa pengesa të tejskajshme?	
2.2.6 A sigurohet aksesi i duhur në informacion gjatë procedurës?	
2.2.7 A janë caktuar afate për hapat proceduralë? A janë të sakta dhe të përshtatshme afatet?	
2.2.8 A garanton konkurrencën e lirë procedura, nëse vendos rregulla përzgjedhëse?	
2.2.9 A është e qartë procedura e vendimmarrjes? A janë kriteret e qarta për vendimmarrje?	
2.3 Organi zbatues	
2.3.1 A është caktuar një organ kompetent për zbatimin e ligjit apo të aktit nënligjor?	
2.3.2 A janë caktuar qartë kompetencat e organit? A ka mbivendosje kompetencash?	
2.3.3 Nëse organi zbatues është deleguar të rregullohet me akt nënligjor, a është caktuar një afat për nxjerrjen e organit nënligjor? A ka rrezik për ngritjen e vonuar të organit?	
2.3.4 A është parashikuar më shumë se një organ për zbatimin e ligjit? A janë koherente kompetencat e tyre? A është e qartë se cili është organi kryesor përgjegjës?	
2.3.5 A respektojnë rregullat e hartuara standardet e parandalimit dhe të shmangies së konfliktit të interesave?	
2.4 Mbikëqyrja	
2.4.1 A parashikon ligji apo akti nënligjor një mekanizëm mbikëqyrës?	
2.4.2 A garanton ligji apo akti nënligjor transparencë të zbatimit të tij?	

2.5 Sanksionet	
2.5.1 A përcakton ligji apo akti nënligjor sanksione në rast të shkeljes së detyrimeve?	
2.5.2 A janë sanksionet proporcionale?	
2.6 Kontrolli gjyqësor	
2.6.1 A parashikon ligji apo akti nënligjor kontrollin gjyqësor të veprimtarisë administrative?	
2.6.2 Rregullat për kontrollin gjyqësor a janë formuluar qartë?	

Shtojca J
Përmbledhje e rregullave për teknikën legjislative

Listë kontrolli e rregullave për teknikën legjislative

- Projekti duhet të jetë i njëtrajtshëm, koherent dhe i qartë; rrjedhimisht, ai duhet të hartohet bazuar në teknikat uniforme të hartimit.
- Projekti duhet të ofrojë siguri ligjore dhe parashikueshmëri; duhet të përmbajë të drejta dhe detyrime që janë të qarta për subjektet të cilave u drejtohet projekti dhe duhet të lërë sa më pak hapësirëpër interpretim.
- Struktura e një projektakti:
  - Pjesët - të numërtuara me fjalë ose numra të mëdhenj romakë (p.sh. "Pjesa e parë" ose "Pjesa I);
  - Titujt - të numërtuar me numra të mëdhenj romakë (p.sh. "Titulli I", "Titulli II");
  - Krerët - të numërtuar me numra të mëdhenj romakë (p.sh. "Kreu I", "Kreu II");
  - Seksionet - të numërtuar me numra arabë (p.sh. "Seksioni 1", "Seksioni 2").
- Njësia bazë e projektaktit është Neni, i cili numërtohet me numra arabë (p.sh. "Neni 1", "Neni 2") dhe i cili mund të ndahet në:
  - Paragrafë - të numërtuar me numra arabë (p.sh. "1.", "2."),
  - nënparagrafët - të numëruara me shkronja (p.sh. "a)", "b)"),
  - nën-nënparagrafët - - të numërtuar me numra romakë të vegjël (p.sh. "i", "ii)").
- Renditja e dispozitave të projektaktit:
  - Titulli - emërtimi ligjor i aktit, numri rendor, data e miratimit, emri përshkrues, shkrimi fundor me informacionin CELEX;
  - Baza ligjore - nenet e Kushtetutës, ose ligjeve që autorizojnë nxjerrjen e akteve nënligjore;
  - Dispozita e qëllimit - qëllimi i ligjit;
  - Dispozita për fushën e zbatimit - subjektet e ligjit dhe kufizimet në

zbatimin e tij;
- Përkufizimet - kuptimi i termave të veçantë të përdorur; ato mund të vendosen në fillim të ligjit;
- Dispozitat për procedurat administrative - organet shtetërore të autorizuara për zbatimin e ligjit;
- Dispozita të delegimit - autorizimi për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe organi përgjegjës për këtë në përputhje me parimet e Kushtetutës (shih Nenin 118 të Kushtetutës);
- Dispozitat sanksionuese - sanksionet penale dhe administrative;
- Dispozitat shfuqizuese - specifikimi i ligjeve ose dispozitave të ligjeve që pushojnë së qeni në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit;
- Dispozitat për ndryshimet në ligjet e tjera - specifikimi i ndryshimeve në dispozitat e veçanta të ligjeve të tjera;
- Dispozitat kalimtare dhe të fundit - specifikimi i procedurave për kalimin nga regjimi i mëparshëm ligjor në atë të ri;
- Dispozitat e hyrjes në fuqi - specifikimi i datës së hyrjes në fuqi të ligjit, sipas Kushtetutës jo më pak se 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

- Gjuha e projektaktit duhet të jetë e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë:
  - Fjalitë duhet të jenë të shkurtra dhe të qarta.
  - Kryefjala, kallëzuesi dhe kundrinori i fjalisë duhet të mbahen afër me njeri-tjetrin. Fjalët duhet të përdoren në kuptimin e tyre kryesor.
  - Fjalët me origjinë të huaj duhet të shmangen, përveç kur ato janë të nevojshme; në çdo rast ato duhet të shkruhen me shkronja korsive.
  - Fjalët e panevojshme duhet të shmangen.
  - Shkurtimet duhet të përdoren vetëm kur lejohen nga një praktikë e mirë-vendosur.
  - Numrat dhe muajt duhet të shkruhen me fjalë (dhe shkronja e parë e muajve nuk duhet të shkruhet me shkronjë të madhe); datat dhe vitet duhet të shkruhen në numra arabë.
- Stili i projektaktit:
  - Projekti duhet të përmbajë fjalë dhe shprehje në një mënyrën dëftore, duke shmangur formulimet mohore kur është e mundur.
  - Duhet të përdoret stili narrativ.
  - Referenca e përsëritur e dispozitave të tjera brenda ligjit duhet të shmanget. Njëjësi duhet të përdoret më shumë sesa shumësi.
  - Projekti duhet të përdorë kohën e tashme.
  - Teksti i projektit duhet të jetë në mënyrën dëftore dhe trajtën veprore kur është e mundur.
  - Fjala "dhe" duhet të përdoret për të treguar marrëdhënien bashkërenduese

Shtojcat

të dy pjesëve të një fjalie, me fjalën "ose" për të treguar alternativa.
    - Emërzimi duhet të shmanget.
- Pikësimi:
    - Pika - përdoret në fund të neneve, paragrafëve dhe nënparagrafëve. Presja - përdoret në kuptimin e saj të zakonshëm sintaksor.
    - Dy pikat - përdoren pas pjesës hyrëse të një paragrafi. Pikëpresja - përdoret për ndarjen e nënparagrafëve.
    - Thonjëzat - përdoren për termat e përkufizuar dhe kur një tekst i ri prezantohet me anë të ndryshimeve.
    - Duhet të shmangen kllapat (kllapat e rrumbullakëta) dhe shenjat e tjera ortografike.
    - Shenja e përqindjes mund të përdoret në tabela, por duhet të shkruhet me shkronja ('përqindja') në tekst.
- Referencat:
    - Referencat e brendshme - një dispozitë e projektit që i referohet një dispozite tjetër në të njëjtin projekt - duhet të jetë e saktë; shmangni referimet zinxhir në dy ose më shumë nene në të njëjtën kohë.
    - Referencat e jashtme - një dispozitë e projektit që i referohet një dispozite të një akti tjetër - duhet të tregojë aktin tjetër saktësisht, sipas titullit, numrit dhe datës.
- Ndryshimet në një akt parësor. Format e ndryshme të ndryshimit të një ligji janë:
    - Shtesa - shtimi i tekstit të ri në tekstin ekzistues të një ligji.
    - Zëvendësimi - zëvendësimi i tekstit ekzistues me tekst të ri të një ligji.
    - Shfuqizimi - fshirja e një pjese ose të gjithë tekstit të një ligji.
- Ndryshimi kërkon saktësi në lidhje me citimin e plotë të dispozitës që ndryshohet dhe vendosjen e tekstit të ndryshimit në thonjëza.
- Numërtimi i dispozitave të ligjit pas ndryshimit duhet të lidhet me koherencën e tekstit të ligjit origjinal.
- Numrat, ose identifikimi alfabetik, i dispozitave të shfuqizuara nuk duhet tu ri-caktohen dispozitave ndryshuese, përveç kur ndryshohet e gjithë dispozita;
- Duhet të shmanget ri-numërtimi dhe riformulimi i shkronjave të dispozitave të një ligji që ndryshohet. Kur një dispozitë zëvendësohet tërësisht, lejohet ri-numërtimi dhe ri-formulimi i identifikimit alfabetik.
- Mos harroni se një ligj ndryshues ka për qëllim vetëm të ndryshojë një ligj ekzistues dhe nuk ka një ekzistencë të pavarur. Pas miratimit të tij i vetmi "ligj" në fuqi është ligji origjinal i ndryshuar.

Shtojcat

Shtojca K
Listë kontrolli për përafrimin në të drejtën e BE-së dhe formulari i Tabelës së Përputhshmërisë

Listë-kontrolli për përafrimin në të drejtën e BE-së dhe formulari i Tabelës së Përputhshmërisë (TP)

Eksperti teknik për fushën përkatëse të ekspertizës pritet të përfundojë detyrat e mëposhtme brenda afateve specifike siç udhëzohet:

Detyra 1: Hulumtimi i sfondit
Si hap i parë ju do të kryeni hulumtime që do të përfshijnë kërkime të literaturës dhe legjislacionit për fushën tuaj si dhe rishikimin e praktikës gjyqësore, në lidhje me zbatimin e Direktivës përkatëse. Për këtë ju duhet të kontrolloni një numër burimesh siç janë bazat e të dhënave legjislative, përfshirë CELEX, regjistrat e praktikës gjyqësore, studimet përkatëse të nivelit kombëtar dhe të BE-së të kryera tashmë, rishikimet e ligjit dhe neneve që mbulojnë fushën përkatëse të ligjit, duke u mbështetur në burimet e universiteteve lokale dhe institucioneve të tjera të rëndësishme, përfshirë studimet akademike, revistat juridike dhe bazat e të dhënave ligjore. Ju do të hulumtoni legjislacionin përkatës në Shqipëri, duke marrë parasysh çdo kod të brendshëm përkatës dhe dokumente udhëzuese.

Kjo pjesë nuk duhet të neglizhohet pasi vlerësimi juaj ka të ngjarë të kërkojë një pasqyrë të mirë të praktikës gjyqësore përkatëse dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës.

Mbi këtë bazë, ju duhet të jepni një pasqyrë paraprake të mënyrës së transpozimit të Direktivës në Shqipëri. Siç shpjegohet më poshtë, kjo do të ketë implikime të rëndësishme për pjesën e mbetur të punës tuaj.

Detyra 2: Plotësimi i Tabelës së Përputhshmërisë
Ju lutemi lexoni me vëmendje udhëzimet e mëposhtme.

Udhëzime të Përgjithshme

Një Tabelë e Përputhshmërisë (TP) është një mjet analize për të vlerësuar përputhshmërinë e legjislacionit transpozues me Direktivën përkatëse. Kjo do të dokumentojë pikat e përputhshmërisë me kërkesat e BE-së dhe ku mund të ketë boshllëqe ose probleme.

1. Fusha e informacionit të përgjithshëm: Kjo fushë duhet të përmbajë emrin e vendit, emrin e ekspertit, si dhe datën në të cilën TP-ja është kompletuar ose / dhe modifikuar më pas. Ju lutemi vini re gjithmonë datën e fundit në të cilën është plotësuar TP, në mënyrë që ekipi ynë i menaxhimit të mbetet i informuar me versionet më të azhurnuara të TP-së.

2. Fusha prezantuese (maksimalisht 1-2 faqe): Kjo fushë duhet të përfshijë një paragraf të shkurtër hyrës për Direktivën mbi kontekstin e saj të transpozimit *dhe* një deklaratë të shkurtër mbi cilësinë e transpozimit.

Hyrja pasohet nga një listë e ligjeve transpozuese. Ju lutemi përdorni pikat treguese për të renditur ligjet. Filloni duke treguar aktin kryesor (ose aktet) transpozues dhe pastaj renditni të tjerët në rend kronologjik nga më i afërti te më i vjetri. Nëse akti ose rregullimi është ndryshuar, ju lutemi jepni ndryshimin në kllapa. Vini re që nëse ka shumë ndryshime për t'u cituar, sigurohuni që të tregoni referencat dhe datën e ndryshimeve të fundit. Gjithashtu, në kllapa, jeni të lutur të jepni shkurtimin që keni zgjedhur për aktin ose rregullimin të cilin do të përdorni në pjesën tjetër të TP-së. Në fillim duhet të citohet titulli në anglisht dhe pastaj titulli në gjuhën e brendshme.

Për më tepër, shkurtimet e tjera të përdorura në TP-ë duhet të shpjegohen pas listës së ligjeve.

3. Fusha përmbledhëse mbi përputhshmërinë: Kjo fushë duhet të plotësohet në fund kur të ketë përfunduar i gjithë teksti i TP-së. Në bazë të gjetjeve të TP-së, eksperti ligjor do të duhet të tregojë nëse ligji transpozues është në përputhje të plotë me Direktivën, apo nëse transpozimi nuk është në përputhje me kërkesat e BE-së të renditura në Direktivë.

Nëse ka mospërputhje, eksperti ligjor do të duhet të tregojë nëse mungesa e pajtueshmërisë është për shkak të transpozimit **jo të plotë (G: Boshllëk) ose / dhe jo të përputhshëm (I: I pasakte)**.

Në mënyrë të ngjashme, eksperti ligjor duhet të nxjerrë në pah ato raste kur ligjvënësi ka shkuar më larg sesa parashikohet nga Direktiva e BE-së dhe ligji

Shtojcat

transpozues përfshin kërkesa më të rrepta sesa ato të renditura në analizën e *acquis-së*.

Simbolet që do të përdoren nga të gjithë ekspertët ilustrohen në Figurën 1.

Figura 1: Simbolet që duhet të përdoren në Fushën Përmbledhëse të TP-së

PO			JO		
ose/dhe Hollësisht	më	+	I paplotë (G) ose / dhe i pasaktë (I)	G	I

Në çdo rast, eksperti do të shënjojë fushën Po ose Jo. Në asnjë rrethanë nuk duhet të shënjohen të dy kutitë.

4. Teksti Kryesor i TP-së Kjo fushë përfshin një tabelë ku eksperti teknik duhet të kryejë shqyrtimin e çdo dispozite të legjislacionit transpozues duke i krahasuar me kërkesat përkatëse të së drejtës së BE-së. Përbëhet nga kolonat e mëposhtme:

Neni dhe detyrimi kundrejt BE-së: Këto kolona rendisin dispozitat ligjore të Direktivës që Shqipëria do të duhet të përfshijë në të drejtën e brendshme.

Çdo rresht rendit një dispozitë ose nën-dispozitë të veçantë. Kur një dispozitë ose nën-dispozitë përmban më shumë se një detyrim ligjor, secilit detyrim ligjor i jepet rreshti i tij. Shpërndarja nuk duhet të modifikohet. Nëse një ekspert mendon se duhet të ndryshohet, ai/ajo duhet së pari të informojë menaxherin e projektit.

Dispozitat janë hijezuar në gri për të treguar kur nuk ka asnjë detyrim ligjor për transpozimin. Kur dispozitat nuk kanë nevojë të transpozohen, rreshti përkatës duhet të lihet bosh.

Mund të ketë gjithashtu dispozita që kërkojnë nga eksperti të vendosë bazuar në rrethanat dhe kontekstin specifik të brendshëm. Në këto raste, i lihet gjykimit të vetë ekspertit nëse dispozitat e brendshme e transpozojnë Direktivën në detaje të mjaftueshme për të siguruar që rregullimet e bëra mundësojnë përputhjen me objektivin. Me kusht që objektivi të jetë mjaft i qartë, nuk konsiderohet të jetë një rast i mos-përputhshmërisë, nëse ligji i brendshëm nuk transpozon në mënyrë të qartë dispozitat e tilla. Sidoqoftë, nëse objektivi nuk është mjaft i qartë, eksperti duhet të deklarojë arsyen pse është kështu. Një shembull tipik do

të ishte kërkesa që sanksionet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese.

Megjithëse radha e detyrimeve të BE-së përfshin një botim tekstual të tekstit të konsoliduar të çdo Direktive, TP-të nuk duhet të merren të mirëqena si tekste ligjore. Përkundrazi, gjatë kryerjes së verifikimit të përputhshmërisë, ekspertët teknikë inkurajohen të punojnë me version e shtypur të Direktivës në një gjuhë që ata e kuptojnë më mirë. Sigurohuni që përdorni versionin e fundit të konsoliduar (i disponueshëm në faqen eur-lex). Për më tepër, ekspertët ligjorë duhet të marrin parasysh tekstet shtesë të BE-së, të cilëve u referohet drejtpërdrejt Direktiva.

Dispozita transpozuese (jepni ligjin / rregullimin përkatës & nr. e nenit): Kjo kolonë ofron një fushë për të vendosur referencën ligjore të dispozitës përkatëse nga ligji i brendshëm që ka transpozuar kërkesën e BE-së (ju mund të përdorni një formë të shkurtuar të referencës ligjore dhe të përfshini referencën e saj të plotë ligjore në fillim të TP-së, në fushën e parashikuar për çelësin e shkurtesave), si dhe nenin përkatës.

Nëse ka masa të ndryshme transpozimi, akti i parë juridik që do të citohet duhet të jetë instrumenti më i rëndësishëm për transpozimin e Direktivës në nivelin e brendshëm. Ju lutemi, mos shtoni kolona të tjera në kolonat tashmë ekzistuese.

Nëse nuk ka ndonjë dispozitë transpozuese specifike, lëreni këtë kolonë bosh dhe vlerësoni menjëherë transpozimin. Shpesh, kjo do të çonte në transpozim jo të plotë, por transpozimi mund të bëhet gjithashtu përmes parimeve të përgjithshme të së drejtës.

Teksti i plotë i dispozitës transpozuese në gjuhën e Shtetit Anëtar / vendit aderues: Teksti i dispozitës transpozuese në gjuhën origjinale duhet të futet në këtë kolonë. Nëse nuk ka ndonjë dispozitë transpozuese, lëreni këtë kolonë bosh.

Ekspertit do ti duhet të kryejë një analizë tekstuale të përputhshmërisë, duke lexuar me kujdes formulimin e secilës dispozitë transpozuese dhe duke krahasuar formulimin me detyrimin specifik siç përcaktohet në Direktivën përkatëse.

Përkthimi në anglisht i dispozitës së brendshme: Kur gjuha kryesore e vendit e analizuar nuk është anglishtja ose frëngjishtja, në këtë kolonë duhet të futet një përkthim në anglisht i dispozitës transpozuese të brendshme. Përkthimi do të bëhet nga eksperti. Nëse dispozita është transpozuar fjalë për fjalë, d.m.th. teksti i dispozitës së brendshme është identik me atë të Direktivës në gjuhën e

Shtojcat

brendshme, mund të kopjohet dispozita përkatëse e Direktivës në versionin në anglisht. Përkthimi ekzistues, p.sh. nga Ministria, mund të përdoret gjithashtu, me kusht që të kontrollohet dyfish. Nëse janë të rëndësishme vetëm aspekte të caktuara të dispozitës transpozuese, është e mundur të përdoret shenja [...] në mënyrë që të mos përkthehen pjesët e panevojshme.

Plotësisht në përputhje (po / jo): Kjo kolonë do të përdoret për të treguar nëse transpozimi i legjislacionit përputhet plotësisht me kërkesat e BE-së apo jo. Në plotësimin e kësaj kolone, është e rëndësishme të siguroheni që përgjigja "po" jepet vetëm nëse transpozimi është i plotë, *d.m.th.*, transpozimi i pjesshëm nuk është i mjaftueshëm.

Përgjigjet e mundshme që do të jepen në këtë kolonë janë vetëm Po ose Jo (shkruar me fjalë të plota).

Shënime/Probleme: Këtu eksperti ligjor duhet të fusë komentet e tij/saj mbi transpozimin. Rreshti i parë duhet të përcaktojë një vlerësim të përgjithshëm të përputhshmërisë:

Transpozimi fjalë për fjalë Transpozimi efektiv	Tërësisht i përputhshëm? Po
Transpozimi i paplotë Boshllëk i transpozim Transpozimi i pasaktë Transpozimi jo i plotë dhe i pasaktë Transpozimi i paqartë Transpozimi i vonuar	Tërësisht i përputhshëm? Jo
Transpozimi më i rreptë	Plotësisht në përputhje? Po

Nëse nuk konstatohet ndonjë problem përputhshmërie, mund të shënoni Transpozimin tekstual ose Transpozimin Efektiv. Përdorni "transpozimi tekstual" aty ku fjalët janë të njëjta (ose pothuajse saktësisht të njëjta) me fjalët e përdorura në Direktivë.

Përdorni "*transpozim efektiv*" nëse fjalët ose ndërtimi i fjalisë që përdoren për të transpozuar janë të ndryshëm nga Direktiva, por qëllimi për transpozimin arrihet. Dallimet duhet të theksohen dhe komentohen. Duhet të thuhet qartë se si keni arritur në përfundimin se dispozita e brendshme është në përputhje

me kërkesat e Direktivës, kur kjo nuk është e qartë nga formulimi i ligjit transpozues. Një shembull është nevoja për të komentuar disa nocione që nuk janë përcaktuar nga Direktiva p.sh. 'dëm i konsiderueshëm' ose or 'dashje'. Kur dispozita e brendshme është shumë e gjatë, duhet të përmblidhni pikat kryesore të dispozitave të cituara.

Duhet t'i trajtoni këto çështje duke iu referuar specifikisht udhëzimit të brendshëm, praktikës gjyqësore dhe jurisprudencës, sipas rastit. Kjo do të kërkojë hulumtime të thelluara të literaturës akademike ose të ndonjë dokumenti udhëzues në Shtetet Anëtare që mund të ofrojë interpretime të këtyre nocioneve dhe mënyrës se si ato duhet të zbatohen në praktikë.

Shprehja transpozim jo i plotë përdoret kur transpozimi është i pjesshëm. Eksperti duhet të shpjegojë qartë se cilat pjesë të kërkesave të Direktivës nuk janë transpozuar. Boshllëk në transpozim konsiderohet kur dispozita e Direktivës nuk është transpozuar fare. Kur transpozimi konsiderohet i pasaktë, eksperti duhet të shpjegojë qartë arsyet pse bëhet një vlerësim i tillë.

Nëse është gjetur një problem përputhshmërie, duhet të shpjegoni qartë se cili është problemi dhe çfarëdo implikimi që mund të ketë kjo.

Transpozim i paqartë konsiderohet kur formulimi i dispozitës së brendshme mund të lejojë një interpretim të ndryshëm në përputhje me kërkesën e Direktivës ose jo. Me fjalë të tjera, termat e përdorur mund të çojnë në zbatimin e pasaktë të kërkesave të Direktivës. Vlerësimi "Transpozim i paqartë" do të përdoret vetëm në rrethana të veçanta. Në rast transpozimi të paqartë, ekspertët duhet të përgjigjen "Jo" nën kolonën me titull "plotësisht në përputhje" dhe të shpjegojnë në kolonën e shënimeve pse është e dyshimtë nëse ligji i brendshëm është apo jo në përputhje me Direktivën për pikën në fjalë.

Vlerësimi i transpozimit të vonuar mund të përdoret vetëm në lidhje me afatin e transpozimit të përcaktuar nga Direktiva në fjalë. Kjo nuk është e zbatueshme për sa kohë që Shqipëria nuk është anëtare e BE-së.

Nëse konstatohet një transpozim më i rreptë, ju lutemi shpjegoni edhe këtë.

Së fundmi, eksperti duhet të tregojë kur një rast i mos-përputhshmërisë konsiderohet si 'i vogël'. Kjo do të nënkuptonte që mos-përputhshmëria nuk është shumë serioze dhe nuk do të pengonte zbatimin efektiv të kërkesës së Direktivës. Shembuj tipikë do të ishin një gabim tipografik ose mos-transpozimi ose transpozimi i pasaktë i një referimi të kryqëzuar tek dispozitat e tjera brenda

Shtojcat

një dispozite. Sidoqoftë, ekspertët teknikë gjithmonë duhet të përdorin gjykimin e tyre për të vendosur nëse një mungesë e tillë e referimit të kryqëzuar përbën një rast të vogël të mos-përputhshmërisë apo jo.

Ekspertët duhet të theksojnë gjithashtu se kur mos-përputhshmëria e një dispozite të caktuar, si p.sh., një përkufizim, ndikon në dispozitat e tjera të Direktivës, duhet të zbatohet një qasje rast pas rasti, por çështja duhet gjithmonë të tregohet qartë. Si rregull i përgjithshëm, në vend që të konsiderohet çdo dispozitë ku termi i dhënë paraqitet si i pasaktë, eksperti duhet të vlerësojë secilën dispozitë individualisht dhe më pas të deklarojë se, p.sh., megjithëse transpozimi është fjalë për fjalë, përsëri mund të lindin probleme si rezultat i faktit se përkufizimi nuk korrespondon me atë të Direktivës. Prandaj, nëse mospërputhja mund të çojë në mospërputhje të dispozitave të tjera, kjo duhet të theksohet dhe shpjegohet.

Sigurimi i Cilësisë

Cilësia e TP-ve do të verifikohet nga Ekipi i Sigurimit të Cilësisë në mënyrë që të sigurohet një thellësi e njëjtë analize në punën e paraqitur nga ekspertë të ndryshëm teknikë. Ekipi i Sigurimit të Cilësisë do të rishikojë ToC-të për çdo mospërputhje ose boshllëk dhe për qartësinë e shpjegimeve ku janë identifikuar problemet. Çdo koment nga Ekipi i Sigurimit të Cilësisë mbi TP-të do t'u kthehet ekspertëve ligjorë teknikë për sqarime të mëtejshme. Pritet që t'i përgjigjeni çdo komenti menjëherë dhe plotësisht. Ky proces përsëritet derisa ekipi i Sigurimit të Cilësisë të jetë i bindur për rezultatet.

Rregulla për Formatimin

Rregulla të përgjithshme për gjuhën dhe tipografinë

Gjuha - Raportet kombëtare do të hartohen në anglisht. Jeni të lutur që gjatë hartimit të studimit tuaj të përdorni ANGLISHTEN BRITANIKE.

Jeni të lutur të zgjidhni kuptimin e zakonshëm të një fjale (përdorimi i një kuptimi të paqartë mund ta ngatërrojë lexuesin, veçanërisht një folës jo-vendas); mos përdorni gjuhë pompoze; shmangni idiomat specifike të vendit; dhe përpiquni të përdorni të njëjtin term çdo herë.

Përdorni folje në formën veprore, kur është e mundur. Përdorni folje, jo emra ('duke prezantuar' në vend të 'me prezantimin e')

Shtojcat

Shkronjat - Shkronjat e përdorura duhet të jenë Times New Roman 11, duke përdorur opsionin e shtrirjes së tekstit.

Organizatat e huaja – Paraqisni emërtimet e institucioneve, gjykatave, organeve publike etj., në vende të ndryshme në gjuhën origjinale, duke dhënë përkthimin në kllapa kur përmenden për herë të parë; kjo është praktikë aktuale në Gjykatën e Drejtësisë dhe përmbush nevojën për qartësi që duhet të plotësojnë tekstet tona. Vini re se në tekstet e BE-së emra të tillë qëndrojnë në shkrimin romak: Ayuntamiento (Bashkia), An Chuirt Uachtarach (Gjykata e Lartë), Amtsgericht (Gjykata e Shkallës së Parë)

Shkurtimet dhe akronimet – Përsëri për hir të qartësisë, kur përmendet për herë të parë një shkurtim ose akronim i pazakontë, kështillohet që të shkruhet i plotë, në kllapa: ose qasja e kundërt dhe të jepet së pari termi i plotë, pastaj shkurtimi ose akronimi në kllapa: Ministria e Drejtësisë (MD).

Për të njëjtën temë, rregulli që ndiqet zakonisht është: paraqitini ato me *shkronja të mëdha* deri në jo më shumë se pesë shkronja: EAGGF, NATO, PHARE etj. Nga gjashtë shkronja e më tej, përdorni vetëm një shkronjë të madhe në fillim: Unctad, Ecosoc, Euratom etj. Si Komisioni ashtu dhe Këshilli e ndjekin këtë rregull dhe ne duhet ta bëjmë këtë gjithashtu kudo që të jetë e mundur.

Shumësat e shkurtimeve (NVM, VOC) nuk marrin apostrof.

Shkruani të gjitha shkurtimet latine (p.sh., ibid, i.e.,) me shkrim romak (jo me shkronja korsive).

Shkronjat korsive – Përdorni shkronjat korsive për parathëniet (të mos ngatërrohen me parathëniet ose hyrjet, të cilat shkruhen nga autori) nëse vetë teksti është në gjuhën romake. E njëjta gjë vlen për shkrimet pasuese, njoftimet e botuesit dhe çdo pjesë të veprës që nuk janë në dorën e autorit.[302]

Përdorni shkronjat korsive edhe për titullin e çdo vepre (gazetë, revistë etj.) kur përmendet emri i plotë: *The Independent*, *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian.* Bëni të njëjtën gjë me frazat që kanë një funksion dokumentar: *vazhdim, mbartet, vazhdon* etj. Mund ta përdorni këtë edhe për të theksuar tekstin (shih më poshtë).

302 Përdorni shkronja korsive për emrat e anijeve, aeroplanëve, etj. dhe veprave të artit, shkronjat për të treguar variablat (funksioni n), fjalët e huaja, përveç atyre të renditura më sipër, emrat shkencorë latinë dhe sistemin Latin të numrave *bis, ter, quater, etj.*

Theksimi– Theksoni një fjalë, shprehje ose fragment vetëm me shkronja të zeza, të theksuara.. Ju lutemi vini re se ky opsion duhet të përdoret me masë. Përdorimi i tepërt është joproduktiv. Shmangni theksimin e fjalëve ose frazave në shkrimet fundore. Ato janë vetëm për komente shtesë ose dytësore, ndërsa vendi i destinuar posaçërisht për theksim është *teksti*.

Pikat – Ju lutemi përdorni vetëm simbolet e mëposhtme (pika ose / dhe vija):

- Direktiva ...
* Direktiva

Vendi:	Shqipëri	Data e Plotësimit të Tabelës:
Personi(at) që plotësojnë tabelën:		

Hyrje e shkurtër:

[Ju lutemi tregoni aktin(et) kryesor transpozues.

Jepni çdo të dhënë paraprak ose sfond historik të posaçëm (nëse ka) që ju e konsideroni të nevojshëm për të kuptuar kontekstin e transpozimit. Jeni të lutur të jepni gjithashtu një përmbledhje të autoriteteve kompetente në kontekstin e zbatimit të Direktivës.

Renditni dhe përmblidhni të gjitha rastet e mos-përputhshmërisë të identifikuara në analizë]

Lista e ligjeve transpozuese (përfshirë referencat ligjore dhe shkurtimet e përdorura në Tabelën e Korrelacionit)

[*Filloni duke përmendur aktin (ose aktet) më të rëndësishme transpozuese dhe pastaj renditni të tjerët në rend kronologjik nga më i afërti te më i vjetri.*

Jeni të lutur të ndiqni këtë stil kur vendosni ligjin: përkthimi i emrit të aktit në anglisht, *emri i aktit në gjuhën e brendshme me shkronja korsive*, referenca e botimit në GZ-ë, ndryshimet (nëse ka) (shkurtimet e përdorura në TK-ë në kllapa).]

Shkurtime të tjera

- [*Vendosni shkurtimet e përdorura zakonisht,*
- *p.sh.,* AK: autoritetet kompetente]

I. Direktiva 2004/113/KE			II. Masat zbatuese të brendshme			III. Vlerësim	
Neni	Teksti në anglisht	Teksti në gjuhën vendase	(a) Akti, Neni nr.	(b) Teksti në gjuhën vendase	(c) Përkthimi në anglisht	(a) Plotësia (Po / Jo)	(b) Plotësia Konkluzione / komente: Plotësia, plotësia e pjesshme, jo e plotë
Kreu I - Dispozita të Përgjithshme [*Nëse Direktiva është e ndarë në Krerë, shkruani këtu Kreun dhe titullin e Kreut*]							
Neni 1 - Qëllimi [*Shkruani këtu Nenin dhe titullin e nenit*]							
1(1) [*Shkruani këtu numrin e nenit dhe paragrafin, sipas rastit*]	[*Shkruani këtu fjalinë e parë të Nenit 1*]	[*Shkruani këtu përkthimin në shqip të fjalisë së parë të Nenit 1*] [*Kontrolloni nëse Direktiva është përkthyer tashmë në shqip*]					[*Ngjyrosni në gri të lehtë sfondin e një rreshti, nëse dispozita:* *-nuk është e zbatueshme (N / A)* *-nuk është e nevojshme të transpozohet* *-është një parim i përgjithshëm që nuk është domosdoshmërish e nevojshme të transpozohet*]

Shtojcat

I. Direktiva 2004/113/KE			II. Masat zbatuese të brendshme			III. Vlerësim	
Neni	Teksti në anglisht	Teksti në gjuhën vendase	(a) Akti, Neni nr.	(b) Teksti në gjuhën vendase	(c) Përkthimi në anglisht	(a) Plotësia (Po / Jo)	(b) Plotësia Konkluzione / komente: Plotësia, plotësia e pjesshme, jo e plotë
1(1)(a) [*Shkruani këtu numrin e Nenit, paragrafin dhe shkronjën, sipas rastit*]	[*Shkruani këtu fjalinë e dytë të Nenit 1*] [*Nëse një nen ka më shumë se një fjali, secila fjali duhet të shkruhet në një rresht të veçantë*]	[*Përktheni çdo fjali*]					[*Fusha mbetet e bardhë kur dispozita është ose nuk transpozohet*]
Neni 2 – Përkufizime [*Sa herë që filloni me një nen të ri, mos harroni të përdorni një rresht pa kolona (si ky) dhe sfond me ngjyrë gri*]							

I. Direktiva 2004/113/KE			II. Masat zbatuese të brendshme			III. Vlerësim	
Neni	Teksti në anglisht	Teksti në gjuhën vendase	(a) Akti, Neni nr.	(b) Teksti në gjuhën vendase	(c) Përkthimi në anglisht	(a) Plotësia (Po / Jo)	(b) Plotësia Konkluzione / komente: Plotësia, plotësia e pjesshme, jo e plotë
[*Ndonjëherë një nen mund të përmbajë vetëm një paragraf dhe nuk është i numërtuar, prandaj mos shkruani këtu*]							

Shtojcat

I. Direktiva 2004/113/KE			II. Masat zbatuese të brendshme			III. Vlerësim	
Neni	Teksti në anglisht	Teksti në gjuhën vendase	(a) Akti, Neni nr.	(b) Teksti në gjuhën vendase	(c) Përkthimi në anglisht	(a) Plotësia (Po / Jo)	(b) Plotësia Konkluzione / komente: Plotësia, plotësia e pjesshme, jo e plotë
3(1)	[*Ndonjëherë një paragraf ka më shumë se një fjali, prandaj duhet të keni po aq rreshta sa edhe fjali. Mos përsëritni numrin e nenit dhe paragrafit sa herë që shkruani një fjali*] [*Shkruani këtu fjalinë e parë*]						
	[*Shkruani këtu fjalinë e dytë*]						

I. Direktiva 2004/113/KE			II. Masat zbatuese të brendshme			III. Vlerësim	
Neni	Teksti në anglisht	Teksti në gjuhën vendase	(a) Akti, Neni nr.	(b) Teksti në gjuhën vendase	(c) Përkthimi në anglisht	(a) Plotësia (Po / Jo)	(b) Plotësia Konkluzione / komente: Plotësia, plotësia e pjesshme, jo e plotë
	[*Shkruani këtu fjalinë e tretë*]						
3(2)	...						
	...						
							[*Ngjyroseni sfondin në jeshile të lehtë nëse transpozimi është fakultativ*]

Shtojca L
Listë kontrolli për përgatitjen e analizës së hapësirave ligjore dhe modeli i LGA

Përmbledhja në nivel kapitulli

Kjo pjesë e analizës së hapësirave/boshllëkut duhet të bëjë një krahasim të përgjithshëm të situatës aktuale me situatën e synuar. Situata e synuar është anëtarësimi në BE, çka nënkupton adoptimin e *acquis*.

Identifikimi i acquis

Në këtë fushë eksperti liston aktet në nivel nën-kapitulli që i janë nënshtruar analizës së hapësirave. Ekspertët nuk do të përfshijnë masat e *acquis* së BE-së, të cilat nuk kanë relevancë për Shqipërinë.

Analiza e hapësirave të nënkreut _____

Rregullorja për XYZ, CELEX Nr 123

Njohja e kërkesave kryesore të BE-së nga acquis-ja

Në këtë fushë, eksperti shpjegon parimet kryesore të aktit që duhet të arrihen me anë të nivelit të përputhshmërisë, detyrimet ligjore që dalin nga akti të cilat duhet të përmbushen nga vendi për t'u arritur harmonizimi dhe zbatimi i mekanizmave që duhet të përdoren për të mbrojtur të drejtat dhe detyrimet e parashikuara sipas masës së analizuar të *acquis*-së. Eksperti shpjegon ndikimin që do të ketë në sistemin e brendshëm zbatimi i masës së BE-së.

Identifikimi i dokumentit/teve të politikës së brendshme dhe e legjislacionit që rregullon fushën, dhe krahasimi midis kërkesave të acquis së BE-së dhe politikave të brendshme.

Në këtë fushë, eksperti vendos dokumentin ose dokumentet e brendshme që paraqesin transpozimin e masës së analizuar të *acquis*-së.
Ajo paraqet kuadrin e politikes së kësaj mase të BE-së, si strategjitë sektoriale dhe dokumente të tjerë të politikave, udhëzimet ekzistuese të politikave për fushën përkatëse në dokumentet strategjikë kombëtarë (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim etj.)
Më pas, analizohet legjislacioni konkret i brendshëm. Gjatë analizimit të legjislacionit ekzistues të brendshëm, nuk merret në konsideratë vetëm legjislacioni sektorial, por edhe legjislacioni përkatës horizontal. Kuadri legjislativ i brendshëm analizohet sipas kërkesave të *acquis*-së - nëse tashmë ato ekzistojnë në legjislacionin e brendshëm, nëse legjislacioni i brendshëm konfliktohet me to/nuk ekziston, ose kërkesa është përmbushur pjesërisht.
Nëse ekziston një dokument i vetëm që paraqet transpozimin e masës së *acquis* së analizuar, atëherë përmendet vetëm ai dokument. Nëse ka disa dokumente që plotësojnë dokumentin kryesor që paraqet transpozimin, atëherë ata përmenden individualisht dhe eksperti shpjegon mënyrën se si transpozimi është kryer duke adresuar secilin dokument të brendshëm individualisht. Për shembull, nëse një Direktivë është e transpozuar në një ligj, ligji analizohet i pari. Më pas, aktet nënligjore që derivojnë nga ligji shpjegohen individualisht. Nëse ekziston një ligj kryesor që përfaqëson transpozitën, atëherë, eksperti shpjegon ligjin, por liston edhe akte të tjerë të brendshëm që nuk përfaqësojnë transpozitën, por kanë ndërlidhje me fushën e rregulluar dhe detajojnë ndërlidhjet.
Në këtë pjesë eksperti paraqet:
- Krahasimin e kërkesave të *acquis* përkundrejt politikës së brendshme dhe kuadrit legjislativ dhe
- Identifikohen politikat dhe boshllëqet legjislative.

Tabelat e Përputhshmërisë janë dokumenti kryesor mbështetës për analizën e boshllëkut për secilën masë të *acquis* së BE-së. Ekspertët kontrollojnë disponueshmërinë e TP në shqip dhe në anglisht, dhe mbajnë një kopje. Në këtë seksion, ata përcaktojnë edhe disponueshmërinë e një TP për masën e analizuar të BE-së.
*Në rastet kur masa e analizuar nuk transpozohet në legjislacionin e brendshëm, në këtë seksion, nuk shënohet se nuk ekziston legjislacion i brendshëm që transpozon aktin e BE-së.

Identifikimi i institucioneve përgjegjëse, rolet dhe kapacitetet e tyre

Shtojcat

Në këtë fushë, eksperti liston institucionet përgjegjëse, rolet dhe kapacitetet e tyre për masën e acquis. Këtu, mund të vendoset përmbledhja e shkurtër e IAGA. *Në rastet kur masa e analizuar e acquis nuk transpozohet në legjislacionin e brendshëm, atëherë, ky seksion përcakton vetëm faktin.

Niveli i përputhshmërisë

Sipas analizës, në këtë fushë, eksperti paraqet vlerësimin për nivelin e përputhshmërisë, duke përcaktuar njërin nga sa më poshtë: - Harmonizimin e plotë - Harmonizimin e pjesshëm - I patranspozuar ende Për harmonizimin e plotë, nuk është deklaruar vlerësim shtesë. Për harmonizimin e pjesshëm, eksperti nënvizon arsyet për harmonizimin e pjesshëm, dhe përcakton se kur planifikon ministria të arrijë harmonizimin e plotë, dhe nëse akti i paraqitur për harmonizim të plotë ka qenë i planifikuar në PKIE. Në rastet kur masa e analizuar e acquis nuk është transpozuar ende, eksperti kontrollon nëse ministria ka pasur informacion për ekzistencën e kësaj mase, nëse masa ka qenë planifikuar në PKIE, nëse ministria përgjegjëse ka një përkthim për këtë mase (ose MEPJ, nëse nuk ka një institucion të përcaktuar), dhe të paraqitet çdo arsye tjetër përse masa nuk është transpozuar ende.

Rekomandimet e politikave për masën e acquis-së

Në këtë fushë eksperti paraqet rekomandimet për masën e analizuar të acquis. Kjo pjesë shërben si pikënisje për planifikimin e masave të së ardhmes që do të çojnë në përputhshmëri të plotë me acquis-në.

Rekomandimet institucionale për masën e acquis-së

Kur vlerësohet kapaciteti institucional i institucioneve përkatëse kombëtare për transpozimin, është e rëndësishme të identifikohet se cilin funksion të ri ose të modifikuar duhet të realizojnë institucionet, për të qenë në gjendje të zbatojnë masën e acquis së analizuar.

Tabela e LGA

Shtojcat

Acquis-ja e BE-së	Institucioni(et) Përgjegjës	Transpozuar në legjislacionin shqiptar nga	Niveli i harmonizimit Boshllëqe/Hapësirave	Plane për transpozim
I. Sektori i ...				
Acquis-ja e BE-së				
Akti ligjor i BE nn/vvvv i... në lidhje me...	Ministria...	Ligji nn/vvvv Ligji nn/vvvv Ligji nn/vvvv	[Ligji i brendshëm parashikon parimet e mëposhtme që kërkohen nga acquis e BE: ... Megjithatë, ligji i brendshëm nuk parashikon të drejtat, detyrimet dhe ndryshimet institucionale të mëposhtme: ...]	[Qeveria ka miratuar një strategji për të mbushur boshllëqet e identifikuara. Strategjia do të mbulohet sipas buxhetit të vitit vvvv dhe do të finalizohet përpara përfundimit të vitit vvvvv.]

Shtojca M
Listë kontrolli për përgatitjen e vlerësimin e hapësirave institucionale dhe administrative dhe modeli i IAGA

A. STRUKTURAT ADMINISTRATIVE DHE INSTITUCIONALE

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
1. TITULLI I NËNKAPITULLIT							

303 Lista me emrat e institucioneve/njësive përgjegjëse për i) transpozimin; ii) planifikimin e politikave dhe/ose monitorimin dhe raportimin, (nëse nuk është njëlloj me institucionin përgjegjës për transpozimin); iii) zbatimi (p.sh. Licencimi, inspektimi dhe zbatimi, infrastruktura ose funksione të tjerë - për t'u përcaktuar). Ju lutemi, përdorni një rresht të veçantë për secilin lloj institucioni/njësie.

304 Përfshin informacionet për: linjën e llogaridhënies; pavarësinë (procedura e emërimit dhe mandati i drejtuesit), burimi i financimit, buxhetin vjetor, numri i burimeve njerëzore për aktivitete individuale.

305 Përfshin informacionet për planin e zhvillimit institucional: nëse një institucion i ri duhet të ngrihet ose nëse institucionet ekzistuese duhet të jenë në linjë me kërkesat e acquis (p.sh. Pavarësia, linja e llogaridhënies etj.), të rritet numri i stafit, trajnime dhe/ose masa të tjera për zhvillimin e kapaciteteve.

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
				Institucioni/ njësia përgjegjëse për transpozim: **XXX** -Institucioni/ njësia përgjegjëse për planifikimin e politikave dhe/ ose monitorimin dhe raportimin (nëse janë të ndryshme nga institucioni përgjegjës për transpozimin): **XXX**	-Linja e llogaridhënies: **XXX** -Pavarësia (procedura e emërimit dhe mandati i drejtuesit): **XXX** Nëse është e zbatueshme, nuk është e nevojshme për çdo herë. -Burimi i financimit: **XXX** - Buxheti vjetor **XXX**	- nëse duhet të ngrihet një institucion i ri Kjo është një masë si zgjidhja e fundit, dhe është më e mirë për të rregulluar funksionet e reja në strukturat ekzistuese sa më shumë të jetë e mundur. - nëse duhet të ngrihet një institucion i ri	

Shtojcat

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
				-Institucioni/ njësia përgjegjëse për zbatim (licencimi, inspektimi dhe zbatimi, infrastruktura ose të tjera - për t'u përcaktuar - funksione): **XXX** Kjo ndarje në transpozim, planifikim dhe zbatim duhet të zbatohet vetëm në rastet relevante.	-Linja e llogaridhënies: **XXX** -Pavarësia (procedura e emërimit dhe mandati i drejtuesit): **XXX** -Burimi i financimit: **XXX** - Buxheti vjetor **XXX** - Numri i burimeve njerëzore për aktivitete të caktuara: **XXX**	- nëse institucioni(et) ekzistues duhet të jetë në linjë me kërkesat e acquis-së, p.sh.: Për pavarësinë, linjën e llogaridhënies; funksionet; detyrat etj.) Për rritjen e numrit të stafit, si edhe kompetencat e tyre me anë të trajnimeve dhe/ ose masave	

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
				Institucioni/ njësia përgjegjëse për transpozim: **XXX** -Institucioni/ njësia përgjegjëse për planifikimin e politikave dhe/ ose monitorimin dhe raportimin (nëse janë të ndryshme nga institucioni përgjegjës për transpozimin): **XXX**	- Numri i burimeve njerëzore për aktivitete të caktuara: **XXX**	të tjera për zhvillimin e kapaciteteve. - nëse isntitucioni(et) ekzistues duhet të jetë në linjë me kërkesat e acquis-së, p.sh.: Për pavarësinë, linjën e llogaridhënies; funksionet; detyrat etj.)	

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
				-Institucioni/ njësia përgjegjëse për zbatim (licencimi, inspektimi dhe zbatimi, infrastruktura ose të tjera - për t'u përcaktuar - funksione): **XXX**		Për rritjen e numrit të stafit, si edhe kompetencat e tyre me anë të trajnimeve dhe/ose masave të tjera për zhvillimin e kapaciteteve.	
2. TITULLI I NËNKAPITULLIT							

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
				Institucioni/ njësia përgjegjëse për transpozim: **XXX** -Institucioni/ njësia përgjegjëse për planifikimin e politikave dhe/ ose monitorimin dhe raportimin (nëse janë të ndryshme nga institucioni përgjegjës për transpozimin): **XXX**	-Linja e llogaridhënies: **XXX** -Pavarësia (procedura e emërimit dhe mandati i drejtuesit): **XXX** -Burimi i financimit: **XXX** - Buxheti vjetor **XXX** - Numri i burimeve njerëzore për aktivitete të caktuara: **XXX**	- nëse duhet të ngrihet një institucion i ri - nëse institucioni(et) ekzistues duhet të jetë në linjë me kërkesat e acquis-së, p.sh.: Për pavarësinë, linjën e llogaridhënies; funksionet; detyrat etj.)	

Shtojcat

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
				-Institucioni/ njësia përgjegjëse për zbatim (licencimi, inspektimi dhe zbatimi, infrastruktura ose të tjera - për t'u përcaktuar - funksione): **XXX**		Për rritjen e numrit të stafit, si edhe kompetencat e tyre me anë të trajnimeve dhe/ ose masave të tjera për zhvillimin e kapaciteteve.	
				Institucioni/ njësia përgjegjëse për transpozim: **XXX** -Institucioni/ njësia përgjegjëse për planifikimin e	-Linja e llogaridhënies: **XXX** -Pavarësia (procedura e emërimit dhe mandati i drejtuesit): **XXX**	- nëse duhet të ngrihet një institucion i ri - nëse institucioni(et) ekzistues duhet të jetë në linjë me kërkesat e acquis-së, p.sh.:	

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
				politikave dhe/ ose monitorimin dhe raportimin (nëse janë të ndryshme nga institucioni përgjegjës për transpozimin): **XXX** -Institucioni/ njësia përgjegjëse për zbatim (licencimi, inspektimi dhe zbatimi, infrastruktura ose të tjera - për t'u përcaktuar - funksione): **XXX**	-Burimi i financimit: **XXX** - Buxheti vjetor **XXX** - Numri i burimeve njerëzore për aktivitete të caktuara: **XXX**	Për pavarësinë, linjën e llogaridhënies; funksionet; detyrat etj.) Për rritjen e numrit të stafit, si edhe kompetencat e tyre me anë të trajnimeve dhe/ ose masave të tjera për zhvillimin e kapaciteteve.	

Shtojcat

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
3. TITULLI I NËNKAPITULLIT							
				Institucioni/ njësia përgjegjëse për transpozim: **XXX** -Institucioni/ njësia përgjegjëse për planifikimin e politikave dhe/ ose monitorimin dhe raportimin (nëse janë të ndryshme nga institucioni përgjegjës për transpozimin): **XXX**	-Linja e llogaridhënies: **XXX** -Pavarësia (procedura e emërimit dhe mandati i drejtuesit): **XXX** -Burimi i financimit: **XXX** - Buxheti vjetor **XXX** - Numri i burimeve njerëzore për aktivitete të caktuara: **XXX**	- nëse duhet të ngrihet një institucion i ri - nëse institucioni(et) ekzistues duhet të jetë në linjë me kërkesat e acquis-së, p.sh.: Për pavarësinë, linjën e llogaridhënies; funksionet; detyrat etj.)	

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
				-Institucioni/ njësia përgjegjëse për zbatim (licencimi, inspektimi dhe zbatimi, infrastruktura ose të tjera - për t'u përcaktuar - funksione): **XXX**		Për rritjen e numrit të stafit, si edhe kompetencat e tyre me anë të trajnimeve dhe/ ose masave të tjera për zhvillimin e kapaciteteve.	
				Institucioni/ njësia përgjegjëse për transpozim: **XXX** -Institucioni/ njësia përgjegjëse për planifikimin e	-Linja e llogaridhënies: **XXX** -Pavarësia (procedura e emërimit dhe mandati i drejtuesit): **XXX**	- nëse duhet të ngrihet një institucion i ri - nëse institucioni(et) ekzistues duhet të jetë në linjë me kërkesat e acquis-së, p.sh.:	

Shtojcat

Shtojcat

Acquis e BE/ standardi dhe/ose politikat europiane	Struktura administrative e nevojshme për zbatimin e standardeve të acquis/ europiane	Elemente kyçe të strukturës administrative sipas standardeve europiane të acquis.	Akte ligjorë të brendshëm ku përcaktohet struktura e kërkuar	Ngritja institucionale[303]	Përshtatja dhe funksionimi i strukturës administrative[304]	Boshllëqet dhe masat për përforcimin e strukturës dhe kapaciteteve administrative[305]	Data e synuar dhe aspekte financiare
				politikave dhe/ ose monitorimin dhe raportimin (nëse janë të ndryshme nga institucioni përgjegjës për transpozimin): **XXX** -Institucioni/ njësia përgjegjëse për zbatim (licencimi, inspektimi dhe zbatimi, infrastruktura ose të tjera - për t'u përcaktuar - funksione): **XXX**	-Burimi i financimit: **XXX** - Buxheti vjetor **XXX** - Numri i burimeve njerëzore për aktivitete të caktuara: **XXX**	Për pavarësinë, linjën e llogaridhënies; funksionet; detyrat etj.) Për rritjen e numrit të stafit, si edhe kompetencat e tyre me anë të trajnimeve dhe/ ose masave të tjera për zhvillimin e kapaciteteve.	

B. ZBATIMI

Kërkesë që buron prej acquis-së/ standardeve të BE-së/ strategjisë së BE-së	Kritere specifike që burojnë prej acquis-së/ standardeve të BE-së/ strategjisë së BE-së[306]	Politikat / strategjia/ legjislacioni i brendshëm (parësor dhe dytësor)	Institucioni përgjegjës për zbatimin	Zbatimi / të dhënat[307]
1. TITULLI I NËNKAPITULLIT				
				- Raporte/monitorimi i përputhshmërisë me direktivën nga autoriteti kompetent - Numri i opinioneve/raporteve të publikuar - Numri i çështjeve administrative/ çështjeve gjyqësore/inspektimeve/ gjobave/kontratave etj. (Gjithçka në lidhje me të dhënat për zbatimin) - Numri i trajnime etj.

306 Kryesisht mbështetur në pyetjet e Komisionit Evropian për Raportin Vjetor.
307 Përfshin informacione (për xx vitet e fundit) për numrin e çështjeve, numrin e opinioneve/raporteve të publikuar, etj.

Shtojcat

Kërkesë që buron prej acquis-së/ standardeve të BE-së/ strategjisë së BE-së	Kritere specifike që burojnë prej acquis-së/ standardeve të BE-së/ strategjisë së BE-së[306]	Politikat / strategjia/ legjislacioni i brendshëm (parësor dhe dytësor)	Institucioni përgjegjës për zbatimin	Zbatimi / të dhënat[307]
2. TITULLI I NËNKAPITULLIT				
2.1 Titulli i nën-nënkapitullit ……				
				- Raporte/monitorimi i përputhshmërisë me direktivën nga autoriteti kompetent - Numri i opinioneve/raporteve të publikuar - Numri i çështjeve administrative/ çështjeve gjyqësore/inspektimeve/ gjobave/kontratave etj. (Gjithçka në lidhje me të dhënat për zbatimin) - Numri i trajnime etj.
3. TITULLI I NËNKAPITULLIT				
3.1. Titulli i nën-nënkapitullit ……				

Kërkesë që buron prej acquis-së/ standardeve të BE-së/ strategjisë së BE-së	Kritere specifike që burojnë prej acquis-së/ standardeve të BE-së/ strategjisë së BE-së[306]	Politikat / strategjia/ legjislacioni i brendshëm (parësor dhe dytësor)	Institucioni përgjegjës për zbatimin	Zbatimi / të dhënat[307]
				- Raporte/monitorimi i përputhshmërisë me direktivën nga autoriteti kompetent - Numri i opinioneve/raporteve të publikuar - Numri i çështjeve administrative/ çështjeve gjyqësore/inspektimeve/ gjobave/kontratave etj. (Gjithçka në lidhje me të dhënat për zbatimin) - Numri i trajnime etj.
3.2. Titulli i nën-nënkapitullit				

Kërkesë që buron prej acquis-së/ standardeve të BE-së/ strategjisë së BE-së	Kritere specifike që burojnë prej acquis-së/ standardeve të BE-së/ strategjisë së BE-së[306]	Politikat / strategjia/ legjislacioni i brendshëm (parësor dhe dytësor)	Institucioni përgjegjës për zbatimin	Zbatimi / të dhënat[307]
3.3. Titulli i nën-nënkapitullit				
				- Raporte/monitorimi i përputhshmërisë me direktivën nga autoriteti kompetent - Numri i opinioneve/raporteve të publikuar - Numri i çështjeve administrative/ çështjeve gjyqësore/inspektimeve/ gjobave/kontratave etj. (Gjithçka në lidhje me të dhënat për zbatimin) - Numri i trajnimeve etj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

EURALIUS Consolidation of the Justice System in Albania

IRZ

CILC Center for International Legal Cooperation

aed

CSM Consiglio Superiore della Magistratura

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 71
Datë: 2022/05/13 13:07:18
eb21a4e4-ce57-4035-8934-d51133e9454f

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 1504 lekë